

## PËRMBAJTJA

<i>Parathënie</i> .....	4
<i>Hyrje</i> .....	5
<i>Objekti dhe hipotezat e punimit</i> .....	5
<b>0.2. Metodologjia dhe struktura e punimit</b> .....	7
<b>0.3. Përkthimet e teksteve shqipe nga Lamerci dhe studimet në fushë të gjuhësisë dhe të letërsisë</b> ...	9
<b>0.3.1. Tekstet shqipe të përkthyer në gjermanisht</b> .....	10
<b>0.3.2. Studimet për folklorin letrar dhe letërsinë</b> .....	11
<b>0.3.3. Studimet në fushë të gjuhësisë</b> .....	14
<b>1. GJUHËSIA KONTRASTIVE DHE GJUHËSIA TEKSTORE (PASQYRË E ZHVILLIMIT HISTORIK)</b> .....	16
<b>1.1. Fillet e gjuhësisë krahasimtare dhe kontrastive</b> .....	16
<b>1.2. Gjuhësia kontrastive (sinkronike)</b> .....	18
<b>1.3. Zhvillimi i gjuhësisë tekstore</b> .....	21
<b>2. KONSIDERATA TEORIKE PËR GJUHËSINË E TEKSTIT</b> .....	23
<b>2.1. Kuptimi i konceptit tekst</b> .....	23
<b>2.2. Përkufizime mbi kohezionin dhe koherencën e tekstit</b> .....	25
<b>2.3. Tekstualiteti dhe përmbushja e kriterëve komunikative të tekstit</b> .....	29
<b>2.4. Tema dhe rema – përbërës informativë të tekstit</b> .....	31
<b>2.5. Kategoritë semantike të tekstit – konteksti dhe koteksti</b> .....	36
<b>3. ÇËSHTJE TË TIPOLOGJISË SË TEKSTIT</b> .....	38
<b>3.1. Grupet e tekstit</b> .....	38
<b>3.2. Tipat e tekstit</b> .....	39
<b>3.3. Format e tekstit</b> .....	40
<b>3.3.1. Variantet e gjuhës</b> .....	43
<b>3.3.2. Kompozicioni</b> .....	44
<b>4. KONSIDERATA TEORIKE PËR FOLJET DHE KONEKTORËT</b> .....	45
<b>4.1. Format e foljeve – konstituentë të rëndësishëm të strukturës së tekstit dhe diskursit</b> .....	45
<b>4.1.1. Funkcioni i kohës (Tempus) në tekst</b> .....	46

4.1.2. Kuptime të mënyrës së foljes ( <i>Modus</i> ) .....	54
4.1.3. Përkufizime të aspektit ( <i>Aspekt</i> ) dhe mënyrës së veprimit ( <i>Aktionsart</i> ).....	58
4.1.4. Funkzioni i vetës ( <i>Person</i> ) dhe numrit ( <i>Numerus</i> ) në situatën e ligjërit .....	61
4.1.5. Diateza .....	63
4.1.6. Format e pashtjelluara të foljeve ( <i>infinite Verbformen</i> ) dhe funksioni i tyre .....	66
4.2. Mendime të studiuesve për konektorët e tekstit .....	71
4.2.1. Mbi konektorët ( <i>junktorët</i> ) e gjuhës gjermane .....	73
4.2.2. Mbi konektorët e gjuhës shqipe .....	76
5. ANALIZË TEKSTORE DHE KONTRASTIVE E PËRKTHIMEVE TË LAMBERCIT .....	80
5.1. Rreth kritereve të analizës .....	80
5.2. Korpusi dhe analiza e korpusit.....	82
5.2.1. Tekstet e letërsisë gojore të përkthyer në gjermanisht .....	83
5.2.2. Tekstet e letërsisë së shkruar të përkthyer në gjermanisht.....	85
5.3. Përdorimi i kohëve të mënyrës dëftore ( <i>Indikativ</i> ) në tekstet shqipe dhe në tekstet e përkthyer .....	87
5.4. Përdorimi i kohëve të mënyrës lidhore ( <i>Konjunktiv</i> ) në tekste.....	99
5.5. Mënyra urdhërore e foljeve në tekste ( <i>Imperativ</i> ).....	109
5.6. Përdorimi dhe kuptimi i mënyrës dëshirore në tekste ( <i>Optativ</i> ) .....	118
5.7. Mënyra habitore ( <i>Admirativ</i> ) në tekste.....	124
5.8. Mënyra kushtore në tekste ( <i>Volitiv</i> ) .....	129
5.9. Format e pashtjelluara të foljeve në tekste ( <i>infinite Verbformen</i> ).....	133
6. HULUMTIMI I KONEKTORËVE NË TEKSTET SHQIPE DHE NË TEKSTET E PËRKTHYERA .....	144
6.1. Tekstet e analizuara me lidhëza që krijojnë marrëdhënie shtesore .....	145
6.2. Tekstet e analizuara me lidhëza që krijojnë marrëdhënie kundërshtore .....	150
6.3. Tekstet e analizuara me lidhëza që krijojnë marrëdhënie shkakore.....	154
7. VËSHTIMI I PËRGJITHSHËM I PËRDORIMIT TË SHENJAVE NOMINALE, DETERMINANTËVE DHE REFERENTËVE TË TYRE .....	158
7.1. Shenjat nominale, determinantët dhe referencat e tyre në tekste .....	159
8. STILI I TEKSTEVE TË ANALIZUARA .....	169
8.1. Folja – shenjë stilistike e teksteve të analizuara.....	170
TEKSTET E ANALIZUARA .....	180
PËRFUNDIME .....	309

<b>ZUSAMMENFASSUNG</b> .....	320
<b>BURIMET</b> .....	324
<b>BIBLIOGRAFIA:</b> .....	325
<b>INDEKSI I EMRAVE</b> .....	335
<b>INDEKSI I TERMAVE</b> .....	339

## *Parathënie*

Studimet kontrastive kanë qenë qysh herët synim i interesimeve të mia. Prandaj, pas mbarimit të studimeve pasuniversitare, në punimin tim të magistraturës kam trajtuar mënyrën lidhore të shqipes dhe të gjermanishtes në rrafsh krahasimtar. Këtë çështje e kam hulumtuar në tekstet e shqipes të përkthyer në gjuhën gjermane, të shtrirë vetëm brenda fjalisë dhe në mënyrë të shkëputur nga konstituentët e tjerë të rëndësishëm të tekstit. Që atëherë më ishte zgjuar kureshtja për studimin e tekstit si njësi integrale dhe për funksionin e analizës së shenjave tekstore që e ndërtojnë atë. Këto interesime të mia fillimisht i kam diskutuar me kolegët e mi, të cilët kanë shënuar rezultate në fushë të studimeve të tekstit dhe të analizës tekstore e kontrastive, me ç'rast kemi ardhur në përfundim që interesimet e mia për caktimin e tezës së disertacionit të doktoratës t'i orientoj në këtë fushë. Pas konsultimeve të shumta u dakordua që t'u bëhet analizë tekstore teksteve shqipe të përkthyer në gjermanisht nga albanologu i njohur austriak Maksimilian Lamberg dhe në punën time gjatë shtjellimit të tezës së doktoratës të titulluar „Përkthimet në gjermanisht të teksteve shqipe nga Maksimilian Lamberg – analizë tekstore”, të më udhëheqë mentorja prof.Flutura Çitaku dhe bashkëmentori prof.Izer Maksuti.

Pasiqë, sigurova pjesën më të madhe të teksteve shqipe të përkthyer në gjermanisht nga M. Lamberg, gjegjësisht korpusin e teksteve, në të cilat do të mbështetja analizat e bëra tekstore dhe kontrastive, mentorja prof.Flutura Çitaku më orientoi në literaturën e nevojshme për hartimin e këtij studimi. Prandaj, edhe në këtë rast e konsideroj të nevojshme t'i falënderoj për zemërsisht mentoren dhe bashkëmentorin për iniciimin e këtij punimi si dhe për sugjerimet, ndihmën dhe përkrahjen e madhe, që më kanë ofruar gjatë trajtimit të problemeve, me të cilat jam ballafaquar në të gjitha fazat e punës sime.

## *Hyrje*

### *Objekti dhe hipotezat e punimit*

Synimi i tezës së disertacionit të doktoratës „Përkthimet në gjermanisht të teksteve shqipe nga Maksimilian Lamerci – analizë tekstore” është paraqitja, analiza dhe krahasimi i shenjave tekstformuese në gjuhën shqipe dhe në gjuhën gjermane.

Ky punim synon, që brenda caqeve të lejueshme për një punim të tillë si studim teorik përfaqësues, të shqyrtojë realizimin e mjeteve apo shenjave gjuhësore, ku do të spikaten dallimet dhe ngjashmëritë mes të dyja gjuhëve. Gjithashtu, do të bëhen përpjekje të paraqiten edhe përkimet mes tyre si dy gjuhë indoevropiane. Në këtë drejtim do të trajtohen në mënyrë më të vëmendshme dhe më të thelluar folja, konektorët dhe shenjat nominale. Vetë tema e disertacionit nuk përjashton dhe trajtimin e shenjave të tjera tekstformuese, mirëpo gjatë analizave që do të bëhen, do të ndalemi më shkurt në këto shenja. Kjo nuk nënkupton se këto shenja nuk janë po aq të rëndësishme për strukturën kohezive e koherente të tekstit sa dhe folja, konektorët dhe shenjat nominale, por një trajtim më i thelluar i tyre do të përfshinte një punë shumë të gjerë.

Përkthimi dhe analiza e këtyre shenjave tekstore në punim do të mbështetet në tekstet shqipe, të cilat Lamerci i ka përkthyer në gjermanisht, kryesisht nga dialekti gegë i shqipes. Meqenëse, korpusi i këtyre teksteve është tepër i gjerë, atëherë përzgjedhja e tyre do të bëhet sipas modeleve letrare, karakteristike e së cilave është teksti narrativ. Prandaj, shqyrtimi i shenjave tekstformuese si foljet, konektorët dhe shenjat e tjera tekstore do të jetë qëllimi kryesor i këtij studimi.

Duke u mbështetur në studimet e gjuhësisë së tekstit do të bëhet përpjekje të paraqitet baza teorike, si nevojë e domosdoshme për të analizuar në mënyrë sa më të plotë shenjat tekstformuese të gjuhës shqipe në raport me shenjat apo elementët tekstformues në gjuhën gjermane. Në këtë mënyrë do të bëhet përpjekje t'u jepen përgjegje këtyre çështjeve:

- Ç'janë teksti dhe tekstualiteti ?
- Cilat janë kriteret kryesore dhe të dorës së dytë të ndërtimit të tekstit ?
- Cilët janë mekanizmat e kohezionit të tekstit ?
- Cilët janë përbërësit informativë të tekstit ?
- Cilat janë kategoritë semantike të tekstit ?
- Cilët janë tipat e teksteve ?

Ndërkaq, duke u marrë me foljen dhe funksionin e saj në tekst, do të mundohemi t'i zgjidhim këto çështje :

- Si përkufizohen dhe si shfaqen format finite (të shtjelluara) të foljeve në gjuhën shqipe dhe gjuhën gjermane ?
- Si konceptohen teoritikisht dhe si shfaqen në tekstet e shqipes dhe në tekstet e përkthyerat format e pashtjelluara (infinite) të foljes?
- Si dalin raportet kohore në tekstet e analizuara ?
- Si bëhet përkufizimi teorik i mënyrave të foljes dhe a dallojnë ato mes këtyre dy gjuhëve ?
- Cilat janë diatezat e foljes në gjuhën shqipe dhe gjuhën gjermane dhe si shfaqen ato në tekste ?

Veç këtyre çështjeve do të fokusohemi dhe në rëndësinë e konektorëve (lidhëzorëve) si mekanizma të kohezionit të tekstit, gjegjësisht si mekanizma të lidhjes së fjalive të tekstit, ku do të spikatet klasifikimi i kuptimeve të tyre në tekst apo klasifikimi semantik, por edhe klasifikimi morfologjik dhe sintaksor. Në këtë drejtim do të sqarohen çështjet si:

- Ç'janë konektorët dhe ç'funksion kryejnë ata në tekst ?
- Cilët janë llojet e konektorëve në gjuhën shqipe dhe gjermane ?
- Cilat janë marrëdhëniet që realizojnë konektorët në të dy gjuhët ?
- A llogariten vetëm lidhëzat si konektorë, apo edhe pjesëzat dhe ndajfoljet?

Krahas foljeve, si shenja që e organizojnë tekstin dhe konektorët, si shenja që bëjnë lidhjen e tekstit, në studim do të shqyrtohen në mënyrë më të përmbledhur dhe funksionet e disa shenjave të tjera tekstore, siç janë emri, determinantët dhe referentët e tij.

Dhe fare në fund do të shtrohen këto çështje:

- Si realizohet funksioni stilistik i teksteve letrare të analizuara përmes shenjave finite verbale, shenjave infinite verbale dhe konektorëve ?

## ***0.2. Metodologjia dhe struktura e punimit***

Punimi „Përkthimet në gjermanisht të teksteve shqipe nga Maksimilian Lamerci – analizë tekstore”, si studim përmasës – kontrastiv merret me analizën dhe krahasimin e shenjave tekstformuese në gjuhën shqipe dhe gjuhën gjermane. Prandaj, ky punim

pashmangshëm mbështetet në metodën kontrastive të analizës, e cila zë fill në Gjermani në shek.18 e veçanërisht në shek 19.<sup>1</sup> Pra, metoda kontrastive e analizës, e cila është zhvilluar krahas gjuhësisë kontrastive, do të na mundësojë ndriçimin e dallimeve që do të dalin në tekstet e përkthyer në gjuhën gjermane nga shqipja, meqë kjo metodë në radhë të parë spikat kontrastet a dallimet mes gjuhëve duke mos lënë anash dhe ngjashmëritë që kanë ato dhe duke i studiuar gjuhët gjithëherë në sinkroni.

Për këtë hulumtim përmasës jemi mbështetur në një literaturë të nevojshme, ku përfshihen vepra dhe studime të hershme, por edhe teoritë dhe gramatikat më të reja për tekstin në të dy gjuhët. Kurse, ana empirike e analizës mbështetet në shembuj të përzgjedhur nga shqipja në gjermanisht.

Në pjesën e parë të punimit, pas dhënies së korpusit, në të cilin do të mbështetet punimi, do të shtrohen çështje të përgjithshme teorike të gjuhësisë së tekstit, ku do të jepet përkufizimi i kuptimit tekst dhe tekstualitet. Në këtë pjesë do të shqyrtohen dhe konstituentët e tekstit duke mos përjashtuar dhe përkufizimet teorike për *temën* dhe *remën*. Në vazhdim të kësaj pjese do të shfaqen dhe çështje teorike për format e shtjelluara të foljeve (finite Verbformen) në kuadër të tekstit, siç janë: koha (Tempus), mënyra (Modus), aspekti dhe mënyra e veprimit (Aspekt und Aktionsart), veta dhe numri (Person und Numerus) dhe diateza e foljeve (Diathese) në të dy gjuhët. Edhe format e pashtjelluara të foljeve (infinite Verbformen) të shqipes dhe gjermanishtes do të jenë pjesë e këtij kapitulli. Gjithashtu, në këtë pjesë do të futen çështje teorike të konektorëve të tekstit, llojet e konektorëve dhe marrëdhëniet që krijojnë ata në lidhjen e fjalive në gjuhën shqipe dhe gjermane, bazë teorike kjo e domosdoshme për të bërë analiza tekstore në të dy gjuhët.

Në pjesën qendrore të punimit do të bëhen analiza të shenjave tekstformuese, e veçanërisht të foljeve dhe konektorëve në një numër tekstesh të përzgjedhura nga korpusi. Në këtë mes do të analizohet funksioni i këtyre shenjave tekstore dhe rëndësia e

---

<sup>1</sup> Rein,K., Einführung in die Kontrastive Linguistik, Wissenschaftliche Buchgesellschaft Darmstadt, 1983, f.7



tyre në ndërtimin e kohezionit dhe të koherencës së tekstit si dhe struktura e tekstit kur këto mjete gjuhësore mungojnë. Natyrisht, gjithë kjo punë do të realizohet duke pasur gjithmonë parasysh krahasimet që do të bëhen në shembujt e përzgjedhur të teksteve në shqipe dhe në gjermanishte. Mirëpo, në këtë drejtim, nuk do të lihet anash as analiza e shenjave të tjera tekstore, siç janë emri, determinantët dhe referentët e tij, si dhe çështje të stilit në të dy gjuhët të realizuara me anë të shenjave tekstore finite verbale, shenjave infinite verbale, konektorëve etj.

Tekstet, të cilat do të analizohen do të jenë aneks i punimit, i cili do të vendoset pas analizës. Secila analizë do të identifikohet me shembullin e tekstit me shenjë të njejtë në aneks.

Dhe në fund, në mënyrë të sintetizuar do të paraqiten rezultatet e analizave të bëra. Rezultatet e punimit do të jepen në gjuhën shqipe dhe në gjuhën gjermane.

### ***0.3. Përktimet e teksteve shqipe nga Lamberci dhe studimet në fushë të gjuhësisë dhe të letërsisë***

Traditën e studiuesve austriakë në fushë të albanologjisë, të nisur nga dijetarët Johann Georg von Hahn, Gustav Mayer dhe Norbert Jokli, do ta vazhdonte më tutje studiuesi vienez Maksimilian Lambertz, i cili kishte studiuar në Vjenë gjuhësinë e krahasuar indoevropiane te profesori i njohur Paul Kretschmer dhe filologjinë klasike<sup>2</sup>. I pajisur me njohuri nga gjuhësia e krahasuar indoevropiane dhe filologjia klasike, ai tërë jetën do të merrej me kompetencë shkencore me gjuhët dhe kulturat e popujve të Ballkanit. Në fillim të karrierës së vet shkencore afirmohet me studimet për greqishten, ndërsa që nga kontakti i parë me gjuhën shqipe, në vitin 1906, i zgjohet kërshtëria për këtë

<sup>2</sup> Çabej, E., Studime gjuhësore V, Prishtinë, 1975, f.80

gjuhë dhe deri në vdekje ai do të merrej aktivisht dhe me pasion me studimin e gjuhës shqipe, të letërsisë, etnologjisë, folklorit letrar, me hartimin e teksteve shkollore për mësimin e shqipes dhe me përkthimin e teksteve shqipe në gjermanisht. Në studimet e bëra sidomos në shkencat albanologjike, ai u afirmua dhe bëri emër në botën e studimeve shkencore të kohës. Prandaj, kontributet e Lambercit që u përkasin disa disiplineve do të bëhen mbështetje e rëndësishme për studimet e mëvonshme albanologjike.

### ***0.3.1. Tekstet shqipe të përkthyer në gjermanisht***

Përkthimet e teksteve shqipe të Lambercit në gjermanisht kanë një rëndësi të madhe për lexuesin e huaj ( gjerman ) dhe paraqesin lëndë të rëndësishme për studime gjuhësore. Ndryshe nga studimet që ai bëri në fushë të gjuhësisë shqiptare, letërsisë, folklorit letrar dhe etnologjisë, për të cilat është shkruar, përkthimet e teksteve shqipe në gjermanisht deri më sot nuk janë studiuar fare. Prandaj, ky studim për herë të parë synon të trajtojë analizën tekstore e kontrastive të këtyre përkthimeve. Tekstet shqipe, të cilat i ka përkthyer Lamberci janë të vëllimshme dhe u takojnë dy formave të krijimtarisë letrare: folklorit letrar dhe letërsisë së shkruar.<sup>3</sup>

---

<sup>3</sup> Vepra më e rëndësishme me tekste shqipe të përkthyer në gjermanisht konsiderohet koleksioni „ Albanische Märchen und andere Texte zur albanischen Volkskunde“ (Wien, 1922) . Vepra ka një hyrje të gjatë (fq.1-101). Ndërsa, në vazhdim janë përfshirë tekste në shqip dhe gjermanisht të gojëdhënave demonologjike, në të cilat flitet për përmbajtjen demonike të figurave të besimeve popullore, siç janë kuçedra, dragoi, shtrigat, lugetërit, shtojzovallet, floçkat, harapi i detit, si dhe të gojëdhënave që flasin për ndërtimin e kështjellave. Në këtë pjesë të librit janë përkthyer gjithsej 41 gojëdhëna. Në pjesën e dytë të kësaj vepre janë përfshirë një numër përrallash popullore, nga treva të ndryshme si Dibër, Elbasan, Zadrimë, Tiranë, Shkodër, Prishtinë etj. Bota e përrallës

### 0.3.2. Studimet për folklorin letrar dhe letërsinë

Maksimilian Lamerci interesimet e para i shfaqti për folklorin letrar, gjegjësisht për letërsinë gojore. Puna e tij rreth gjurmimit, mbledhjes, studimit, përkthimit dhe botimit të folklorit letrar shqiptar nis gjatë Luftës së Parë Botërore me rastin e ekspeditave të tij të bëra në terren që nga Veriu, Shqipëria e Mesme e deri në Jug. Rezultat i këtyre hulumtimeve do të jetë vepra e tij monografike “Die Volks poesie der Albaner” - „Poezia popullore e shqiptarëve”. Në këtë vepër, për herë të parë në studimet

---

shqiptare në gjuhën gjermane nga Lamerci është dhënë dhe në përmbledhjet , „Zwischen Drin und Vojussa” (Leipzig und Wien, 1922) dhe „Albanien erzählt” (Berlin, 1956).

Ndër përkthimet që Lamerci i bëri nga folklori shqiptar hyn dhe vepra „Die Volksepik der Albaner” (Halle- Saale, 1958), ku botohen të përkthyer gjithsej 20 këngë kreshnike të përzgjedhura, me vlera artistike dhe që janë perla të eposit legjendar. Tekstet e këtyre njëzet këngëve të përkthyer në gjermanisht janë marrë të gjitha nga koleksioni antologjik i autorëve Bernardin Palaj dhe Donat Kurti „Visaret e kombit II- Kangë kreshnikësh dhe legenda”. Ndërkaq, në pjesën e dytë të këtij libri është përfshirë studimi i rëndësishëm i Lamercit ku flitet për strukturën artistike të modelit të moçëm epik gojor-këngës kreshnike. Poashtu, tekste nga poezia gojore të përkthyer në gjuhën gjermane janë përfshirë dhe në studimin monografik „Die Volks poesie der Albaner” (Sarajevo, 1917).

Pjesa tjetër e teksteve shqipe të përkthyer nga M.Lamerci janë të letërsisë së shkruar. Tekstet e hershme të përkthyer, të cilat paraqesin zhvillimin historik të letërsisë shqipe, janë përfshirë në „Albanische Chrestomathie” (Berlin, 1955). Këtu hyjnë tekstet më të lashta të letërsisë shqipe që nga „Formula e Pagëzimit”, „Perikopeja e Ungjillit” si dhe fragmente të ndryshme tekstesh nga „Meshari” i Gjon Buzukut”, „Doktrina e krishtenë” e Pjetër Budit, „Çeta e profetëve” e Pjetër Bogdanit, „Gjella e Shën Mërisë së Virgjër” e Jul Varibobës, poema „Bagëti e bujqësi” e Naim Frashërit, disa poezi të Lasgush Poradecit dhe të Çajupit, pjesë nga „Kanuni i Lekë Dukagjinit”, një numër këngësh lirike, përralla popullore dhe tekste nga krijimtaria e autorëve të pas Luftës së Dytë Botërore. Nga letërsia shqipe e pas Luftës së Dytë Botërore, përkatësisht nga gjinia e krijimtarisë dramatike, Lamerci përktheu dhe dramën e Kolë Jakovës „Unser Boden” (Halle – Saale, 1961) . Mirëpo, „ Laute des Hochlandes” (München, 1958) mbetet vepra më e rëndësishme e letërsisë shqipe e përkthyer në gjermanisht nga Maksimilian Lamerci. Ky përkthim është një punë e madhe, që ka kërkuar dije dhe mundim të jashtëzakonshëm për ta përkthyer në gjuhën gjermane dhe Lamercit nuk i mungonte kjo dije për këtë punë që bëri, sepse kodet epike, strukturën e poemave epike dhe të epopeve e njihje shumë mirë, meqë ishte homerolog i përkushtuar.

e folkloristikës shqiptare, diskutohet me kompetencë shkencore struktura artistike e modeleve të poezisë popullore shqiptare si të gjinisë epike, ashtu edhe të asaj lirike të të gjitha zonave folklorike shqiptare. Ndërkaq, punën në këtë drejtim Lamerci do ta vazhonte me mbledhjen dhe gjurmimin e përrallave popullore. Vepra e tij „ Albanische Märchen und andere Texte zur albanischen Volkskunde” - „ Përralla shqipe dhe tekste të tjera të folklorit shqiptar” është i pari koleksion i rëndësishëm me përralla shqiptare të botuara në të kaluarën. Materialet e përfshira në këtë vepër, të cilat i kishte regjistruar vetë në terren, në zonat folklorike veriore, ai i përkthen dhe në gjuhën gjermane. I pajisur me njohuri teorike për folklorin letrar dhe duke njohur biologjinë e modeleve folklorike në terren, pra edhe të përrallave popullore, Lamerci bëri sistemimin e tyre të mbështetur me kritere të qendrueshme shkencore. Në këtë vepër është për t’u veçuar hyrja, në të cilën autori jep mendime të rëndësishme për ndërtimin artistik të përrallës si një nga modelet më të përhapura të prozës popullore. Këtu, ai diskuton kompozicionin e përrallës, sistemin e formulave si dhe përmbajtjen e personazheve të tyre me prejardhje nga bota mitike si zanat, dragojt, kuçedrat etj. Lamerci fondin e përrallës gojore shqipe do ta begatojë edhe me përkthimin dhe botimin në gjermanisht të përmbledhjes „ Zwischen Drin und Vojussa” - „ Midis Drinit e Vjosës”. Kurse, studimet për përrallën si strukturë folklorike, të nisura që më 1922, ai do t’i thellonte në studimin „Albanien erzählt” - „Shqipëria rrëfen”. Si njohës i traditës homerike, Maksimilian Lamercin e ka preokupuar edhe eposi heroik legjendar i shqiptarëve, cikli i këngëve kreshnike. Në këtë drejtim, ai është marrë me morfologjinë e këtij modeli epik si dhe ka përkthyer njëzet këngët më të bukura me vlera antologjike ideo-artistike nga eposi i kreshnikëve në veprën e njohur „ Die Volksepik der Albaner” - „Epika popullore e shqiptarëve”.

Krahas studimeve për folklorin shqiptar, Maksimilian Lamerci ka shfaqur interesime të hershme edhe për krijimtarinë letrare të traditës dhe krijimtarinë letrare të mëvonshme. Letërsinë shqipe e ka studiuar sipas zhvillimit të saj në qarqet letrare konfesionale. Në kuadër të studimeve të letërsisë së kolonive arbëreshe shquhet vepra e tij për „ Gjellën e Shën Mërisë së Virgjër” të Jul Varibobës. Ndërkaq, si homerist dhe

epikolog që ishte, objekt të interesimeve të veta studiuese krahas eposit të kreshnikëve, në fushë të letërsisë gojore, siç u pa edhe më lart, pati dhe veprën monumentale epike „Die Laute des Hochlandes” - „Lahuta e Malcis” të Gjergj Fishtës, të cilën e përktheu në gjermanisht më 1958. Lamberci në studimin për veprën e Fishtës „Lahuta e Malcis”, të cilën e vlerësonte lart dhe autorin e së cilës e quajti „Homer shqiptar”, ka ndriçuar probleme të rëndësishme të ndërtimit të saj artistik. Rezultatet e arritura për veprën e Fishtës mbështeten në njohuritë e thella, që Lamberci i kishte për strukturën artistike të epikës gojore shqiptare dhe të dijes teorike të krijimit të epopesë si formë e epikës në vargje. Si njohës i çështjes homerike, ai përkrahu idetë e teorisë së Wolfit për krijimin e epopesë<sup>4</sup> „Lahuta e Malcis” sikurse të të gjitha epopeve klasike në mbështetje të modeleve të poetikës së epikës gojore. Filologu klasik gjerman A.Wolf në veprën e njohur „Prologomena ad Homerum” (1975) shprehu i pari idenë se Homeri nuk ka ekzistuar fare dhe nuk është krijuar epeve „Ilijada” dhe „Odisea”. Sipas tij, epet janë krijime kolektive popullore, të cilat gjenezën e vet e kanë nga krijimet apo këngët e shkurtëra epike gojore, të cilat rapsodët-redaktorë i kanë lidhur mes veti duke krijuar tërësi të mëdha epike apo epe.<sup>5</sup> Edhe M.Lambertz në studimin e tij „Çështja homerike dhe epi i madh shqiptar” shtjellon çështje të gjenezës së epi artistik prej këngësh popullore, çështje e rrahur kaq shumë që prej Friedrich August Wolf (1975) e këtej.<sup>6</sup>

Një paraqitje të zhvillimit historik të letërsisë shqipe, Lamberci e ka bërë në veprën „Albanische Chrestomathie”, të cilën e nis me dokumentet e para të shqipes „Formulën e Pagëzimit”, „Fjalorin” e Arnold von Harfit dhe „Perikopenë e Ungjillit”, për të vazhduar me letërsinë biblike dhe autorët e saj eminentë Gjon Buzukun, Pjetër Budin, Jul Varibobën, pastaj me krijimtarinë letrare të letërsisë nacionale në periudhën e Rilindjes Kombëtare nga Naim Frashëri deri te Çajupi. Si shtyllë tjetër të qenësisë kulturore shqiptare të traditës, Lamberci në këtë vepër krahas letërsisë biblike dhe të Rilindjes Kombëtare paraqet dhe komenton pjesë nga Kanuni i Lekë Dukagjinit dhe eposi

<sup>4</sup> Çabej, E., vepra e cit., f.180-181

<sup>5</sup> Čubelić, T., Književni leksikon, Zagreb, 1972, f.140-149; Rečnik književnih termina, Nolit, Beograd, 1985, f.246-247

<sup>6</sup> Çabej, E., vepra e cit., f.180-181

i krshnikëve, kurse në fund gjithashtu paraqet me komente, fragmente nga letërsia e pas Luftës së Dytë Botërore të autorëve të njohur si Fatmir Gjata, Jakov Xoxa, Dhimitër Shuteriqi, Lazër Siliqi etj.

### *0.3.3. Studimet në fushë të gjuhësisë*

Me gjithë kontributin dhe rezultatet e arritura në fushë të përkthimeve, të folklorit letrar, të mitologjisë dhe të letërsisë së shkruar shqipe, veprimtaria albanologjike e Lambercit peshon sidomos dhe në fushë të gjuhësisë shqiptare. Shqipja qysh më 1906 atij ia kishte tërhequr vëmendjen kur ishte takuar në Tebe të Greqisë me disa barinj shqiptarë, të cilët flisnin me një gjuhë ndryshe nga greqishtja, në shqip, në dialektin arbëror të shqipes në Greqi.<sup>7</sup> Pra, Lamberci vetëm pas disa vitesh nga kontakti i parë me shqipen do të merrej me përkushtim me studimin e kësaj gjuhe. Më 1914, ai së bashku me Gjergj Pekmezit<sup>8</sup>, i cili në Vjenë ishte mësimitdhënës i gjuhës shqipe në Universitet, hartoi tekstin didaktiko-mësimor në shqipe për të huaj me titull „ Lehr – und Lesebuch des Albanischen”<sup>9</sup> - „Libër mësimi dhe leximi i shqipes”. Në fakt ky libër, që është një doracak për mësimin e shqipes nga të huajt trajton çështje të prejardhjes së shqiptarëve nga ilirët dhe të shqipes nga ilirishtja si dhe çështje gramatikore të gjuhës shqipe. Njohuritë gramatikore të shqipes në këtë libër jepen të mbështetura në tekste të folklorit letrar dhe të letërsisë së kultivuar. Po në këtë vit, ai do të merrej me probleme të sistemit të shqipes, do të botonte studimin monografik „ Die hypothetische Periode im

---

<sup>7</sup> Çabej, E., vepra e cit., f.176

<sup>8</sup> Çabej, E., vepra e cit., f.182

<sup>9</sup> Lambertz, M., Lehr - und Lesebuch des Albanischen, Wien, 1914

Albanischen”<sup>10</sup> - „Periudha hipotetike në shqipe”. Pas këtyre dëshmime serioze dhe të suksesshme të përballjes së tij me probleme të sistemit të gjuhës shqipe, ai do të dërgohet për hulumtime gjuhësore nga Akademia Mbretërore e Shkencave e Vjenës në kolonitë shqiptare të Italisë, në Campobasso dhe Foggia (Molise). Prandaj, kontributet e Lambercit në fushë të gjuhësisë shqiptare, që nisën me studimin e sipërpërmendur në fushë të sintaksës dhe njohuritë mbi gramatikën e shqipes për të huaj, do të vazhdonin me studimin e dialekteve të shqipes, pikërisht të të folmeve arbëreshe të Molises. Rezultatet e hulumtimeve të tij dialektologjike ai i botoi në „Zeitschrift für vergleichende Sprachforschung auf dem Gebiete der indogermanischen Sprachen” më 1923. Poashtu, në kuadër të studimeve dialektologjike, ai është marrë me ndarjen dialektore të shqipes këndej Adriatikut. Në studimet dialektologjike të shqipes, Lamberci vërteton njësinë e gjuhës shqipe, me gjithë dallimet e vogla krahinore që ka.

Në mbështetje të materialit dialektor të të folmeve arbëreshe, Lamberci trajtoi dhe çështje të rëndësishme gramatikore të këtyre të folmeve si në fushë të fonetikës ashtu edhe në fushë të morfologjisë<sup>11</sup>. Mirëpo, studime më të thella për gramatikën e shqipes ai i shtroi në veprën „Grammatik der albanischen Sprache”<sup>12</sup> - „Gramatika e gjuhës shqipe”, në të cilën në fillim trajton dialektet e shqipes dhe në kapitullin e dytë përqendrohet kryesisht në morfologjinë e shqipes në sistemin nominal, verbal, në parafjalë si dhe në çështje të fjalëformimit.

Disiplinë tjetër e gjuhës shqipe, ku Maksimilian Lamberci dha ndihmesën e vet të rëndësishme është dhe leksikologjia. Fjalori i tij „Albanisch –Deutsches Wörterbuch” është më i miri që nga fjalori i Vajgandit e deri në vitet e 60-ta të shek. të kaluar.<sup>13</sup> Ky

---

<sup>10</sup> Lambertz, M., Die hypotetische Periode im Albanischen, Wien, 1914

<sup>11</sup> Lambertz, M., Grammatik der albanischen Sprache, Halle (Saale), 1959, f.14-19

<sup>12</sup> Lambertz, M., Grammatik der albanischen Sprache, Halle (Saale), 1959

<sup>13</sup> Palloshi, N., Kontributi i Maksimilian Lambercit në gjuhësinë shqiptare (Punim magjistrature), Prishtinë, 1988, f.83

fjalor hapet me parathënien dhe kriteret e hartimit të fjalorit si shkurtesat, alfabetin, shqiptimin dhe drejtshkrimin e gjuhës shqipe. Ai përmban një fond afro 13000 fjalësh<sup>14</sup>.

## **1. GJUHËSIA KONTRASTIVE DHE GJUHËSIA TEKSTORE (PASQYRË E ZHVILLIMIT HISTORIK)**

### ***1.1. Fillet e gjuhësisë krahasimtare dhe kontrastive***

Gjuhësia krahasimtare si degë e gjuhësisë së përgjithshme, objekt studimi ka hulumtimin dhe shpjegimin e ndryshimeve dhe lidhjeve mes gjuhëve të ndryshme në shkallë të ndryshme duke i studiuar këto afërsi dhe ndryshime në diakroni. Ngjashmëritë në sistemin gramatikor të gjuhës bënë që studiuesit e gjuhësisë krahasimtare-historike të konkludojnë që këto gjuhë në të kaluarën ishin shumë të afërta dhe gjenetikisht lidheshin me një gjuhë mëmë të përbashkët. Të gjitha këto gjuhë që konsiderohen si pasardhëse të gjuhës mëmë, sipas këtyre gjuhëtarëve, përbënin një familje gjuhësore<sup>15</sup>.

Gjuhësia e krahasuar është zhvilluar në kuadër të interesimeve të gjuhëtarëve për gjuhët indoevropiane. Kjo disiplinë gjuhësore lidhet me emrat e studiuesve të njohur në hulumtimin e sistemit gjuhësor të gjuhëve indoevropiane. Ndër studiuesit e parë në këtë fushë është gjuhëtari i shquar gjerman, profesori i Universitetit të Berlinit dhe themeluesi i gjuhësisë së krahasuar historike indoevropiane Franz Bop, i cili hulumtoi lidhjet mes sanskritishtes, greqishtes, latinishtes, persishtes dhe gjuhëve gjermanike në vitin 1816 në

---

<sup>14</sup> Palloshi, N., vepra e cit., f.84

<sup>15</sup> Lyons, J., Hyrje në gjuhësinë teorike (Introduction to Theoretical Linguistics), Tiranë, 2001, f.36-37



studimin „Über das Conjugationssystem der Sanskritsprache in Vergleichung mit jene der griechischen, lateinischen, persischen und germanischen Sprache” - „Mbi sistemin e lakimit të gjuhës sanskrite në krahasim me atë të greqishtes, latinishtes, persishtes dhe gjuhëve gjermanike”, ku së pari përdoret shprehja „gramatikë krahasuese” (vergleichende Grammatik). Në këtë kontekst sipas Lyons-it „Përpunimi i parimeve dhe metodave, mbi bazën e të cilave grupohen këto ose ato familje gjuhësore, dhe, çka është më e rëndësishme, ndërtimi i një teorie të përgjithshme të ndryshimeve dhe të afrive gjuhësore ishte arritja më e rëndësishme e shkencës gjuhësore në shekullin XIX”<sup>16</sup>. Ndërkaq, në mënyrë të gjerë dhe të thelluar, më vonë ai studion sistemin gramatikor të gjuhëve indoevropiane në librin e tij me tri vëllime „Vergleichende Grammatik des Sankrit, Zend, Armenischen, Griechischen, Lateinischen, Lituanischen, Altslawischen, Gotischen und Deutschen” - „Gramatika krahasuese e sanskritishtes, zendishtes, armenishtes, greqishtes, latinishtes, lituanishtes, sllavishtes së vjetër, gotishtes dhe gjermanishtes”. Kjo veprë është studimi i parë në fushë të gjuhësisë historike – krahasimtare.

Krahas Franc Bopit rëndësi të madhe në vënien e themeleve të gjuhësisë historike (diakronike) ka edhe studiuesi danez Rasmus Rask, i cili nuk e kishte famën e Bopit për arsye se edhe pse pranonte afërsitë ndërgjuhësore, nuk mendonte që gjuhët me këto afërsi krijojnë familje gjuhësh. Kontributet e Raskut shtrihen në rrafsh të fonetikës komparative indoevropiane. Kështu, në veprën e tij për gjuhën veriislandeze, Rasku spikat ngjashmëritë e tingujve të fjalëve gjermane me fjalët e njëjta të gjuhëve të tjera indoevropiane.<sup>17</sup>

Në plejadën e themeluesve të gramatikës krahasuese bën pjesë edhe gjuhëtari dhe filozofi gjerman Jacob Grimm, i cili hartoi „Gramatikën gjermane”, ku në mënyrë

---

<sup>16</sup> Lyons, J., vepra e cit., f.37

<sup>17</sup> Rugova, L., Analizë tekstore e kontrastive e fjalive të varura të përcaktuara sipas përmbajtjes në tipat e ndryshëm të tekstit në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe. (Disertacion i doktoratës në dorëshkrim). UP / Fakulteti i Filologjisë. Prishtinë, 2008, f.13

komparative jep karakteristikat themelore të grupit të gjuhëve gjermanike. Në botimin e dytë të këtij libri në vitin 1822 paraqet raportin e konsonanteve të gjuhës gjermane me gjuhët e tjera indoevropiane. Këto raporte fonologjike mes këtyre gjuhëve, njihen si Ligji i Grimmit. Përputhjen e pjesërishme të tingujve në gjuhët gjermanike, Jacob Grimm e sheh si zhvendosje të tingujve në një periudhë prehistorike të gjermanishtes<sup>18</sup>.

Përfaqësuesit e lingvistikës krahasimtare historike të shek. 19, përveç themelimit të metodës krahasimtare në lingvistikë, kontribut të posaçëm dhanë sidomos në sjelljen e materialit gjuhësor nga gjuhë dhe grupe të ndryshme gjuhësh indoevropiane, siç janë sankritishtja, greqishtja, persishtja, lituanishtja, armenishtja, gjuhët keltike, gjuhët sllave, gjuhët romane, gjuhët gjermanike. Përveç kontributeve të themeluesve të sipërpërmendur të gjuhësisë krahasimtare historike, për sjelljen e materialeve gjuhësore dallohen edhe komparativistët si Georg Curtius, Johann Kaspar Zeuss, Friedrich Diez, Franz Mikloschitsch, August Friedrich Pott etj. Kontributet e këtyre dijetarëve shtrihen në fusha të ndryshme të studimeve gjuhësore. Kështu, Poti dha ndihmesë të rëndësishme në studimet etimologjike. Ai studioi arketipat etimologjikë, gjegjësisht format e vjetra të gjuhëve indoevropiane. Curtius është marrë me etimologjinë e gjuhës greke, Zeus me gramatikën e gjuhëve kelte, Diez me gramatikën e gjuhëve romane, Mikloshiq me gramatikën e gjuhëve sllave e sidomos me sintaksën e tyre. Sllavisti dhe ballkanologu i njohur slloven Franc Mikloshiq është marrë dhe me studimin historik të gjuhës shqipe në rrafsh krahasimtar. Ai bëri studime për leksikun e shqipes, për fonetikën dhe morfologjinë historike, studioi format e foljeve të shqipes duke i krahasuar me gjuhët e tjera të Ballkanit.<sup>19</sup>

## ***1.2. Gjuhësia kontrastive (sinkronike)***

---

<sup>18</sup> Lyons, J., vepra e cit., f.41-41

<sup>19</sup>Iviq, M., Drejtimet në lingvistikë, Prishtinë, 1977, f.40-44

Derisa në shek.19 themelohet dhe zhvillohet gjuhësia e krahasuar, në dekadat e para të shek.20 zë fill dhe zhvillohet gjuhësia kontrastive. Dallimet esenciale mes gjuhësisë historike krahasimtare apo komparativizmit dhe gjuhësisë kontrastive qendrojnë në metodën e studimit të gjuhëve. Siç u theksua më lart, gjuhësia komparative studion zhvillimin historik të gjuhëve të lidhura gjenetikiisht mes tyre. Ajo, pra, studion paralelizmat mes gjuhëve. Gjuhësia kontrastive, përkundrazi spikat në radhë të parë kontrastet apo dallimet mes gjuhëve duke mos lënë anash edhe ngjashmëritë që kanë dhe duke i studiuar gjuhët gjithëherë në sinkroni<sup>20</sup>.

Linguistika kontrastive si disiplinë është e viteve të 60-ta të shek.20. Studiuesi Kurt Rein në veprën e tij të njohur „Einführung in die Kontrastive Linguistik” (1983), gjuhësinë kontrastive e definoi si „ ‘Kontrastive Linguistik’ auch ‘Kontrastive Grammatik’, ist kurz definiert, eine vergleichende Sprachwissenschaftliche Beschreibung und Analyseverfahren, bei deren möglichst detaillierten ‘vergleichen’ das Hauptinteresse nicht auf den Gemeinsamkeiten, sondern auf die Abweichungen oder ‘Kontrasten’ zwischen den beiden-oder mehreren-verglichenen Sprachsystemen bzw. Subsystemen liegt.”<sup>21</sup> „një metodë krahasuese përshkrimi dhe analize, në të cilën interesimi kryesor përqendrohet në „ krahasimin” jo vetëm të ngjashmërive, por edhe të dallimeve ose „kontrasteve” mes dy a më shumë sistemeve gjuhësore të krahasuara, gjegjësisht subsistemeve”.<sup>22</sup>

Gjuhësia kontrastive si qëllim primar kishte krijimin e bazës metodike për mësimdhënien e gjuhëve të huaja. Kështu, duke bërë krahasimin sistematik mes gjuhës amtare dhe gjuhës së huaj lehtësohej nxënja e gjuhës së huaj. Metodikën sistematike kontrastive e nisi njëri ndër përfaqësuesit e strukturalizmit amerikan C.Fries ( 1945 ), duke bërë përshkrime paralele të strukturave të gjuhës amtare dhe gjuhës së huaj. Edhe

---

<sup>20</sup> Rein, K., vepra e cit., f.1

<sup>21</sup> Rein, K., vepra e cit., f.5

<sup>22</sup> Rein, K., vepra e cit., f.5

distribucionalisti Z.Harris (1966) u mor me metodikën kontrastive duke bërë përshkrimin dhe prezantimin e dallimeve strukturore të gjuhëve të ndryshme. Ndërsa, themelues të tjerë të rëndësishëm të gjuhësisë kontrastive si R.Lado (1957), Ch.Ferguson (1968), G.L. Trager (1966), Valdman (1966), Stockwell (1965), Bowen (1965), Agard (1966), Di Pietro (1966), R.Filipović etj<sup>23</sup>., mendojnë se duke bërë kontrastimin e gjuhës amtare në rrafsh fonetik, gramatikor dhe të leksikut me sistemin e gjuhës së huaj, vihen në dukje vështirësitë gjatë mëimit të gjuhës së huaj dhe do të ishte e nevojshme që ato vështirësi të radhiteshin sipas ndërlikueshmërisë së tyre , të cilat do të ishin të rëndësishme për hartimin e planprogrameve mësimore. Kontributet e këtyre studiuesve ishin me rëndësi për metodikën e mëimit të gjuhës së huaj duke e kontrastuar atë me gjuhën amtare dhe duke spikatur sidomos dallimet strukturore.

Shumë studiues, siç janë Nickel (1972), Krzeszowski (1972) etj., propozojnë ndarjen e gjuhësisë kontrastive në dy degë kryesore: në gjuhësinë kontrastive teorike dhe në gjuhësinë kontrastive aplikative. Sipas tyre, gjuhësia kontrastive teorike trajton probleme të gjuhësisë kontrastive teorike të përgjithshme dhe probleme teorike të veçanta, kurse gjuhësia kontrastive e aplikuar trajton probleme të aplikuara të gjuhësisë kontrastive të përgjithshme dhe probleme të aplikuara kontrastive specifike. Përderisa gjuhësia kontrastive teorike ka të bëjë me kornizat teorike të hulumtimit të sistemeve gjuhësore, gjuhësia kontrastive aplikative është zhvilluar për qëllime didaktike.

---

Gramatika kontrastive sinkronike, e cila u themelua si disiplinë gjuhësore në vitet 60, me gjithë objektin e vet të studimit, fushat dhe metodën e studimit, ka dhe kritikët e saj. Ndër kritikët e njohur janë Coseriu, Lee, etj., të cilët e konsiderojnë këtë disiplinë josistematike dhe të paplotë „etwa zu dem Vorwurf (1972, S.45), die KG sei in deskriptiver Hinsicht ‘unvollständig’ weil sie etwa nicht alle, insbesondere nicht die nicht verbalen Kommunikationsmöglichkeiten erfasse. Ähnlich steht es mit dem Vorwurf, KL

---

<sup>23</sup> Rein, K., vepra e cit., f.13-16

sei 'als Grammatik inkohärent', weil in der Sprachpraxis auch 'Nullentsprechungen' bzw. Umverteilung sowie Verschiebung von Entsprechungen auf eine andere Sprachebene vorkämen.<sup>24</sup>

### ***1.3. Zhvillimi i gjuhësisë tekstore***

Gjuhësia e tekstit si disiplinë e mëvetësishme gjuhësore nuk ka ndonjë traditë të hershme, pra ajo njihet edhe si shkencë moderne. Konstituimi i saj si disiplinë gjuhësore i takon viteve 60 të shekullit të kaluar.<sup>25</sup> Mirëpo, edhe pse e vonshme, interesimet për tekstin janë shumë më të hershme. Ato nisin në Greqinë dhe Romën e lashtë, vazhdojnë gjatë Mesjetës e deri sot. Rëndësi të madhe në këtë drejtim në lashtësi ka pasur sidomos retorika, kurse në Mesjetë edhe gramatika dhe logjika.<sup>26</sup> Në dekadat e para të shek. XX strukturalizimi që shfaqet në gjuhësi dhe në poetikë, nxit studimet e para për vetitë e tekstit. Me çështje të tekstit janë marrë shkolla formaliste ruse dhe shkolla e Pragës.<sup>27</sup> Mirëpo, studiuesi Zellig Harris është ndër të parët që, duke diskutuar për diskursin si njësi gjuhësore e rangut të lartë, konstaton se diskursi tejkalon konceptin e fjalisë, të cilin e shihte si strukturë globale. Prandaj, rëndësia e mendimit të tij, ndryshe nga Blumfildi, i cili fjalinë e konceptonte si shprehje të pavarur gjuhësore, qendron në faktin se fjalia nuk mund të shkëputet nga diskursi.<sup>28</sup>

Emra të njohur që u morën me studimet mbi tekstin janë Halliday/Hasan me studimin „Cohesion in English” (1976), të cilët e përkufizonin tekstin si „*vargje fjalësh*

---

<sup>24</sup> Rein, K., vepra e cit., f.19

<sup>25</sup> Werlich, E., Typologie der Texte, Heidelberg, 1979, f.11

<sup>26</sup> Beaugrande, R. -A. /Dressler, U.-W., Einführung in die Textlinguistik, Tübingen, 1981, f.15-16

<sup>27</sup> Beaugrande /Dressler, vepra e cit., f.21

<sup>28</sup> Beaugrande /Dressler, vepra e cit., f.22-23

*apo fjalish të ngjitura në një tërësi*".<sup>29</sup> Mirëpo, nevojën për studimin e tekstit si strukturë semantiko-sintaksore të mbifrazës ndër të parët e hodhi studiuesi gjerman Harald Weinrich në veprën „Tempus besprochene und erzählte Welt” (1964), edhe pse para tij Roland Harweg në veprën „Pronomina und Textkonstitution” (1968) ishte marrë me çështje të strukturës sipërfaqësore të tekstit.<sup>30</sup>

Studime për tekstin kanë bërë dhe dijetarë të tjerë gjermanë dhe anglezë, siç janë Peter Hartman në studimin „Text, Texte, Klassen von Texten” (1964), Teun A. Van Dijk me studimin „Some Aspects of Text Grammars, A Study in theoretical Linguistics and Poetics”, ( 1980 ), Hennig Brinkmann e të tjerë. Ndërkaq, studiuesi i njohur gjerman Harald Weinrich është ndër të parët që përdor termin gramatikë e tekstit në veprën e tij „Textgrammatik der deutschen Sprache” (1968), ku del shkencërisht në mënyrë të konsoliduar koncepti „Gramatikë e tekstit”. Në këtë drejtim, autori thellësisht dhe në mënyrë të zgjeruar është marrë me strukturën e njësisë të veçanta kohezive të tekstit dhe me strukturën koherente të tij, duke bërë analiza për secilën njësi kohezive e koherente të tekstit veç e veç.

Me studime në fushë të gjuhësisë së tekstit ndër ne janë marrë relativisht herët akademik Rexhep Ismajli me veprat „Shenjë dhe ide”(1974) dhe „Shumësia e tekstit” (1980) dhe më vonë Bardh Rugova me veprën „Gjuha e gazetave” (2009), në të cilën merret me mikro - dhe makrostrukturat e teksteve të gazetave , Linditë Sejdiu – Rugova me punimin e saj të doktoratës „Analizë tekstore e kontrastive e fjalive të varura të përcaktuara sipas përmbajtjes në tipat e ndryshëm të tekstit në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe”, Lindita Tahiri me veprën „Monologu i brendshëm”, në të cilën bën përshkrim formal gjuhësor të një teknike letrare dhe është ndër studiueset e para që merret me interpretim gjuhësor të veprës letrare, Avdi Visoka, i cili ka ndriçuar çështje të rëndësishme të ndërtekstualitetit në veprën e Camysë e ndonjë tjetër. Poashtu, së voni me çështje të gjuhësisë së tekstit në Shqipëri janë marrë Jani Thomai me veprën „Teksti dhe

<sup>29</sup> Halliday, M.A.K., Hasan, R., Cohesion in English, Longman, 1976, f.1

<sup>30</sup> Beaugrande /Dressler, vepra e cit., f.24

gjuha” (1992), Klodeta Dibra dhe Nonda Vorfi me veprën „Gjuhësi teksti” (2005), Tefë Topalli me veprën „Gjuhësi teksti” (2011), Arbër Çeliku me veprën „Herstellung von Textkohärenz im Deutschen und im Albanischen” (2007), etj..

## **2. KONSIDERATA TEORIKE PËR GJUHËSINË E TEKSTIT**

### ***2.1. Kuptimi i konceptit tekst***

Në shumë fjalorë të gjuhëve të ndryshme (fjalorët e shqipes, gjermanishtes, anglishtes, frengjishtes etj) koncepti tekst përkufizohet jashtë kriterëve të gjuhësisë së tekstore (Bußmann). Ndërkaq, përkufizimi i nocionit tekst i mbështetur në parimet e gjuhësisë tekstore përjashton përkufizimet e fjalorëve të ndryshëm për tekstin. Po të shihet historikisht dija për përkufizimin e tekstit nga fillimet e deri në kohët e fundit është plotësuar vazhdimisht.

Ndër të parët, që bënë përkufizimin e tekstit duke u mbështetur në parimet e gjuhësisë tekstore është studiuesi K.Brinker, i cili në veprën e tij „Linguistische Textanalyse”, tekstin e sheh si strukturë gjuhësore të shkruar, përtej fjalisë.<sup>31</sup> Kuptimi i strukturës së tekstit nga studiuesit Beaugrande/Dressler është zgjeruar dhe më tej me konstituentë të tjerë. Këta studiues konceptin tekst e plotësojnë me termin tekstualitet (Textualität). Sipas pikëpamjeve të tyre çdo tekst për të qenë tekst duhet të ketë kriteret e tekstualitetit. Ndryshe nga Brinker-i, De Beaugrande/Dressler tekstin me të drejtë e konsiderojnë si strukturë gjuhësore më komplekse. Sipas këtyre autorëve kriteret

<sup>31</sup> Brinker, K., Linguistische Textanalyse, Erich Schmidt Verlag, 1997, f.12

kryesore të strukturës së tekstit konsiderohen kohezioni dhe koherenca e tekstit. Ndërkaq, përbërësit e tjerë që plotësojnë ndërtimin e një teksti janë *synueshmëria*, apo *qëllimi*, *pranueshmëria* apo *akceptimi*, *njoftueshmëria*, *situacionaliteti* dhe *ndërtëkstualiteti*.<sup>32</sup>

---

Ka dhe studiuës të tjerë që kanë dhënë mendime, të cilat e plotësojnë kuptimin e konceptit tekst. Të një rëndësie të veçantë janë edhe pikëpamjet e studiuësve E.Werlich, U.Oomen, W.Schmidt, M.Schrener etj. Kështu, sipas Egon Werlich teksti përcaktohet si „shprehje e shkruar e përbërë nga shumë fjali”.<sup>33</sup> Edhe studiuësja U.Oomen, ashtu sikurse Halliday / Hasan, tekstin e konsideron si „*supershenjë*” (supersign), i cili është i përbërë nga shuma e pjesëve të tij dhe përbën një tërësi integrale.<sup>34</sup> Sipas studiuësit Wilhelm Schmidt „*një tekst është një pjesë e një ligjërimi të shkruar apo të folur, i cili gjuhësisht paraqet një situatë si njësi kuptimore relativisht të mbyllur sipas planit komunikativ, në mënyrë që të realizohet një qëllim i caktuar komunikimi*”.<sup>35</sup> („*Ein Text ist ein Stück mündlicher und schriftlicher Rede, durch das ein Sachverhalt als relativ abgeschlossene Inhaltseinheit nach einem Kommunikationsplan sprachlicher gestaltet ist, um eine bestimmte Kommunikationsabsicht zu realisieren*”). Edhe studiuësi M.Schrener tekstin e definoi si pikëqëllim (Zielpunkt) dhe realitet të plotë social-komunikativ të gjuhës.<sup>36</sup>

Nga këto diskutime të studiuësve rreth përkufizimit të tekstit del qartë se teksti është shenja më e madhe organizative e gjuhës, që definohet si njësi komunikuese gjuhësore me strukturë komplekse, e cila ka ndërvarësi tematike dhe konceptuale.

---

<sup>32</sup> Beaugrande / Dressler, vepra e cit., f.8-13

<sup>33</sup> Werlich, E., vepra e cit., 1979, f.13

<sup>34</sup> Oomen, U., Texts and sentences, Petöfi (editor) Bd.1, 1979, f.274

<sup>35</sup> Schmidt, W., Thesen zur Beschreibung und Einleitung von Texten, Potsdam, 1977, f.155

<sup>36</sup> Schrener, M., Sprache als Text. Ansätze zu einer sprachwissenschaftlich begründeten Theorie des Textverstehens, Tübingen, Niemeyer, 1984, f.3



## 2.2. Përkufizime mbi kohezionin dhe koherencën e tekstit

Dy kriteret kryesore të tekstualitetit, kohezioni dhe koherenca, kanë qenë objekt i interesimeve të shumë studiuesve që janë marrë me gjuhësinë e tekstit. Studiuesit tradicionalistë si Jakobson, O.Jeperson, D. Crystal e të tjerë kanë spikatur rëndësinë e kohezionit të tekstit si „përbërës i domosdoshëm i tekstit”.<sup>37</sup> Mirëpo, studiuesit tradicionalë, edhe pse kanë hetuar rëndësinë që ka kohezioni për tekstin, ata nuk konsiderohen si themelues të teorisë së kohezionit tekstor. Përkufizimi teorik i këtyre dy përbërësve të strukturës së tekstit në gjirin e gjuhësisë tekstore është bërë nga studiuesit M.A.K Halliday dhe Ruqaiya Hasan në studimin „Cohesion in English” (1976). Me fjalë të tjera, përkufizimi i kohezionit dhe koherencës ka evoluar gjatë zhvillimit të gjuhësisë së tekstit. Mbështetur në pikëpamjet e Halliday/Hasan për kohezionin e tekstit del se kohezioni si përbërës i rëndësishëm i tekstualitetit është ndërlidhje semantike e tekstit dhe përcaktues i tij. Sipas kësaj, shihet se këta dy autorë bëjnë dallim të prerë në përkufizimin terminologjik mes kohezionit dhe koherencës duke përfshirë këtu veç ndërlidhjes semantike dhe ndërlidhjet apo raportet sintaksore të tekstit. Më vonë, Hasan përkufizimin e njësisë së kohezionit të tekstit do ta zgjeronte, duke diskutuar aspektin strukturor të kohezionit dhe aspektin jostrukturor të tij. Sipas saj, aspekti strukturor i kohezionit nënkupton konstituentët informativë të tekstit: *temën* dhe *remën*. Ndërkaq, aspekti jostrukturor përfshin ndërlidhjet përbërëse dhe ndërlidhjet organike të tekstit. Në kuadër të ndërlidhjeve përbërëse të tekstit hyjnë mjetet kohezive gramatikore, siç janë:

<sup>37</sup> Jeperson, O., The philosophy of Grammar, London, 1934, f.175; Crystal, D.A., Dictionary of Linguistics and Phonetics, Oxford Blackwell, 1977, f.1924

*referenca, elipsa dhe zëvendësimi*. Kurse, në kuadër të ndërlidhjeve organike hyjnë lidhëzat apo konektorët si mjete gramatikore të kohezionit.<sup>38</sup>

Sipas De Beaugrande / Dressler-it, kohezioni si përbërës sipërfaqësor i tekstit bën lidhjen e fjalëve me njëra-tjetrën. Ndërkaq, në njësi si fjalia, kohezionin e realizojnë njësitë në varësi gramatikore të caktuar. Në njësi më të mëdha se fjalia, do të thotë në tekst, është e domosdoshme të hetohet mënyra e ripërdorjes së elementeve të përdorura më parë në po atë tekst. Ky funksion në tekst realizohet me *rimarrjen, proformat, elipsat dhe zëvendësimin*.<sup>39</sup>

*Rimarrja* është parim i rëndësishëm i ndërtimit të tekstit dhe koherencës së tij. Me rimarrjen si parim i rëndësishëm i tekstit dhe i koherencës së tekstit janë marrë shumë studiuës . Ndër ta duhet përmendur Weinrich-un, Van Dijk-un, De Beaugrande / Dressler-in etj. Sipas tyre, rimarrja ose rekurrenca është përsëritja e një fjale disa herë në fjali. Riafirmimi apo pohimi i qendrimit të folësit në tekst realizohet me anë të rimarrjes, e cila sipas këtyre autorëve ka një rëndësi të veçantë për tekstin. Klaus Brinker-i dallon *rimarrjen eksplicite dhe implicite*. Identiteti preferencial i shprehjeve gjuhësore në fjalitë e tekstit që vinë njëra pas tjetrës përbën apo shpreh rimarrjen eksplicite, e cila realizohet me emra dhe përemra. Kurse, rimarrjes implicite i mungon referenca e caktuar mes fjalëve që rimerren. Veçori e rimarrjes implicite është lidhshmëria mes pjesës dhe tërësisë.<sup>40</sup>

Ndër mekanizmat kohezivë të tekstit që e shkurtojnë dhe e thjeshtojnë tekstin, gjegjësisht sipërfaqen e tekstit janë *proformat*. Proformat më të njohura të tekstit janë përemrat , të cilët u referohen emrave. Ato janë fjalë të shkurtra dhe ekonomike „të zbrazëta në përmbajtjen e tyre të veçantë, të cilat mund të qendrojnë në sipërfaqen e tekstit në vend të shprehjeve”.<sup>41</sup> Sipas Halliday/Hasan janë dy tipa kryesorë të referencës:

<sup>38</sup> Halliday, M.A.K / Hasan,R., vepra e cit., f.317

<sup>39</sup> Beaugrande, R.A. /Dressler, W.U., vepra e cit., f.64-74

<sup>40</sup><http://www.hispanoteca.eu/Lexikon%20der%20Linguistik/t/TEXTLINGUISTIK%20nach%20Klaus%20Brinker.htm>

<sup>41</sup> Beaugrande, R.A. /Dressler, W.U., vepra e cit., f.64

tipi ekzoforik dhe tipi endoforik. Këtë të fundit ata e ndajnë në tipin anaforik dhe në tipin kataforik, ku tipi anaforik del si diç e njohur dhe e përdorur më parë në atë tekst, ndërkaq tipi kataforik del si informacion për diçka që posedon më vonë në tekst.<sup>42</sup>

Ndër mjetet e tjera të lidhjes së tekstit është dhe *elipsa*. Elipsa është përsëritje e strukturës dhe përmbajtjes duke mënjeluar disa njësi sipërfaqësore të tekstit.<sup>43</sup> Ajo është element shumë i ngjashëm me zëvendësimin. Mirëpo, ndryshe nga zëvendësimi, ku një element i tekstit zëvendësohet me një element tjetër në tekst, te elipsa shfaqet „zëvendësimi zero”.

*Zëvendësimi* apo *substitucioni* është një mjet tjetër i tekstit, i cili përmes zëvendësuesit krijon nuanca të reja kuptimore, që lidhen me objektin referencial. Zëvendësimi në tekst realizohet me anë të sinonimeve, hiponimeve, metaforës. Ndryshe, kjo formë e kohezionit të tekstit njihet edhe si koreferencë (Koreferenz) apo identitet referencial (Referenzidentität). Janë tri lloje të zëvendësimit : zëvendësimi i foljeve, zëvendësimi i emrave dhe i fjalisë.

*Konektorët* janë mekanizma kryesorë eksplicitë të ndërtimit të kohezionit të tekstit, sepse bëjnë lidhjen kohezive dhe koherente mes fjalive, periudhave dhe të tekstit në tërësi. Pra, funksioni i tyre ka të bëjë me lidhjen e pjesëve të tekstit. Kallmeyer (1974) ka përkufizuar mënyrën se si bëhet lidhja me pjesët e tij që pasojnë „*Im welcher Weise das im Text Vorangegangene mit dem im Text Nachfolgenden verbunden wird*”.<sup>44</sup>

Sipas Halliday/Hasan elementët lidhëzorë apo konektorët dalin si elemente, të cilat në mënyrë indirekte apo të tërthortë ndërtojnë kohezionin e tekstit. Pra, ato nuk janë elementë kohezivë në vetvete, por që semantikisht bëjnë lidhjen e pjesës së parë me pjesën vazhduese në tekst. Në grupin e konektorëve, si mekanizma lidhëzorë të tekstit hynë: lidhëzat, konektorët që përbëhen nga më shumë se një pjesë dhe ndajfoljet.\_

<sup>42</sup> Halliday M.A.K. / HASAN, R., vepra e cit., f.33-37

<sup>43</sup> Beaugrande, R.A., /Dressler, W.U., vepra e cit., f.51

<sup>44</sup> <http://www-user.uni-brem.de/~schonetike/tlg/tlgld/3.html>

Studiuesit Halliday/Hasan nuk bëjnë dallim konceptual mes kohezionit dhe koherencës në veprën e tyre „Cohesion in English” (1976).

Kohezioni dhe koherenca si shtyllat kryesore të tekstit apo si kriteret më të rëndësishme të tekstualitetit, si koncepte të ndara së pari janë përkufizuar nga studiuesit De Beaugrande Dressler në „Einführung in die Textlinguistik” (1981:5) dhe Teun A. Van Dijk në studimin e tij „Some Aspects of Text Grammars. A Study in Theoretical Linguistics and Poetics” (1980:42). Beaugrande/Dressler e interpretojnë koherencën tekstore si raport kuptimor i tekstit dhe si rezultat i proceseve kognitive të realizuesit të tekstit „Kohärenz ist nicht bloß ein Merkmal von Texten, sondern vielmehr das Ergebnis kognitiver Prozesse der Textverwender”.<sup>45</sup> Ndërkaq, Van Dijk në veprën e tij është përqendruar në koherencën globale dhe koherencën lokale të tekstit. Koherenca globale përfshin tekstin si tërësi, ndërsa ajo lokale lidhjet propozicionale në tekst.<sup>46</sup>

Duke pasur parasysh gjithë këto që u thanë, mund të përfundohet se koherenca dhe kohezioni në studimet e gjuhësisë tekstore me të drejtë shihen si dy standardet kryesore të tekstualitetit. Kohezioni përbën strukturën sipërfaqësore të tekstit dhe është gramatikor dhe leksikor. Kohezioni gramatikor ndërtohet nëpërmjet : elipsës, zëvendësimit, referencës. Ndërkaq, mjetet kohezive leksikore janë: rimartja, përsëritja, sinonimia dhe kolokacioni. Nga ana tjetër, koherenca tekstore në bazë të studimeve të gjuhësisë së tekstit paraqet strukturën e thellë, komplekse dhe shumëdimensionale të tij, e cila bën lidhjen tematike të tekstit në mënyrë të natyrshme. Gjithë kjo vërteton se teksti si shenja më e madhe organizative e gjuhës, mund të konsiderohet si i tillë kur këto dy kritere të tekstualitetit nuk mungojnë dhe kanë ndërvarësi mes vete.

---

<sup>45</sup> Beaugrande, R.-A., / Dressler, W.U., vepra e cit., f.7

<sup>46</sup> Van Dijk, A.T., Some Aspects of Text Grammars. A Study in Theoretical Linguistics and Poetics, 1980, f.42-43

### 2.3. *Tekstualiteti dhe përmbushja e kritereve komunikative të tekstit*

Teksti është njësi unike që ndërtohet nga fjalë e fjali, të cilat kanë aftësi që të kombinohen mes vete. „Një tekst i shkruar mirë, qoftë ai edhe një paragraf i vetëm, një artikull apo një libër i tërë duhet të karakterizohet nga kohezioni dhe koherenca. Kohezioni ka të bëjë me mënyrën se si lidhen midis tyre, në bazë të rregullave gramatikore të gjuhës, njësitë që përbëjnë tekstin. Kurse, koherenca ka të bëjë me organizimin logjik të tekstit, me mënyrën se si gjykimet dhe arsyetimet lidhen midis tyre”.<sup>47</sup> Andaj, rrjedh se kohezioni dhe koherenca janë kriteret kryesore të tekstualitetit, të cilat ndërlidhen me njëra-tjetrën. Në këtë kontekst, studiuesi P.H. Mathews me të drejtë konstaton se „kohezioni dhe koherenca janë burime të tekstualitetit”.<sup>48</sup> Shumësia e kritereve të tekstualitetit të shfaqura në tekst dhe të ndërthura organikisht janë kusht i domosdoshëm i strukturës semantike të tekstit. Prandaj, në këtë kuptim del se tekstualiteti është tipari i të qenit tekst, i cili e bën tekstin kompakt dhe unik.<sup>49</sup>

Përveç standardeve apo kushteve themelore të tekstualitetit, kohezionit dhe koherencës, studiuesit e tekstit numërojnë edhe pesë kritere të tjera të domosdoshme, që plotësojnë strukturën kuptimore të tij.

Edhe pse sipas studiuesve Beaugrande/Dressler kohezioni dhe koherenca janë kriteret themelore të tekstualitetit, prapëseprapë ato nuk mjaftojnë që tekstet „Texte” të dallohen nga „jotekstet” - „Nicht – Texte”. Prandaj dhe kriteret e tjera të tekstualitetit kanë rëndësi të posaçme në aktin e komunikimit mes bashkëfolësve. Kriteret tjera të tekstualitetit janë: *synueshmëria, pranueshmëria, njoftueshmëria, situacionaliteti dhe ndërtekstualiteti*.<sup>50</sup>

<sup>47</sup> Memushaj, R., Shqipja standarde, Tiranë, 2011, f.19

<sup>48</sup> Mathews, P.H., The Concise Oxford Dictionary of Linguistics, OUP, 1997, f.6

<sup>49</sup> Halliday, M.A.K., Hasan, R., vepra e cit.,f.2

<sup>50</sup> Beaugrande, R.A., / Dressler, W.U., vepra e cit., f.5-14

*Synueshmëria (Intentionalität)* si kriter i tekstualitetit ka të bëjë me qendrimin e folësit, i cili prodhon tekst logjik dhe formal dhe këtë tekst ia drejton marrësit. Sipas Beaugrande/Dressler-it synueshmëria paraqet mjetet që i përdor dërguesi i tekstit për ta realizuar qëllimin e tij.<sup>51</sup> Ndërkaq, T.Topalli nënvizon se kur mohohet qëllimisht kohezioni dhe koherenca e tekstit që e prodhon dërguesi i tij, atëherë nuk mund të kuptohet qëllimi i atij teksti. Pra, duhet të qartësohet dallimi mes qëllimit të autorit dhe asaj që shpreh teksti, meqë shpesh teksti nuk është i njëjtë me atë që në të vërtetë synon të thotë autori.<sup>52</sup> Me fjalë të tjera, qëllimi i prodhuesit të tekstit është që t'i transmetojë tekst të kuptueshëm marrësit të atij teksti.

*Pranueshmëria (Akzeptabilität)* është kusht i domosdoshëm i tekstualitetit që i referohet marrësit të tekstit. Thënë ndryshe, roli i marrësit është po aq i rëndësishëm sa dhe roli i prodhuesit të tekstit, meqë, ai gjykon se teksti mund të pranohet apo jo. Sipas H.Vater, pranueshmëria e tekstit në të shumtën e rasteve mund të jetë subjektive (1994:52).<sup>53</sup> Gjithashtu edhe Beaugrande/Dressler theksojnë se qëndrimi i marrësit kushtëzohet nga lloji i tekstit dhe rrethi kulturor e shoqëror i tij.<sup>54</sup>

*Njoftueshmëria (Informativität)* lidhet drejtëpërdrejtë me karakterin informativ të tekstit. Tema e tekstit shpreh elementet e njohura dhe të panjohura tekstore.<sup>55</sup> Teksti mund të ofrojë informacione minimale dhe maksimale. Tekstet me informacione maksimale janë ato tekste, të cilat ofrojnë të reja nga fusha të ndryshme shkencore. Ndërkaq, tekstet me informacione minimale ofrojnë informata të pakëta. Mirëpo, nuk mund të thuhet se në tekstet e tilla akti i komunikimit nuk vazhdon.

*Situacionaliteti (Situationalität)* është kriteri i gjashtë i tekstualitetit, i cili lidhet ngushtë me rrethanat për të cilat është prodhuar teksti, do të thotë se teksti duhet të ketë përputhshmëri me situatën për të cilën flitet në të.

<sup>51</sup> Beaugrande, R.A., / Dressler, W.U., vepra e cit., f.122

<sup>52</sup> Topalli, T., Gjuhësi teksti, Shkodër, 2011, f.162

<sup>53</sup> Vep. e cit. nga Rexhepi, S., në punimin e doktoratës në dorëshkrim „Analizë tekstore e përfaqëse e përdorimit të kohëve të shkuara në gjuhët gjermane dhe shqipe”, Prishtinë, 2012, f.159

<sup>54</sup> Beaugrande, R.A., / Dressler, W.U., vepra e cit., f.9

<sup>55</sup> Beaugrande, R.A., / Dressler, W.U., vepra e cit., f.10-11

*Ndërtëkstualiteti (Intertextualität)* është kriteri i fundit sipas studuesve Beaugrande/Dressler, i cili nënkupton receptimin e tekstit në bazë të një a disa teksteve të njohura më parë, që kanë kontinuitet me tekstin që pason.<sup>56</sup>

Të shtatë kriteret e tekstualitetit janë veti të domosdoshme të të qenit tekst. Pa këto kritere fjalët dhe fjalitë e strukturës së tekstit në asnjë mënyrë nuk mund të kenë qëndrueshmëri të plotë. Në të kundërtën, ato e përlligjin strukturën formale e logjike të tekstit.

#### **2.4. Tema dhe rema – përbërës informativë të tekstit**

Në literaturën shkencore të gjuhësisë tekstore rëndësi e veçantë i kushtohet dy konstituentëve informativë të fjalisë: temës dhe remës.<sup>57</sup> Ndarjen temë-remë (Thema-Rhema-Gliederung) e kanë bërë të njohur studiuesit Drach dhe Boost si dhe disa lingvistë të shkollës së Pragës: Mathesius (1929), Beneš (1967), Firbas, Sgall etj., sipas së cilëve fjalia ndahet në dy pjesë : në temë si pikë nismëtare e thënies dhe remë<sup>58</sup>, si thelb i thënies „Nach dieser Konzeption lässt sich ein Satz von seinem ‘Mitteilungswert’ her gesehen in zwei Teile gliedern, in das das ‘Thema’ als den ‘Ausgangspunkt der Aussage’ und das ‘Rhema’ als den Kern der Aussage”.<sup>59</sup> Sipas studiuesit F. Daneš tema në aspektin kontekstual paraqet informacion të ri ,ndërkaq rema identifikon se çfarë thuhet për temën. Sipas tij struktura e tekstit përbëhet nga sequenca e temave. Në këtë kontekst, ai shton se struktura e tekstit, në mënyrë hierarhike, përbëhet nga një zinxhir i lidhjes së temave, të cilat ndërtojnë lidhje mes paragrafëve dhe të tekstit në tërësi „Die eigentliche thematische

<sup>56</sup> Beaugrande, R.A., / Dressler, W.U., vepra e cit., f.13

<sup>57</sup> Polenz von R., Deutsche Satzsemantik, Berlin, 1988, f.293

<sup>58</sup> Polenz von R.,vepra e cit.,f.293

<sup>59</sup> Brinker, K., vepra e cit., f.44

Struktur des Textes besteht ... in der Verkettung und Konnexität der Themen, in ihrer Wechselbeziehungen und ihrer Hierarchie, in den Beziehungen zu den Textabschnitten und zum Textganzen, sowie zur Situation".<sup>60</sup> Tërë ky kompleksivitet i relacioneve tematike në tekst, sipas tij njihet si progresion tematik „thematische Progression” dhe ai dallon pesë tipa të tij :

- **Progresionin e thjeshtë linear (einfache lineare Progression)**, në të cilin rema e fjalisë së parë bëhet temë e fjalisë së dytë, rema e fjalisë së dytë bëhet temë e fjalisë së tretë, etj:

$$R_1=T_2, R_2=T_3, R_3=T_4 \dots :$$

„Prore Mashi djelmve t’Hotit

„Gerne pflegte zu erzählen

U kallzote punët e motit(R<sub>1</sub>),

Mafla alte Heldentaten,

Punët e motit(T<sub>2</sub>=R<sub>1</sub>), punë trimnije”<sup>61</sup>

Hotis Jugend, Heldentaten,

Wie vorzeiten fie gebräuchlich.”<sup>62</sup>

Në këtë rast, progresioni i thjeshtë linear i shembullit të shqipes, në tekstin e përkthyer nga Lamerci del me tematizim të kombinuar.

- **Progresionin me një temë përshkuese (die Progression mit einem durchlaufenden Thema)**. Në këtë rast tema e disa fjalive që përdoren radhazi mbetet e njejtë apo konstante, kurse në fjalitë e veçanta vetëm rema futet si e re:

$$T_1=R_1, T_1=R_2, T_1=R_3 \dots$$

<sup>60</sup> Brinker, K., vepra e cit., f.44

<sup>61</sup> Fishta., Gj., O.F.M., Lahuta e Malcis, Shkodër, 1937, f.134

<sup>62</sup> Lambertz, M., Die Laute des Hochlandes, München, 1958, f.79.



„Oso Kuka (T<sub>1</sub>) na u ká prî (R<sub>1</sub>).  
 Oso Kuka (T<sub>1</sub>) 'i rrfë prej qiullet (R<sub>2</sub>)  
 Shoq(T<sub>1</sub>) nuk ka kah vrán e kthiellet(R<sub>3</sub>).”<sup>63</sup> gleihet(R<sub>2</sub>), der (T<sub>1</sub>) vom Himmel zündet  
 hatt er(T<sub>1</sub>) doch nicht seinesgleichen  
 unter'm Himmelszelt, soweit es sich  
 bewölkt und wieder blauet(R<sub>4</sub>)”<sup>64</sup>

- ***Progresionin me tema prodhuese (die Progression mit abgeleiteten Themen).***

Në këtë tip të progresionit të temave prodhohet nga fjalitë e veçanta një hipertemë:

T<sub>1</sub>=R<sub>1</sub>, T<sub>2</sub>=R<sub>2</sub>, T<sub>3</sub>=R<sub>3</sub> = hipertemë;


„Vetulla (T<sub>1</sub>) e saj ndrejt si fiskaja (R<sub>1</sub>);  
 Syni (T<sub>2</sub>) i saj, si kokrra e qershís (R<sub>2</sub>);  
 Qafa (T<sub>3</sub>) e saj, si qafa e pllumbit (R<sub>3</sub>)”:  
 Dhâmët (T<sub>4</sub>) e bardhë, si gurzit e lumit (R<sub>4</sub>)”<sup>65</sup>

„ Ihre Augenbrauen (T<sub>1</sub>) sind wie ein  
 junger Eichenwald (R<sub>1</sub>),  
 Ihr Auge (T<sub>2</sub>) wie die Kirsche (R<sub>2</sub>),  
 Ihr Hals (T<sub>3</sub>) wie der Hals der Taube (R<sub>3</sub>),  
 Ihre Zähne (T<sub>4</sub>) weiss, wie die  
 Kieselsteine des Flusses nach dem  
 Regen (R<sub>4</sub>).”<sup>66</sup>

<sup>63</sup> Fishta., Gj., vepra e cit., f.19

<sup>64</sup> Lambertz, M., Die Laute des Hochlandes, f.21

<sup>65</sup> Palaj.B., Kurti.D., vepra e cit., f.27



- **Progressionin me një remë të zbërthyer (die Progression eines gespaltenen Rhemas),** ku rema e një fjalie zbërthehet në disa tema:

$T_1=R_1, T_2=R_1, T_3=R_1..$

„Un po tnap n'i kok' e moł (R<sub>1</sub>) ! Mołen (T<sub>2</sub>=R<sub>1</sub>) tē haš vet (R<sub>2</sub>). Eđe lekuret (T<sub>3</sub>=R<sub>1</sub>) tja huđis pelēs (R<sub>3</sub>) !”<sup>67</sup>

„Ich will dir einen Apfel (R<sub>1</sub>) geben!

Den Apfel (T<sub>1</sub>=R<sub>1</sub>) musst du selbst essen (R<sub>2</sub>)!

Die Schale (R<sub>3</sub>) wirf der Stute vor!”<sup>68</sup>

<sup>66</sup> Lambertz, M., Die Volspezie der Albaner, Sarajevo, 1917, f.7-13

<sup>67</sup> Lambertz, M., Albanische Märchen, f.196

- *Progresionin me një kapërcim tematik ( die Progression mit einer thematischen Sprung).* Ky tip i progresionit realizohet duke bërë kapërcim tematik, që nënkupton se një pjesë e zinxhirit tematik mënjanohet nga koneksioni i temave:

$T_1=R_1, T_2=R_1, T_4=R_4$

„Ište i mret ( $T_1$ ), k’i nuk kište femi ( $R_1$ ).

Femi ( $T_2=R_1$ ) nuk kam ( $R_2$ ). N fron ( $T_4$ ) t mretit nuk kam, tsilin te la ( $R_4$ )”<sup>69</sup>

„Es war einmal ein König ( $T_1$ ), der keine Kinder hatte ( $R_1$ ).

Weil ich keine Kinder ( $T_2$ ) habe ( $R_2$ ),

Niemanden habe, den ich auf dem Königsthorn ( $T_4$ ) zurücklassen kann ( $R_4$ ).”<sup>70</sup>

Studiuesi F. Daneš duke folur për tipat e progresionit tematik thekson se në tekste konkrete këta tipa realizohen ashtu siç u pa më lart, mirëpo nganjëherë, në raste të veçanta, ato mund të kombinohen.<sup>71</sup>

„Tema FSP është term i specializuar i perspektivës funksionale të fjalisë, e cila nuk duhet ngatërruar me temën e tekstit si koncept i përgjithshëm gjuhësor”.<sup>72</sup> Tema si perspektivë funksionale e fjalisë (Thema FSP) shfaq informacion të njohur në fjali. Nga ana tjetër, rema (Rhema) realizon pjesën e informacionit të panjohur. Pra, tema dhe rema shpalosin informacionet e tekstit. Në këtë mënyrë, këta dy kodues funksional dalin me role të veçanta gjatë realizimit të informacionit. Konceptet temë dhe remë shërbejnë si

<sup>68</sup> Lambertz, M., vepra e cit., f.199

<sup>69</sup> Lambertz, M., vepra e cit., f.196

<sup>70</sup> Lambertz, M., vepra e cit., f.199

<sup>71</sup> Brinker, K., vepra e cit., f.44-45

<sup>72</sup> DUDEN, Die Grammatik,Manneheim, Band 4, 2009, f.1133

lidhje e fortë mes formës dhe përmbajtjes së tekstit, gjegjësisht kohezionit dhe koherencës tekstore. Nga kjo hetohet se lidhjet mes strukturës informative (Informationsstruktur) të fjalisë dhe strukturës gramatikore të saj (grammatische Struktur) përbëjnë perspektiven e fjalisë (Satzperspektive).<sup>73</sup>

Me çështje të përbërësve strukturorë të fjalisë: temës dhe remës janë marrë edhe studiues shqiptarë si : K.Dibra, N.Vorfi, A.Çeliku etj. Sipas K.Dibra dhe N.Vorfi në optikën e perspektivës funksionale të fjalisë (funktionale Satzperspektive-FSP), është përcaktuar aspekti tematik dhe aspekti konceptual i temës dhe remës. Në aspektin tematik, tema është ajo mbi të cilën kumtohen diçka dhe është përcaktues i informacionit (Identifikation), ndërkaq ajo që kumton për temën është rema. Nga ana tjetër, shikuar në aspektin konceptual, tema paraqet diçka që është e njohur në kontekst. Përkundër temës, rema është informacion i ri i panjohur i tekstit.<sup>74</sup>

Edhe A.Çeliku duke folur për dallimin mes temës dhe remës shton se tema paraqet informacion të njohur, ndërsa rema informacion të ri. Autori në veprën e tij „Herstellung von Textkohärenz im Deutschen und im Albanischen” mbështet kompleksivitetin e relacioneve tematike në tekst, përkatësisht progresionin tematik, që ka përcaktuar ndër të parët nga studiuesi F.Daneš.<sup>75</sup>

## ***2.5. Kategoritë semantike të tekstit – konteksti dhe koteksti***

Koncepti tekst në teorinë e komunikimit nënkupton të gjitha elementet e situatës së komunikimit, me anë të të cilave mundësohet të kuptuarit e një shprehjeje apo teksti. Mund të flitet për dy dimensione të kontekstit: për dimensionin gjuhësor (verbales

<sup>73</sup> DUDEN, f.1199 -1120

<sup>74</sup> Dibra, K., Vorfi,N., Gjuhësi teksti, Shkodër, 2005, f.69

<sup>75</sup> Çeliku, A., Herstellung von Textkohärenz im Deutschen und im Albanischen, Mannheim, 2007, f.50-54

Kontext) dhe dimensionin situativ (situative Kontext) të tij. Brenda kuptimit të përgjithshëm të konceptit kontekst hyn nga njëra anë konteksti personal e social dhe nga ana tjetër konteksti gjuhësor. Në kuadër të kuptimit të përgjithshëm të kontekstit të situatës së ligjërit, rëndësi të posaçme kanë vendi, koha dhe lidhja e veprimeve për të cilat flitet.

Në „Lexikon der Sprachwissenschaft” të H.Bußmann-it, pas shpjegimit etimologjik të fjalës *kontekst* (nga lat. *contextere* > eng *verknüpfen*), përkufizimi i kontekstit si një ndër elementet e rëndësishme të teorisë së komunikimit përfshin kontekstin verbal dhe jo verbal, kontekstin aktual të situatës së ligjërit si dhe kontekstin social, që nënkupton lidhjen mes folësit dhe dëgjuesit.<sup>76</sup> Sikurse Bußman-i, ashtu edhe Schegloff bën kategorizimin e kontekstit. Ai dallon dy tipa të kontekstit: kontekstin „eksternal” dhe kontekstin „interakcional”. Konteksti i jashtëm „external” ka të bëjë me faktorët e jashtëm (përkatësinë etnike dhe shtresore). Nga ana tjetër, konteksti i brendshëm apo „interakcional” paraqet situatën e bisedës (*speech event*) dhe rolin e pjesëmarrësit në këtë ngjarje.<sup>77</sup>

Studiuesit si Bloomfield dhe Budagov e shohin si të njëjtë, pra e identifikojnë kontekstin me situatën e bisedës, ndërkohë që Amosova bën dallimin mes kontekstit në kuptimin e ngushtë të fjalës dhe situatës së bisedës. Ndërsa, sipas Lewandowskit, koncepti kontekst nënkupton qarkun e një njësie linguistike, kushtet e paraqitjes së disa njërive kuptimore dhe së fundi tekstin apo pjesët e tekstit si përmbyllje relativisht e kuptueshme e mendimeve. Studiuesi tjetër Kolšanskij dallon faktorët gjuhësorë brenda fjalisë (*Mikrokontext*), brenda paragrafit (*Makrokontext*) dhe të tërë tekstit<sup>78</sup>.

Koncept tjetër i rëndësishëm i teorisë së komunikimit krahas kontekstit është dhe konteksti. Përderisa strukturën e kontekstit e përbëjnë një numër faktorësh, për të cilët u fol më lart, konteksti është bashkëtekst, të cilin e ndërtojnë faktorët situativë. Çdo shprehje me

<sup>76</sup> Bußmann, H., Lexikon Sprachwissenschaft, Stuttgart: Körner, 1983, f.267

<sup>77</sup> [https://www.univie.ac.at/linguistics/publications/diplomarbeit/schepelmann/der\\_begriff\\_kontext.htm](https://www.univie.ac.at/linguistics/publications/diplomarbeit/schepelmann/der_begriff_kontext.htm)

<sup>78</sup> Schippan, Th., Lexikologie der deutschen Gegenwartssprache, Tübingen Niemeyer, 1992, f.176

anë të kontekstit situativ krijon vetë kontekstin e po atij konteksti.<sup>79</sup> Edhe në leksikonin e Bußmann-it, konteksti shpjegohet si kontekst situativ, që dallohet nga konteksti gjuhësor.<sup>80</sup>

Nga e gjithë kjo, shihet se konteksti dhe konteksti janë faktorë të rëndësishëm të strukturës gjuhësore dhe strukturës semantike të tekstit, gjegjësisht aktit të komunikimit.

### **3. ÇËSHTJE TË TIPOLOGJISË SË TEKSTIT**

Ndër çështjet e rëndësishme të lingistikës së tekstit është klasifikimi i tekstit në klasa, tipa dhe lloje. Megjithatë, diskutimet lidhur me këto probleme mbeten të hapura, sepse teksti si shenjë e madhe komplekse gjuhësore ka veçori të shumëta.<sup>81</sup>

#### ***3.1. Grupet e tekstit***

Tekstet ndahen në dy grupe të mëdha, në tekste fiktive (letrare) dhe në tekste jofiktive (joletrare).

Tekstet letrare janë fikcion (trill). Si krijime të trilluara, ato janë të pavarura në aspektin situacional që nënkuptojnë temat, personazhet, vendet dhe kohën. Dërguesi dhe marrësi nuk komunikojnë në të njëjtën kohë. Pasiqë, situata e teksteve letrare është abstrakte, ajo nuk u referohet rrethanave dhe faktorëve të sotëm a të dikurshëm kontekstualë. Teksti letrar, duke qenë tekst me karakter universal, jeton gjatë. Tekste të

---

<sup>79</sup> [https://www.univie.ac.at/linguistics/publications/diplomarbeit/schepelmann/Daten/der\\_begriff\\_kontext.htm](https://www.univie.ac.at/linguistics/publications/diplomarbeit/schepelmann/Daten/der_begriff_kontext.htm)

<sup>80</sup> Bußmann, H., vepra e cit., f.278

<sup>81</sup> Werlich, E., vepra e cit., f. 106

tilla janë baladat, përrallat, fabulat, novelat, romanet, krijimet dramatike, poemat epike etj.<sup>82</sup>

Tekstet joletrare (jofiktive) janë tekste faktike që do të thotë rrethanat, hapësira, koha, vendi dhe individët janë të njohur. Tekstet faktike janë tekste të një situatë konkrete, në të cilën dërguesi dhe marrësi komunikojnë me anë të shenjave gjuhësore. Përkundër teksteve letrare që qarkullojnë në kohë, tekstet joletrare shenojnë një periudhë të caktuar.

### **3.2. Tipat e tekstit**

Tipat e tekstit përcaktohen nga tematika tipike e tyre. Duke u mbështetur në këtë kriter, dallohen pesë tipa tekstesh: *teksti përshkrues (deskriptive Text)*, *teksti narrativ (narrative Text)*, *teksti shpjegues (expositorische Text)*, *teksti argumentues (argumentative Text)*, dhe *teksti instruktiv (instruktive Text)*.

1. Në *tekstin përshkrues (deskriptive Text)* baza tekstore është strukturë e thjeshtë kryefjalë – kallëzues – rrethanor (SPA) dhe imperfekti, si dhe një ndajfolje vendi. Ndajfolja e vendit mund të jetë e varur ose e pavarur kontekstualisht dhe lidhet me kornizat hapsinore. Fjalja e tekstit përshkrues është fjali e fenomeneve të regjistruara.
2. *Baza tekstore narrative* ka strukturë të fjalisë kryefjalë – kallëzues – rrethanor (vendi) – rrethanor (kohe) (SPAA). Forma e foljes është në imperfekt. Në këtë tip të tekstit ndajfolja e kohës mund të jetë e varur ose e pavarur kontekstualisht dhe lidhet me korniza kohore. Fjalja e tekstit narrativ është fjali regjistruese e veprimeve, gjegjësisht e ndryshimeve.
3. *Baza tekstore shpjeguese* ka strukturë kryefjalë – kallëzues – grup emëror (Subjekt – Prädikat – Nominalgruppe apo Complement). Folja e fjalive të tekstit

---

<sup>82</sup> Werlich, E., vepra e cit., f. 21

shpjegues semantikisht lidhet me formulimin „i referohem” (refer to), „është definuar” (be defined), „quhet” (be called).

4. *Baza tekstore argumentuese* ka të bëjë me zgjedhjen e relacioneve mes koncepteve ose thënive të folësit. Fjalja në këtë tekst ka strukturë kryefjalë – kallëzues – mbiemër. Ndryshe, fjalja e tekstit argumentues quhet fjali atributive.
5. *Baza tekstore instruktive* ndërtohet me anë të urdhërores me një kallëzues të thjeshtë d.m.th ka strukturë folje (P) ose folje – grup foljor (PC). Fjalja e tekstit instruktiv është fjali udhëzuese e veprimeve.<sup>83</sup>

### 3.3. *Format e tekstit*

Tri format kryesore të tekstit janë: *perspektiva e folësit* (*Sprecherperspektive* ose *point of view*), *variantet e gjuhës* (*Sprachvariante*) dhe *kompozicioni* (*Kompositionsmuster*).

Perspektiva e folësit –lidhet me situatën komunikative të folësit, fjalitë e së cilës përbëhen nga një varg konstituentësh që shprehin rrethana dhe gjendje të ndryshme. Këta konstituentë të tekstit e plotësojnë perspektivën e folësit dhe bëjnë tematizimin e aspekteve të ndryshme të perspektivës së folësit.

1. *Veta (Person)* është aspekt i perspektivës së folësit, e cila plotëson vendin e kryefjalës. Veta e parë në njëjës dhe shumës shënon rolin e folësit ose folësve, do të thotë shpreh perspektivë personale të folësit a folësve dhe është e lidhur me botën njerëzore. Ndërsa, përemri i pacaktuar paraqet perspektivë jovetore (nicht-personale Sprecher – Perspektive) të folësit. Veta e tretë shumës nuk

---

<sup>83</sup> Werlich, E., vepra e cit., f. 27-43



nënvizon dallim mes perspektivës vetore dhe jovetore.<sup>84</sup> Veta e parë, e cila paraqet rolin e folësit në shprehjet tekstore lidh të gjitha rrethanat, ndryshimet dhe faktet: „Der Sprecher thematisiert in der Füllung der Subjektstelle der Sätze die grammatische Person-hier sich selbst in der personal besetzen Sprecherrolle der 1. Person Singular. Auf diese Person werden alle Gegenstände, Veränderungen und Sachverhalte in der textlichen Äusserungen bezogen.“<sup>85</sup> Nëse prodhuesi i tekstit tematizon përemrat e vetës së parë njëjës (I), vetës së parë shumës (we) dhe vetës së tretë njëjës (he/she) me iniciator nominal, atëherë perspektiva vetore e folësit është e caktuar (definierte personale Sprecherperspektive). Ndërkaq, tematizimi i përemrit të vetës së 3. njëjës shfaq perspektivë jovetore, gjegjësisht perspektivë të folësit që lidhet me gjësende. Së fundi, përemri vektor i vetës së 3. shumës është konstituent tekstor që shpreh dallueshmërinë mes perspektivës vetore dhe jovetore.<sup>86</sup>

2. *Këndvështrimi (Fokus/Blickwinkel)* është aspekti i dytë i perspektivës së folësit.

Këndvështrimi paraqet gjerësinë kohore dhe hapsinore, me të cilën folësi shpreh rrethanat dhe gjendjet në një afërsi kohore-hapsinore. Këndvështrimi mund të jetë i hapur dhe i mbyllur. Këndvështrimi, në të cilin përmbledhen format e sekuencave lokale dhe temporale është kundvështrim i hapur (öffnende Fokus), ndërsa këndvështrimi që përmbledh më pak format e sekuencave lokale e temporale është fokus i mbyllur (schließende Fokus).<sup>87</sup>

3. *Koha (Tempus)* paraqet rrethanat dhe gjendjet, që kanë të bëjnë me aksin orientues. Duke u mbështetur në funksionin primar të kohëve në tekst, ato dallohen nga aspekti i paraqitjes së aksit orientues kohor, me ç' rast folësi gjatë

<sup>84</sup> Werlich, E., vepra e cit., f.46-47

<sup>85</sup> Werlich, E., vepra e cit., f.46

<sup>86</sup> Werlich, E., vepra e cit., f.46-47

<sup>87</sup> Werlich, E., vepra e cit., f.50-51

aktit bisedimor (Sprechakt) mund të zgjedh mes aksit të së tashmes (Gegenwartsachse) dhe aksit të së shkuarës (Vergangenheitsachse). Në aksin e së tashmes grupohen e kryera dhe e ardhmja, ndërkaq në aksin e së shkuarës grupohen e kryera e thjeshtë dhe e pakryera. Prezenti përdoret pa ndonjë lidhje me aksin e së tashmes.<sup>88</sup> Varësisht nga lloji i tekstit distribuohen edhe grupet e kohëve. Kështu pra, forma foljore në imperfekt është bazë tekstore tematike për narracion, forma foljore në prezent është bazë tematike e teksteve argumentuese, ndërkaq në tekstet deskriptive distribuohet prezenti apo imperfekti.<sup>89</sup>

4. *Aspekti (Aspekt)* është pika e katërt e perspektivës së folësit. Folësi gjatë prodhimit të tekstit ndryshimet dhe faktet i përcakton në kontinum kohor: „Die Wahl eines Aspekts, der sich in den Verbformen eines Textes manifestiert, signalisiert, wie der Sprecher Veränderungen und Zustände in Bezug auf Segmente im Zeitkontinuum sieht.“<sup>90</sup> Kështu, mund të theksohet se perspektiva aspektore është e lidhur ngushtë me zgjedhjen e kohës d.m.th me manifestimin e formave të foljes në një tekst.<sup>91</sup>

5. *Diateza (GenusVerbi)* është zgjedhje e llojit të veprimit dhe do të thotë se është pjesë tjetër e perspektivës së folësit. Zgjedhjet e veprimit janë veprorja (Aktiv) dhe pësoja (Passiv). Folja në veprorë i jep shprehjes një drejtim qëndrimi d.m.th kryefjala është agent me ndikim të drejtuar me anë të foljes në veprorë. Ndërkaq, pësoja është një formë shenjuese foljore e gjinisë. Folësi në fjalinë

---

<sup>88</sup> Werlich, E., vepra e cit., f.51-52

<sup>89</sup> Werlich, E., vepra e cit., f.51-52

<sup>90</sup> Werlich, E., vepra e cit., f.52

<sup>91</sup> Werlich, E., vepra e cit., f.52

në pësore ose nuk mund të përmendë ose nuk do ta përmendë bartësin e veprimit (Handlungsträger).<sup>92</sup>

6. *Modusi (Modus)* është pjesë tjetër e aspektit, ku përmes formës foljore të një teksti jepen informacione për mënyrën e shprehjes së folësit, personave, objekteve dhe fakteve. Janë tri moduse mes të cilave folësi mund të zgjedhë: modusi faktik (faktische Modus), modusi negativ (negative Modus) dhe modusi i mundësisë (wahrscheinliche Modus). Modusi faktik shpreh ekzistencën reale të fakteve dhe rrethanave përmes fjalive afirmative (affirmativer Sätze), Modusi negativ paraqet ekzistencën reale përmes fjalive mohore (verneinte Sätze), pikërisht me anë të pjesëzave propozicionale (not), prefiksive të mbiemrave (un-, dis-) dhe ndajfoljeve (never, not longer). Dhe së fundi, folësi me modusin e mundësisë shfaq ekzistencën e mundëshme të rrethanave dhe fakteve të ndryshme. Modusi i mundësisë modifikohet përmes fjalive mohore (verneinte Sätze), pikërisht përmes foljeve modale (can, could, may, might).<sup>93</sup>

### 3.3.1. Variantet e gjuhës

Variantet e gjuhës janë kode të një gjuhe natyrore, të cilat përmbajnë veçori kontekstuale dhe kontekstuale. Variantet e gjuhës janë: *dialekti, idiolekti, sociolekti, registri dhe stili*. Dialekti është një variant regjional (ku një grup i folësve flet një variant të gjuhës në një regjion të caktuar) dhe temporal (kur një grup i folësve në një kohë të

---

<sup>92</sup> Werlich, E., vepra e cit., f.53

<sup>93</sup> Werlich, E., vepra e cit., f.54

caktuar flet një variant të caktuar të gjuhës). Këto variante të gjuhës njihen dhe si medium komunikativ. Përderisa dialekti është prodhim kolektiv i gjuhës, idiolekti është prodhim individual i saj.

*Idioma tekstore* paraqitet në strukturën e fjalisë dhe konstituentët e saj janë karakteristikë për secilin nga pesë tipat e tekstit, do të thotë dallohen idiomat tekstore përshkruese, idiomat tekstore narrative, idiomat tekstore shpjeguese, idiomat tekstore argumentuese dhe idiomat tekstore instruktive. Pra, idioma tekstore e varianteve të gjuhës ka të bëjë me tipat e tekstit dhe realizohet individualisht nga folësi.

*Stili* është një paraqitje leksikore dhe sintaksore si dhe një përzierje e varianteve gjuhësore referenciale. Nën konceptin variant i gjuhës radhiten disa lloje të stilit si stili neutral (neutraler Stil), i cili shfaqet në të gjitha variantet gjuhësore të një gjuhe natyrore si thelb i përbashkët, leksikor dhe sintaksor, *stili metaforik (metaphorischer Stil)*, i cili konsiderohet si stil referencial i gjuhës me anë të të cilit shfaqen rrethanat e menduara, pastaj *stili ironik (ironischer Stil)*, *stili hiperbolik (hiperbolischer Stil)*, *stili teknik (technischer Stil)* etj.

### **3.3.2. Kompozicioni**

Kompozicioni i tekstit i referohet konstituentëve të brendshëm të tij. Aspektet e kompozicionit të tekstit janë hyrja, format e njëpasnjëshme, njësitë e tekstit dhe përfundimet. Me anë të njërive të tekstit, koduesit (folësit) i mundësohet që të prodhojë thënie gjuhësore koherente përtej fjalisë për dekoduesin. Shkalla e renditjes të njërive të tekstit nis nga njësia më e madhe, siç janë libri (Buch), pjesa e librit (Teil des Buches),

kapitulli (Kapitel), segmenti i librit (Sektion des Buches), paragrafi (Paragraph) dhe fjalia (Satz).<sup>94</sup>

#### 4. KONSIDERATA TEORIKE PËR FOLJET DHE KONEKTORËT

##### *4.1. Format e foljeve – konstituentë të rëndësishëm të strukturës së tekstit dhe diskursit*

Për strukturën e tekstit, krahas përbërësve të tjerë, të një rëndësie të veçantë janë folja dhe konektorët. H.Weinrich në veprën „Textgrammatik der deutschen Sprache” foljen e sheh si njësi qendrore të organizimit të tekstit.<sup>95</sup>

Funksionet e foljes, gjegjësisht e të gjitha formave të foljes, siç janë funksioni semantik, funksioni sintaksor etj., që ka folja për tekstin, janë trajtuar si probleme të rëndësishme dhe në DUDEN Grammatik, e cila është sintezë e mendimit gramatikor gjerman. Në këtë gramatikë koncepti „*Verb*” përdoret në kuptimin e foljes dhe varianteve të foljes, por dhe në kuptimin e formave të foljes. Në të më tutje nënvizohet se folja

---

<sup>94</sup> Werlich, E., vepra e cit., f.18-60

<sup>95</sup> Weinrich, H., Textgrammatik der deutschen Sprache, vierte revidierte Auflage, Zürich, 2007, f.29

ndyshon formën sipas këtyre kategorive: kategorisë së kohës (Tempus), mënyrës (Modus), numrit (Numerus), vetës (Person) dhe diatezës (Genus).<sup>96</sup>

Pra, folja si kategori gramatikore ka format e shtjelluara apo finite, por dhe format e pashtjelluara apo infinite të saj. Format e shtjelluara të foljes janë forma predikative ose vetore. Kur fjalia është dykryepërbërëse, format e shtjelluara të foljes kanë gjithmonë një kryefjalë, me të cilën ato bashkëpërshtaten në numër dhe vetë, herë-herë edhe në gjini. Format e shtjelluara të foljes kanë kategoritë gramatikore të mënyrës, të vetës, të numrit, të kohës (në disa gjuhë edhe kategorinë e aspektit), të diatezës, ato marrin kundrinorë të drejtë e të zhdrejtë të plotësuar me ndajfolje”.<sup>97</sup>

#### **4.1.1. Funkzioni i kohës (Tempus) në tekst**

Kategorizimi tradicional i kohës (Tempus) është i hershëm. Qysh herët njihen tri kundërvënie gramatikore të kohëve. Këto kundërvënie, që janë rezultat i shprehjeve sistematike gramatikore shfaqin marrëdhënie të ndryshme kohore. Janë gjithsej tri kundërvënie të tilla gramatikore: preteriti, e tashmja dhe e ardhmja. Në studimet e hershme linguistike është menduar se raporti trigjymtyrësh i kohës ka karakter universal dhe është i drejtë. Mirëpo, John Lyons kundërshton tri kundërvëniet e tilla të tempus-it të gramatikës tradicionale. Sipas tij, „*koha nuk vërehet në të gjitha gjuhët; dhe kundërvënia e shkruar, e tashme, e ardhme në greqishte dhe latinishte nuk është thjeshtë vetëm një çështje kohe. Tipari themelor i kategorisë së kohës është se ajo vendos marrëdhënie midis kohës së veprimit, të ngjarjes ose gjendjes, të gjërave të cilave u referohet fjalia dhe kohës së shprehjes (ku koha e shprehjes i përket çastit të ligjërimit). Prandaj, koha është një kategori deiktike, e cila është në të njëjtën kohë tipar i fjalisë dhe i shprehjes*”.<sup>98</sup>

<sup>96</sup> DUDEN, vepra e cit., f.395

<sup>97</sup> Çeliku, M., Format e pashtjelluara të foljes në gjuhën shqipe, Tiranë, 2013, f.30

<sup>98</sup> Lyons, J., vepra e cit., 2001, f.284

Sipas studiuesve A.Linke/M. Nussbaumer/P.R Portmann „*kategoria e kohës nuk ka fuqi të posaçme aktive për lidhjen e tekstit*”<sup>99</sup>. Megjithatë, ata konstatojnë se në tekstet e tipit rrëfimitar (narrativ), përdorimi i kohëve ka rëndësi, sepse është udhëzim i sekuençave të ngjarjeve që rrëfohen dhe në këtë mënyrë bën rregullimin linear – kohor të objekteve referenciale që lidhen me kohën apo tempusin.<sup>100</sup>

Interpretimi dinamik i tempusit në tekst dhe në diskurs është i një rëndësie të veçantë. Pra, ndryshimi i formave të tempusit nga njëra kohë në tjetrën, brenda segmenteve të tekstit ndërton kontekst të ri kohor interpretues – Interpretationskontext (krh.G.Zifonun u.a.1997, f.1713). Sipas J.Schwitalla (krh.1997a, f.103), ky ndryshim i formave të tempusit nuk bën vetëm ndryshimin e situatave kohore, por dhe të statusit të pjesëve të tekstit.<sup>101</sup>

Në studimet për tekstin janë bërë hulumtime të ndryshme për format kohore në gjuhën gjermane. Format kohore në tekst janë hulumtuar sipas vendit të tyre që zënë në tekst, sipas llojit të tekstit apo edhe sipas karakterit absolut dhe relativ të përdorimit të tyre në tekste.<sup>102</sup>

Analiza e formave kohore apo formave të tempusit në tekst ka tërhequr vëmendjen e shumë studiuesve, H.Weinrich, S.Latzel, R.Reichenbach, H.Vater, M. Marschall etj.

Ndër studiuesit e parë që janë marrë me analizën e formave kohore të mbështetura në tekstet letrare, duke bërë ndarjen e kohëve në tekst është H.Weinrich. Sipas pikëpamjeve të tij, kohët në gjuhën gjermane ndahen në dy grupe: *në kohë të komentit (besprechende Tempora)* dhe *në kohë të rrëfimit (erzählende Tempora)*.<sup>103</sup> Në bazë të dominimit të kohëve në tekst, ai bën dhe ndarjen e teksteve. Tekstet, në të cilat më shpesh përdoren kohët e komentit i quan *tekste të të folurit*<sup>104</sup>, ndërsaq tekstet në të cilat më

<sup>99</sup> Linke, A. /Nussbaumer, M. /Portmann, R.P., Studienbuch Linguistik, Tübingen , 2001, f.222

<sup>100</sup> Vepra e cit., f.222

<sup>101</sup> Gansel, Ch./ Jürgens, F., Textlinguistik und Textgrammatik, Göttingen, 2009, f.214

<sup>102</sup> Rexhepi, S., vepra e cit., f.19

<sup>103</sup> Kohët e rrëfimit (erzählende Tempora) janë karakteristikë e teksteve narrative.

<sup>104</sup> Në tekste të të folurit përdoren kohët e komentit. Në këto tekste haset komunikim i drejtpërdrejtë folës-dëgjues

shpesh përdoren kohët e rrëfimit i quan *tekste rrëfimore*. Në „*besprechenden Tempora*” hyjnë: prezenti, perfekt, futuri dhe futuri II. Nga ana tjetër, në „*erzählenden Tempora*” ai numëron: preteritin, pluskuamperfektin, kondicionalin (me *würde* + Infinitiv I) dhe kondicional II (me *würde* + Infinitiv II).<sup>105</sup>

Gjatë analizës së formave të tempusit Weinrich ka diskutuar dhe dy dimensione të tjera të sistemit kohor „*Sprechperspektive*” (*perspektivën folëse*) dhe „*Reliefgebung*” (*relievizimin*). Perspektiva folëse përcaktohet si raport mes kohës së tekstit (*Textzeit*) dhe aktit të tekstit (*Aktzeit*).<sup>106</sup> Kurse, relievizimi në tekste bëhet me anë të parainformatave.<sup>107</sup>

Përdorimi relativ i kohëve (*Relativer Gebrauch der Tempora*) është i lidhur ngushtë me temporalitetin mes fjalive të përbëra, që kanë varësi mes vete. Varësia temporale mes fjalive të përbëra lidhet me zhvendosje të kohës, gjegjësisht me *njëkohësi* (*Gleichzeitigkeit*). Njëkohësia nënkupton zhvillimin e ngjarjes në kohën e njëjtë mes fjalisë kryesore (*Hauptsatz*) dhe fjalisë së varur (*Nebensatz*). *Parakohësia* (*Vorzeitigkeit*) paraqet zhvillimin e ngjarjes në fjalinë e varur para zhvillimit të ngjarjes në fjalinë kryesore. Dhe së fundi, *paskohësia* (*Nachzeitigkeit*) lidhet me zhvillimin e ngjarjes së fjalisë së varur pas fjalisë kryesore.<sup>108</sup>

Sipas Latzel, i cituar në studimin „*Einführung in die Textlinguistik*“ të H.Vater: „Das Merkmal ‘gebunden’ gilt im Grunde nur für ein einziges Tempus. Die restlichen Tempora des Deutschen werden-wie auch in anderen indogermanischen Sprachen – nicht durch gebundene Morpheme ausgedrückt”<sup>109</sup>

Latzel në kuadër të formave të tempusit në gjuhën gjermane ka diskutuar strukturat e ndryshme sintaksore të lidhjeve „haben + Partzip”, të cilat kanë rëndësi të madhe në tekst. Në bazë të pikëpamjeve të tij, e vetmja kohë që ka veçorinë e lidhjes (das

<sup>105</sup> Weinrich, H., vepra e cit., f.198-201

<sup>106</sup> Weinrich, H., vepra e cit., f.207-212

<sup>107</sup> Weinrich, H., vepra e cit., f.230

<sup>108</sup> Helbig, G. / Buscha, J., *Deutsche Grammatik*, Leipzig, 1993, f.158-160

<sup>109</sup> Vater, H., *Einführung in die Textlinguistik*, 2., überarb. Auflage, München: Fink, 1994, f.122-123



Merkmal „gebunden”) është preteriti. Kurse, kohët e tjera, gjegjësisht perfekt dhe pluskuamperfekti në gjuhën gjermane, ashtu si dhe në gjuhët tjera gjermanike, nuk janë morfema të lidhura.<sup>110</sup>

Po në këtë studim të Vater-it theksohet se: „Reichenbach (1947:288) nimmt drei Bezugspunkte für die zeitliche Einordnung von Ereignissen an:

- S (point of speech),
- E (point of event),
- R (point of reference)<sup>111</sup>

Pra, me interes për analizën e tempusit të teksteve dalin dhe mendimet e Reichenbach-ut, në bazë të të cilave janë të rëndësishme tri pika lidhëse të rregullimit kohor të ngjarjeve në tekst. Ai konstaton këto pika të kësaj lidhjeje: *pikën e bisedës (point of speech)*, *pikën e ngjarjes (point of event)* dhe së fundi *pikën e referencës (point of reference)*.<sup>112</sup>

Mbështetur në pikëpamjet e këtyre studiuesve për rëndësinë e formave kohore në tekste del se ka pajtueshmëri pothuajse të plotë mes përkufizimeve të J. Lyons-it, H. Weinrich-ut dhe Reichenbach-ut, meqë të gjithë pothuajse pajtohen me lidhjet që shfaqen mes çastit të ligjëritimit, ngjarjes dhe objekteve, të cilave u referohet fjalia, përbërës këta të cilët ndërtojnë funksionimin e formave të tempusit. Kjo lidhje mes këtyre përbërësve të tempusit qartëson kuptimin e tekstit, të cilin folësi ia adreson marrësit, qoftë në formë të shkruar apo në formë të folur. Prandaj, kategoria e tempusit ka rëndësi parësore për ta kuptuar dhe analizuar tekstin.

Mendime sintezuese për kategorinë e tempusit në gjuhën shqipe janë dhënë nga studiuesit shqiptarë, por dhe nga studiues të huaj, që janë marrë me studimet gramatikore të shqipes. Veprat më të njohura në këtë drejtim janë „Gramatika e gjuhës shqipe”, botim

---

<sup>110</sup> Vater, H., vepra e cit., f.122-123

<sup>111</sup> Vater, H., vepra e cit., f.125

<sup>112</sup> Vater, H., vepra e cit., f.125

i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, „Gramatika e gjuhës shqipe” nga Bahri Beci, ndërkaq nga studimet gramatologjike të huaja me vlera të veçanta është „Albanische Grammatik” nga studiuesit gjerman O.Buchholz / W.Fiedler.

Në këto dhe gramatika të tjera, krahas kategorive të tjera është përkufizuar dhe kategoria e tempusit. Në Grammatikën e ASHRSH, kategoria e tempusit shihet si lidhje e kohës së kryerjes së një veprimi dhe çastit të ligjëritimit, ku çasti i ligjëritimit merret si bazë për marrëdhëniet kohore. Derisa në gjuhën e shkruar si bazë për marrëdhëniet kohore merret çasti kur shkruajmë, në gjuhën e folur çasti i ligjëritimit merret si bazë për marrëdhëniet kohore. Çdo veprim që bëhet njëkohësisht me çastin e ligjëritimit shprehet me anë të kohës së tashme. Nga ana tjetër, veprimet e kryera para çastit të ligjëritimit shfaqen me kohën e kryer të foljes. Ndërkaq, veprimi që do të kryhet pas çastit të ligjëritimit, shprehet me kohën e ardhme.

Në mbështetje të marrëdhënieve kohore d.m.th kohës së kryerjes së veprimit dhe çastit të ligjëritimit del se janë tri kohë themelore të foljes në gjuhën shqipe: e tashmja, e shkuara dhe e ardhmja.<sup>113</sup>

Format foljore të tempusit të shqipes krahas kuptimeve të ndryshme kohore kanë dhe ngjyrimet e shumta aspektore „*Një gjë e tillë bie në sy sidomos te koha e shkuar e mënyrës dëftore, e cila ka pesë ndarje kryesore: të pakryerën, të kryerën e thjeshtë, të kryerën, më se të kryerën, dhe të kryerën e tejshkuar. Disa nga këto ( e kryera, më se e kryera dhe e kryera e tejshkuar) dallohen midis tyre për nga ngjyrimet kohore, por dallimet midis së pakryerës, së kryerës së thjeshtë dhe së kryerës kanë më fort karakter aspektor. E pakryera zakonisht e paraqet veprimin në zhvillim e sipër në një çast të caktuar të së shkuarës; e kryera e thjeshtë zakonisht paraqet atë të përfunduar në një çast*

---

<sup>113</sup> Agalliu, F., Angoni, E., Demiraj, Sh., Dhrimo, A., Hysa, E., Lafe, E., Likaj, E., Gramatika e gjuhës shqipe, Morfologjia, Tiranë, 2002, f.273

*të caktuar të së shkuarës, ndërsa e kryera tregon një veprim të përfunduar, që nuk i ka këputur lidhjet me çastin e ligjëritit*".<sup>114</sup>

Derisa disa nga format e së shkuarës të mënyrës dëftore kanë ngjyrime aspektore, kuptimi gramatikor i tempusit të mënyrave të tjera në gjuhën shqipe gërshetohet me modalitetin. Pra, nga kjo del se ekziston lidhje e ngushtë mes kategorisë së kohës dhe asaj së modalitetit në gjuhën shqipe.<sup>115</sup>

Po kështu edhe Bahri Beci në gramatikën e tij flet për rëndësinë e marrëdhënieve apo të lidhjeve kohore mes çastit të veprimit dhe çastit të ligjëritit. Sipas tij „*e tashmja tregon diçka që bëhet tani*”, e shkuara me nëndarjet e veta „*shpreh veprime të kryera para çastit të ligjëritit*”, kurse „*e ardhmja shpreh një veprim që pritet të kryhet pas çastit kur flasim ose që do të kryhet në të ardhmen*”.<sup>116</sup>

Ndryshe nga gramatikat e shqipes, të hartuara nga studiuesit shqiptarë, studiuesit gjermanë O.Buchholz dhe W.Fiedler sistemin e tempusit të shqipes e kanë zbërthyer shkencërisht në mënyrë më të detajuar. Kështu, sistemin e tempusit të shqipes sipas tyre e përbëjnë:

*Koha e tashme (Präsens)*, e cila në kuptimin e së tashmes (Gegenwart) përputhet me momentin e ligjëritit (Redemoment); në kuptimin e së ardhmes (Zukunft), varësisht nga konteksti i caktuar, ajo lidhet me përcaktues temporalë (Temporalbestimmungen); në kuptimin e së shkuarës (Vergangenheit), koha e tashme lidhet me prezentin historik (Praesens historicum), që do të thotë se në këtë mënyrë e shkuara projektohet në të tashmen.

Präsens në kuptimin e së ardhmes (Zukunft):

---

<sup>114</sup> vepra e cit., f.274

<sup>115</sup> vepra e cit., f.248

<sup>116</sup> Beci, B., Gramatika e gjuhës shqipe, Tiranë, 2010, f.111

- „Eðe msonj<sub>e tash.</sub> fmin mbas sodit” - „Daß sie nicht mehr gieren mögen, Präs.

- „Mos t’lakmojn<sub>e tash.</sub> toks s’Kastriotit”<sup>117</sup> nach dem Lande Kastriotis!”<sup>118</sup>

*Koha e pakryer (Imperfekt)* përdoret në kuptimin e së shkuarës. Ajo hyn në regjistrin rrëfimitar<sup>119</sup>:

- „ište<sub>e pak.</sub> n’iher n’i duhandži i ri, i tsili kište<sub>e pak.</sub> n’i gru pak të bukur.”<sup>120</sup>

- Es war Prät. einma ein junger Tabakhändler, der eine schöne Frau hatte Prät.<sup>121</sup>

*E kryera e thjeshtë (Aorist)* në gramatikën e Buchholz / Fiedler del me dy veçori themelore: me veçorinë e vet temporale dhe aspektore. Në kuptimin e së shkuarës (Vergangenheit) përmbajtja aspektore e aoristit paraqet një veprim si ngjarje të përfunduar a të mbyllur. Format e aoristit mund të formojnë zinxhir veprimesh (Handlungskette). Në kuptimin e së shkuarës, veprimi që bart aoristi shfaqet si i mbyllur edhe pse në momentin e ligjërimit është relevant. Aoristi shfaq veprim të shkuar, i cili lidhet me momentin e ligjërimit (Redemoment).

- „S’ka gje! kemi hasmeri te vjeter une dhe ay, prandaj s’foli<sub>e kr.thj</sub>”<sup>122</sup>

- „Das hat nichts zu sagen! Wir haben alte Feindschaft miteinander, ich und jener darum hat er nichts gesagt Perf.”<sup>123</sup>

---

117 FISHTA, Gj., O.F.M.: Lahuta e Malcis, Shtypshkronja françeskane, Shkodër, 1937, f.58

118 Lambertz, M., Die Laute des Hochlandes, München, 1958, f.42

119 Weinrich, H., vepra e cit., f.219-222

120 Lambertz, M., Albanische Märchen, Wien, 1922, f.215

121 Lambertz, M., vepra e cit., f.217

122 Lambertz, M., vepra e cit., f.166

123 Lambertz, M., vepra e cit., f.170

*E kryera (Perfekt)* në gjuhën shqipe lidhet me dy shkallë kohore: me të shkuarën (Vergangenheit) dhe me të tashmen (Gegenwart). Mirëpo, perfekti ka edhe dimensionin e së tashmes:

*„Ne kemi qenë (= jemi) shokë të ngushtë që në vegjëli.”<sup>124</sup>*

- dimensionin e së shkuarës :

*„Domethene afro njezet kokrra ve, kurse pula te shkreten, s’ka as pese dite qe ka nisur kry. te pjelle.”<sup>125</sup>*

*„Das heißt fast 20 Stück Eier, obwohl doch unser Huhn, das arme, seit fast fünf Tagen nicht mehr angefangen hat<sub>perf</sub>, Eier zu legen.”<sup>126</sup>*

-dhe dimensionin e së ardhmes:

*„Gjersa të vijë babai nga zyra,ne kemi mbaruar punën.”<sup>127</sup>*

*Koha më se e kryer (Plusquamperfekt)* ka dy veçori: kohësi të dyfishtë (Doppelzeitigkeit) dhe të shkuarën (Vergangenheit). Veçoria e parë ka të bëjë me lidhjen kohë e parashkuar (Vorvergangenheit) në kuptim të së shkuarës (Vergangenheit). Kurse, veçoria e dytë e kohës më se të kryer ndërton lidhje të veprimeve me kohë të parashkuar (Vorvergangenheit) dhe të shkuar (Vergangenheit). Varësisht nga konteksti, kjo formë kohore mund të shfaqet në mënyrë të njëpasnjëshme në fjali.<sup>128</sup>

*„Te një mritz, te një lejthí*

*„Auf dem schatt’gen Ruheplätzchen,*

<sup>124</sup> Buchholz, O., / Fiedler, W., Albanische Grammatik, Leipzig, 1987, f.130

<sup>125</sup> Lambertz, M., Albanische Chrestomathie, Berlin, 1955, f.196

<sup>126</sup> Lambertz, M., Albanische Märchen., f.198

<sup>127</sup> Buchholz,O./Fiedler,W.,vepra e cit.,f.130

<sup>128</sup> Po aty, f.123-133

*Kishin ndollun*<sup>mëse e kr. tre bar</sup>”<sup>129</sup>

*Unter einer Hafelstaude*

*Trafen*<sup>Prät. sich der Hirten dreie</sup>”<sup>130</sup>

Në mbështetje të këtyre pikëpamjeve, ndryshe nga gramatikat e hartuara nga studiuesit shqiptarë është evidente se Buchholz/Fiedler në gramatikën e tyre konceptin dhe përmbajtjen e tempusit e kanë thelluar, zgjeruar, plotësuar dhe pasuruar akoma më shumë. Në këtë kontekst, ata në gramatikën e tyre flasin në mënyrë më të gjerë për Tempussystem / Indikativ, ku përfshihen të gjitha kohët e dëftores; për Modussystem, ku përveç kohëve të Konjunktivit, Volitivit, Admirativit dhe Optativit, autorët gjerësisht i qasen dhe Possibilativ / Tempussystem, si dhe shtrojnë çështje të ndërtimit të kohëve me forma dhe konstrukcione të tjera, siç janë format „po...”, „dot...” etj.<sup>131</sup> Prandaj, aspektet e tyre të detajizuara për tempusin e shqipes së bashku me dijen gramatologjike të autorëve shqiptarë i mundësojnë studiuesve që të kuptohet në mënyrën më të plotë përmbajtja e tempusit dhe marrëdhëniet kohore në tekst, gjegjësisht lidhjet: kohë e veprimit dhe kohë e çastit të ligjëritimit, të cilat janë të domosdoshme për zbatimin dhe analizën e tekstit.

#### ***4.1.2. Kuptime të mënyrës së foljes (Modus)***

Kategoria e mënyrës (Modus) paraqet gramatikisht qëndrimin e folësit në raport me realitetin e shprehur. Ndërtimi i mënyrës së foljes në të shumtën e rasteve bëhet me

---

129 Fishta., Gj., vepra e cit., f.133

130 Lambertz, M., Laute des Hochlandes, f.78

131 Buchholz,O./Fiedler,W.,vepra e cit.,f.122-170

anë të eptimit apo me anë të foljeve ndihmëse.<sup>132</sup> Qëndrimi i folësit ndaj veprimit të tij të shprehur përmes foljes mund të jetë i ndryshëm. Janë tri shkallë mundësish apo modalitetesh, përmes të cilave realizohet ky qëndrim i folësit:

- shkalla e parë lidhet ngusht me dëshirën dhe qëllimin,
- shkalla e dytë ka të bëjë me domosdoshmërinë ose detyrimin
- dhe së fundi e treta me sigurinë dhe mundësinë.

Format e modusit janë mjetet kryesore për të shprehur modalitetet. Në gjuhën gjermane janë gjithsej tri mënyra themelore të foljes: *mënyra dëftore (Indikativ)*, *mënyra lidhore (Konjunktiv)* dhe *mënyra urdhërore (Imperativ)*.

Mënyra dëftore (Indikativ) në „Deutsche Grammatik” të autorëve G.Helbig / J.Buscha përkufizohet si „*formë e përgjithshme e shprehjeve gjuhësore*”. Indikativi paraqet kuptime të ndryshme të shprehjeve si vërtetësi (Wirklichkeit), dyshim (Zweifel).<sup>133</sup> Ndërkaq , në gramatikën e DUDEN-it nënvizohet se indikativi paraqet modus normal, gjegjësisht standard dhe vetëm me anë të tij shprehet „bota e vërtetë”. Indikativi në diskurs shfaq njohuri (Wissen), mendim (Glauben)<sup>134</sup> etj.

Sipas H.Weinrich, mënyra dëftore e foljeve në gjuhën gjermane ka *dy kohë të thjeshta (einfache Tempora): kohën e tashme (Präsens) dhe kohën e pakryer (Präteritum)*. Përveç, prezentit dhe preteritit, të gjitha kohët e tjera janë *kohë të përbëra „zusammengesetzte Tempora”*, ku hyjnë: *koha e kryer (Perfekt)*, *koha më se e kryer (Plusquamperfekt)*, *koha e ardhme (Futur)* dhe *koha e ardhme e përparme (Vorfutur)*. Rëndësia apo roli i zgjedhimit (Konjugationsrolle) përcakton strukturën e thjeshtë apo të përbërë të tyre.<sup>135</sup> Kohët e shkuara të gjuhës gjermane, siç janë Perfekt dhe Plusquamperfekt ndërtohen me foljet ndihmëse „kam” (haben) dhe „jam” (sein).

<sup>132</sup> Lyons, J., vepra e cit., f.286-288

<sup>133</sup> Helbig, G./Buscha, J., vepra e cit., f.188

<sup>134</sup> DUDEN,B.4, f.507

<sup>135</sup> Weinrich, H., vepra e cit., f.184,197

Ndërkaq, koha e ardhme (Futur) ndërtohet me anë të foljes „werden”. Lyons shprehet se „*vërtetë werden shpesh përdoret në fjali, që shprehin të ardhmen, por kjo mund të gjykohet edhe si një pasojë natyrore që shprehjet (thëniet) për ngjarjet e ardhshme nisen gjithmonë nga mendimet, paragjykimet dhe dëshirat e folësit dhe jo nga dijet e tij për realitetin*”.<sup>136</sup>

Përderisa mënyra dëftore shpreh realitet, vërtetësi dhe siguri, mënyra lidhore (Konjunktiv) është mënyrë e mundësisë, pasigurisë dhe jovërtetësisë. Do të thotë, mënyra lidhore ka karakter opozicional në raport me mënyrën dëftore. Me fjalë të tjera, përmes lidhores folësi shpreh dëshirë dhe qëllim të mundshëm për t’u plotësuar, mirëpo ky qëllim për t’u plotësuar nuk është i sigurt.

Konjunktivi në gjuhën gjermane ka dy forma kohore: *Konjunktiv I* dhe *Konjunktiv II*, por ekziston edhe një formë e posaçme e ndërtimit të Konjunktivit që njihet si „würde Form”. Përkundër indikativit, me anë të të cilit folësi paraqet një thënie të vërtetë, përmes Konjunktiv II, shprehja apo thënia e folësit duhet kuptuar si një konstrukcion i menduar. E pakryera e konjunktivit (Konjunktiv Präteritum) është koha themelore e Konjunktiv II, përmes së cilës folësi shpreh veprim që lidhet me të tashmen (Gegenwärtiges) apo me të ardhmen (Zukunftiges). Kohë tjetër e Konjunktiv II është dhe koha e kryer (Perfekt) që njihet si Plusquamperfekt Konjunktiv. Lidhja e Konjunktiv II me kohën e shkuar del si modus i irealitetit, kontrafaktik apo hipotetik. Ndërkaq, lidhja e tij me të ardhmen paraqet potencialitet apo eventualitet. Sipas gramatikës DUDEN sistemi kohor gjashtëpjesësh i indikativit është reduktuar në sistem dypjesësh në Konjunktiv.

Kuptimin dhe funksionin e ngjashëm me Konjunktiv II në gjuhën gjermane e kanë dhe konstrukcionet e ndërtuara me formën „würde”.<sup>137</sup> Ndërkaq, ligjëratat e zhdrejtë (Indirekte Rede) ndërtohet nga një formë specifike e Konjunktivit. Kjo formë specifike e Konjunktivit njihet si Konjunktiv indirekt ose si Konjunktiv I (Konjunktiv I, indirektive Konjunktiv). Njëjësi i një numri të konsideruar foljesh në Konjunktiv I, gjegjësisht në

<sup>136</sup> Lyons, J., vepra e cit., f.289

<sup>137</sup> DUDEN, B. 4, f.522-524



konjuktivin indirekt ka rol referencial nga njëra anë dhe nga ana tjetër Konjuktivi I dallohet nga format e prezentit me anë të konsonantit flektiv –t.<sup>138</sup>

Krahas mënyrave të mvetësishme të foljes, siç janë indikativi, konjuktivi dhe imperativi, gjuha gjermane ka dhe mënyrat josintetike të foljes. Këtu hyjnë kushtorja, dëshirorja dhe habitorja. Këto tri mënyra të foljes në gjermanishte ndërtohen me anë të mënyrës lidhore. Dëshirorja (Optativ) ndërtohet me lidhore restriktive; me lidhëzën kushtore „wenn” (nëse), ose me pjesëzën „doch”. Këto forma shprehin funksionin e modalitetit të dëshirës (Wunsch). *Kushtorja (Konditional)* në gjuhën gjermane nuk del si formë as mënyrore e as kohore. Ajo është variant shprehimor i një mundësie të kushtëzuar modale. Do të thotë se mënyra kushtore paraqet një kusht (Bedingung), që lidhet me një pasojë. Ajo më së shpeshti ndërtohet me mënyrën lidhore dhe lidhëzën kushtore „wenn”.<sup>139</sup> *Habitorja (Admirativ)* shfaqet pas një veprimi apo gjendjeje të pavërejtur deri në çastin e ligjërimin dhe shpreh habi.<sup>140</sup> *Habitorja* në gjuhën gjermane ndërtohet nga format e mënyrës lidhore, me folje modale dhe me ndajfolje.

*Mënyra urdhërore (Imperativ)* është formë mënyrore më vete, pra është mënyrë sintetike e foljeve në gjuhën gjermane, me anë të së cilës në formë të urdhërit shprehet dëshirë, kërkesë, lutje, këshillë, ndalesë. Folja në urdhërore del në vetën e dytë njejës dhe shumës të kohës së tashme. Duke parë strukturën e mënyrës urdhërore, J.Lyons me të drejtë konstaton se „në shumë gjuhë, të cilat e zgjedhojnë foljen sipas vetës, kohës, mënyrës, numrit etj: (duke përfshirë gjuhët indogjermane), forma e foljes në fjalitë urdhërore për vetën e dytë njejës për të gjitha këto kategori del e paepuar”<sup>141</sup>. Sipas Lyons-it, më tutje del se urdhërorja si mënyrë e foljes ka në të shumtën e rasteve karakter autoritar.<sup>142</sup>

<sup>138</sup> Weinrich, H., vepra e cit., f.258-261

<sup>139</sup> Weinrich, H., vepra e cit., f.251-253

<sup>140</sup> Buchholz, O./ Fiedler, W., vepra e cit., f.154-155

<sup>141</sup> Lyons, J., vepra e cit., f.287

<sup>142</sup> Lyons, J., vepra e cit., f.287

Ndryshe nga gjuha gjermane, në të cilën modusi shfaqet, pra si kategori më vete (Indikativ, Konjunktiv, Imperativ) dhe përmes mënyrave të tjera (Optativ, Konditional, Admirativ), mënyrat e shqipes kanë ndërtim më vete. Në të gjitha gramatikat e gjuhës shqipe dalin gjithsej gjashtë mënyra të foljes: *dëftorja, lidhorja, dëshirorja, urdhërorja, habitorja* dhe *kushtorja*.

Pra, siç shihet më lartë, funksioni kryesor i mënyrës është për të shprehur modalitetin me anë të të cilit folësi duke shprehur qëndrimin e tij paraqet veprimin si të vërtetë, të mundshëm, apo të dëshirueshëm.<sup>143</sup>

Kategoria e mënyrës dhe e kohës janë të gërshetuara mes vete. „*Lidhur me kategorinë gramatikore të kohës do pasur parasysh se me përjashtim të formave kohore të mënyrës dëftore, te format kohore të mënyrave tjera, kuptimi gramatikor i kohës është i gërshetuar me anë të modalitetit, i cili në përgjithësi del në plan të parë. Prandaj, kuptimet kohore të mënyrës dëftore dallohen më shkoqur nga ato të mënyrave tjera*”<sup>144</sup>. Lidhja e ngushtë mes kohës dhe modalitetit në gjuhën shqipe është përcaktues i një numri të madh apo më të vogël të formave kohore. Pra, meqenëse mënyra dëftore është më pak e shenjzuar se mënyrat e tjera ka një numër më të madh të formave kohore dhe në të kundërtën mënyrat e tjera, të cilat janë „*të shenjzuara*” (të markuara) për nga lloji i kuptimeve modale që ndërthejnë kanë forma kohore më të kufizuara.<sup>145</sup>

#### **4.1.3. Përkufizime të aspektit (Aspekt) dhe mënyrës së veprimit (Aktionsart)**

Derisa koha është kategori deiktike, që shenjon tipare të gjuhës, të cilat lidhen me kohën e shprehjes, aspekti nuk i referohet asnjë pike kohore të shprehjes. Sipas

<sup>143</sup> Gramatika e gjuhës shqipe I, f.272

<sup>144</sup> Gramatika e gjuhës shqipe I, f.275

<sup>145</sup> Po aty, f.275

Bussmann-it aspekti duke qenë kategori gramatikore e foljes ka të bëjë me perspektivën subjektive të folësit, i cili përmes një forme foljore paraqet një veprim që shfaq relacionet mes folësit dhe situatës së bisedës. Më tutje, Bussmann dallon aspektin (Aspekt) nga akcionsarti (Aktionsart), i cili përfshin kuptimin objektiv të foljeve; ndërkaq aspekti nënkupton qendrimin individual të folësit, me ç'rast veprimi del si zhvillim *imperfektiv* (*Imperfektive Verlauf*) ose ngjarje *perfektive* (*perfektive Ereignis*).<sup>146</sup>

Mendime rreth kuptimit të aspektit si veçori gramatikore ka dhënë dhe Hockett, sipas të cilit aspekti më tepër ka të bëjë me „*ndarje në kohë*”, përkatësisht kufizime kohore të një veprimi, ngjarje a gjendje sesa me „*përcaktim në kohë*”.<sup>147</sup>

Përderisa aspekti shenohet me elemente morfologjike, akcionsarti si mënyrë e veprimit të foljes lidhet me kuptimin leksikor të saj. Andaj, aspekti dhe akcionsarti përbëjnë *aspektualitetin* (*Aspektualität*), që në fakt ka të bëjë me „*strukturën e brendshme kohore të një ngjarjeje*”.<sup>148</sup>

Sipas gramatikës së DUDEN-it, në gjuhën gjermane mund të flitet për akcionsartet e foljeve *telike* (*telische Aktionsarten*) dhe të foljeve *atelite imperfektive* (*atelische Aktionsarten*).

*Foljet telike* paraqesin ngjarjet a veprimet të kufizuara në kohë (*zeitbegrenzte Vorgänge*), të cilat kanë pikë të kulminacionit dhe pikë të përfundimit të veprimit. Si folje *telike* konsiderohen foljet që e ndërrojnë gjendjen, që ndryshe njihen si *folje transformative* (*transformative Verben*). Foljet *transformative* më tutje mund të jenë *ingressive* (*ingressiv*) apo *inkoative* (*inchoativ*). Këto folje në gjuhën gjermane dalin me strukturë komplekse. Ato tregojnë fillimin e një gjendjeje dhe ndërtohen me prefikse apo pjesëza (*einschlafen, aufwachen*). Nga ana tjetër, foljet *transformative egressive* (*egressiv*) janë ato që shprehin përfundimin e një veprimi, që tregon gjendje.

---

<sup>146</sup> Bußmann, H., vepra e cit., f.46

<sup>147</sup> Shih Lyons, J., vepra e cit., f.293

<sup>148</sup> Rothstein, B., *Tempus*, Heidelberg, 2007, f.62

Gjendja statike e foljeve (statische Zustände) ose veprimet dinamike (dynamische Vorgänge) shprehen me anë të foljeve atelike ose imperfektive (atelische b.z.w imperfektive Verben). Foljet atelike në gjuhën gjermane mund të jenë folje atelike transformativë (atelische transformativë Verben), të cilat shfaqin ndryshim gradual të gjendjes dhe folje atelike jotransformativë (atelische intransformativë Verben), të cilat nuk paraqesin ndryshim të gjendjes (Zustandsänderung).

Këndvështrimi i jashtëm (Sicht von außen) i akcionsartit telik, i cili paraqet fillimin apo përfundimin e një veprimi të kufizuar në kohë, njihet si perspektivë e jashtme (Außenperspektive), e cila së bashku me kohët e shkuara (Vergangenheitstempora) dominon në tekstet rrëfimore apo narrative (erzählenden Texten).

*Foljet atelike* në mënyrë të veçantë kanë lidhje të ngushtë sidomos me perspektivën e brendshme (Binnenperspektive), e cila lidhet me këndvështrimin e një pike të fillimit a të përfundimit të një veprimi të pakufizuar në kohë. Perspektiva e brendshme zakonisht shfaqet me folje atelike në Präsens, por mund të realizohet edhe në Präteritum. Dhe, pikërisht dallimi mes perspektivës së jashtme (Außenperspektive) dhe perspektivës së brendshme (Binnenperspektive) përbën esencën e aspektit si kategori.<sup>149</sup>

Në fushë të studimeve për kategorinë e aspektit, me interes del dhe mendimi i Smith-it, sipas të cilit aspekti ndahet në perfektiv dhe imperfektiv. I pari, aspekti perfektiv, nënkupton pikën e fillimit dhe të përfundimit të një ngjarjeje. Ndërkaq, aspekti imperfektiv sipas tij mund të jetë aspekt imperfektiv progresiv dhe aspekt imperfektiv joprogresiv. Struktura e brendshme kohore e ngjarjes paraqet aspektin progresiv.<sup>150</sup>

Edhe J.Lyons ka diskutuar aspektin progresiv dhe joprogresiv. Në këtë drejtim, ai konstaton se „*Meqë funksioni më i shpeshtë i aspektit progresiv është të tregojë*

---

<sup>149</sup> DUDEN, B. 4, f.415-418

<sup>150</sup> Shih te Rothstein, B.,vepra e cit., f.64

vazhdimësi, është e natyrshme se foljet statike nuk lidhen me aspektin progresiv, sepse kuptimi i vazhdimësisë përfshihet tanimë në kuptimin e përgjithshëm të këtyre foljeve”.<sup>151</sup>

Nga e gjithë kjo shihet se aspekti si kategori gramatikore ka ndërvarësi apo gërshetohet me kohën dhe mënyrën. Me fjalë të tjera, aspekti nuk do të kishte mundësi të qëndronte si kategori e pavarur në radhë të parë nga kategoria e kohës, por edhe e mënyrës prandaj duhet parë si një shkrirje me kohën dhe mënyrën.

#### **4.1.4. Funkzioni i vetës (Person) dhe numrit (Numerus) në situatën e ligjëritimit**

Veta (Person) si kategori gramatikore ka rëndësi të posaçme në situatën e ligjëritimit. Mendimi teorik për kategorinë e vetës është i hershëm. Në gramatikat tradicionale, veta konsiderohet si kategori e foljes, e cila shenjohe si formë eptimore e foljes, meqë në shumë gjuhë folja përdorej pa përemra vetorë dhe përzgjedhjen e përemrit e përcaktonte folja. Mirëpo, ky qendrim i gramatikës tradicionale shihet si i diskutueshëm. Këtë çështje e bën të diskutueshme fakti se nuk merret parasysh struktura e thellë dhe struktura sipërfaqësore e fjalive. Po të merret parasysh struktura semantike e fjalive del se „duhet të presupozohet një element përemëror abstrakt (që përcaktohet nga veta dhe numri), i cili është kryefjalë e foljes dhe që është vendimtar për rregullat e përshtatshme fonologjike të foljes në strukturën sipërfaqësore”.<sup>152</sup> Ky element përemëror „në gjuhën gjermane dhe angleze prodhohet si përemër vetor”.<sup>153</sup> Edhe në gramatikën e

---

<sup>151</sup> Lyons, J., vepra e cit., f.294

<sup>152</sup> Lyons, J., vepra e cit., f.263-264

<sup>153</sup> Lyons, J., vepra e cit., f.294

gjuhës shqipe kategoria e vetës definohej si lidhje që shprehet përmes foljes midis folësit dhe kryefjalës së fjalisë.<sup>154</sup> Duke u nisur nga ky lloj këndvështrimi del se veta e parë i takon folësit, me anë të së cilës ai shenjon vetveten si objekt i bisedës, e dyta lidhet me dëgjuesin dhe e treta përfshin persona të tjerë që përjashtojnë folësin dhe dëgjuesin. Në situatën ligjërimore veta e tretë dallohet qartë nga veta e parë dhe e dytë, meqë në vetën e parë dhe të dytë nënkuptohet prania e folësit dhe dëgjuesit, ndërkaq në vetën e tretë edhe pse vendoset lidhje me persona a sende, nuk është e detyrueshme që ata të jenë të pranishëm në situatën e ligjërimorit. Me fjalë të tjera, veta e parë dhe e dytë konceptohen si elemente pozitive të vetës si kategori gramatikore. Përkundrazi, veta e tretë merret si element negativ, meqë nuk merr pjesë në situatën e ligjërimorit.<sup>155</sup>

Edhe lidhja mes vetës dhe numrit sipas gramatikës tradicionale konsiderohet si e „gabuar”. „P.sh., është e qartë që **ne** (veta e parë, shumës) normalisht nuk qendron në të njëjtin raport ndaj **unë** (veta e parë njëjës), por ajo konsiderohet si ‚Unë dhe një ose shumë persona të tjerë’ ; te personat e tjerë mund të përfshihet dëgjuesi ose jo. Me fjalë të tjera, **ne** nuk është ‚shumësi i **unë**’; **ne** më shumë shpreh një lidhje me ‚unë’ dhe është një shumësi ”.<sup>156</sup>

Veta si kategori gramatikore, përveç me numrin ka raporte dhe me gjininë. Kështu, p.sh si në shumë gjuhë të tjera dhe në gjuhën shqipe midis vetës së tretë njëjës dhe shumës bëhen shumë dallime gjinore (ata, ato). Përkundër kësaj, në gjuhën gjermane dhe angleze veta dhe shumësi janë të kombinuara (sie; they).

Në gramatikën e DUDEN-it krahas kohës (Tempus) dhe mënyrës (Modus), e një rëndësie të posaçme është dhe kategoria e vetës (Person) dhe e numrit (Numerus), në bazë të të cilave kategori folja zgjedhohet, do të thotë del në forma të ndryshme.<sup>157</sup>

<sup>154</sup> Gramatika e gjuhës shqipe 1, f.267

<sup>155</sup> Lyons, J., vepra e cit., f.260-261

<sup>156</sup> Lyons, J., vepra e cit.,f.261

<sup>157</sup> DUDEN, B. 4, f.395

Sipas Weinrich-ut rëndësi të madhe në procesin e konjugimit (Konjugations der Verben) kanë: folësi (Sprecher / ich), dëgjuesi (Hörer / du) dhe roli referencial (Referenzrolle / er, sie, es), që në kuptimin e gramatikës tekstore paraqesin vetën. Ndërkaq, numri i subjekteve (Numerus des Subjekts) në rolin e bisedës (Gesprächsrolle) mund të jetë njëjës (Singular) dhe shumës (Plural).<sup>158</sup>

Në mbështetje të gjithë kësaj që u tha për vetën, mund të përfundohet se veta është kategori e rëndësishme e foljes e lidhur ngushtë sidomos me numrin, por edhe me gjininë, funksionet e së cilës në rasën emërore shfaqen si kryefjalë në të tri format e njëjësit dhe të shumësit.

#### 4.1.5. Diateza

Termi diatezë rrjedh nga fjala greke „*diathesis*” që do të thotë „*gjendje*” „*dispozicion*” „*funktion*”.<sup>159</sup> Diateza është veprim i kryefjalës i emëruar nga folja në fjali. Lidhjet midis veprimit dhe kryefjalës së fjalisë shfaqen në forma kundërvënese. Në fakt, këto kundërvënie paraqesin formën veprorë (Aktiv) dhe formën pësore të foljes (Passiv). Foljet që kanë mundësi të përdoren në formën veprorë dhe pësore me kundërvënie kuptimore kanë kategorinë e diatezës.<sup>160</sup>

*Forma veprorë (Aktiv)* është formë e pamarkuar (unmarkirte) apo formë normale e foljes; përkundër *pësorës (Passiv)* që është formë e markuar e foljes. Si e tillë, ajo si rregull emërton veprimin që e kryen kryefjala. Kur folja në diatezën veprorë lidhet me kundrinën e drejtë, përkundrazi në diatezën pësore transformohet në kryefjalë, do të thotë

<sup>158</sup> Weinrich, H., vepra e cit., f.88-90

<sup>159</sup> Lyons, J., vepra e cit., f.345

<sup>160</sup> Gramatika e gjuhës shqipe 1,f.270

merr funksionin e kryefjalës. Në rast se folja në diatezën veprorë s'ka fare kundrinë të drejtë, atëherë edhe në diatezën pësore mungon kryefjala.

Formë tjetër e rëndësishme, e cila qendron në kundërvënien me diatezën veprorë është diateza pësore. Në gjuhën gjermane variantet e pasivit paraqesin gjendje apo ngjarje të shkuar. Në këtë rast pasivi ndërtohet nga foljet ndihmëse (Hilfsverben) „werden” dhe „sein” dhe quhet „werden – Passiv” dhe „sein-Passiv”. Variant tjetër i pasivit është dhe i ashtuquajtur i „bekommen – Passiv”.

Semantikisht ndryshimi i rolit të kryefjalës (Subjekt) rregullohet përmes formave të pasivit (Passivformen). Kur në fjalinë aktive (Aktivsatz) gramatikisht vepruesi (Agens) është kryefjalë, përkundrazi në fjalitë pësore kryefjala është pësues (Patiens) i veprimit. Atëherë, si rregull kryefjala qendron në fillim të fjalisë (Satzanfang) në fjalitë aktive, ndërkaq në fjalitë pasive, ajo bartet prapa dhe merr rolin e pësuesit. Dhënësi i tekstit përmes zgjedhjes së aktivitetit apo pasivit në mënyrë të natyrshme bën rregullimin e informacioneve, të cilat i integron në tekst.<sup>161</sup> Kjo mënyrë e integritit të pasivit në tekst bën lidhjen e tij me tekstin dhe diskursin.

Në gjuhën gjermane pasivi i ndërtuar me „werden”, që quhet edhe pasiv i së shkuarës (Vorgangspassiv) merret si forma kryesore e pasivit. Ai ndërtohet me anë të foljeve kalimtare (transitive Verben), ku kryefjala dhe kallëzuesi dalin në rolin e vepruesit (Agens), shkaktarit (Verursacher) apo pësuesit (Patiens).

„Bekommen – Passiv” poashtu konsiderohet si një nga llojet e rëndësishme të pasivit në gjuhën gjermane. Ai ndërtohet nga konstruktionet e foljeve kalimtare (transitive Verben) dhe veç kundrinës në kallëzore (Akkusativobjekt) ka dhe një aktant në dhanore (Dativaktant), i cili paraqet rol të rëndësishëm semantik. Ky rol i dhanores shprehet përmes marrësit (Rezipient), shfrytëzuesit (Beneficient) dhe poseduesit (Possessor). Kjo formë e pasivit e gjuhës gjermane quhet edhe „Dativ-Passiv”, meqë aktanti në dativ merr funksionin e kryefjalës në pasiv.

---

<sup>161</sup> DUDEN, B. 4, f.1128-1129



*Pasivi i gjendjes (Zustandspassiv)* ndërtohet me anë të foljes ndihmëse „sein” (jam) dhe „Partizip II” (pjesores II). Pasivi i gjendjes është i lidhur ngushtë me foljet kalimtare (transitive Verben), foljet refleksive (reflexive Verben) dhe me foljet jokalimtare (intransitive Verben). Kryefjala e „sein – Passiv” duhet të përputhet me kundrinë në kallëzore (Akkusativobjekt)<sup>162</sup>.

H.Weinrich duke folur për format e pasivit në gjuhën gjermane, ato i sheh pothuajse si në Gramatikën DUDEN. Sipas tij, format kryesore të pasivit janë „werden-Passiv” dhe „sein-Passiv”, por pasivin e zgjeron dhe me forma të tjera, siç janë *pasivi modal (Modal-Passiv)*, *pasivi funksional (Funktional-Passiv)* si dhe me konstrukcione kuazipasive (*quasipassivische Konstruktionen*).

Pasivi modal shpreh modalitet dhe semantikisht paraqet gjendje pasive. Ai formohet nga kllapat pasive (Passivklammer) me një folje të vendosur përpara (Vorverb) dhe një folje të vendosur prapa në fjali (Nachverb). Folja e parë ka të njëjtin funksion si folja „sein” e pasivit të gjendjes, ndërkaq folja prapa përbëhet nga parafjala „zu” dhe forma infinitive e një foljeje kalimtare.

Pasivi modal, poashtu lidhet me një folje kalimtare si dhe me një kundrinë (Objekt), e cila bëhet kryefjalë (Subjekt) në pasiv.

Konstrukcionet kuazipasive nuk janë konstrukcione reale pasive. Ato ndërtohen përveç se me folje edhe me mbiemra (Adjektive), me pësore modale (Modal – Partizipien), të cilat kanë kuptim pasiv.<sup>163</sup>

Edhe në gjuhën shqipe, si në gjuhën gjermane, folja ka diatezën veprorë dhe diatezën pësore. Foljet në formën veprorë krahasuar në formën joveprorë qendrojnë në raport kundërvënës mes vete. Të parat, gjegjësisht foljet në diatezën veprorë janë forma të pashenjëzuara (të pamarkuara) të foljes, kurse të dytat janë forma të shenjëzuara (të markuara) të saj.

---

<sup>162</sup> vepra e cit., f.550-562

<sup>163</sup> Weinrich, H., vepra e cit., f.163-166

Gramatikat e shqipes duke u mbështetur në lidhjet e ndryshme midis kryefjalës dhe veprimit të dhënë nga folja, diatezën e ndajnë në katër lloje. Ato janë: diateza veprare, diateza pësore, diateza vetvetore dhe diateza mesore.

Studiuesit gjermanë O.Buchholz, W.Fiedler kanë dhënë kontribut të rëndësishëm në zgjerimin e konceptit të diatezës si kategori morfologjike dhe si kategori funksionale-semanticke. Ata kanë konstatuar se gjinia e foljes (Genus verbi) ndërtohet nga format e caktuara të saj, ku bëjnë pjesë pjesëmarrësit e veprimit (Partizipanten) – vepruesit dhe pësuesit (Agens, Patiens). Gjeneriteti (Generität) përcakton rangun, gjegjësisht shkallën, në të cilën marrin pjesë participientet dhe konsiderohet si kategori funksionale-semanticke e gjinisë së foljes. Pësuesi i veprimit (Patiens) duhet të përputhet me formë të shenjzuar të kategorisë morfologjike të gjinisë. Ndërkaq, funksioni sintaksor i pësuesit të veprimit është i rangut të dytë në fjali. Në rastin e parë, kur pësuesi i veprimit përputhet me formën e shenjzuar të foljes, atëherë kemi të bëjmë me funksione semanticke – komunikative të kategorisë së gjinisë së foljes, kurse në rastin e dytë mund të flitet për anën apo aspektin sintaksor funksional të gjinisë së saj.

Sipas gramatikës së Buchholz/Fiedler, kategorinë morfologjike të diatezës në gjuhën shqipe e përbëjnë: *forma e aktivitetit (Aktivform)*, *forma joaktive (Nichtaktivform)*, *forma joaktive e ndërtuar me kundrinë të zhdrejtë (Nichtaktivform – Dativ -OZ)*, *forma „duhet+pjesore” (duhet + Partizip)*, *forma „do+pjesore” (do+Partizip)*, *pësorja refleksive dhe jorefleksive (Reflexiv/Nichtreflexiv)* dhe *pësorja e gjendjes (Zustandspassiv)*.<sup>164</sup>

#### **4.1.6. Format e pashtjelluara të foljeve (infinite Verbformen) dhe funksioni i tyre**

---

<sup>164</sup> Buchholz, O., Fiedler, W., vepra e cit., 183-193

Format e pashtjelluara të foljeve (infinite Verbformen) janë forma jopredikative, do të thotë janë forma jovetore. Në mungesë të kategorisë së vetës, numrit dhe mënyrës, brenda fjalisë ato nuk dalin si folje kryesore. Si të tilla, format e pashtjelluara mund të jenë pjesë e një kallëzuesi, nëse paraqiten me një formë foljore të shtjelluar modale. Këtyre formave të foljeve, meqë nuk kanë kategorinë e vetës, numrit dhe mënyrës u mungon dhe kryefjala. Veç këtyre veçorive dalluese të formave të pashtjelluara të foljeve, megjithatë ato mund të numërohen si folje dhe janë pjesë e sistemit foljor, „shprehin veprim si process ose gjendje, pësojnë ndryshime diatezore e kohore (aspektore), marrin lloje të caktuara të argumentave foljore, si kundrinorë të drejtë, kundrinorë të zhdrejtë, plotësohen me ndajfolje etj”.<sup>165</sup>

Duke u gërshetuar apo kombinuar me kategoritë e tjera gramatikore si me emrin, mbiemrin dhe ndajfoljen, format e pashtjelluara dalin si kategori gjuhësore ndërmjetëse. Në këtë mënyrë, paskajorja dhe gerundivi gërshetojnë veçoritë e foljes dhe të mbiemrit, kurse përcjellorja gërsheton veçori të foljes dhe të ndajfoljes.<sup>166</sup>

Në gjuhën gjermane format infinite të foljes (infinite Verbformen) janë *infinitivi me „zu” apo pa „zu”* (*Infinitiv mit oder ohne „zu”*), *pjesorja I ose pjesorja e së tashmes (Partizip I, Partizip Präsens)*, *pjesorja I me „zu” apo gerundivi (Partizip I mit „zu” oder Gerundiv)* dhe *pjesorja II apo pjesorja e së shkuarës (Partizip II, Partizip Perfekt)*. Format e përmendura foljore infinite në gjuhën gjermane ndërtohen vetëm nga foljet kalimtare, të cilat kanë funksionin e atributit dhe përdoren me mbaresa të mbiemrave (*Adjektivendungen*).

Partizip I në diatezën veprorë në kohën e tashme (Aktiv, Präsens) ka funksionin e një mbiemri atributiv (*attributives Adjektiv*).

Përkundër, Partizipi me „zu” edhe pse paraqitet në funksion atributiv, si rregull ndërtohet me folje kalimtare (*transitive Verben*) dhe funksioni i tij është pasiv modal

<sup>165</sup> Çeliku, M., vepra e cit., f.30

<sup>166</sup> Weinrich, H., vepra e cit., f.32

(passivisch–modale Bedeutung), që në aspektin modal shpreh nevojshmëri (Notwendigkeit) apo mundësi (Möglichkeit). Edhe Partizip II në gjuhën gjermane ka funksion atributiv dhe formohet me „werden” apo „sein-Passiv” me ç’rast emri duhet të ketë rolin semantik të pësuesit të veprimit (Patiens).<sup>167</sup>

Nga këndvështrimi gramatikor-tekstor, Weinrich është marrë me strukturat e veçanta të formave të Partizipit dhe të Infinitivit. Ai dallon *infinitivin leksikor (der lexikalische Infinitiv)*, *infinitivin në situatë (Infinitiv in der Situation)* si dhe *infinitivin në kontekstin verbal (Infinitiv im verbalen Kontext)*. Kurse, në strukturat e participit ai e fut *participin mes mbiemrit dhe foljes (Partizip zwischen Adjektiv und Verb)*, *participin e së kryeres (Rück-Partizip, Partizip Perfekt, Partizip II)*, *participin neutral (Neutral-Partizip)*, *participin neutral aktiv (aktive Neutral-Partizip)* dhe *participin modal (Modal-Partizip)*.<sup>168</sup>

*Infinitivi leksikor* lidhet me kuptimin e foljes në tekst dhe është i lirë nga të gjithë determinantët e kontekstit dhe të situatës. Në këtë rast ka funksionin e kryefjalës (schön sein ist herrlich), *infinitivi i situatës* është formë foljore që lidhet me situatën. Ky variant i infinitivit është shprehje gjuhësore ekonomike (nicht hinauslehnen), infinitivi në kontekstin verbal është infinitiv determinant minimal dhe mund të paraqitet në fjali i shoqëruar me një formë finite të foljes. *Infinitivi në kontekstin verbal* njihet në variantet e tij, siç janë: foljet me infinitiv të pastër (Verben mit dem reinen Infinitiv) dhe foljet, të cilat ndërtohen nga infinitivi me „zu” (Verben, die den Infinitiv mit „zu” bei sich haben).<sup>169</sup>

*Strukturat e participit si forma infinite*, të cilat qendrojnë mes mbiemrit dhe foljes, janë mbiemra që përputhen me rregullat e zgjedhimit të foljeve, të cilat dallohen nga mbiemrat jofoljor (deverbale Adjektive). Dallimet midis tyre bëhen përmes mbareave „-lich” dhe „-bar”. Participi i së shkuarës (Rück Partizip, Partizip-Perfekt, Partizip II) është mbiemër prejfoljor (Verbal-Adjektiv), i cili lidhet me të shkuarën. Morfologjikisht

<sup>167</sup> DUDEN, B. 4, f.436,568-572

<sup>168</sup> Weinrich, H., vepra e cit., f.276-289, 534-544

<sup>169</sup> Weinrich, H., f.276-289

ai ndërtohet me prefiksin „ge-“ dhe mbaresën „-t” te foljet e rregullta (regelmässige Verben) dhe me prefiksin „ge-“ dhe mbaresën „-en” te foljet e parregullta (unregelmässige Verben). Participi neutral (Partizip-Präsens, Partizip I) në perspektivën e tij kohore është neutral. Ai lidhet me perspektivën e mëpastajshme (Voraus-Perspektive) dhe me perspektivën e mëparshme (Rück-Perspektive), e cila përdoret në kuptimin aktiv dhe pasiv. Participi aktiv neutral është particip i së shkuarës. Ai ka funksionin e mbiemrit, por me formë të njëjtë flektive sikurse folja. Mbaresa e këtij varianti të participit është „-end” (lese-vorlsend). Dhe së fundi, participi modal ka kuptim modal dhe si i tillë shfaqet në formë pasive (die zu treffende Entscheidung).<sup>170</sup>

Format infinite të foljes në gjuhën gjermane të trajtuara në „Textgrammatik der deutschen Sprache” të H.Weinrich janë të trajtuara pothuajse njësoj si në gramatikën e DUDEN-it, por janë të zgjeruara me nëndarje më të shumëta, të fokusuara në aspektin tekstor.

Edhe Helbig/Buscha në „Deutsche Grammatik”, në kuadër të formave infinite shqyrton *lidhjet e lira infinitive (frei Infinitivverbindungen)*, *particip I (Partizip I)*, brenda të cilit fut *lidhjet e nevojshme të particip I (notwendige Partizip I – Verbindungen)*, *lidhjet e lira të particip I (freie Partizip I – Verbindungen)* dhe *lidhjet e particip II (PartizipII)*, të cilin e përbëjnë *lidhjet e nevojshme (notwendige Partizip II Verbindungen)* dhe *lidhjet e lira (frei Partizip II – Verbindungen)*<sup>171</sup>.

Do shtuar se, ndarja dhe trajtimi i formave infinite sipas „Deutsche Grammatik” konceptualisht nuk ndryshon nga Gramatika e DUDEN-it dhe Gramatika tekstore e Weinrich-ut.

Koncepti formë e pashtjelluar është koncept që lidhet me format joeptuese të foljes, do të thotë se foljes në formën e pashtjelluar i mungon veta dhe numri. Pra, si në gjuhën gjermane ashtu edhe në gjuhën shqipe, format e pashtjelluara të foljeve janë forma

<sup>170</sup> Weinrich, H., f.534-544

<sup>171</sup> Helbig, G., Buscha, J., vepra e cit., f.118-121

jopredikative, forma jovetore dhe si të tilla atyre u mungon kryefjala. Në „Gramatikën e gjuhës shqipe” janë dhënë mendime sintezuese krahas formave të shtjelluara edhe për format e pashtjelluara të shqipes. Në këtë gramatikë konstatohet se për nga ndërtimi njihen dy grupe të pashtjelluara të foljes „Në grupin e parë përfshihen pjesorja dhe ato që janë ndërtuar mbi bazën e emrit prejfoljorë asnjans (të tipit të larë). Ndryshimi në tipin e ndërtimit të këtyre dy grupeve sa vjen e zhduket duke qenë se emrat prejfoljorë asnjans në gjuhën e sotme po vijnë duke u pakësuar gjithnjë e më shumë, kurse format e pashtjelluara të tipit „për të larë” e „me të larë” (sidomos e para mund të formohen për çdo folje). Prandaj, në gjuhën e sotme ato interpretohen si forma të pashtjelluara që ndërtohen mbi bazën e pjesores”.<sup>172</sup>

#### **Pjesorja si formë e pashtjelluar e foljes ka tipare të foljes dhe të mbiemrit.**

Mirëpo, Shaban Demiraj shpreh mendimin se edhe pse pjesorja e ka marrë formën e një mbiemri të nyjshëm, nuk kalon semantikiisht në kategorinë e mbiemrit.<sup>173</sup>

Në gjuhën shqipe pjesorja në radhë të parë shërben për të ndërtuar kohët e përbëra të foljes, por përdoret edhe pas foljeve modale si duhet, lipset, do. Pjesorja pa pjesëzat „pa” dhe „duke” nuk ka kategori gramatikore. Ndërkaq, kur ajo del me këto pjesëza përmban kategorinë e diatezës dhe kuptim kohor të kufizuar. Pjesorja e ndërtuar nga pjesëza „pa” mohon kryerjen e një veprimi, qoftë në të shkuarën apo në të ardhmen.

Forma e pashtjelluar mohore apo pjesorja mohore ka një numër funksionesh: funksionin e përcaktorit kallëzuesor (jam, kam), funksionin e rrethanorit të kohës, e rrethanorit të mënyrës dhe rrethanorit të kushtit.

*Përcjellorja* si formë e pashtjelluar e foljes është e lidhur ngushtë me një folje drejtuese dhe ndërtohet duke vendosur pjesëzën „duke” para pjesores. Në bazë të kontekstit të fjalisë, gjegjësisht kohës në të cilën përdoret folja drejtuese apo kryesore, përcjellorja del me kuptim kohor të së tashmes, të së shkuarës apo të së ardhmes.

<sup>172</sup> Gramatika e gjuhës shqipe 1., f.298-299

<sup>173</sup> Demiraj, Sh., Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe I, Tiranë, 1970, f.84

Përcjellorja përdoret në funksion mënyror, kohor, shkakor, kushtor dhe në funksionin e përcaktorit kallëzuesor.<sup>174</sup>

*Paskajorja* e mirëfilltë i mungon shqipes standarde. Infinitivi në shqipen standarde është formë ende e pakristalizuar sa duhet dhe e përbërë prej shumë elementësh, siç janë: lidhorja (të punoj), paskajorja e re, që është në lindje e sipër (për të punuar), pjesorja pas foljeve modale (duhet punuar) etj. Paskajorja e mirëfilltë e gjuhës shqipe e dialektit gegë, që edhe sot përdoret në komunikim të përditshëm mes folësve të këtij dialekti dhe që është përdorur në gegërishten letrare nga autorët tanë të vjetër e deri më sot, ndërtohet nga parafjala „me” dhe pjesorja e foljeve në gegërishte (me punue). Paskajorja e mirëfilltë e gegërishtes dhe paskajorja si sistem shumëelementësh gramatikorë e shqipes standarde shpreh veprim në proces dhe ka funksion qëllimor, përcaktor dhe kallëzuesor.

#### ***4.2. Mendime të studiuesve për konektorët e tekstit***

Me konektorët si mekanizma të rëndësishëm, të cilët ndërtojnë kohezionin e tekstit janë marrë studiues të shumtë të gjuhësisë së tekstit, siç janë: Halliday / Hasan, Beaugrande / Dressler, Heinemann / Heinemann, Van Dijk, Pasch et al, C. Fabricus – Hansen e të tjerë. Ata në studimet e veta në kuadër të trajtimit teorik të konektorëve, e sidomos duke u mbështetur në lidhjet që ata bëjnë mes fjalive brenda tekstit, kanë bërë dhe klasifikimin e konektorëve si çështje të rëndësishme, me anë të të cilëve realizohen këto lidhje. Studiues të ndryshëm, që janë marrë me klasifikimin e konektorëve, jo gjithëherë pajtohen me klasifikimin e konektorëve, por megjithatë marrëdhëniet bazë,

---

<sup>174</sup> Gramatika e gjuhës shqipe 1., f.333-337; Beci, B., vepra e cit., f.134-136

përmes të cilave konektorët bëjnë lidhjen e fjalive në tekst janë marrëdhëniet shtesore, kundërshtore dhe marrëdhëniet shkakore.

Ndër studiuesit kompetentë, që janë marrë me konektorët e tekstit, janë autorët e njohur të gjuhësisë së tekstit Halliday dhe Hasan. Ata në veprën e tyre të njohur „Cohesion in English”, veç njësive të tjera të kohezionit të tekstit, vend të rëndësishëm në organizimin e tekstit apo në ndërtimin e kohezionit të tekstit u japin *lidhëzave* (*conjunction*). Mirëpo, sipas Halliday dhe Hasan-it termi lidhëz ndryshon nga mënyra e lidhjes sistematike mes fjalive. Me fjalë të tjera, lidhëzat në tekst konkretizojnë mënyrën specifike të informacionit mes një pike të tekstit me pjesën e mëparshme apo paravajtëse të tij. Lidhjen e tillë, Halliday/Hasan më pak e shohin si lidhje strukturore sesa semantike, sepse ata mendojnë se marrëdhëniet lidhëzore janë të koduara në format e shprehshme mes përbërësve të një teksti dhe nuk janë të koduara në formën e strukturave gramatikore.<sup>175</sup>

-,„Asnje nuk u ngrit ta pershendese dhe ketu beut nuk i erdhi mire.”<sup>176</sup>

-,„Keiner erhob sich um ihn zu begrüßen, und hier wurde es dem Beg etwas übel zumute”<sup>177</sup>

M.Halliday në veprën e tij „An Introduction to Functional Linguistics” ka plotësuar dhe zgjeruar konceptin për konektorët krahasuar me veprën e mëparshme të hartuar së bashku me R.Hasan. Duke konsideruar lidhëzën në këtë vepër si përbërës të rëndësishëm të teksturës, ai konstaton se lidhëzat në tekst krijojnë marrëdhënie të rëndësishme logjike dhe semantike. Marrëdhëniet kryesore, siç janë *marrëdhënia shtesore*, *marrëdhënia kundërshtore*, *marrëdhënia shkakore*, të diskutuara më parë nga Halliday/ Hasan, në këtë vepër Halliday i zgjeron duke bërë nënkategorizimin e tyre në :

- *marrëdhënien e përpunimit, ku hyjnë opozicioni dhe sqarimi,*

<sup>175</sup> Halliday, M., Hasan, R., vepra e cit., f.227, f.321

<sup>176</sup> Lambert, M., Albanische Chresthomathie, f.160

<sup>177</sup>Lambert, M., vepra e cit, f.164



- marrëdhënien e zgjerimit, ku përfshihen variacionet dhe marrëdhëniet shtesë.

Marrëdhënia e zgjerimit sipas Halliday-t ka edhe llojet e veta, siç janë: *marrëdhënia shtesore, kundërshtore dhe marrëdhënia e variacioneve*. Sipas tij, marrëdhënia shtesore është pozitive (and – dhe) ose negative (nor - as); marrëdhënia kundërshtore realizohet me anë të lidhëzave „but-por”, on the other hand-nga ana tjetër”; dhe marrëdhënia e variacioneve përfshin marrëdhënien zëvendësuese (replacive) si „instead-në vend të kësaj” dhe marrëdhënien zbritëse (subtractive) si „except from that-pavarësisht prej kësaj”; dhe së fundi marrëdhënia e pasurimit përfshin marrëdhëniet hapsinore dhe kohore. Në këtë lloj marrëdhënie hynë lidhëza hapsinore si „there-atje” dhe ato kohore „then-atëherë”, „in the end- në fund” etj.<sup>178</sup>

#### **4.2.1. Mbi konektorët (junkturët) e gjuhës gjermane**

Mendimi teorik gjerman për konektorët, si mekanizma kryesorë të kohezionit të tekstit, lidhet me emrin e Robert de Beaugrande dhe Wolfgang Dressler, të cilët në veprën e tyre „Einführung in die Textlinguistik” kanë dhënë shpjegime të rëndësishme mbi kriteret kryesore të strukturës së tekstit, nga të cilët lidhëzat i konsiderojnë me rëndësi të dorës së parë si kritere sipërfaqësore të tekstit. Ndryshe nga Halliday/Hasan, të cilët për emërtimin e lidhëzave përdorin termin lidhëz (conjunction), Beaugrande/Dressler përdorin termin *vendbashkim (Junktion)*. Sipas tyre, mekanizmi i vendbashkimit mes fjalive të tekstit, është mekanizëm që qartëson lidhjet e zhvillimeve të situatave dhe të ngjarjeve të tekstit<sup>179</sup>. Vendbashkimi midis fjalive, sipas tyre bëhet me

<sup>178</sup> Halliday, M., An Introduction to Functional Linguistics, London, 1985, f.250-304

<sup>179</sup> Beaugrande/Dressler, vepra e cit., f.76

anë të lidhëzave. Në këtë drejtim, ata bëjnë katër grupime lidhëzash. Kështu, në grupin e parë hyn *lidhëza (Konjunktion)*, si mekanizëm i marrëdhënies shtesore. Kjo ndarje përfshin lidhëzat „und-dhe”, „außerdem-përveç kësaj”<sup>180</sup>. Në grupin vijues bëjnë pjesë *lidhëzat veçuese (Disjunktionen)*, që kanë funksion alternativ, të cilat veçojnë të vërtetën nga jo e vërteta. Në këtë rast recipienti i tekstit duhet t’i gjykojë të dyja alternativat në mënyrë që të gjendet zgjidhja (Entscheidung). Ndër lidhëzat me funksion alternativ njihet lidhëza „oder-ose”.<sup>181</sup> *Kontrajunkcioni (Kontrajunktion)* është marrëdhënie kundërlidhëse, përmes së cilës mundësohen zgjedhjet e ndërlikuara të ngjarjeve dhe situatave të tekstit të transmetuara nga dhënësi i tekstit. Në fjalitë e kësaj natyre është karakteristike lidhëza „aber-por”, „dagegen-përkundër” etj.<sup>182</sup> Dhe së fundi, *nënrenditja (Subordination)* realizohet përmes një numri të madh shprehjesh junktive (Junktive Ausdrücke), siç janë lidhëzat „weil-sepse”, „denn-sepse”, „deshalb - për arsye se”, „während-përderisa” etj. Sipas Beaugrande / Dressler-it<sup>183</sup> junktivët nënrenditës (Subordination Junktive) i bëjnë eksplicitë tipat e relacioneve koherente (Kohärenzrelationen).

Mendime mbi lidhjet logjike-semantike mes fjalive dhe pjesëve të tekstit kanë dhënë dhe studiuesit Heinemann/Viehweger (1991:42-44) dhe Heinemann/Heinemann (2002:76). Lidhjet logjike-semantike të pjesëve të tekstit (Texteinheiten) konsistojnë në disa lloje relacionesh dhe realizohen me anë të konektorëve të caktuar. Llojet e këtyre relacioneve janë:

- *relacioni i thjeshtë këpujor (einfache additive Relation): und – dhe,*
- *relacioni shkakor objektiv (objektive kausale Relation): weil – sepse,*
- *relacioni shkakor subjektiv (subjektive kausale Relation): denn – sepse,*
- *relacioni kushtor (konditionale Relation): obwohl – edhe pse,*
- *relacioni kohor (temporale Relation): vorher – para se, nachher – pastaj,*

<sup>180</sup> Beaugrande/Dressler, vepra e cit., f.76-77

<sup>181</sup> Beaugrande/Dressler, vepra e cit., f.77-78

<sup>182</sup> Beaugrande/Dressler, vepra e cit., f.79

<sup>183</sup> Beaugrande/Dressler, vepra e cit., f.79

- *relacioni pasues (konsekutive Relation): sodass – kështu që,*
- *relacioni përmbyllës (finale Relation): dammit – me këtë,*
- *relacioni kundërshtor (adversative Relation): aber – por,*
- *relacioni i specifikuar (spezifizierende Relation): spezif – pikërisht,*
- *relacioni krahasues (Vergleichs Relation): wie – si,*
- *relacioni shpjegues (explizierende Relation): expliz - shpjegues<sup>184</sup>*

Në studimin „Textpragmatische und kommunikative Ansätze” W. Heinemann thekson se sipas Van Dijk-ut këto relacione, meqë kanë të bëjnë me rrafshet e ndryshme të përmbajtjes (Inhaltsebenen) mund të ndahen në relacione lidhëzore (kausale Relationen), kurse relacionet e tjera janë relacione logjike-semantike të fjalisë.<sup>185</sup>

Emra të njohur të studimit teorik të funksioneve të konektorëve të tekstit në gjuhën gjermane janë edhe Pasch et al. Studiuesit Pasch et al., funksionin e konektorëve në tekst e kanë shqyrtuar në fusha të ndryshme gramatikore, si në rrafshin morfologjik, në rrafshin sintaksor, semantik dhe fonetik.

Duke i studiuar konektorët në rrafshin morfologjik ata konstatojnë se: meqë konektorëve u mungon fleksioni, ata duhet renditur me parafjalët dhe me pjesët e tjera të pandryshueshme. Në rrafshin sintaksor, konektorët nuk e drejtojnë ose nuk mund të ndikojnë në për zgjedhjen e rasës, siç ndikojnë parafjalët. Kurse, në rrafshin semantik konektorët krijojnë marrëdhënie, apo vendosin relacione mes dy fakteve. Prandaj, në gjuhën gjermane përdoret dendur lidhëza „weil-sepse”. Dhe së fundi, në plan fonetik, konektorët kanë veçoritë tingull-kuptim.<sup>186</sup>

<sup>184</sup> Heinemann, W., Textpragmatische und kommunikative Ansätze, Në Janisch, N., Hrsg: Textlinguistik – 15 einföhrungen, Tübingen, 2008, f.94-95

<sup>185</sup> Heinemann, W., vepra e cit., f.95

<sup>186</sup> Pasch, Renate; Ursula, Brauße, Eva, Breindl&Werich, H., Waßner, Handbuch der deutschen Konnektoren, Berlin, 2003., f.1

Me çështje të llojeve apo formave të koneksionit në gjuhën gjermane është marrë dhe studiuesja Catherine Fabricus – Hansen në veprën e saj „Formen der Konnexion” (2000), ku bën ndarjen e konektorëve në konektorë gramatikorë (grammatischen Konnektoren) dhe konektorë leksikorë (lexikalischen Konnektoren). Me anë të këtyre formave nënkupton lidhjen eksplicite përmbajtësore, të cilën ajo ndryshe e quan koneksion (Konnexion). Fabricus – Hansen në kuadër të koneksionit, gjejmë lidhjeve të konektorëve gramatikorë dhe atyre leksikorë, flet për gjashtë relacione, që krijojnë konektorët. Këto relacione janë:

- *relacionet bashkërenditëse (koordinative Relationen),*
- *relacionet shkakore (kausale Relationen),*
- *relacionet shkakore në kuptimin e ngushtë (kausale Relationen im engeren Sinne),*
- *relacionet pasuese (konsekutive Relationen),*
- *relacionet kushtore (konditionale Relationen),*
- *relacionet përmbyllëse (finale Relationen),*
- *relacionet lejore (konzessive Relationen),*
- *relacionet kohore (temporale Relationen),*
- *relacionet modale –instrumentale (Modal –instrumentale Relationen)<sup>187</sup>*

#### **4.2.2. Mbi konektorët e gjuhës shqipe**

Edhe në studimet gramatikore të shqipes bëhet ndarja e konektorëve në disa lloje. Kështu, duke u mbështetur në marrëdhëniet bazë, me anë të të cilave konektorët bëjnë

<sup>187</sup> Klisch, A.M., Textkohärenz, Heidelberg, 2013., f.18-24

lidhjen e konstituentëve të tekstit, në shqipe mund të bëhet fjalë për *marrëdhënie shtesore, kundërshtore dhe marrëdhënie shkakore* ,, një vend të rëndësishëm në trajtimin teorik të konektorëve të tekstit zë dhe klasifikimi i tyre sipas marrëdhënies që realizojnë. Por autorët kryesorë të gjuhësisë së tekstit jo gjithnjë bien dakord në lidhje me marrëdhëniet që mund të realizojnë mjete të ndryshme gjuhësore”<sup>188</sup>

Marrëdhënia shtesore në gramatikën e gjuhës shqipe realizohet përmes lidhëzave këpujore, siç janë lidhëzat: dhe, e, edhe. Lidhëzat këpujore janë trajtuar nga studiuesit e njohur si : J.Rrota, K.Cipo, S.Floqi, pastaj në gramatikën e gjuhës shqipe etj. Kështu, J.Rrota ndër të parët ka parë karakterin shtues të lidhëzave bashkërenditëse dhe, e, edhe. Ai konstaton se duke shtuar një mendim të ri, ato mund të vihen në fillim apo në mes të një fjalisë.<sup>189</sup> Kurse, S.Floqi zgjeron kuptimin shtesor të lidhëzave këpujore dhe, e, edhe në fjalitë e bashkërenditura, duke nënvizuar marrëdhëniet që ato realizojnë në fjali, siç janë marrëdhënia kohore, marrëdhënia përqasëse dhe marrëdhënia shkak-pasojë. Në kuadër të marrëdhënies shtesore, që realizojnë lidhëzat këpujore në fjalitë e bashkërenditura, ato në një rëndësi anë ndërtojnë komunikim të ri që lidhet me përmbajtjen e fjalisë dhe nga ana tjetër shtojnë dhe sqarojnë mendimin e shprehur brenda fjalisë.<sup>190</sup> Edhe sipas K.Cipos lidhëzat e, dhe, edhe përbëjnë grupin e lidhëzave këpujore.<sup>191</sup> Gramatika e gjuhës shqipe si lidhëza këpujore përcakton lidhëzat: as, dhe, e, edhe, si (e) dhe, hem.....hem, si..... si, si ..... ashtu.<sup>192</sup>

Autorët e mësipërm (J.Rrota, K.Cipo, S.Floqi, autorët e Gramatikës shqipe) përveç lidhëzave shtesore, shqyrtojnë edhe marrëdhënien kundërshtore në gjuhën shqipe. Kështu, J.Rrota mendon se njëra nga fjalitë me marrëdhënie kundërshtore si rregull mohohet apo kundërshtohet nga tjetra. Lidhëzorët që shprehin raporte kundërshtore mes

<sup>188</sup> Mëniku, L., Konektorët e tekstit në gjuhën shqipe (punim për mbrojtjen e gradës „Doktor”), Tiranë, 2013, f.51

<sup>189</sup> Rrota, J., Sintaksi i shqipes, Shkodër, 1942

<sup>190</sup> Floqi, S., Fjalja e përbërë e bashkërenditur në gjuhën shqipe, „Buletin për shkencat shoqërore”, Tiranë, 1956, f.20-43

<sup>191</sup> Cipo, K., Sintaksa, Tiranë, 1952

<sup>192</sup> Gramatika e gjuhës shqipe 1., f.405

fjalive janë: por, po, veçse, porse, veç, përkundrazi, përndryshe.<sup>193</sup> Ndërkaq, sipas S.Floqit raportet kundërshtore në gjuhën shqipe ndërtohen me lidhëzat kundërshtore (por, po, porse, kurse, ndërsa) si dhe pjesëzat lidhëza (veç, veç se).<sup>194</sup>

Sipas „Gramatikës së gjuhës shqipe” „lidhëzat kundërshtore janë: kurse, megjithatë, megjithëkëtë, mirëpo, ndërsa, teksa, po(r), porse, veç, veçqë, veçse, vetëm, vetëm se etj. Këto lidhëza shprehin marrëdhënie kundërshtore, përqasore – kundërshtore ose kundërshtore – kufizuese midis gjymtyrëve a fjalive që lidhin”.<sup>195</sup>

Si lidhëzorë të tjerë, që nuk janë lidhëza, por që hyjnë në grupin e konektorëve me marrëdhënie kundërshtore janë ndajfoljet: *ndryshe, përkundrazi, përndryshe, nga ana tjetër, në të kundërtën* etj.

Dhe së fundi, do thënë se „lidhëzat shkakore se, sepse, si, pasi (mbasi), derisa, gjersa, përderisa, kur, që, sapo, meqenëse, meqë, ngaqë, ngase, prejse, duke qenë se, nga frika se, nga shkak që, për arsye se, për shkak se, posa që, sapo që etj., shërbejnë për të ndërtuar fjali që shprehin lloje të ndryshme marrëdhëniesh shkakore”.<sup>196</sup>

Marrëdhënien shkakore të realizuar përmes këtyre lidhëzave e sheh dhe Cipo, sipas të cilit „fjalja shkakore tregon shkakun pse ngjan një punë për të cilën bën fjalë fjalja kryesore”.<sup>197</sup> Ndërsa, Floqi mendon se lidhëzat, të cilat lidhin dy fjali në një periudhë mund të kenë nuanca shkak, atëherë kur kallëzuesi i fjalisë kryesore paraqet ndjenjë a gjendje të brendshme. Dhe, në këtë mënyrë fjalja e varur paraqet shkakun e ngjarjes.<sup>198</sup> „Lidhur me kuptimin e fjalive shkakore mund të thuhet që pjesa e varur shkakore shpreh shkakun ose sqarimin e përmbajtjes që jepet në pjesën kryesore. Raportet kauzale të shprehura në fjalitë shkakore mund të grupohen në tri lloje:

<sup>193</sup> Rrota, J., vepra e cit., f.28

<sup>194</sup> Floqi, S., Periudha me fjali të varur shkakore I, Studime filologjike, nr.2, Tiranë, 1966, f.4

<sup>195</sup> Gramatika e gjuhës shqipe 1, f.406

<sup>196</sup> Gramatika e gjuhës shqipe., f.408

<sup>197</sup> Cipo,K., vepra e cit., Tiranë, 1952

<sup>198</sup> Floqi, S., vepra e cit., f.121

- shkakësi reale – në këtë rast shkak është i tillë që domosdoshmërisht pas njëfarë kohe prodhon një pasojë të caktuar:

Meqë ai nuk shqiptonte qartë, ne nuk e kuptuam ç' tha.

- motivim – ky lloj raporti shkakësor përfshinë rastet kur përmbajtja e pjesës së varur është një shpjegim, një argumentim e saqrim i asaj që thuhet në pjesën kryesore:

Megjithatë ndaloi ngaqë donte ta ndëgjonte

- shkakësi logjike – raportet shkakore në këtë rast mbështeten në ligjësitë logjike:

Meqë shtëpia është më e madhe se Emili, natyrisht Emili është më i vogël se ajo.”<sup>199</sup>

Sintaksa e gjuhës shqipe, fjalitë e varura shkakore i trajton të bashkuara me fjalinë kryesore me anë të lidhëzave dhe lokucioneve lidhëzore, të cilat i ndan në tri grupe „ 1) lidhëza e lokucione lidhëzore konstatuese të shkakut si: *se, pse, sepse, meqë, ngase, nga shkak se, nga shkak që, për shkak se, për arsye se, me pretekst se, nga frika se mos*: 2) lidhëza e lokucione lidhëzore motivuese, arsyetuese si: *meqë, meqenëse, meqënëqë, duke qenë se, duke qenë që, përderisa*: 3) lidhëza e lokucione kohore si: *kur, tek, si, mbase, pasi, posa, sapo, gjersa, derisa, sakohë që, tani që, sot që, qëkur, qëkurse, qysh se*”<sup>200</sup>

<sup>199</sup> Sadiku, G., Shkakësia si kategori logjike dhe gjuhësore në shqip dhe në gjermanisht (Punim për gradën shkencore doktor), Tiranë, 2013, f.12

<sup>200</sup> Gramatika e gjuhës shqipe 2, f.563

## **5. ANALIZË TEKSTORE DHE KONTRASTIVE E PËRKTHIMEVE TË LAMBERCIT**

### ***5.1. Rreth kritereve të analizës***

Në studimin „Përkthimet në gjermanisht të teksteve shqipe nga Maksimilian Lamerci – analizë tekstore”, ashtu si është thënë më parë, do të mbështetemi kryesisht në metodën e analizës përfaqëse kontrastive, e cila, siç është e njohur, bën përshkrimin dhe krahasimin mes gjuhëve në sinkroni. Shembujt që do të shkëputen apo përzgjidhen nga korpusi, do të bëhen objekt trajtimi i analizave në disa rrafshë: sintaksor, semantik dhe pragmatik. Për trajtimin sa më të plotë dhe të gjithanshëm të analizave që do të bëhen, do të mbështetemi në parimet teorike të gjuhësisë së tekstit. Në këtë mënyrë do të shfrytëzohet dija teorike, themelet e së cilës i kanë dhënë studiues të njohur të gjuhësisë dhe të gramatikës së tekstit si R.A. de Beaugrande / W.U.Dressler (Einführung in die Textlinguistik), K.Brinker (Linguistische Textanalyse), H.Vater (Einführung in die Textlinguistik), M.A.Klisch (Textkohärenz), Ch.Gansel / F.Jürgens (Textlinguistik und



Textgrammatik), H.J.Heringer (Texte analysieren und verstehen), H.Weinrich (Textgrammatik der deutschen Sprache) etj. Mirëpo, gjatë analizave konkrete që do të bëhen, pashmangshëm duhet t'u referohemi kritereve të tekstualitetit (kohezionit, koherencës, synueshmërisë, pranueshmërisë, njoftueshmërisë, situacionalitetit dhe ndërtekstualitetit), të cilat së pari janë konceptuar nga studiuesit De Beaugrande / Dressler. Këto kritere të përkufizuara nga ta, janë përkrahur dhe nga një plejadë studiuesish të fushës së gjuhësisë së tekstit, siç janë H.Vater, M.A.Klisch, N.Janich etj. Do shtuar, se N.Janich në studimin e saj „Aspekte einer systematischen Beschreibung von Intertextualität” duke folur për ndërtekstualitetin (Intertextualität) dhe duke u dakorduar me studiuesit e tjerë (Adamzik: 2004:96) bën sistemimin dhe klasifikimin e lidhjeve të mundshme intertekstuale mes teksteve.<sup>201</sup>

Edhe K.Brinker ka trajtuar dhe diskutuar kategoritë dhe kriteret e analizës tekstore gjuhësore. Sipas tij, në fushë të hulumtimeve gjuhësore, rëndësi të dorës së parë ka dallimi ndërmjet strukturës dhe funksionit të tekstit. Në kuadër të aspektit strukturor, si kriter i analizës së tekstit ai nënkupton strukturën gramatikore dhe atë tematike të tekstit, të cilat janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën. Në rrafshin gramatikor (grammatische Ebene) ai e quan kategori qendrore (als zentrale Analysekatgorie) koherencën gramatikore (grammatische Kohärenz), e cila shpreh relacionet lidhëse sintaktike dhe semantike (syntaktische und semantische Verknüpfungsbeziehungen) të fjalive të tekstit. Ndërsa, në rrafshin tematik (thematische Ebene), ai përfshin temën e tekstit (Textthema) dhe formën e zhvillimit të vetë temës (Form der Thementfaltung).

Aspekti komunikativ – funksional (Kommunikativ – funktionale Aspekt), sipas K.Brinker-it paraqet kriterin e dytë themelor të analizës tekstore gjuhësore. Ky kriter realizon kuptimin e tekstit në aktin e komunikimit mes dhënësit dhe marrësit (Rezipient).<sup>202</sup>

---

<sup>201</sup> Janich, N., Aspekte einer systematischen Beschreibung von Intertextualität, Në Janisch, N., Hrsg: Textlinguistik-15 Einführungen, f.183-184

<sup>202</sup> Brinker, K., vepra e cit., f.137

Kriteret e gjuhësisë së tekstit, të përcaktuara dhe të trajtuara nga këta studiues dhe stuidues të tjerë, do të jenë mbështetja kryesore në procedimin e analizave që do të bëhen. Gjatë punës sonë të mëtutjeshme, trajtimi i analizave do të jetë njëdrejtimësh, pra analizat do të bëhen duke u nisur nga shqipja në gjermanisht. Mënyra e kësaj çasjeje mbështetet në faktin se tekstet origjinale për analizë janë tekste letrare të shqipes, të cilat më vonë Lamberci i ka përkthyer në gjuhën gjermane. Për këtë arsye analiza do të niset nga tekstet origjinale në tekstet e përkthyera.

## *5.2. Korpusi dhe analiza e korpusit*

Përkthimet e Lambercit në gjermanisht paraqesin fushë të rëndësishme të veprimtarisë shkencore të tij. Ai, si njohës i thellë i gjuhës shqipe, u përpoq që tekstin ta përkthejë dhe mesazhin e tekstit ta bartë sa më mirë në gjuhën gjermane. Tekstet shqipe të përkthyera në gjermanisht nga Maksimilian Lamberci të gjitha janë tekste letrare dhe u takojnë dy fushave të krijimtarisë. Korpusin e parë të teksteve e përbëjnë tekstet e folura, të cilat janë të krijuara gojarisht dhe të regjistruara me shkrim dhe si të tilla e fitojnë statusin e teksteve të shkruara letrare, përkatësisht të krijimtarisë folklorike letrare. Në këtë mes hyjnë në radhë të parë përrallat popullore, që u takojnë të gjitha zonave folklorike shqiptare, si të veriut ashtu edhe të jugut, madje edhe të diasporës historike shqiptare (arbëreshëve të Italisë), pastaj gojëdhënat demonike dhe gojëdhënat etiologjike. Ky është korpusi i teksteve të folklorit letrar në prozë. Ndërkaq, Lamberci ka përkthyer në gjermanisht edhe një numër tekstesh të folklorit letrar shqiptar në vargje, apo krijime folklorike të poezisë popullore. Këtu hyjnë në radhë të parë këngët kreshnike dhe disa këngë historike.

Korpusin e dytë të teksteve shqipe të përkthyera në gjermanisht e përbëjnë tekstet nga letërsia e shkruar apo e kultivuar. Këtu bëjnë pjesë vepra monumentale e Gjergj Fishtës „Lahuta e Malcis” dhe një numër tekstesh të poezisë shqipe të traditës dhe të poezisë së

krijuar pas Luftës së Dytë Botërore. Shumica e teksteve të përkthyer përrallat, gojëdhënat, këngët kreshnike, këngët historike, „Lahuta e Malcis” etj., janë tekste epike narrative.<sup>203</sup>

### ***5.2.1. Tekstet e letërsisë gojore të përkthyer në gjermanisht***

Tekstet e para që Maksimilian Lamerci i përktheu nga shqipja në gjermanisht janë të letërsisë gojore. Këto tekste i përktheu në vitin 1917 në studimin e tij „Volks poesie der Albaner” - „Poezia popullore e shqiptarëve”. Në këtë studim të tij ai ka dhënë të përkthyer në gjermanisht një numër tekstesh të këngëve epike historike, një këngë elegji dhe disa këngë lirike. Këngë historike janë gjithsej dhjetë, gjashtë këngë lirike, një elegji dhe rreth njëmbëdhjetë këngë për fëmijë. Të gjitha tekstet e këngëve të përfshira në këtë studim, të përkthyer në gjermanisht janë marrë nga koleksioni i njohur i Vinçenc Prenushit „Këngë popullore gegnishte”.

Nga fusha e poezisë gojore, Lamerci shquhet sidomos me përkthimin e këngëve kreshnike. Nga ky model narrativ ai përktheu njëzet këngë kreshnike ndër më të bukurat, të cilat i mori nga koleksioni antologjik „Këngë kreshnikësh dhe legenda” të autorëve Bernardin Palaj dhe Donat Kurti. Këngët, të cilat i ka përkthyer sipas rradhës në gjermanisht kanë këta tituj: „Die Kraft der Muji” – Fuqia e Mujit”, „Die Heirat des Gjeta Basho Muji” - „Martesa e Gjeta Basho Mujit”, „Halili entführt die Tanusha” - „Halili rrëmben Tanushën”, „Omeri, der Sohn des Muji” - „Omeri prej Mujit”, „Omeris Tod und Ajkunas Totenklage” - „Ajkuna kjan Omerin”, „Die Gattin des Muji wird geraubt” - „Rrëmbimi i së shoqes së Mujit”, „Mujis Oren” - „Orët e Mujit”, „Muji und Behuri oder

<sup>203</sup> Narracioni (lat. Narration – rrëfim) është term, i cili e zgjeron dhe e zëvendëson kuptimin e epikës si gjini letrare. Ky koncept në krijimtarinë letrare epike lidhet me situatat e komunikimit mes njerëzve. Narracioni në veprat letrare epike është ndërmjetësues mes ngjarjeve dhe dëgjuesve. Në fakt narracioni nënkupton apo përfshin çdo njësi, që tekstin letrar e bën të jetë integral në mënyrë që të arrihet tërësia e rrëfimit-koherenca e tekstit. (Rreth kësaj problematike shih lit. E.Neis, Struktur und Thematik der traditionellen und modernen Erzählkunst, 1964; E. Lämmert, Bauformen des Erzählens, 1972; K. Kanzog Erzählstrategie, 1976 etj..)

Tod des Dizdar Osman Aga und des Zuku Bajraktar” - „Muji e Behuri. Deka e Dizdar Osman Agës me Zukun Bajraktar”, „ Zuku Bajraktar” - „ Zuku Bajraktar”, „Arnaut Osmani und Hysko Radoica” - „Bejlegu ndërmjet dy vllaznëve të panjoftun – Arnaut Osmani dhe Hysko Radoica”, „Ali der Bajraktar oder Besa” - „Ali Bajraktari. Besa”, „Der verwundete Muji” - „Muji i varruem”, „Tod des Halil” - „Deka e Halilit”, „Muji nach seinen Tode” - „Muji mbas deket”, „Halil nimmt Blutrache für Muji” - „Halili merr gjakun e Mujit”, „Das Pferd des Muji” - „Gjoku i Mujit”, „Der junge Omeri” - „Omeri i ri”, „Arnaut Osmani” - „Zuku erbeutet die Rusha” - „Zuku e merr Rrushen” dhe „Muji und Jevernija” - „ Muji dhe Jevernija”. Këtë punë të rëndësishme, përmes së cilës iu ofrohen njohuri të huajve (gjermanëve) për këtë traditë të pasur epike gojore të shqiptarëve, Lamberci e përfshiu në veprën „Die Volksepik der Albaner”, të cilën e botoi më 1958. Teksti nga eposi i kreshnikëve i përkthyer në gjermanisht përfshin 5483 vargje, të cilat Lamberci nuk i përktheu në vargje, por në prozë.

Ndërkaq, tekstet narrative në prozë (përrallat dhe gojëdhënat) të përkthyer në gjermanisht, Lamberci i botoi në koleksionin „Albanische Märchen und andere Texte zur albanischen Volkskunde” në vitin 1922. Në fillim të kësaj përmbledhjeje, pas studimit për strukturën e përrallës gojore, janë përfshirë të përkthyer në gjermanisht këto gojëdhëna demonologjike „Die Kulschedra mit dem Dranges”- „Kulshedra me dragoit”, „Kulschedra” - „Kulshedra”, „Die Hexe und ihr Sohn” - „Štriga e i biri i sai”, „Die sieben Hexen in Schlauch” - „Štat štrigat n eřšiš”, „Der Ochs und die Teufel” - „Kau e dretšrit”. Kurse, në vijim jepen të përkthyer gojëdhënat për heronjtë e vjetër siç janë „der Mohr und Džerdž Eléz Alia” - „Harapi e Džerdž Eléz Alia”, „Als das Gewehr zum ersten Mal aufkam” - „Kur dul puška s parit”, „Muji und Halili” - „Muji dhe Halili” si dhe gojëdhënat etiologjike „Die Burg von Škodra” - „Kalaja e Škodrë”, „Die Burg von Berat” - „Kalaja e Beratit”. Në korpusin e teksteve gojore të përkthyer në prozë në gjermanisht, krahas gojëdhënave hyjnë edhe përrallat: „Der heilige Georg” - „Šn’erdži”, „Der Sohn der Padischan, der den Dif und die Kulschedra tötet” - „I biri i padišahit, tši e müt difin e kulshedrën”, „Der Sohn des Königs, die Mutter der Feder und die Stuten

Kjüelane” - „I biri i mbretit, e ama e puples ede pelat k’üleane”, „Der Satan und seine Schwester. Märchen von dem Burschen der 80 Jahre im Paradise war” - „Šeitani ede motra e ti, ose Pralza e aslanit, koplanit e vešn’erzit”, „Der alte Räuber” - „Kusari i vjetër” etj. Të gjitha tekstet gojore në prozë, të përfshira në përmbledhjen „Përralla shqiptare”, janë dhënë me shenja diakritike.

Maksimilian Lamberci ka përkthyer në gjermanisht përralla shqiptare edhe më vonë, më 1955 në veprën „Albanische Chrestomathie”. Këto përralla të përkthyer janë përfshirë nga faqja 120 deri në faqen 136. Përrallat u përkasin krahinave të ndryshme si Dibër, Shqipëri e Veriut, Borgo Erizzo e arbnesheve të Zarës, nga zonat folklorike të Jugut marrë nga përmbledhja e Thimi Mitkos „ Bleta shqiptare” si dhe nga folklori i shqiptarëve të Greqisë. Disa nga titujt e këtyre përrallave janë „Der Tschätsljäm” - „ Tsäts’isl’ämi, tsi u mbyt n’groš”, „Der Sohn des Padischan” - „I biri i padišahit”, „Die Meernixe” - „Hyrija e detit”, „Die Schöne der Erde” - „E bukura e Dheut” dhe „Das Mädchen und die Ziege” - „Vašëza e Lia”.

### ***5.2.2. Tekstet e letërsisë së shkruar të përkthyer në gjermanisht***

Një pjesë të teksteve të përkthyer nga shqipja në gjermanisht, Lamberci i përfshiu në „Albanische Chrestomathie”. Në këtë vepër ai përktheu në gjermanisht pjesë të teksteve të letërsisë shqipe nga më të hershmet duke filluar nga letërsia biblike. Në këtë vepër janë dhënë të përkthyer në gjermanisht edhe disa tregime dhe novela që nga 1945-ta nga autorët Fatmir Gjata („Die Braut” - „Nusja”), Jakov Xoxa („Die Haarschöpfe des Masar Beg” - „Kurorat e Masar beut”), Dhimitër Shuteriqi („Der älteste Sohn des Sale Ceni” - „Ky çuni i math i Sale Ceni”), Zihni Sako („Versöhnung in einer Blutrachesache” - „Pajtim me gjak”), Luan Qafzezi („Das Ertrinken” - „Mbytja”),

Shefqet Musaraj („Auf die Schwelle der Freiheit” - „Në parkun e Lirisë”). Edhe pse krijimet e Migjenit janë para vitit 1945, Lamerci në këtë vepër ka përfshirë edhe disa tregime të tij siç janë „Der verbotene Apfel” - „Mollë e ndalume”, „Es sollen die Hintertüren geöffnet werden” - „Të çelen arkapijat”.

Nga poezia shqipe e pas Luftës së Dytë Botërore janë përkthyer edhe disa krijime poetike në vargje të poetëve Aleks Çaçi („ Nëna dhe Paqja” - „Die Mutter und der Friede”), Llazër Siliqi („Atit tim” - „Meinem Vater”, „Përsëri u përtri jeta” - „Wiederum erneuerte sich das Leben”), Mark Gurakuqi („Pranverë” - „Frühling”, „Dashuria e Pandit” - „Die Liebe des Pandi”, „Letër së Dashunës në Hekurudhë” - „Brief an die Geliebte in der Eisenbahn”, „Kangë për t’ Ardhmen” - „Lied auf die Zukunft”, „Krenari” - „Stolz”). Lamerci në këtë vepër përktheu në gjermanisht edhe tekstin e „Hymnit të Flamurit”, poezi e Asdrenit.

Vepra „Lahuta e Malcis” - „Die Laute des Hochlandes” e Gjergj Fishtës, e përkthyer në gjermanisht nga Lamerci paraqet punën më madhore, që ai bëri në fushë të përkthimeve . Këtë projekt të madh pati mundësi ta realizojë vetëm Lamerci, sepse si homerolog ishte njohës i thellë i epopeve klasike dhe i gjuhës shqipe, sidomos i dialektit gegë. Lamerci përktheu botimin e parë të „ Lahutës së Malcis” të vitit 1937. Këtë vepër ai e përktheu në tërësi nga kënga e parë deri te kënga e fundit, kënga e tridhjetë, me rreth 15613 vargje, ndërkaq fjalori i saj përfshin 14000 fjalë.<sup>204</sup>

Analiza kontrastive e tekstore, e cila do të jetë qëllimi kryesor i këtij studimi, do të mbështetet në gjithë këtë korpus të begatshëm të përkthimeve të teksteve shqipe që i kishte bërë studiuesi i njohur austriak Maksimilian Lamerc. Analizat tona do të mbështeten, pra, në tekstet letrare të letërsisë gojore dhe të letërsisë së shkruar në prozë dhe në vargje, do të thotë në përralla, në gojëdhëna popullore, në këngët historike dhe kreshnike, në një numër poezish të letërsisë së traditës dhe asaj të krijuar pas vitit 1945, e

<sup>204</sup> Aliçkaj, Xhavit, Lahuta e Malcis e Gjergj Fishtës, Shtëpia botuese Faik Konica, Prishtinë, 2000, f.254. Në këtë studim autori shprehet se vepra e Gjergj Fishtës – Lahuta e Malcis ka më shumë fjalë se vetë Fjalori i Bashkimit i vitit 1908 i hartuar nga Dodë Koleci

në disa tregime e novela të autorëve të viteve 50 dhe së fundi, në analizën tekstore e kontrastive të epopesë „Lahuta e Malcis”.

### ***5.3. Përdorimi i kohëve të mënyrës dëftore (Indikativ) në tekstet shqipe dhe në tekstet e përkthyer***

Tekstet shqipe të përkthyer nga Lamberci, si përrallat, këngët kreshnike, poemat e „Lahutës së Malcis” janë tekste letrare të tipit narrativ, të cilat, si lloje të gjinisë së epikës, i karakterizon narracioni. Narracioni bën që tekstet letrare, që do të shqyrtohen gjatë analizave, të jenë integrale si kusht i domosdoshëm për t’u arritur tërësia e rrëfimit-koherenca e tekstit. Meqë, shembujt e përzgjedhur nga tekstet janë të tipit narrativ, narracioni do të shprehet kryesisht me anë të regjistrit narrativ (H.Weinrich:2007:198-201/ O. Buchholz, W. Fiedler:1987:146;131;527).<sup>205</sup>

1. Teksti „Saleptsiu” i përzgjedhur nga „Albanische Märchen” është përrallë popullore me strukturë të tekstit narrativ. Narracioni apo rrëfimi në tekstin në gjuhën shqipe shprehet me anë të mjeteve tekstore verbale, të cilat kryesisht në tekst i takojnë regjistrit narrativ. Në shqyrtimin e tekstit në fjalë, jemi përqendruar në realizimin e komunikimit mes dhënësit dhe marrësit përmes mënyrës dëftore të shenjave verbale si

<sup>205</sup> Kohët në gjuhën gjermane ndahen në dy grupe: në kohë të komentit (besprechende Tempora) dhe në kohë të rrëfimit (erzählende Tempora). Tekstet, në të cilat më shpesh përdoren kohët e rrëfimit quhen tekste rrëfimtare. Kohët që ndërtojnë tekstet rrëfimtare në gjuhën gjermane janë preteriti, plusquamperfekti, kondicionali (würde + Infinitiv I) dhe kondicionali II (würde + Infinitiv II). Edhe në gjuhën shqipe kohët e rrëfimit janë e pakryera, më se e kryera dhe e kryera e thjeshtë (aoristi).

mjete gjuhësore. Mënyra dëftore, duke qenë mënyrë e pashenjësuar (e pamarkuar) e foljeve, në tekstin të cilin jemi duke e analizuar del me një numër të konsideruar kohësh. Kështu, duke hulumtuar kohët e mënyrës dëftore, mund të konstatohet se në këtë tekst narrativ shumica e shenjave verbale janë të regjistrit narrativ. Pra, do sqaruar se, edhe pse shenjat verbale në këtë tekst janë mikste, në të epërsi kanë shenjat verbale që i përkasin regjistrit narrativ (ište, kište, bešin, škoj). Kurse, shenjat e tjera të strukturës së tekstit, të cilat janë më të kufizuara në numër, i përkasin regjistrit të kohëve të komentit (theret, vjen).

Meqenëse, strukturën e këtij teksti në gjuhën shqipe e ndërtojnë dhe mënyrat e tjera të shenjave verbale (shko, thui, të them, të napi etj), ato do të trajtohen në kuadër të shfaqjes së mënyrave të tjera gjatë analizave që do të bëhen në tekste.

Duke iu përmbajtur parimit të njohur të gjuhësisë tekstore, përkitazi me përdorimin e formave në tekst, del se ky tekst i takon llojit të teskteve narrative. Kurse, sipas vendit që zënë format kohore në tekstin në shqyrtim, ato janë më shumë të pranishme në fjalitë e varura të tekstit krahasuar me fjalitë kryesore të këtij teksti. Në fjalitë kryesore të tekstit në fjalë, shenja verbale e regjistrit narrativ në dy raste dalin në pozicion nistor (Ište, Bešin). Në vazhdim vërehet se në këtë tekst ka varësi temporale mes fjalive të përbëra, të cilat bëjnë zhvendosjen e kohëve të tekstit. Zhvillimi i ngjarjes së tekstit të kësaj përralle paraqet njëkohshmëri mes veprimit të realizuar në fjalinë kryesore dhe veprimit në fjalinë pasuese apo fjalinë e varur (Ište...,... kište...):

„Ište<sub>e pak</sub> n’i her n’i duhandži i ri i tsili kište<sub>e pak</sub> n’i gru tē bukur.”

„Es war <sub>Prät.</sub> einmal ein junger Tabakhändler, der eine schöne Frau hatte <sub>Prät.</sub>”

Në fjalinë e radhës kemi raport kohor njëkohësie mes fjalisë kryesore dhe fjalive të varura (...gindeš..., ište...,...de kište...):



„Me at kütet ku g'indeš<sub>e pak</sub> kü, ište<sub>e pak</sub> n'i Vali i martu, bur i škumun nga vjetšt ðe kište<sub>e pak</sub> šum femí.”

„In jener Stadt, wo dieser sich befand Prät., lebte Prät. auch ein Vali, ein verheirateter Mann, schon vorgeschritten an Jahren und kinderreich.”

Fjalialia e katërt e tekstit, e cila përbëhet nga një fjali kryesore dhe disa fjali të tjera të varura ndërton raporte parakohësie, meqë në fjalitë e varura veprimi ndodh para fjalisë kryesore në tekst. Edhe fjalialia e pestë e vazhdimit të tekstit paraqet raporte parakohësie të fjalive të varura krahasuar me fjalinë kryesore. Derisa ndërtimet e mësipërme të kësaj përralle shfaqin raporte njëkohësie dhe parakohësie, në fjalinë:

„Šerbetori škoi<sub>e pak</sub> me ndzitim ðe e Øeret<sub>e tash</sub> duhanžiu, t tsili duk u drið vjen përpara Zon'es”

„Der Diener ging Prät. in Eile und ruftPräs. den Tabakhändler, der zitternd vor die Dame tritt”.

dalin raporte paskohësie mes fjalisë kryesore dhe fjalisë së varur.

Shenjat tekstore të diskutuara më lart, në këtë rast foljet, lidhen apo i referohen më së shpeshti kryefjalës (ai, sherbetori, gruaja), e cila në tekst shprehet me emër ose përemër. Por, ndodh që kryefjala e fjalisë kryesore nënkuptohet në fjalitë e varura nga vetë konteksti. Përemrat, të cilët në tekst ndërlidhen me foljen, apo të cilët nënkuptohen nga konteksti, janë në vetën e tretë të njëjësit, vetë kjo që në tekstet narrative njihet si „er-Form”.<sup>206</sup>

Teksti shqip i kësaj përralle të përkthyer nga Lamberci edhe në gjermanisht, në të shumtën e rasteve është i ndërtuar me folje të mënyrës dëftore (Indikativ) dhe më rrallë janë të pranishme dhe foljet në mënyra të tjera, si lidhore (Konjunktiv – erzürnt wäre) dhe urdhërore (Imperativ – Geh, sag). Në tekst ka laramani të kohëve të mënyrës dëftore,

<sup>206</sup> Čubelić, T., vepra e cit 1972, f.411-412

sepse strukturën e tij, sa u përket foljeve, e ndërtojnë Präsents-i, Perfekti dhe Präteritum-i, por **Präteritum-i**, që ka shtrirje të gjerë në gjithë tekstin, përcakton karakterin narrativ të tij.

Gjatë analizës së tekstit në gjermanisht shihet se, ashtu si në tekstin origjinal, folja ndërlidhet me një kryefjalë, e cila në fjalitë e fillimit të tekstit shprehet me emër, ndërkaq në vazhdim të tekstit bëhet përemërzimi i tij (Pronominalisierung) në vetën e tretë të njëjësit, gjegjësisht me „Er-Form”. Në këtë mënyrë, përemri del në rol referencial (Referenzrolle) ndaj emrit.<sup>207</sup>

„E šoka keti Valiut n’i dit duke neit ne dritare e šef<sub>e tash</sub>. ket duhandžin, k’<sub>e</sub> po škonte<sub>e pak</sub>. anei, si i bukur ke ište<sub>e pak</sub>. naturišt, bukuria e ketij i bani<sub>e kr. e thj.</sub> n’i perštüpje te mađe đe pa daš si e nderšeme, ke ište<sub>e pak</sub>, huđi<sub>e kr. e thj.</sub> sevda me kete.”

„Die Gattin dieses Vali saß<sub>Prät.</sub> eines Tages im Fenster und sieht<sub>Präs.</sub> diesen Tabakhändler, der<sub>1</sub> dort vorüberging<sub>Prät.</sub> und schön, wie er<sub>2</sub> von Natur aus war<sub>Prät.</sub>, machte<sub>Prät.</sub> seine Schönheit auf sie<sub>3</sub> einen großen Eindruck, und ohne daß sie<sub>4</sub> es wollte<sub>Prät.</sub> – denn sie<sub>5</sub> war<sub>Prät.</sub> eine anständige Frau-verlor<sub>Prät.</sub> sie<sub>6</sub> ihr Herz an ihn”.

Varësinë temporale mes fjalive të këtij teksti e shprehin marrëdhëniet e ndryshme kohore të foljeve. Në këtë mënyrë marrëdhënie njëkohëshmërie në tekstin gjermanisht shprehin fjalitë:

„Ište<sub>e pak</sub>. n’i her n’i duhandži i ri i tsili kište<sub>e pak</sub> n’i gru te bukur.”

„Es war<sub>Prät.</sub> einmal ein junger Tabakhändler, der eine schöne Frau hatte<sub>Prät.</sub>”

„Me at kütet ku g’indeš<sub>e pak</sub>. kü, ište<sub>e pak</sub> n’i Vali i martu, bur i škumun nga vjetšt đe kište<sub>e pak</sub>. šum femí.”

„In jener Stadt, wo dieser sich befand<sub>Prät.</sub>, lebte<sub>Prät.</sub> auch ein Vali, ein verheirateter Mann, schon vorgeschritten an Jahren und kinderreich.”

<sup>207</sup> Weinrich, H., vepra e cit., f.372-373

„Kete sevda nuk mundte<sub>e pak.</sub> me e deklaruar dhe andaj, sa po vinte<sub>e pak.</sub>, po fushkeshe dhe trette shembuj mbi vete”

„Ihre Liebe konnte <sub>Prät.</sub> sie ihm aber nicht erklären<sub>Präs.</sub> und daher schrumpfte <sub>Prät.</sub> sie zusammen und verkroch sich in sich selbst, so oft er vorbeikam”

„K’o mafedhan’e ng’ati<sub>e kr. e thj.</sub> disa koh duke ble duhan per dit me anen e sherbetorit”

„Dieser Verkehr dauerte <sub>Prät.</sub> einige Zeit so an, indem sie alltaglich durch Vermittlung ihres Dieners Tabak kaufte”

Në kuadër të marrëdhënieve kohore mes fjalive kryesore (Hauptsätze) dhe fjalive të varura (Nebensätze) të këtij teksti realizohen edhe marrëdhënie parakohësie. Fjalitë në marrëdhënie kohore të parakohësisë, në të cilat zhvillimi i ngjarjes në fjalinë e varur ndodh para zhvillimit të ngjarjes në fjalinë kryesore, në tregim paraqitet në këta shembuj:

„Per me u difru, sheret <sub>e tash.</sub> sherbetorin besnik, ke mbante<sub>e pak.</sub> ne shpeji, dhe te tsilen, ks kur ishte <sub>e pak.</sub> i vogel, e kiste <sub>e pak.</sub> nen kudesin e sai, mbasi ishte <sub>e pak.</sub> jetim pa print dhe ke vend te larg”

„Um sich Erleichterung zu verschaffen, ruft<sub>Präs.</sub> sie ihren treuen Diener , den sie im Hause hielt <sub>Prät.</sub> und den sie seit seiner Jugend unter ihrer Obhut hatte <sub>Prät.</sub>, weil er ein Weisenkind ohne Eltern war <sub>Prät.</sub>”

„Po pastai nga pak nga pak i deften<sub>e tash.</sub> sevdan, ke kiste<sub>e pak.</sub>, dhe i kaldzon<sub>e tash.</sub> zemren e sai”

„Aber hernach enthüllt<sub>Präs.</sub> sie ihm nach und nach ihre Liebe, die sie für ihn hingete<sub>Prät.</sub>”.

Dhe së fundi, marrëdhënie paskohëshmerie në tekst paraqet ky shembull i fjalisë së mëposhtme:

„Šerbetori ško<sub>ie kr. e thj.</sub> me ndзитим ðe e ðeret<sub>e tash.</sub> duhandžin, t tsili duk u drið vjen përpara Zon'es.”

„Der Diener ging <sub>Prät.</sub> in Eile und ruft <sub>Präs.</sub> den Tabakhändler, der zitternd vor die Damme tritt”.

Në tekstet e analizuara në të dy gjuhët preteriti, si formë kohore e mënyrës dëftore, përdoret më së shpeshti. Përmes preteritit të kësaj mënyre realizohet narracioni si përbërës kryesor i strukturës së tekstit narrativ. Poashtu, në të dy tekstet njësoj bëhet përemërimi apo zëvendësimi i emrit me përemër, i cili shpreh raport referencial ndaj tij. Raportet e tilla referenciale të përemrit janë të lidhura ngushtë me foljen, e cila paraqet veprimin e kryefjalës. Edhe marrëdhëniet kohore të foljeve si shenja kohezive të tekstit, shprehin varësi të njëjtë temporale si njëkohësi, parakohësi dhe paskohësi.

Në të dyja tekstet ka shprehje, të cilat për nga kuptimi semantik që kanë, janë të ekuivalente :

„ ... ðe kište šum femi” „ ... und kinderreich”,

„... ðe i katdzon zemren e sai...” - „... und eröffnet ihm ihr Herz...”

„ ... huði sevda me kete” - „ ... verlor sie ihr Herz an ihn”

Por, ato me përjashtim të shembullit të parë, ku foljen e zëvendëson mbiemri në gjermanisht, dy shembujt e tjerë, edhe pse kanë forma të njëjta kohore, në tekst shfaqen me shenja të ndryshme verbale. Shprehjet e diskutuara kanë ngjyrimet e veta në të dy gjuhët. Kështu, shprehja e gjermanishtes „kinderreich” na duket se del stilistikisht më e pëlqyeshme krahasuar me shprehjen e shqipes „kište shum femi”. Kurse, dy shprehjet e tjera kanë për afërsisht ngjyrimet e njëjta emocionuese.

2. Kënga „Marash Uci”, që do të merret në shqyrtim është nga „Lahuta e Malcis” e Gjergj Fishtës. Nga ky tekst analizohen tre paragrafë, të cilët paraqesin një tërësi integrale kuptimore të tij.

Në mbështetje të shenjave verbale të mënyrës dëftore përcaktohet se teksti në fjalë ka strukturë narrative, do të thotë është tekst i llojit narrativ. Teksti shqip ndërtohet më së shumti nga foljet në kohën e pakryer dhe kohën më se të kryer (kishin ndollun, i kish’rá, kishte pá, kje, i kjenë, kallzote, bâte, u përmendte, u thote, i njifte, dojshin, ndigojshin). Por, do theksuar se në strukturën e këtij teksti janë të pranishme dhe folje në kohën e tashme apo folje të regjistrit komentues, sepse, siç është e ditur nga gramatika e tekstit, nuk ka krejtësisht tekste të pastërta të një lloji të caktuar (piqet, âsht, zêhet, bân, jânë). Pra, si shihet më lart, prania e formave kohore narrative në raport me ato të regjistrit të komentit në tekst del më i madh si në tekstet shqipe ashtu edhe në tekstet e përkthyer. Ky numër i formave kohore narrative të mënyrës dëftore, përmes të cilave realizohet narracioni, do të ishte edhe më i madh në vargjet ku formalisht folja mungon, por prania e saj nënkuptohet. Kështu, në paragrafin e parë, folja e vargut të dytë të tekstit mbulon katër vargjet vijuese (kishin ndollun). Por, megjithë mungesën e tyre, kuptimi semantik i tekstit arrin të realizohet:

„Te një mriz, te një lejthí  
Kishin ndollun<sup>mese e kr.</sup> tre barí  
Dy me dhën e një me dhí,  
N jâni plak e dy te rí:

Marash Uci e t’bijt e Calit :

„Auf dem fchatt’gen Ruhenplätzchen,  
Unter einer Hafelstaude,  
Trafen<sup>Prät.</sup> sich der Hirten dreie.  
Einer war<sup>Prät.</sup> ein Ziegenhirte,

Zwei der Schafe treue Hüter;

Dy ðjelm t'letë si shpezt e malit. ”

Alt an Jahren war<sup>Prät.</sup> der eine,  
Jung jedoch die beiden andern.  
Einer hieß<sup>Prät.</sup> Marafh, des Uc Sohn,  
Calis Söhne die zwei Jungen, ”

Një mënyrë e tillë e realizimit të tekstit narrativ përmes foljeve në kohën e pakryer dhe më se të kryer është e pranishme jo vetëm në paragrafët që po i shqyrtojmë, por në tërë tekstin e këngës, madje edhe në poemat e tjera të Lahutës. Mënyra e tillë e ndërtimit të tekstit narrativ, ku nuk shprehet folja në çdo varg, por nënkuptohet, është karakteristike për poezinë rrëfimore.

Përveç formave të shtjelluara të foljes në mënyrën dëftore, për të cilat u fol më lart, rëndësi në ndërtimin e tekstit kanë dhe format e pashtjelluara të saj, meqë gjuha e Lahutës është e dialektit gegë dhe shquhet për përdorim të dendur të formave infinite të foljes. Mirëpo, për këtë çështje do të flitet në mënyrë të veçantë në vazhdim të punimit.

Po të shqyrtohet realizimi i marrëdhënieve kohore mes fjalisë kryesore dhe fjalive të varura, në tekstin narrativ në fjalë, mund të hetohet se marrëdhënie kohore njëkohëshmërie paraqesin këto fjali:

„Marash Uci i Uc Mehmetit

Anë e m'ânë i kishit'rá<sup>më se e kr.</sup> ðetit

Kishte pá<sup>më se e kr.</sup> pronet e Mbretit ”

„Marash Uci, Sohn des Uc, der

Selber des Mehmeti Sohn war<sup>Prät.</sup>,

hatt'weithin das Meer befahren<sup>Plusquam.</sup>,

Alles Land geschaut des Sultans ”

„Burrë i fortë e trim si Zâna  
Armët i kjenë<sup>e pak.</sup> ktij baba e nâna:  
Babë tagani e nanë breshâna,  
Vllâ e motër dý pistolet  
Dý gjarpnusha prej Stambollet”.

„Tapf’rer Mann, Held wie die Zâna!  
Seine Waffen war’n <sup>Prät.</sup> ihm teuer,  
Juft wie Vater und lieb Mutter.  
Vater war <sup>Prät.</sup> der Jatagan ihm,  
Doch die Mutter die Breshana,  
Das Gewehr aus der Stadt Brescia.  
Bruder, Schwester, zwei Piftolen,  
Schlangengriff’ge aus Istanbul.”

„Prore Mashi ðjemve t’Hotit  
U kallzote<sup>e pak.</sup> punët e motit,  
Punët e motit, punë trimnije:  
Si Shqyptari mbas lirije  
Ë mbas besës e s’bardhës Fé  
bâte<sup>e pak.</sup> deken si me le”

„ Gerne pflegte <sup>Prät.</sup> zu erzählen  
Mashi alte Heldentaten,  
Hotis Jugend, Heldentaten,  
Wie Vorzeiten sie gebräuchlich.  
Wie für seinen heil’ gen Glauben  
Der Albaner ging <sup>Prät.</sup> zu sterben,  
Nicht wie wenn der Tod bevorstünd <sup>Prät.</sup>”

Lamerci tekstin e paragrafëve të shkëputur nga kënga „Marash Uci” e ka bartur në gjermanisht përmes kohëve të foljeve që janë karakteristike për tekstin narrativ, të cilat për realizimin e tekstit i ka përdorur shpesh si mundësi për bartjen e kuptimit të tekstit te receptuesi apo marrësi. Këta elementë kohezivë të organizimit të tekstit narrativ të këtij shembulli, të cilin jemi duke e trajtuar janë: trafen sich, war, war, hieß, war, hatt’ ... befahren, hatt’ ... gesachaut, war, diene, war’n, war, fand, ließ sich .. finden, verließ,

entlud, war'n, pflegte, ging, bevorstünd, erzählte, konnte, liebten. Kurse, si forma jonarrative, që poashtu kanë rëndësi në ndërtimin e tekstit në fjalë dalin: bäckt, ist, ist.

Fjali që paraqesin marrëdhënie njëkohëshmërie në tekstin gjermanisht janë :

„Marash Uci, Sohn des Uc, der Selber des Mehmeti Sohn war Prät., hatt' weithin das Meer befahren Plusquam. Alles Land geschaut des Sultans“  
„Marash Uci i Uc Mehmetit Anë e m'ânë i kishit'rá<sub>më se e kr.</sub> ðetit Kishte pá<sub>më se e kr.</sub> pronet e Mbretit”

„Der Albaner ging Prät. zu sterben, Nicht wie wenn der Tod bevorstünd Prät.; Nein, der Anfang neuen Lebens“  
„Si Shqyptari mbas lirijs E mbas besës e s'bardhës Fé bâte<sub>e pak.</sub> deken si me le”

Po të krahasohen dy tekstet, përkitazi me përdorimin e kohëve të regjistrit narrativ, mund të konstatohet se në tekstin në gjermanisht është shumë më i madh numri i kohëve narrative të përdorura se sa në tekstin shqip. Kështu, në gjuhën gjermane funksionin narrativ e realizojnë 21 folje në Präteritum dhe 5 folje në Plusquamperfekt, kurse në tekstin shqip atë e përbëjnë 9 folje në të pakryerën dhe 3 folje në kohën më se të kryer. Jashtë regjistrit narrativ numri i foljeve në Präsens në tekstin e përkthyer është i kufizuar, gjithsej janë 3 folje, ndërsaq në tekstin origjinal janë 5 folje. Sa i përket raportit të njëkohëshmërisë mes dy teksteve, në dy fjali del i njëjtë. Do thënë se Lamberci në tekstin



e përkthyer në disa raste përdor fjali shtuese me karakter sqarues, të cilat nuk hasen në tekstin origjinal si:

„Selber des Mehmeti Sohn war Prät..“ „Marash Uci i Uc Mehmetit”

Kjo ndodh me qëllim që receptuesit të tekstit t’i bëhen sqarime për ta kuptuar sa më mirë tekstin dhe situatat e tekstit origjinal, të cilat Lamberci i jep përmes vargut të parimuar, meqë përkthimi i këtij teksti me rimë, siç është në origjinal, do të ishte një punë e vështirë, madje ndoshta edhe e pamundur.

**3.** Teksti i autorit Jakov Xoxa „Kurorat e Masar Begut” i shkëputur nga përmbledhja e tregimeve „Albanische Chrestomathie” i takon tipit të teksteve narrative, meqë format kohore të mënyrës dëftore të përdorura në tekstin në fjalë janë kryesisht të regjistrit narrativ. Format kohore narrative, gjegjësisht format e së pakryerës dhe të më se të kryerës, që e ndërtojnë narracionin e tekstit origjinal janë: ndillte, kishte, vriste, ishte, kishin dalë, kishin thënë. Këto forma kohore narrative të mënyrës dëftore në tekstin e përkthyer nga Lamberci shfaqen në Präteritum dhe Plusquamperfekt (lockte, hatte, war, hatte gesagt, hervorgekommen waren) :

„Ish, si te thuash një zakon, i cili ndillte<sub>e pak.</sub> mbaresi”

„Es war<sub>Prät.</sub> sozusagen ein Brauch der zur Übertreibung lockte<sub>Prät.</sub>”.

„Dhe kështu Masar Beu, si bej që ishte<sub>e pak.</sub>, vriste<sub>e pak.</sub> mendjen se si mund të pihet në dy sisa bashkë”.

„Und so plagte Prät. Masar Beg, als Beg, der er nun einmal war Prät., seinen Verstand mit der Frage, wie man den an zwei Brüsten gleichzeitig trinken könne”.

Edhe format kohore të më se të kryerës së dëftores së tekstit shqip në shumicën e rasteve janë shfaqur me Plusquamperfekt në tekstin në gjuhën gjermane:

„Edhe Aliu, djali i fundit xha Osmanit, të cilit i kishin dalë mëse e kr. edhe po i binin dhëmbët në konaket e beut, kishte kurora në kokë, bile tri:”

„Auch Ali, der letzte Sohn des Onkel Osman, dem die Zähne schon hervorgekommen waren Plusquam., und dem die ersten Zähne auch schon ausfielen ihm Palaste des Begs, der hatte auch Haarkränze auf dem Kopfe, ja sogar drei:”

Ndërkaq, format e aoristit, Lamberci i ka përkthyer me format e preteritit në gjuhën gjermane:

„Kur nisne t’i dersinin mustaqet, atij i erdhi aorist ner ment te pyesi dadon se kur do të bëhej Vali i dy krahinave, ashtu siç i kishte thënë mëse e kr. ajo që ne vogeli.”

„Als der Schnurrbart ihm zu sprossen began, da kam Prät. es ihm in den Sinn, seine Kinderfrau zu fragen, wann er Vali der zwei Provinzen werden würde, so wie sie es ihm in seiner Kindheit gesagt hatte Plusquam.

Ndërkaq, format kohore të së kryerës së thjeshtë të dëftores së shqipes, në tekstin në gjermanisht janë paraqitur kryesisht në preterit (priti – empfang, përcolli – begleitete,

qëlloi – traf, kërkoi – wünschte). Nga kjo analizë, shihet se format kohore të së kryerës së thjeshtë të mënyrës dëftore të shqipes, në gjuhën gjermane dalin në preterit. Format kohore të së pakryerës së dëftores së shqipes në tekstin e analizuar janë dhënë poashtu në preterit. Dhe së fundi, format kohore të më se të kryerës së dëftores të tekstit të shqyrtuar të shqipes, në tekstin e përkthyer janë shfaqur në Plusquamperfekt.

#### ***5.4. Përdorimi i kohëve të mënyrës lidhore (Konjunktiv) në tekste***

Lidhorja (der Konjunktiv) në gjuhën gjermane ka një mënyrë tjetër formimi krahasuar me lidhoren e gjuhës shqipe . Me anë të kësaj mënyre shfaqen dëshirorja (Optativ):

„ Aman,falë i kojshim<sub>opt.</sub> Zotit” „Sei<sub>konj.I</sub> uns gnädig, Herr im Himmel!”

habitorja(Admirativ) dhe kushtorja (Konditional), të cilat nuk janë mënyra të mërfillta të foljes ashtu si në gjuhën shqipe. Gjatë hulumtimit në tekstet e analizuara nuk është gjetur ndonjë shembull që habitorja dhe kushtorja është shprehur me konjunktiv në tekstet e përkthyer. Megjithatë, edhe mënyra lidhore në gjuhën shqipe shfaq imperativitet, optativitet dhe admirativitet.

Mënyra lidhore ka një përdorim mjaft të gjerë në gjermanishten standarde. Veprimet që shprehen nga folja në mënyrën lidhore paraqesin veprim joreal (irreale Handlung) dhe potencial (potenziale Handlung). Fjala „Konjunktiv” vjen nga gjuha latine „conjungere”,në gjermanisht do të thotë „verbinden” dhe në shqipe „lidh”. Kjo shprehje latine ka një përmbajtje të gjerë kuptimore dhe paraqet të pavërtetën dhe të pamundurën si lidhëz, dëshirë, pasiguri, mundësi. Kjo shprehje, pra është më e pranueshme se

shprehja „formë mundësie” (Möglichkeitensform)<sup>208</sup>. Në gjermanishte janë dy forma kohore të lidhore, në bazë të të cilave del Konjunktiv I (lidhorja I) dhe Konjunktiv II (lidhorja II) si dhe ekziston edhe një tjetër formë e posaçme e ndërtimit të Konjunktivit, që njihet si „würde Form”<sup>209</sup>.

Konjunktiv I ndryshe njihet si Konjunktiv Präsens (lidhorja e së tashmes) dhe përdoret në ligjëratën e zhdrejtë (indirekte Rede). Konjunktiv Präsens është formë modale e folur dhe për këtë arsye është „Null Form” (formë boshe) e modalitetit. Lidhjet mes Konjunktivit në përgjithësi dhe Konjunktivit I në veçanti janë të ngushta, sepse Präsens Konjunktivi nuk mund të paraqitet si modus i pavarur, por është një lloj i posaçëm i lidhore me vlerë modale.<sup>210</sup>

„Mögen sie besungen werden” „N’ kângë e n’valle, por u knđojshin”

Konjunktiv Präteritum është modus që shpreh të pavërtetën në kuptim të gjerë. Me Konjunktiv II jepet një supozim i pasigurt, shpesh në formën e shkruar dhe shfaq dëshirë, përmbushja e së cilës është e pasigurt.<sup>211</sup>

Edhe mënyra lidhore në gjuhën shqipe paraqet shumëllojshmëri modalitetesh.<sup>212</sup> Me anë të lidhore shprehet imperativi, optativi, admisivi. Imperativi diferencohet sipas vetave gramatikore. Veta e dytë në njëjës dhe shumës shpreh urdhër të posaçëm, veta e parë në njëjës dhe shumës shpreh hortativitet (imperativ që shpreh veturdhër), me formën e vetës së tretë jepen urdhëra që i drejtohen një personi të caktuar apo të pacaktuar. Optativi eksklamativ paraqet një dëshirë, e cila përmes pjesmarrësit në aktin bisedimor nuk realizohet drejtpërdrejt. Lidhorja në disa fjali pyetëse realizohet si e koordinuar me dëshirën e bashkëbiseduesit. Pastaj, ekzistojnë dhe fjalitë pyetëse me komponente distributive. Në këto raste lidhorja përdoret pas elementit „sikur” . Edhe fjalitë pyetëse polemike që shprehin zemërim a protestë realizohen me anë të lidhore. Mënyra lidhore

<sup>208</sup> Jung,W., Grammatik der deutschen Sprache, Leipzig,1982, f. 266

<sup>209</sup> DUDEN, B.4, f.522-534

<sup>210</sup> Admoni,W., Der deutsche Sprachbau, Leningrad, 1960, f.181-182

<sup>211</sup> Jung,W., vepra e cit., f.228-229

<sup>212</sup> Gramatika e gjuhës shqipe 1, f.320-328

në gjuhën shqipe shfaqet edhe te fjalitë pyetëse me presumptivitet (kohë të tashme) si dhe te fjalitë koncesive me „sado që” dhe „sido që”, në fjalitë kohore, vendore, relative me përemrat lidhorë që, i cili, e cila, kush, ç’ dhe së fundi me fjalitë që dalin me formën „po” pas së cilës përdoret kjo mënyrë e foljes.<sup>213</sup> Pra, mënyra lidhore ka karakter polivalent si në gjermanishte ashtu edhe në shqipe, pasi që ajo ofron mundësi të krijojë lidhje a raporte edhe me mënyrat e tjera, ashtu që folësit i jepet mundësia që në mënyrë sa më të plotë dhe të drejtë të shprehë atë që mendon dhe ndien.

Meqenëse kuptimi dhe ndërtimi i mënyrës lidhore dhe i kohëve të saj u diskutua më lart, këtu do të hulumtohet funksioni i saj tekstdërtues në shembujt e teksteve që do të analizohen në vazhdim.

**4.** Teksti „I biri i mretit, e ama e puples eðe pelat k’uelane”, në të cilin do të përqendrohemi për ndriçimin e funksioneve tekstore të mënyrës lidhore, ka strukturë të tekstit narrativ. Fryma narrative e tij shprehet me format karakteristike kohore narrative, por që këtu nuk do të trajtohen. Mund të thuhet se kohët e shenjave verbale të mënyrës dëftore me funksion narrativ kanë shtrirje të gjerë në gjithë tekstin. Mirëpo, ndryshe qëndron puna e shenjave verbale të lidhores. Ato në këtë përrallë të mbledhur nga Lamberci, krahasuar me shenjat verbale të dëftores, dalin në mënyrë më të kufizuar, por që megjithatë kanë rëndësi të madhe tekstdërtuese. Në tekstin shqip janë këto forma të përdorura të lidhores: **të la, t nap, tē haš, tja huðiš, mund tē mē ðerin, ti hūpi, ta gezdis, ti müfi, tē veši, tē perdridhen, tē mi kapiš, ta mař, ta mariš, mos ta mariš, ta diš, ta šofiš, ta g’ei, t g’et, ta g’ei, ta g’ei, t i müfi, tē du, ta pruna, ta diš, tē šofiš, tē g’eti, ta ket, tē jan, tē kemi, tē pakohemi, t na duš, tē g’indemi, tē pakohemi, t na duš, tē g’indemi, deš ta maři, tē iki, po t jap, tē vini, tē dajn, po tē n’afiš, due tē me n’atni, ti g’ej, ta pruna, ti hingli, t erð, le ti miei, ti mieiš, t i miei, mos tē luani, t i miei, ta ziej, tē hūj, ti hūpe, tē vijm, tē baheš.** Të gjitha këto folje të përdorura në tekstin shqip i

<sup>213</sup> Buchholz, O., Fiedler, W., vepra e cit., f. 134-135,

takojnë kohës së tashme të mënyrës lidhore. Në fillim të tekstit është e pranishme folja „te la”, e cila përdoret në fjalinë e varur, dhe ka vlerë kushtore. Dhënësi apo dërguesi i tekstit përmes së tashmes së lidhore, e cila duke u ndërlidhur dhe me shenjat e tjera tekstformuese shpreh veprim të kushtëzuar, i cili receptohet si i dëshirueshëm dhe i mundshëm. Në fjalitë pasuese të tekstit hasen format e lidhore „t nap” „ te haš” „tja huđiš”, ku folja në mënyrën lidhore e fjalisë së parë semantikisht paraqet ngjyrimë kushtore në raport me fjalinë pasuese. Foljet në lidhore të fjalisë pasuese kanë vlerën e urdhërores. Ndërkaq, nëse u çasemi përbërësve informativë të këtyre fjalive mund të konstatohet se këto fjali hyjnë në tipin e progresionit me kapërcim tematik (die Progression mit einer thematischen Sprung):

„Ište i mret (T<sub>1</sub>), k’i nuk kište femi (R<sub>1</sub>).

Femi (T<sub>2</sub>=R<sub>1</sub>) nuk kam (R<sub>2</sub>). N fron (T<sub>4</sub>) t mretit nuk kam, tsilin te la (R<sub>4</sub>)”

„Es war einmal ein König (T<sub>1</sub>), der keine Kinder hatte (R<sub>1</sub>).

Weil ich keine Kinder (T<sub>2</sub>) habe (R<sub>2</sub>).

Niemanden habe, den ich auf dem Königsthorn (T<sub>4</sub>) zurücklassen kann (R<sub>4</sub>)”

Duke u mbështetur në progresionin tematik mund të konstatohet se edhe rendi i fjalive i shembullit më poshtë shfaq tip të progresionit tematik me një remë të zbërthyer (Progression eines gespalteten Rhemas), sepse në to rema e fjalisë së parë zbërthehet në disa tema duke sajuar rematizim të zbërthyer:

„Un po tnap n’i kok’ e moł (R<sub>1</sub>) ! Mołen (T<sub>2</sub>=R<sub>1</sub>) te haš vet (R<sub>2</sub>). Eđe lekuret (T<sub>3</sub>=R<sub>1</sub>) tja huđiš pełes (R<sub>3</sub>) !”

„Ich will dir einen Apfel ( $R_1$ ) geben!

Den Apfel ( $T_1=R_1$ ) musst du selbst essen ( $R_2$ )!

Die Schale ( $R_3$ ) wirf der Stute vor!”

Në fjalinë e radhës në tekst, folja në kohën e tashme të lidhores paraqet mundësi veprimi, e cila duke u lidhur me fjalinë e varur del me nuanca ose ngjyrimë kuptimore kushtore:

„Mun të më ðerin, po  $\Theta$ ui babes keštu,... ”

Ndërkaq, në fjalinë e dytë të varur përmes dy shenjave të lidhores realizohet semantikisht urdhër, prandaj fjalia është me vlerë urdhërore.

„Ti hüpi n i her mazit eðe ta g'ezdis npër fuš”

Dhe në fjalitë e tjera në vazhdim prania e dy foljeve në kohën e tashme të lidhores, poashtu është me vlerë të urdhërores:

„Ti müfi gi $\Theta$  düert, k'i hiki una! Eðe të veši robet e sünetl' ugut!”

Në mbështetje të analizave të paragrafëve vijues të tërësisë së tekstit shqip hetohen dhe fjali të ndërtuara me lidhore që kanë ngjyrimë kuptimore shkakore, qëllimore dhe urdhërore:

„Po zihemi šok me šok, k’i të pakohe mi,…” (kuptim shkakor);

„Hün ti n k’umšit, të baheš ma i bukur, o mret!” (kuptim qëllimor);

„Ato tri k’ime, k’i t’ë perdriden mu, të mi kapiš edhe mos keš frik!” (kuptim urdhëror)

Shenjat verbale të mënyrës lidhore, të cilat shprehin veprim të mundshëm apo të dëshirueshëm me ngjyrimë ose me vlera kushtore dhe urdhërore në tekstin e analizuar, së bashku me shenjat e tjera kohezive të tekstit, verbale dhe joverbale, bëjnë lidhjen e fuqishme mes njësive të tekstit, fjalive dhe paragrafëve.

Në këtë shembull të tekstit, që Lamerci e ka përkthyer në gjermanisht, foljet në lidhore, si shenja kohezive të tekstit, nuk janë identike me ato të lidhore të shqipes. Megjithatë, mund të thuhet se është përcjellë te receptuesi i tekstit kuptimi semantik i tij edhe pse realizohet me shenja kohezive të tjera (... zurücklassen kann, ... will... geben, ... muß ... essen, ... wirf ... vor, ... will ... besteigen, ... will ... spazieren reiten, schließe ..., ... will ... anziehen, ... sich mir locken, ... reiß ..., soll ... nehmen, ... sollest wissen, ... sollest ... sehen, ... kann ... finden, ... wird ... finden, ... soll ... finden, ... kann ... finden, ..soll ... machen, sich von selber schließt, ... soll ... geben, ... willst du mich für sich selbst ..., ... habe ... gebracht, wenn ... kennen lernen, ... bekommen könntest, ... gefunden hat, ... soll... enthalten ..., ... gleichsehn müssen, ...habe ... gebracht, ...wiehere, ... kommen sie, ... haben ..., ... wir weniger werden ..., ... uns brauchst ..., ... sind wir dir zur Stelle, ... uns zu vermindern, ... du uns brauchst, ... wir befinden uns zur Stelle, ... wollte ... mitnehmen, ... um fortzufahren, ... gebe dir ..., ... sollen kommen, ... sollen ...schneiden, ... du machst ..., ... wünsche, ... mir ... macht, ... ich verschaffe ..., ... habe ...gebracht, ... wiehere ....., ... da kommen sie ...,



laß jenen Knaben ..., ... sie melken, ... muß ... melken, ... ich euch melke, rührt euch nicht ..., ... euch melkt ..., ... soll...sieden ..., ... soll ... hineinsteigen, ... besteige mich ..., ... wollen ... herumreiten..., ... du schöner wirst. Po të shihet veç e veç secila nga këto shenja të përdorura në gjuhën gjermane, mund të vërtetohet se foljet e lidhore së shqipes në kohën e tashme, Lamberci në shumicën e rasteve i ka dhënë me mundësitë shprehëse të së tashmes së dëftores së foljeve modale:

„Ich, erwidert er, bin in Gedanken, weil ich keine Kinder habe, und niemanden habe, den ich auf dem Königshorn zurücklassen kann”,

Siç shihet, shenja verbale „zurücklassen kann” në këtë fjali shpreh mundësi të veprimit;

„Ich will dir einen Apfel geben!”

„Ich will einmal das Füllen besteigen und wie über die Wiese spazieren reiten”.

Und ich will die Kleider der Beschneidungsfeier anziehen!”

Në këto fjali është përdorur folja „will”, e cila realizon ngjyrimë apo vlera të dëshirës;

Lidhëria e shqipes më tutje në tekstin e përkthyer paraqet domosdoshmëri në fjalinë e parë të radhës, sepse folja „ muß” në këtë rast shpreh veprim të detyrueshëm nga folësi, ndërkaq dy fjalitë e tjera janë dhënë me foljen në mënyrën urdhërore, me të cilat dhënësi jep urdhër:

„ ... den Apfel mußst du selbst essen und ... “

„ ... und Schale wirf der Stute vor !”

„ Schließe alle Türen zu, ...”

Në bazë të këtyre vështrimeve mund të konstatohet se mënyra lidhore e përdorur në tekstin origjinal shfaqet gjithsej në 57 raste. Ndërsa, në tekstin e përkthyer atë mund ta gjejmë në 23 raste të dhëna në kohën e tashme të mënyrës dëftore (Präsens – Indikativ), në 3 raste në kohën e kryer të dëftores (Perfekt – Indikativ) dhe vetëm në 1 rast në kohën e ardhme të dëftores (Futur – Indikativ). Mirëpo, me një numër mjaft të madh, lidhorja e shqipes del në tekstin gjermanisht dhe me folje modale të kohës së tashme të mënyrës dëftore (Präsens – Indikativ), do të thotë gjithsej në 22 raste dhe vetëm në një rast në kohën e pakryer të mënyrës dëftore (Präteritum – Indikativ).

Lidhorja e shqipes shfaqet vetëm 3 herë me lidhore në tekstin e përkthyer; në mënyrën urdhërore 3 herë dhe me forma infinite, lidhorja e shqipes del 2 herë në tekstin e përkthyer.

Pra, siç shihet në bazë të analizave të tekstit origjinal dhe të tekstit të përkthyer, mund të përfundohet se në gjuhën shqipe, dhënësi i dërgon marrësit veprime të mundshme dhe të detyrueshme, të cilat shprehin urdhër, qëllim, shkak, kusht. Ky mesazh i tekstit i shprehur si urdhër, qëllim, shkak dhe kusht kryesisht bartet edhe në tekstin gjermanisht. Mirëpo, përderisa në tekstin shqip shenjat kohezive verbale që realizojnë këtë mesazh shprehen krejtësisht përmes lidhore; ato në gjuhën gjermane paraqiten me forma verbale të përziera si me : të tashmen, të kryerën dhe të ardhmen e dëftores; të tashmen dhe të pakryerën e foljeve modale të dëftores, me lidhore, me urdhërore dhe me forma infinite të foljeve. Edhe pse lidhoren e shqipes Lamberci e ka përkthyer me forma të përziera verbale në gjermanisht, koherenca e tërësisë së këtij teksti e ndërtuar edhe nga shenjat e tjera tekstore, duket të jetë arritur përafërsisht si në gjuhën shqipe.

5. Shenjat verbale kohezive të mënyrës lidhore si shenja tekstformuese shfaqen dhe në tekstin e përrallës, nga Dibra „Tsätsisl’ämi, tši u mbait n gröš” të cilin Lamberci e ka përkthyer në gjermanisht. Në tekstin e përmendur, përdorimi i shenjave verbale në lidhore është më i kufizuar krahasuar me shenjat verbale të mënyrave të tjera, si p.sh shenjat verbale në mënyrën dëftore janë shumë më të përdorura në tekst. Megjithatë, lidhorja paraqet një rëndësi të posaçme për tekstin, sepse përmes saj realizohen situata të ndryshme në të. Shenjat verbale të mënyrës lidhore në këtë tekst në tri raste dalin me kuptimin e urdhërores:

„T na hjekš buken ene t na ziš gröšen e t na böš punt!”

„Back uns das Brot und koche uns die Fisolen und mache uns die Arbeiten!”

Po të krahasohen këto shenja verbale të lidhores së shqipes me tekstin e përkthyer, del se ato edhe në shqipe edhe në gjuhën gjermane kanë vlerën e urdhërores dhe shprehin urdhër të prerë. Kurse, në fjalitë më poshtë shenjat tekstore verbale të lidhores shprehin modalitetin e mundësisë:

„Ene ájo tsätsisl’ämi tjek buken ene zin gröšen ene mer ni sahan ene mer ni lug ene buk ene škon t tšese gröš, e bije n vörb e mbaitet.”

„Tsäts. bäckt das Brot und kocht die Fisolen und nimmt eine Schlüssel und nimmt einen Löffel und Brot und geht, um Fisolen zu löffeln und er fällt in den Topf und ertrinkt.”

„Škon l’epri, t haje döárða,”

„Da kommt der Hase, um Birnen zu essen”

„ Škon n kröue lépri, t paje ui,”

„Da kommt der Hase an die Quelle um Wasser zu trinken”

Shenjat verbale të lidhore në tekstin origjinal, të cilat shprehin modalitetin e mundësisë, në tekstin e përkthyer nga Lamberci janë dhënë me infinitiv me parafjalën „zu”.

Nga e gjithë kjo që u tha më lart, shihet se shenjat verbale të lidhore, të përdorura në këtë tekst të dialektit gegë të shqipes, kur kanë vlerën e urdhërores, në tekstin e përkthyer dalin në urdhërore (Imperativ). Ndërkaq, kur shprehin modalitet mundësie me anë të këtyre shenjeve verbale në shqipe, në gjermanisht jepen me infinitiv me „zu”.

### 5.5. Mënyra urdhërore e foljeve në tekste (Imperativ)

Mënyra urdhërore në gjuhën shqipe dhe në gjuhën gjermane është mënyrë e mirfilltë e foljes, sepse ka format e veta gramatikore, të cilat dalin në dy veta, njëjës dhe shumës, në kohën e tashme (Präsens). Kjo mënyrë e foljes në të dy gjuhët ka spektër të gjerë funksionesh<sup>214</sup>, të cilat komunikantëve u japin mundësi komunikimi.

Gjatë analizave të mësipërme të teksteve shqipe të përkthyer në gjermanisht, vërehet se folja në mënyrën dëftore dhe lidhore në ndërtimin e teksteve ka përdorim të shpeshtë. Që në fillim mund të supozohet se përdorimi i mënyrës urdhërore në tekstet që do të shqyrtohen mund të jetë më i kufizuar. Mirëpo, mënyra urdhërore edhe pse është më e thjeshtë në pikëpamje të formave gramatikore përkatëse dhe ka përdorim më të kufizuar, kuptimet modale të saj, siç do të shihet gjatë analizave, e begatojnë tekstin.

6. Në poemën „Deka” të „Lahutës së Malcis” të Gjergj Fishtës, e cila paraqet një tërësi të plotë kuptimore, do të shqyrtohen kuptimet modale dhe format gramatikore të urdhërores, të cilat krahas shenjave të tjera tekstore kanë rëndësi në ndërtimin e pjesëve dhe tërësisë së tekstit. Duke hulumtuar kuptimet modale të mënyrës urdhërore në tekste del se kjo mënyrë kryesisht shpreh modalitetin e dëshirës. Modaliteti i dëshirës, i shprehur përmes formave gramatikore të urdhërores në këtë tekst realizohet në formë urdhëri apo kërkesë në vetën e dytë të njëjësit, vetë kjo që është karakteristike për këtë mënyrë të foljeve. Në tekstin në fjalë, me anë të vetës së dytë të njëjësit të mënyrës urdhërore, modaliteti i dëshirës në formë të urdhërit del në këto fjali:

„Kqyre at shpatull, Soko Tona”,

„Hier !Sieh’ an den Schulterknochen,

<sup>214</sup> Buchholz, O., Fiedler, W., vepra e cit., f.149

	Soko Tona, und erklär'uns,"
„Merr, Kaçel, njihërë lahutën ”,	„Nimm, Kaçel einmal die Laute!"
„Nðiej, ti or Gjergj Elez Ali ”,	„Hör', du Gjergj Elez Alija!"
„Mêrr Vuksanin e Sinanin ”,	„Nimm den Vuksan und dem Sinan",
„Eðe mêrr Kerrn Zagorjanin ”	„Und nimm Kerrni von Zagorje",
„Shkomi Osos tash te kryet”	„Tritt mir jetzt Oso zu Häupten”

Kurse, në shembujt e fjalive të shkëputura nga poema „Deka” të „Lahutës së Malcis” të Gjergj Fishtës, modaliteti i dëshirës del me nuanca grishjeje, këshille, porosie, lejimi, lutjeje, nxitjeje në fjalitë:

„Eni, e shifni, oj nâna t'shkreta”,	„Kommt und seht doch, arme Mütter!"
„Eni, e shifni' i herë n'at vá”	„Kommt und seht einmal zür Flußfuhr!"
„Eni, eni mori Shkina”,	„Kommt nur, kommt nur, Slawenmütter!"
„Eni, eni te Vranina”,	„Kommt nur, kommt nur nach Vranina!"
„Mbliðni vetë ndër shpat e prrue”	„Sammelt selbst am Hang, im Wildbach”
„Eðe msonj fmin mbas sodit”	„Daß sie nicht mehr gieren mögen
„Mos t'lakmojn toks s'Kastriotit”	nach dem Lande Kastriotis
„E t'a marrin vesh shyptarët”	„Mögen's die Shqiptaren hören!"
„Po, le ðesin –s'kan shka presin”	„Mögen sie denn sterben! Laß sie!"

„Kjani, kjani oj Zâna, kjani”                      „Weinet, weinet, Zânen weinet!”

„Kjani e lot mos i pushoni”                      „Weinet, laß die Tränen fließen!”

Do shtuar se kuptimi i modalitetit të dëshirës që jepet në formë urdhëri, kërkesë, lutjeje, këshille, grishjeje, lejimi, porosie, nxitjeje etj., në fjalitë e shkëputura hetohet në mënyrë të plotë vetëm nëse kemi parasysh kontekstin, në të cilin janë përdorur fjalitë në kuadër të tërësisë së tekstit.

Në tekstin e diskutuar të kësaj poeme, dhënësi, urdhëroren me modalitet dëshire ia transmeton bashkëbiseduesit apo marrësit në shumicën e rasteve në vetën e dytë njëjës dhe shumës. Në komunikimin marrës-dhënës të këtij teksti në dy fjali dhënësi dëshiron të urdhërojë disa persona të tjerë, të cilët nuk marrin pjesë në këtë bisedë, me ç’rast folja jepet në vetën e tretë të shumësit në mënyrën lidhore:

„Mos t’lakmojn tokës s’Kastriotit”                      „Daß fie nicht mehr gieren mögen  
Nach dem LandeRaftriotis!”

„Po, le dësin – s’kan shka presin”                      „Mögen sie denn sterben! Laß sie!”

Shenjat verbale të mënyrës urdhërore të tekstit shqip, në gjermanisht dalin pothuaj njësoj si në gjuhën shqipe. Numri më i madh i rasteve të urdhërores të përdorura në gjermanisht jepet me urdhërore, kurse dy raste shprehen me folje modale të dëftores dhe tri të tjera me folje modale të lidhores:

„Sollst mich segnen liebe Mutter!”                      „Halláll, nânë, ti me m’a bâ”

„Darfst, mich Trännen um mich weinen!”                      „Lot per mue ti mos me derdhun!”

„Mögen’s die Shqiptaren hören!”                      „Ë t’a marrin vesh shyptarët”

„Mögen sie denn sterben! Laß sie!“ „Po, le ðesin –s’kan shka presin”  
 „Daß sie nicht mehr gieren mögen , „Mos t’lakmojn tokës s’Kastriotit”  
 nach dem Lande Kastriotis!”

Mirëpo, edhe pse për nga forma këto shenja verbale të tekstit në gjuhën gjermane janë të mënyrës dëftore (në dy fjalitë e para) dhe të mënyrës lidhore (në tri fjalitë pasuese), ato bartin te receptuesi vlera kuptimore të urdhërit në formë këshille, lejimi dhe porosie.

Ndërkaq, modaliteti i dëshirës në formë urdhëri të prerë apo të rreptë, i cili është spikatur edhe në tekstin shqip, shfaqet në këto fjali të tekstit të përkthyer:

„hier! Sieh’an den Schulterknochen, Soko Tona” „Kqyre at shpatull, Soko Tona”,  
 „Nimm Kaçel einmal die Laute!” „Merr, Kaçel, njëherë lahutën”  
 „Hör’, du Gjergj Elez Alija!” „Nðiej, ti or Gjergj Elez Ali”  
 „Nimm den Vuksan und dem Sinan”, „Mërr Vuksanin e Sinanin”  
 „Und nimm Kerrni von Zagorje”, „Eðe mërr Kerrn Zagorjanin”  
 „Tritt mir jetzt Oso zu Häupten”, „Shkomi Osos tash te kryet”

Urdhërorja e fjalive të tekstit origjinal apo të tekstit në gjuhën shqipe, në gjermanisht është dhënë me urdhërore që shpreh modalitet dëshire me nuanca thirrjeje dhe nxitjeje në këto raste:



„Kommt und seht doch, arme Mütter!“	„Eni, e shifni, oj nâna t’shkreta ”
„Kommt und seht einmal zur Flußfuhr!“	„Eni, e shifni’ i herë n’at vá ”
„Weinet, weinet, Zânen weinet!“	„Kjani, kjani oj Zâna, kjani”
„Weinet, laß die Tränen fließen!“	„Kjani e lot mos i pushoni”
„Mögen’s die Shqiptaren hören!“	„Ë t’a marrin vesh shyptarët”
„Mögen sie den sterben! Laß sie!	„Po, le ðesin –s’kan shka presin”
„Kommt nur, kommt nur, Slawenmütter!“	„Eni, eni mori Shkina”
„Kommt nur, kommt nur nach Vranina!”	„Eni, eni te Vranina”
„Sammelt selbst am Hang, im Wildbach“	„Mbliðni vetë ndër shpat e prrue”

Dhe së fundi, në tekstin e përkthyer në gjuhën gjermane, urdhërorja shpreh modalitet dëshire si këshillë dhe porosi në katër fjali:

„Darfst nicht Tränen um mich weinen!“	„Lot per mue ti mos me derdhun!”
„Frücht’ dich nicht, du Sohn des Hengstes!“	„Mos u tut, bre zogu i atit”
„Daß sie nicht mehr gieren mögen, nach dem Lande Kastriotis!”	„Ëðe msonje tash. fmin mbas sodit Mos t’lakmojne tash. toks s’Kastriotit “

Edhe pse në rastet e diskutuara më lart, urdhërorja si rregull shprehet me vetën e dytë dhe të tretë të njëjësit dhe të shumësit si në tekstin origjinal ashtu edhe në tekstin e përkthyer; në dy fjali të tekstit, dhënësi u drejtohet bashkëbiseduesve, të cilët nuk marrin pjesë në bisedë, në vetën e tretë të shumësit të mënyrës lidhore:

„Mögen’s die Shqiptaren hören!“                      „Ë t’a marrin vesh shyptarët“  
„Daß sie nicht mehr gieren mögen,                      „Mos t’lakmojn tokës s’Kastriotit“  
nach dem Lande Kastriotis!“

Natyrisht, siç është theksuar dhe më parë gjatë analizës së tekstit shqip, format e ndryshme të modalitetit të dëshirës, të shprehura përmes urdhërores si këshillë, urdhër, kërkesë, lutje, grishje, porosi, nxitje etj., mund të konstatohen dhe në gjermanisht vetëm nëse kemi parasysh rrjedhën e këtyre fjalive në kontekst.

7. Përdorimin e formave të urdhërores në tekstet shqipe të Lambercit të përkthyer në gjermanisht, përveç në poemën „Deka“ të „Lahutës së Malcis“ do ta shtrimë dhe në përrallën „M tšo e m bir prep!“ të marrë nga koleksioni i përrallave „Albanische Märchen“.

Pa u ndalur në regjistrin narrativ të shenjave verbale, që dominon në strukturën narrative të këtij teksti, siç është thënë më parë, shenjat verbale të mënyrës urdhërore në këtë tekst, si përgjithësisht në tekstet narrative, përdoren në mënyrë shumë më të kufizuar. Modaliteti i dëshirës, që përbën esencën e strukturës së fjalive urdhërore, në tekstin shqip të përrallës shprehet në 12 raste. Mund të konstatohet se po e njëjta gjendje e përdorimit të urdhërores shfaqet dhe në tekstin e përkthyer në gjermanisht.

Në këtë tekst bien në sy përsëritjet e formave të urdhërores, të cilat shtrihen jo vetëm brenda fjalisë, por në gjithë tekstin, meqë në të vazhdimisht riafirmohet dhe pohohet qëndrimi i folësit. Format e tilla të përsëritjes së urdhërores në tekst, në fakt paraqesin rekurrencën si element i kohezionit të tekstit<sup>215</sup>, i cili ndihmon që të arrihet koherenca e këtij teksti. Kështu, urdhërorja në zhvillimin e ngjarjeve dhe situatave në tekst, në fjali dhe në paragrafët e tij në funksion të rekurrencës është e pranishme në këto raste:

„m tšo e m bir prep” - „trag mich fort und bring mich wieder”

„m tšo” - „trag mich fort”

„ško e mefja” - „geh und zapfe ...ab”

„ško eđe mefi” - „geh und zapfe ...ab”

„m tšo e m bir prep” - „trag mich fort und bring mich wieder”

„m tšo e m bir” - „trag mich fort und bring mich”

Përdorimi i urdhërores në strukturën e tekstit „M tšo e m bir prep!” të marrë nga përmbledhja e përrallave të Lambercit, si në gjuhën shqipe ashtu edhe në gjermanisht shpreh modalitet dëshire, por vetëm në formë urdhëri, për dallim nga shprehja e modalitetit të dëshirës në poemën „Deka”, e cila ishte e pasur me nuanca të shumta kuptimore të dëshirës të dhëna me mënyrën urdhërore.

---

<sup>215</sup> Shih Beaugrande/Dressler, vepra e cit., f.51

8. Mënyra urdhërore e shenjave tekstore, si shenja të rëndësishme në realizimin e kohezionit dhe koherencës tekstore, është hulumtuar dhe në tekstin „Në Parkun e Lirisë” të përkthyer nga Lamerci në gjuhën gjermane. Në këtë tekst vlerat kuptimore të mënyrës urdhërore, ashtu si në tekstet më lart ku është analizuar mënyra urdhërore e shenjave verbale, shpreh urdhër të rreptë, modalitet dëshire dhe vlera kuptimore në formë lutje. Si urdhër i rreptë, urdhërorja del në këto fjali:

„Bjer parate, ja po me mire, thuajme ta çit qe nashti shkresen.”

„Bring das Geld, oder noch besser, sage mir, daß ich jetzt das Schriftstück zerreiße”.

„Bjere ketu - tha kryeplaku, nje mesoburre, po i zbardhur fare nga lesherat.”

„Leg es hierher! sagte der Dorfversteher, ein Mann in mittleren Jahren, aber schon ganz weißhaarig”.

Në të tri rastet (bjer – bring, thuajme – sage, bjere – leg), shenjat verbale të urdhërores dalin, pra, me vlerë kuptimore të një urdhëri të prerë në tekstin shqip dhe në tekstin në gjuhën gjermane. Ndërkaq, në rastin:

„T’a marre djalli punen me popull”

„Der Teufel soll diese Arbeit mit dem Volke holen!”

mënyra urdhërore në fjalinë e tekstit origjinal realizohet me lidhore dhe shpreh modalitet dëshire në formë mallkimi. Fjalja e përkthyer është e ndërtuar në mënyrën dëftore me ndihmën e foljes modale „sollen” dhe infinitivin e foljes „holen”. Dhe së fundi fjalja:

„Nemi nashti ato te shkreta; pese frenga jane.”

„Gib mir jetzt als armselige Geld: fünf Frangen sind es”

del me vlera kuptimore në formë lutjeje që shfaq urdhërorja si në shqipe ashtu edhe në gjermanishte.

Në mbështetje të hulumtimit të funksioneve kuptimore dhe të përdorimit të mënyrës urdhërore në tekstet e analizuara në vargje dhe në prozë në të dy gjuhët, rezulton se në realizimin e kohezionit dhe koherencës së këtyre teksteve edhe mënyra urdhërore, krahas shenjave tjera tekstdërtuese, ka rëndësinë e vet. Nga analizat e bëra në të dy tekstet në plan kontrastiv del se mënyra urdhërore e shqipes në shumicën e rasteve shfaqet njësoj në tekstet e përkthyer, do të thotë se Lamberci urdhëroren e shqipes e ka përkthyer me urdhërore të gjermanishtes. Kështu, urdhërorja e shqipes në tekstin e përkthyer është dhënë me urdhërore 38 herë, me dëftore 2 herë dhe në 3 raste të tjera, urdhërorja në formën e lidhore përcillet me lidhore dhe në gjermanisht. Edhe në bartjen e funksioneve kuptimore të urdhërores nga shqipja në gjermanisht, Lamberci përpiket të jetë konsekuent, meqë modaliteti i dëshirës përmes urdhërores shfaqet në të dy gjuhët si urdhër i prerë, por dhe si urdhër me nuanca kuptimore të dëshirës (këshillë, kërkesë, grishje, nxitje, lutje, lejim etj.).

Përdorimi i urdhërores në funksion të rekurrencës si riafirmim i qendrimit të folësit është dhënë në të dy tekstet. Në tekstin në vargje përsëritja e formave foljore të mënyrës urdhërore shtrihet brenda fjalisë, gjegjësisht vargut, kurse në tekstin në prozë përsëritja e formave verbale urdhërore ka shtrirje në gjithë tekstin.

Urdhërorja, duke qenë formë foljore që shpreh modalitet me nuanca dëshire, ka fuqi shprehëse dhe funksion të theksuar emocional. Prandaj, në tekstet letrare, siç janë dhe dy tekstet e analizuara, vlera emocionuese e urdhërores që shpreh qëndrimin e folësit e shton peshën stilistike të këtyre teksteve.

### **5.6. Përdorimi dhe kuptimi i mënyrës dëshirore në tekste (Optativ)**

Mënyra dëshirore dhe mënyra urdhërore në pikëpamje të modalitetit afrohen me njëra tjetrën, sepse që të dyja shprehin dëshirë. Dëshirorja shpreh dëshirën e folësit si urim apo mallkim, kurse mënyra urdhërore modalitetin e dëshirës e shpreh në formë urdhëri apo kërkesë.<sup>216</sup>

Derisa mënyra dëshirore në gjuhën shqipe del me format e veta gramatikore në kohën e tashme dhe në kohën e kryer, në gjuhën gjermane nuk ka forma të mirëfillta gramatikore të mënyrës dëshirore. Me gjithë mungesën e formave të mirëfillta, optativi në gjuhën gjermane ndërtohet nga mënyra lidhore indirekte (Konjunktiv Indirektiv) dhe me komponente modale të lidhore (Modalkomponente).<sup>217</sup>

Mënyra dëshirore, qoftë e mërfilltë, qoftë e shprehur me elemente të tjera gjuhësore, është kategori gramatikore me rëndësi të posaçme në çdo gjuhë. Duke shprehur thënie, me të cilat shfaqen ndjenjat e folësit në formë urimi a mallkimi, dëshirorja ka funksion stilistik sidomos në krijimtarinë letrare. Meqenëse dëshirorja e shqipes ka karakter sintetik, gjuha gjermane këtu dallon hetueshëm me shqipen, sepse i mungon optativi i sintetizuar. Nga ana tjetër, nuk mund të thuhet se gjermanishtfolësve u mungojnë format gramatikore për të shprehur dëshirë. Në gjermanishte ekziston fjalia dëshirore ( Wunschsatz), e cila jepet me format e mënyrës lidhore ( Konjunktiv).

**9.** Që të shihen pak a shumë dallimet dhe ngjashmëritë mes optativit të shqipes dhe fjalisë dëshirore të gjermanishtes jam përqendruar në tekstet e Maximilian Lambertzit „ Albanische Märchen und andere Texten zur albanischen Volkskunde”. Në

<sup>216</sup> Gramatika e gjuhës shqipe 1, f.273

<sup>217</sup> Weinrich, H., vepra e cit., f.258-267

këto tekste, optativi i shqipes del në dialektin gegë që flitet në këto hapësira. Kështu, në tekstin numër 9 gjejmë fjalinë „*Te vašin krałt!*”, e cila në gjermanishte është përkthyer „*Mögen deine Arme verdorren!*”.

Optativi në gjuhën shqipe ka funksion të fuqishëm stilistik. Në gjermanishte fjalia është dëshirore. Me anë të foljes modale „mögen”, e cila shfaqet në Konjunktiv I shprehet vullneti si dëshirë e subjektit. Në shqipe, optativi është i sintetizuar, drejtpërsëdrejti pa ndërhyrjen e foljeve modale funksionon si ndjenjë mallkimi, vetëm me foljen kryesore që përmban karakteristikat e mirëfillta gramatikore të optativit, me të cilat ndjenja e subjektit shfaqet fuqishëm krahasuar me fjalinë dëshirore të përkthyer në gjermanishte.

Një shprehje tjetër, e cila poashtu gjendet në tekstin numër 9 „*Mos t’u vašin krałt!*” që në gjermanishte është përkthyer „*Dass dir nur ja deine Arme nicht verdorren!*” shfaqet kuptimi mohor para dëshirores me pjesëzën „mos”. Edhe në gjermanishte fjalia ka kuptim mohor me pjesëzën „nicht”, por nuk dalin elemente gramatikore që shërbejnë për formimin e fjalisë dëshirore. Po të përkthehet kjo fjali nga gjermanishtja në shqipe do të kishte këtë kuptim „Që ty mos të të thahen krahët!”. Nga kjo shihet se porosia e subjektit del në pah, por mbetet shumë më e zbehtë se mundësia që jep optativi i shqipes për të shprehur dëshirë, sepse optativi i shqipes ka mundësi shprehëse të fuqishme duke krijuar kështu dhe vlera stilistike.

**10.** „*Nan koš e zez!*” namë, që gjendet në tekstin numër 10, në gjermanishte është përkthyer „*Mutter! sei verdammt!*!”. Këtu me format e sintetizuara të optativit ndjenja reagon shumë më fuqishëm se në fjalinë dëshirore të gjermanishtes, në të cilën shihet se shfaqet ndjenjë mallkimi, por jo me atë forcë që ka optativi i shqipes. Fjalinë e bën dëshirore folja „sei”, e cila shfaqet në Konjunktiv I.

Optativi në fjalinë „*Për t mir u štroft!*” në gjermanishte është përkthyer „*Wohl bekomm’s was ihr aufgetragen habt!*”. Kjo fjali në gjermanishte nuk ka elemente

gramatikore të fjalisë dëshirore. Megjithatë, me të shprehet një lloj vullneti i subjektit. Në gjuhën shqipe porosia është shumë e qartë , optativi godet shumë fuqishëm dhe ndjenja shfaqet e fortë emocionalisht.

**11.** „*U bašin tóra prei aso flaket, tsi e silte era!*” që gjendet në tekstin numër 11 është përkthyer kështu në gjermanishte „*Und zwar war’s der Nordwind, der das Feuer anfachte und die Flamme gegen ihre Augen jagte!*”. Këtu optativi është i kompletuar me çdo nuancë që të shprehet ajo që ndien subjekti. Në fjalinë e përkthyer në gjermanishte nuk shprehet ndjenjë e fuqishme mallkimi nga subjekti.

Disa forma të klisheizuara që pothuaj hasen në çdo fund përralle të kësaj përmbledhjeje të Lamberzit janë fjali mungesore, pa kallëzues, por nga konteksti që kanë, në shqipe dalin në optativ. Poashtu, këto fjali janë të përkthyer në gjermanishte si fjali mungesore, por edhe këtu hetohet se janë fjali dëshirore:

Prałat n škał! - Das Märchen auf die Treppe!

Dukati n bał! - Der Dukaten auf der Stirn!

Kallëzuesi i këtyre formave do të ishte:

Prałat n škał! - Das Märchen auf die Treppe!

Dukati koft n bał! -Der Dukaten mög’s auf der Stirn sein !



Në këto tekste orale të mbledhura dhe të përkthyer nga Lamberci, gjejmë një numër të konsiderueshëm fjalish të tilla mungesore që janë formulë e çdo fund përralle e që dalin në optativ:

Perałza atje, - Das Märchen dort

Śendetja ke ne! - Die Gesundheit bei uns!

Perałza ne tuła - Das Märchen in den Backsteinen

Śendetja ne burra! - Die Gesundheit bei den Männerin!

Perałza ne trat - Das Märchen in den Balken,

Śendetja ne grat! - Die Gesundheit bei den Weibern!

Perałza ke hartosat - Das Märchen in den Dachsparren

Śendetja ke gotstat! - Die Gesundheit bei den Mädchen!

Të gjitha këto variante të përfundimit të përrallave janë në optativ.

Shembujt e tjerë, ku do të hulumtohet përdorimi i dëshirores do të jenë vargjet e fundit të këngës „Muji dhe Halili” (Muji und Halil) dhe poema „Deka” (Der Tod) e „Lahutës së Malcis” .

**12.** Nga këto tekste këngësh shkëputen këto vargje të klisheizuara të përfundimit të këngëve në optativ:

„ Atje koft si kuvenet moti!

Na kha patšim nimn e Zotit!

Kuś kenon e kuś ni' gon!

Këto vargje në gjermanishte Lamberci i përktheu kështu:

„Dort mög's sein, wie's erzählt wir von altersher! Wir hier mögen teilhaftig werden der Hilfe des Gottes, der, der's singt und der, der zuhört!”

Në këto vargje optativi i shqipes si gjithherë është shumë reflektues dhe subjekti shpreh ndjenjë të fuqishme në formë urimi. Këto vargje janë të përkthyer në gjermanishte me fjali dëshirore, shprehin dëshirë në formë urimi, por jo në mënyrë të ngjeshur, të sintetizuar sikurse në shqipe. Kjo ndodhë sepse optativi në gjuhën gjermane shprehet përmes konjunktivit, ndërsa në gjuhën shqipe optativi ka format e veta me të cilat ka mundësi shprehëse të fuqishme për realizimin e funksioneve stilistike.

**13.** Në poemën „Deka” të „Lahutës së Malcis” kemi hulumtuar shtrirjen e optativit dhe funksionet që ka, në gjithë tekstin. Gjatë zbërthimit të optativit në tekstin shqip dhe të përkthyer vërehet se optativi është përdorur, ashtu si në përralla, me vlerë kuptimore jo vetëm të urimit, por edhe të mallkimit. Në këtë tekst shenjat verbale në mënyrën dëshirore, si përbërës të realizimit të koherencës tekstore, modalitetin e dëshirës me vlerë kuptimore të urimit e ndërtojnë në këto raste:

„Zëmra t'knđoftë !”

– „Mög'dein Herz, Kaçel, dir, singen !”

„Letë u kjoftë mbi vorr leđina”	„Leicht sei auf dem Grabe der Rasten”
„Butë u kjoşin moti e stina”	„Lind sei ihnen Wetter, Jahr’szeit,”
„Ata kurr mos u harrojşin”	„Soll’n sie unvergessen bleiben”
„N’kângë e n’valle, por u knđojşin”	„Mögen sie besungen werden”
„Aman, falë i kjoşim Zotit”	„Sei uns gnädig, Herr im Himmel !”

Derisa në gjuhën shqipe dëshirorja shfaqet me format e veta, bartja kuptimore e urimit si modalitet dëshire në tekstin e përkthyer në gjermanisht nga Lamberci është dhënë me anë të formave foljore të mënyrës lidhore (Indirektiv Konjunktiv), në dy raste me folje modale në Konjunktiv I (mög, mögen) dhe në një rast është me folje modale në mënyrën dëftore (Indikativ). Me vlerë kuptimore të mallkimit, dëshirorja në të dy tekstet është e pranishme në vargjet:

„U zđaf Gjuka, - atë e vraftë buka”	„Zog sich Gjuka aus die Schuhe, - mög’das Brot im Hals ihn würgen!”
„E vraftë buka si â tue e vrá”	„Mög’erstricken er am Brote”
„Ashtû raftë gjithmonë tradhtari”	„Immer sterb’so der Verräter”
- „Ah kadalë, Nikollë, t’vraftë Zoti”	„Mög’der Herrgott dich erschlagen”
- „Trobojnica – kjoftë mallkue” –	“In Vranin die Trikolore”

Edhe në fjalitë me vlera kuptimore të anatemës apo nëmave, optativi i tekstit origjinal në tekstin e përkthyer del me Indirektiv Konjunktiv të foljeve modale në 3 raste.

Në një rast, dëshirorja e shqipes del me dëftore (Indikativ) dhe fare në fund të tekstit është e mënjanuar mënyra dëshirore duke varfëruar fuqinë emocionuese, që dhënësi i tekstit origjinal ia dërgon marrësit.

### 5.7. *Mënyra habitore (Admirativ) në tekste*

Haborja në gjuhën shqipe është mënyrë mëvete, e cila për nga ndërtimi është e veçantë dhe nuk haset në asnjë gjuhë tjetër indoevropiane. E tashmja dhe e pakryera e habitores së shqipes janë forma të përngjitura dhe të gjitha format e kësaj mënyre përdoren kryesisht për të shprehur habinë në çastin e ligjërit të folësit për diçka të papritur. Mirëpo, format e habitores shpesh përdoren për të shprehur dhe qëndrim kundërshtues, ironizues dhe mospajtues.<sup>218</sup> Haborja e shqipes si mënyrë e mvetësishme në pikëpamje të modalitetit afrohet me dëftoren, sepse të dyjat shprehin kryesisht modalitetin e vërtetësisë, por habitojra shpreh dhe ndjenjën e habisë.<sup>219</sup> Pra, ndjenja e habisë e zbeh apo e vë në dyshim modalitetin e vërtetësisë, të shprehur nga haborja.

Mënyra habitore ka spektër të gjerë përdorimi në gjuhën shqipe dhe në gjuhën gjermane. Dy veçoritë esenciale të saj janë emocionaliteti dhe komentimi. Haborja emocionale rezulton spontanisht dhe jospontanisht dhe mund të shfaqet pas një veprimi apo një gjendjeje të pavërejtur deri në çastin e ligjërit. Ndërkaq, haborja komentuese del me komente kryesisht ironike-kritike.<sup>220</sup> Në gjuhën gjermane nuk është mënyrë e ndërtuar nga format e mvetësishme të saj. Kështuqë, haborja në këtë gjuhë del në forma të ndryshme si me lidhore, me folje modale, me ndajfolje e me forma të tjera. Në tekstet në vazhdim, do të hulumtohet modaliteti i habitores në gjuhën shqipe dhe mundësitë e shprehjes të modalitetit të kësaj mënyre në gjuhën gjermane, ku do të bëhen përpjekje të

<sup>218</sup> Demiraj, Sh., vepra e cit., f.905-906

<sup>219</sup> Gramatika e gjuhës shqipe I, f.273

<sup>220</sup> Buchholz, O., Fiedler, W., vepra e cit., f.154-155

spikatet mundësia e përkthimit të habitores nga Lamberci. Shembujt, që do të bëhen objekt trajtimi i shenjave verbale në habitore janë teksti „Oso Kuka” dhe „Deka” nga „Lahuta e Malcis”.

**14.** Në tekstin e këngës „Oso Kuka” habitorja shpreh qendrim kundërshtues, mospajtues, dhe qendrim të habitës së folësit. Shumica e veprimeve të shprehura nga habitorja në tekst janë veprime të përfunduara, ku folësi nuk i ka shkëputur lidhjet me çastin e ligjërit. Në vijim do t’i paraqesim disa vargje të këngës „Oso Kuka”, në të cilat shprehet habitorja si qendrim kundërshtues i folësit në këto raste:

„Paska mbtë Shqypnija m’vasha”,                      „Mädchen gibt’s nur in Albanien!”  
„Qysh se s’leka mbrenðê nji ðjalê,”                      „Wird kein Bursch mehr dort geboren” ,

Ndërsa, habitorja me qendrimin mospajtues në këtë shembull përdoret në fjalitë:

„Paska nði, po, e kênka iðhnue”:                      „Hat’s vernommen ist entrüstet”,  
„M’sylah doren paska çue”                      „Hebt die Hand an seinen Gürtel,”

Dhe së fundi, në tekst në tri raste haset dhe qëndrimi i habitës së folësit pa nuanca kundërshtuese a mospajtuese:

„Oso Kuka paska nði:” –                      „Oso Kuka hat’s vernommen”,  
„Avdi Pasha kênka çue”                      „Da erhob sich Avdi Pasha”

„Per sherbim qi i bâka Mbretit” „Für den Kriegesdienst, true geleistet”

Konstatimi i veprimit në habitore dhe qendrimi mospajtues dhe kundërshtues i folësit në rastet e diskutuara, përveç që vërehet nga forma e mvetësishme e ndërtimit të habitores (pas + ka mbetë; le+ka, pas+ka ndi, kên+ka idhnue, pas+ka çue, kên+ka çue), në mënyrë të plotë modaliteti i habitores qartësohet në kuadër të tërësisë së tekstit.

Po t’i referohemi versionit të përkthyer të tekstit, shihet se mungesën e formave të posaqme të habitores në gjuhën gjermane, Lamberci është përpjekur ta bëjë me shenja verbale të mënyrës dëftore. Përdorimi i shenjave tekstore verbale të mënyrës dëftore në tekstin gjermanisht shprehet në të gjitha rastet që ai i ka përkthyer nga shqipja, duke i dhënë me forma të ndryshme kohore. Kështu, Lamberci në katër raste kohën e kryer të habitores së shqipes e jep me kohë të tashme të dëftores së gjermanishtes (Präsens – Indikativ):

„Paska mbetë Shqypnija m’vasha”,	„Mädchen gibt’s nur in Albanien!”
„M’sylah doren paska çue”	„Hebt die Hand aus seinen Gürtel”,
„Qysh se s’leka mbrenðë një djalë”	„Wird kein Bursch dort geboren”
„Ku po bâte nâm Cetina”	„Die Hajduken aus Cetinje, schaden arg und Elend”

Tri fjalitë e tjera që në tekstin shqip dalin me kohë të kryer të habitores, në gjermanisht janë dhënë në kohën e kryer të dëftores (Perfekt – Indikativ) :

„Paska nđi, po, e kênka iđhnue” : „Hat’s vernommen, ist entrüstet”,

„Oso Kuka paska nđi” : „Oso Kuka hat’s vernommen”,

Përcaktimi i Lambercit që habitoren e shqipes ta përkthejë me dëftore duket se e zvogëlon emocionalitetin e habitores në vargjet e tekstit „Oso Kuka” të Gjergj Fishtës dhe nuk shpreh në mënyrë të plotë ekzaktësinë e tekstit shqip. Mendojmë se gjermanishtja ka mundësi me anë të të cilave mund të shprehej habitorja dhe modaliteti i saj në këto tekste, si p.sh me lidhore, folje modale dhe ndajfolje.

**15.** Edhe në tekstin e dytë të Lahutës „Deka” përdorimi i habitores së shqipes dhe përkthimi i saj në gjermanisht del për afërsisht i njëjtë si në tekstin e mësipërm. Format e habitores së shqipes në shumicën e rasteve shprehin ndjenjën e habitës së folësit. Format kohore të habitores në tekstin shqip janë të kohës së tashme dhe të kohës së kryer. Përkundrazi, në tekstin gjermanisht, sikurse në tekstin e këngës „Oso Kuka, Lamerci e ka përkthyer habitoren e shqipes me forma të ndryshme kohore të dëftores (Indikativ), si me Präteritum – Indikativ:

„Kênka nisë nji hije ðeket” „Aufbruch aus Rijekas Gegend, ein Gespenst,  
ein Todesschatten,”

„Edhe i ðhânka zjarrë barotit.” „Legte Feuer an das Pulver”

„Leter t’vrashtë i paska çue:” „Sandte er ein brüskes Schreiben”

„Paska shkruet m’at derë Stambolle:” „Schrieb’ zuhaus er in Istanbul:”

„Edhe qitka’i porez t’randë:” „Drückte arg mit schwerer Steuer”

me Präsens – Indikativ:

„Paska njeshë shpaten florinit,”	„Gürtet sich das gold’ne Schwert um,”
„Paska veshur petkat arit”	„Kleidet sich in gold’ne Wämser”
„Zgjdhka gjakun pullali”	„Bindet los den Apfelhimmel”
„Edhë dashtka, n’ nâtë t’ pá hânë”,	„Und will heut’Nacht in Vranina,”
„Edë fjalës i ndejka Gjuka”	„Pünktlich folgt dem Auftrag Gjuka”

dhe me Perfekt-Indikativ:

„Kênka mbathë e kênka veshun”:	„Und er war gar wohl beschuhet, und er war gar wohl bekleidet.”
„Paska dynðë nji’ t’ maðhe ushtri”	„Hat ein großes Heer geführt”

Nga kjo paraqitje shihet se edhe në këtë tekst si në tekstin e parë, mënyrën habitore të foljeve, Lamerci e ka përkthyer me mënyrën dëftore me forma kohore të prezentit, perfektit dhe preteritit. Edhe modaliteti i vërtetësisë në tekstin e përkthyer shprehet në mënyrën dëftore.---



### 5.8. Mënyra kushtore në tekste (Volitiv)

Siç është thënë edhe më lart, duke trajtuar përdorimin e lidhore në tekste, edhe mënyra kushtore shpreh modalitetin e mundësisë. Veprimi i shprehur nga folja në mënyrën kushtore mund të kryhet poqëse vërtetohet një kusht i caktuar. Ky kusht, që duhet të kryhej shprehet zakonisht me anë të një fjalisë kushtore. Kushti i shprehur mund të jepet përmes foljeve në mënyrën lidhore. Pra, folja në kushtore është e barasvlershme me të pakryerën, përkatësisht me më se të kryerën e lidhore, të prirë nga folja modale „mund”. Por, mënyra kushtore mund të shprehet edhe përmes ndajfoljes „ndryshe”, e cila ka vlerën e një fjalisë mungesore ose vlerën e një togu të ndërtuar me parafjalën „me” ose „pa” dhe një emër që mund të shoqërohet nga një përcaktor. Mënyra kushtore ka dy kohë kryesore : të tashmen dhe të kryerën.<sup>221</sup> Sipas pikëpamjeve të O.Buchholz / W.Fiedler, kohët e kushtores janë: Präsens Volitiv (= Futur Konditional) që sinjalizon të ardhmen, Imperfekt Volitiv (= Imperfekt Futur = Präsens Konditional), Perfekt Volitiv dhe Plusquamperfekt Volitiv.<sup>222</sup>

16. Sipas hulumtimeve të bëra në tekstet shqipe të përkthyer nga Lamberci, krahasuar me përdorimin e mënyrave të tjera, kushtorja si mënyrë ka shtrirje më të kufizuar në to. Andaj meqë mënyra kushtore nuk është hasur në tekste, atëherë jam mbështetur në fjalitë me kuptim kushtor. Kështu, sipas gjetjeve tona, mund të konstatohet se fjalitë kushtore përdoren më shumë në tregime, sidomos në përralla dhe më rrallë në tekstet në vargje si në këngë kreshnike dhe në poemat e „Lahutës së Malcis”.

<sup>221</sup> Gramatika e gjuhës shqipe 1, f.327-328

<sup>222</sup> Buchholz,O.,Fiedler,W., vepra e cit., f.145-148

Teksti i shqyrtuar nr.16 **„Te dū vlaznit te kt̄sija e i vogle, i t̄sori, me djemnit”** është përrallë, në të cilën shfaqen raporte kushtore mes fjalive të tekstit shqip. Në tekst paraqiten tri fjali që shprehin një kusht të caktuar. Në të gjitha rastet, kushti del në fjalinë e varur kushtore të ndërtuar nga pjesëza mohore „pa” dhe folja në mënyrën dëftore. Ndërkaq, fjala „për”, me të cilën fillon fjalia e varur kushtore, në të tri rastet ka kuptimin e lidhëzës kushtore „nëse”:

„Un s la te me i ui!” „Po pse ?” „Per pa e hjek n’anin si, ui s t la me t mar!”

Por „Mos prek!” i ̄ot dja i. „Pse?” per pa ta hjek tjetrin si, ui s t la me mar”

„Ti, v̄la, ui sun t nap!” „Pse?” ̄ot ai: „Per pa t hjek sit!”

Fjalitë kushtore me kuptim mohor të realizuara me pjesëzën „pa” në shqipe, në versionin e përkthyer në gjuhën gjermane në dy raste kushti shprehet me anë të ndajfoljes „sonst” (ndryshe), që fjalisë së varur i jep vlerën e kushtores:

„ Ich gestalte es nicht, daß du Wasser nimmst.” „Aber warum nicht?” „Vorher muß ich dir das eine Auge ausreißen, sonst lasse ich dich kein Wasser nehmen!”

„Rühr es nicht an!” „Warum nicht?” „Erst muß ich dir auch das andere Auge ausreißen, sonst lasse ich dich kein Wasser schöpfen!”

„ Ich kann dir kein Wasser geben Bruder!” „Warum nicht?” sagt jener.„Vorher muß ich dir deine Auge ausreiten.”

Ndërkaq, fjalia e radhës e shembullit shqip dhe fjalia e përkthyer në gjermanisht, përveç raportit shkakor që kanë (meqë janë të lidhura me lidhëzën nënrenditëse shkakore „se” në shqipe dhe „denn” në gjermanisht), ato krijojnë dhe raporte kuptimore kushtore. Nëse lidhëza shkakore „se” e shqipes dhe lidhëza „denn” e gjermanishtes zëvendësohet me ndajfoljen „ndryshe” në shqipe dhe „sonst” në gjermanishte, atëherë del se këto fjali kanë dhe nuanca kuptimore kushtore në të dy gjuhët:

„Ma špeit me m kałdzue, se hatri mue mi jet!”

„Aber schnell erzähle es mir, denn meine Gunst bleibt dir erhalten!”

**17.** Poashtu edhe në tekstin „ **M tšo e m bir prep!**” fjalitë kushtore përdoren rrallë. Në tërë tekstin, ato paraqiten në katër fjali të varura. Fjalitë me kuptim kushtor në tekstin shqip realizohen me fjalinë e varur kundërshtore me lidhëzën „por”. Në këtë rast, pas lidhëzës kundërshtore „por” pason folja „m’tsit” (gib...heraus) në mënyrën urdhërore. Edhe në këtë shembull paraqitet kuptim kushtor i fjalisë së varur. Ndërkaq, në fjalinë në vazhdim kuptimi kushtor qartësohet nga lidhëza „n” në tekstin shqip dhe lidhëza „wenn” (nëse) në tekstin gjermanisht :

„Të pot kałdzoj, por m tsit, se po t kałdzoj me mrapa, si ašt puna eme.”

„N datš me m i tsit, se po t kałdzoj me mrapa, si ašt puna eme”

„Ich will es dir erzählen, aber gib mir Hemden und Unterhosen heraus, damit ich mich anziehen kann, denn ich bin nackt.”

„Wenn du mir da Gewünschte herauswerfen willst, so erzähl’ ich’s dir später, wie es mit meiner Sache steht!”

Dhe së fundi, fjalia e varur me lidhëzën „se” në tekstin shqip dhe lidhëzën „denn” në tekstin gjermanisht sinjalizojnë kuptim kushtor, e cila në këtë rast mund të zëvendësohet edhe me ndajfoljen „ndryshe” (sonst).

„T kam pshtue djaln n ven, se kan ken tui ta müt štrigat.”

„Ich habe deinem Sohne das Leben gerettet, denn die Hexen hatten die Absicht, ihn dir umzubringen”.

Nga e gjithë kjo që u tha, mund të përfundohet se fjalia kushtore e shqipes e ndërtuar

- me pjesëzën mohore „pa”, në tekstet në gjermanisht del me ndajfoljen „sonst”,
- me lidhëzën kushtore „n”, e cila në tekstet e shqyrtuara në gjermanisht gjithashtu del me lidhëzën kushtore „wenn” dhe me foljen modale „kann” dhe plus infinitiv,
- fjalitë e varura shkakore me lidhëzën „se”, në raste kur mund të zëvendësohen me ndajfoljen „ndryshe” në tekstin shqip dhe me ndajfoljen „sonst” në gjermanisht kanë vlerë kuptimore kushtore,
- fjalitë e varura kushtore të realizuara me lidhëzën „por”, në rastet e trajtuara kanë gjithashtu vlerë kuptimore kushtore në të dy gjuhët.

### **5.9. Format e pashtjelluara të foljeve në tekste (infinite Verbformen)**

Format e pashtjelluara të foljeve janë shenja të rëndësishme tekstndërtuese dhe si të tilla përdoren me funksione të caktuara. Paskajorja duke emërtuar veprim në proces ka funksionet e veta. Kështu, funksionet kryesore të paskajores si formë infinite në kuadër të tekstit janë: funksioni qëllimor, përcaktor dhe kallëzuesor. Përcjellorja, e cila shpreh veprim që shoqëron veprimin e foljes kryesore në tekste, përdoret me funksion mënyror, kohor, shkakor dhe funksion kushtor. Ndërkaq, pjesorja si gjymtyrë më vete përdoret shumë rrallë. Ajo ka tipare të mbiemrit dhe të foljes si dhe shërben për formimin e kohëve të përbëra të foljeve dhe formave të pashtjelluara të tyre. Gjithashtu, pjesorja ka vlerë foljore sidomos në rastet kur përdoret pas foljeve me vlerë modale „do” dhe „duhet”.

Format e pashtjelluara të foljeve duke qenë shenja të rëndësishme tekstformuese, veçanërisht paskajorja dhe përcjellorja, kanë përdorim të gjerë në tekstet shqipe të përkthyer nga Lamberci në gjermanisht. Meqë, këto tekste i takojnë dialektit gegë, në pikëpamje të formës e para, pra paskajorja, ndërtohet nga pjesëza „me”, e cila i paravihet formës së pjesores dhe e dyta, përcjellorja, ndërtohet nga pjesëza „tue” ose „tuj” dhe forma e pjesores.

**18.** Në tekstin „Vranina” të „Lahutës së Malcis” dendur janë përdorur shenjat verbale tekstore të paskajores dhe përcjellores, kurse pjesorja në këtë tekst është më e kufizuar. Në tekstin në fjalë, në të gjitha rastet ku përdoret përcjellorja, veprimi i shprehur nga kjo formë e pashtjelluar e foljes shoqëron veprimin e foljes kryesore. Veprimet e përcjellores kryhen njëkohësisht me veprimet e foljes kryesore në të gjitha rastet:

„Vall ç’po bân Vranina m’Shkjé,	„Krenët po rrijshin tue e ndí,
Rob tue zânë e gjinð tue pré:	tue ndie e tue menðue
Tue pré gjinð, tue zânë hajðuka,”	Se shka Knjazi ish tue ligjrue”
„Thirgka Krenët e Malit t’Zi:	„M’lëni mue, perse, qe besa,
Folë u paska si tue ulrue:”	Me pak pare e tuj gergá”
	„Qi âsht tue ðekë, eh! n’ato suka”

Mirëpo, siç është e ditur përcjellorja gjatë përdorimit shpreh dhe funksione të caktuara. Përdorimi i përcjellores në këtë tekst del me funksion mënyror, shkakor dhe kohor. Me funksion mënyror përcjellorja del në këto fjali:

„Vall q’po bân Vranina m’Shkjé,	„Was hat denn im Sinn Vranina
Rob tue zânë e gjinð tue pré:	Mit den Slawen, daß als Knechte
Tue pré gjinð, tue zânë hajðuka,”	Es sie sängt, die Leute tötet,
	Tötet Leute, sengt Heiduken,”
„Thue se rrefta shkrepe per ânë:	„Wähnst du, daß ein Blitzeinschlage,
Kaq vringllim aj shkon tue i dhânë!”	Dir zur Seite, derart pfeifend”
„Folë u paska si tue ulrue:”	„Sprach zu ihnen, doch sein Sprechen
	Klang wie fernen Donners Grollen”
„Kshtû tha Knjazi i Malit t’Zi	„Also sprach der Knjaz, der Fürst von

„Krenët po rrijshin tue e ndí,	Crnagora, und die Häupter
	Saßen, hörten zu, bedachten”
„M’lëni mue, perse, qe besa,	„Denn – glaubt mir ! – mit wenig Geld nur
Me pak pare e tuj gergá”	Doch mit umsomehr der Räncke”

Përcjellorja me funksion shkakor është dhënë në një rast:

„ Tue ndie e tue mendue	„Saßen,hörten zu, bedachten,
Se shka Knjazi ish tue ligjrue”	Was der Knjaz da hatt’ geredet”

Dhe së fundi, funksioni kohor shprehet në këto vargje:

„Por të desin, si Oso Kuka	„So wie Oso Kuka jetzt dort
Qi âsht tue ðekë, ehu! n’ato suka”	Ist bereit, den Tod zu dulden,
	Weh mir! – bei Vraninas Höh’n!”

Përdorimi i përcjellores në shqip dhe në gjermanisht në këtë tekst, në rastet e shqyrtuara, del me funksione pothuajse të njëjta. Kurse, sa i përket mënyrës së ndërtimit të përcjellores në tekstin gjermanisht paraqiten ndryshime edhe pse funksionet e përcjellores së shqipes dalin të përafërta me ato të gjermanishtes. Format, me të cilat shprehet përcjellorja e shqipes në gjuhën gjermane janë: dëftorja-Indikativ (sängt, tötet),

përcjellorja-Partizip I (pfeifend), infinitivi i ndërtuar me „zu“-Infinitiv mit „zu“ (hörten zu, dulden zu) si dhe format e ndërtuara nga ndajfolja dhe emri (mit umsomehr der Räncke, wie fernem Donners Grollen).

Përkritazi me përdorimin e paskajores (Infinitiv) në tekstet shqipe të përkthyer nga Lamerci, do thënë se kjo formë infinite ka shtrirje të gjerë në to, meqë këto tekste kanë strukturë tregimtare, gjegjësisht rrëfimtare. Ky konstatim mund të bëhet qoftë kur është fjala për tekstet narrative në vargje (poemat e Lahutës, këngët kreshnike, këngët historike), apo dhe për llojet e tregimeve popullore (përrallat, gojëdhënat dhe tregimet e letërsisë së shkruar). Në poemën „Vranina“ të Lahutës, ku u diskutua përdorimi i përcjellores (Gerundium) vërehet se forma e paskajores e tipit me + pjesore, duke shprehur veprim në proces është përbërës i rëndësishëm i tregimtarisë. Kështu, në tekstin e tipit narrativ të poemës „Vranina“, paskajorja është përdorur 33 herë, 14 herë me funksion përcaktor dhe 19 herë me funksion qëllimor. Rastet në tekst, në të cilat paskajorja e shqipes ka funksion përcaktor, ndërtohet me folje modale dhe infinitiv në tekstin e përkthyer, gjegjësisht në gjermanisht :

Top me i rá shpirti s'i shkulet.”	„Kann sie ihm doch nicht die Seele Aus des Leibes Hülle reißen“.
„Gjallë as dekë s po mujm m'e zânë,”	„Weder tot noch lebend können treffen“
„Me u kapë mundet Mali i Zi”	„Kann Fuß sassen Montenegro“
„Shqypnín tjetër kan me e ða”	„Doch den Rest des Landes Albanien sollen teilen“



Shembull i tekstit shqip, në të cilin paskajorja ka funksion përcaktor, që në tekstin gjermanisht del me „zu” është:

„Shqyptarín né me na lshue”

„Uns zu lassen von Albanien”

Kurse, në katër vargje të tjera, paskajorja me funksion përcaktor e tekstit shqip, në gjermanisht jepet në mënyrën dëftore:

„Ká m’iu dhâne Shkjenís e mbara

„Aller Slawenvölker, eine

Ká m’u shtrue ura perpara”

Brücke wird geschlagen werden

Eine slaw’sche Völkerbrücke”

„Ká m’e u thye Krajnive hovi”

„Dann den andern Könrgreichen

Wird die Kraft gebrochen werden”

„Ká m’e marrë një pushkë vrastore”

„Ein Gewehr, das stets den Tod bringt”

Paskajorja e tekstit shqip me funksion qëllimor, në tekstin e përkthyer në shumicën e rasteve është dhënë me infinitiv me „zu” dhe vetëm në një fjali me infinitiv pa „zu” :

„Per me ða t’mjeren Shqypni,”

„Unfried ‘nur und Zwist zu stiften”

Vrasë e pré mos me i a ndalë”

Dort zu morden und zu plündern”

„Osos kryet per m’i a shkurtu?”

„Und zu köpfen Oso Kuka?”

Në tekstin e diskutuar, qoftë në origjinal qoftë në përkthim, paskajorja e dialektit gegë, në të cilin është i shkruar teksti shqip, ka kategorinë gramatikore të diatezës dhe të kohës. Kështu, diateza veprorë e paskajores paraqitet në shumicën e rasteve të diskutuara, kurse diateza pësore në tekste përdoret në dy raste:

„Ká m’i u dhâné Shkjenís e mbara”

„Aller Slawenvölker eine Brücke  
wird geschlagen werden”

„Ká m’i u thye Kralinve hovi.”

„Dann den andern Königsreichen  
wird die Kraft gebrochen werden”

Sa i përket kategorisë së kohës, paskajorja në tekstin shqip del me vlerë kohore të së tashmes (me i rá, me i mrijtë, m’e shinue, m’e varrue, me rá, me i a ndalë, me na lshue, me gjetun, m’e zânë, me u kapë, me dhanun, me shkrî, m’e pshtue, me u përpyekë, me çue, m’ia shkurtue, me ða, me ndênjun, m’i u shtrue, per me dhânë, per me shkrî, me mjelë, mi mkâmbë, m’ua ndezë) dhe të së ardhmes (ká m’i u dhânë, ká m’u shtue, ká m’i u thye, ká m’e marrë, kan me ða, me pasë për t’shkue, ká me gjíkue). Vlerat kohore të paskajores së shqipes në tekstin në gjermanisht janë dhënë me forma të ndryshme verbale, të cilave, siç është dëftorja, ka format e veta kohore. Ndërsa, sa i përket infinitivit me „zu”, me të cilin më së shpeshti është përkthyer paskajorja e shqipes, nga vetë teksti shihet se ka vetëm vlerë kohore të së tashmes.

Si përfundim mund të konstatohet se paskajorja e shqipes, në tekstin e analizuar, në të shumtën e rasteve shfaqet me infinitiv me „zu”, me folje modale (me ç’rast folja modale del në mënyrën dëftore), infinitiv dhe me folje të tjera të dëftores. Do shtuar se, edhe funksionet e paskajores së tekstit shqip, edhepse dalin me forma të ndryshme foljore, në tekstin e përkthyer janë përafërsisht të njëjta. Funksionet e njëjta të këtyre shenjave në tekst janë:

- funksioni përcaktor, që shfaqet në këta shembuj të tekstit original dhe tekstit të përkthyer:

„Shqyptarín né me na lshue”

„Uns zu lassen von Albanien”

Ká m’i u dhâné Shkjenís e mbara”

„Aller Slawenvölker eine Brücke wird

geschlagen werden”

- funksioni qëllimor si në shembulin më poshtë:

„Osos kryet per m’i a shkurtu?”

„Und zu köpfen Oso Kuka?”

Ndërkaq, në shembujt :

Ká m’i u dhâné Shkjenís e mbara”

„Aller Slawenvölker eine Brücke wird

geschlagen werden”

„Ká m’i u thye Kralinve hovi.”

„Dann den andern Königsreichen

wird die Kraft gebrochen werden”

edhe pse paskajorja (Invinitiv) shprehet në diatezën pësore në të dy gjuhët funksioni i saj është përcaktor, veçse në fjalinë e parë *m’i u dhâné* dallon prej formës *wird*

*geschlagen werden* për nga kuptimi. Por, Lamberci në këtë rast e ka gjetur formën më të përshtatshme të mundëshme për t'a përkthyer këtë shenjë tekstore. Në këtë kontekst, është cekur dhe më lart, se funksionet e paskajores së tekstit shqip, edhe pse dalin me forma të ndryshme foljore, në tekstin e përkthyer janë përafërsisht të njejta.

Në tekstin „Vranina” të „Lahutës së Malcis” paskajorja e shqipes e dialektit gegë ka vlerë kohore të së tashmes, vlera këto që në tekstin e përkthyer realizohen me kohë të dëftores, ndërkaq sa i përket infinitivit me „zu”, ai del vetëm në të tashmen.

Pjesorja është formë foljore e ngurosur, që ka tipare kuptimore e gramatikore të foljes dhe mbiemrit të nyjshëm. Me këto tipare, pjesorja del më rrallë e përdorur krahasuar me përcjelloren dhe paskajoren në tekstin „Vranina” të Lahutës. Me tipare të foljes në këtë tekst të Fishtës, pjesorja është përdorur në këto dy raste:

„Folë u paska si tue ulrue”

„Sprach zu ihnen, doch sein Sprechen

Klang wie formen Donners Grollen”

„E mârre t'kenë ðo skele detit”

„Und gewonnen ein'ge Häfte”

Kurse, pjesorja e shqipes me tipare të mbiemrit është përdorur tri herë në tekst:

„Të gjithë le sokola malit:”

„Alle waren sie geboren”,

„E m'ledinë n'kuvend rreshtue,”

„Und nachdem sie Platz genommen”

„Shtrëjt fitue me gjak të t'Parve!...”

„Dieses Land, so schwer erworben

Mit der Ahnen edlem Blut”

Po të krahasohen pjesorja e shqipes me atë të gjermanishtes në nivel të tekstit, shihet se ajo në tekstin e përkthyer del tri herë me folje në dëftore (waren ... geboren, waren... genommen, sprach..) dhe dy herë me Partizip II (gewonnen, erworben).

**19.** Teksti vijues, në të cilin do të diskutohen shenjat verbale të formës së pashtjelluar, është teksti „Të çelen arkapijat”. Ky tekst është i shkëputur nga përmbledhja e teksteve shqipe „Albanische Chrestomathie”, të cilat Lamberci i ka përkthyer në gjuhën gjermane, ku shenjat tekstore verbale të formave të pashtjelluara, krahas shenjave të tjera që e ndërtojnë tekstin, kanë një rëndësi të posaçme për realizimin e kohezionit dhe koherencës së këtij teksti. Si të tilla, këto shenja tekstore verbale, në tekstin në fjalë i takojnë dialektit gegë të shqipes. Natyrisht se format e pashtjelluara të foljeve, në tekstin në shqyrtim, krahasuar me shenjat e tjera finite verbale, dalin më të kufizuara në numër, megjithatë kuptimet dhe funksionet e tyre në tekst realizojnë tërësinë kuptimore të tij. Në tekstin e analizuar të shqipes janë dhënë fjali të ndërtuara nga të tri format infinite të foljes, siç janë paskajorja, përcjellorja dhe pjesorja. Forma e paskajores në tekst është shfaqur në 6 raste:

„Ajo s’e shifte Oson për mbrapa, por vazhdonte me imitue grate ,alla franga’ edhe përdredhej si ,mbas modes’ “.

„Sie sah den Oso nicht von hinten kommen, sondern sie fuhr fort, die Frauen ,alla franca’ nachzuahmen , und sie drehte sich in ihren Hüften genau nach der Mode”

„E Hajrija, ma e zbetë se muri për të cilin u përplas shkoi me la ftyrën prej gjakut që përzjehej me lotët e heshtun të vuajtjes.”

„Und Hajrija, bleicher als die Mauer, an die sie angeflehen war, ging um sich das Gesicht von dem Blute reinzuwaschen, das sich mit den stillen Tränen des Leids vermischte“.

„Tash e kishin çelë at arkapi për me muejt, nëpër oborr të kojshis me shkue te kusherirët, nga të cilët prap me anë t'arkapijave, muejshin me shkue nëpër shumë familje të njoftuna të lagjes pa i pa kush dhe pa pasë nevojë me dale në rrugë.“

„Jetzt hatten sie diese Hintertüre wieder aufgemacht, um über den Hof des Nachbarn zu den Vettern gehen zu können „von denen aus sie wiederum mit Hilfe des Hintertüren zu vielen bekannten Familien des Stadtteils gehen konnten, ohne daß sie jemand sah und ohne daß sie die Notwendigkeit hatten, auf die Straße zu gehen.“

Nga shembujt e këtij tregimi mund të konstatohet se në katër raste paskajorja e shqipës është përkthyer me formën e infinitivit me parafjalën „zu“ në gjermanisht (me imitue, nachzuahmen, me la – reinzuwaschen, për me muejt me shkue – gehen zu können, me dale – zugehen) dhe vetëm në një rast me folje modale dhe infinitiv (muejshin me shkue – gehen konnten). Sa u përket funksioneve të paskajores mund të thuhet se si në tekstin original ashtu dhe në tekstin e përkthyer paskajorja kryesisht del me funksione qëllimore.

Gjatë shqyrtimit të shenjave verbale tekstore në formave të pashtjelluara në tekstin „Të çelen arkapijat“ janë hetuar dhe tri fjali të ndërtuara nga përcjellorja dhe në një fjali është përdorur dy herë forma e pjesores me funksion përcaktor.

„Në dhomë e gjet Hajrijen të veshun dhe të goditun ‚alla franga‘ me diçka si kapelë në krye dhe tue hecë ‚mbas modet‘ “.

„In dem Zimmer fand er Hajrija, gekleidet und hergerichtet ‚ala franca‘ mit irgend etwas wie einem Hute auf dem Kopfe und einherschreitend ganz nach ‚der Mode‘ ”.

„Fëmijët qeshnin dhe brohoritëshin tue u argëtue.”

„Die Kinder lachten und jauchte und unterhielten sich”.

„Osja tue murmurue si qen i terbuen doli prej odes dhe vetëm i merreshin vesht fjalët”.

„Oso murrte wie ein wütender Hund und ging aus dem Zimmer, und man verstand bloß seine Worte”

Në të tri fjalitë e tekstit shqip, përcjellorja del me funksion mënyror. Në tekstin e përkthyer kjo shenjë verbale e formës së pashtjelluar shfaqet në një rast me Partzip I - Gerundiv<sup>223</sup> (einherschreitend) dhe në dy raste me preteritin e dëftores (unterhielten sich, murrte). Ndërkaq, lidhur me format e pjesores mohore të shqipes, të cilat në tekst janë dhënë në dy raste me tipare foljore, në tekstin e përkthyer nga Lamberci në gjuhën gjermane dalin me preteritin e dëftores dhe kanë gjithashtu kuptim mohor, meqë shenjave verbale të dëftores u është paravënë negacioni leksikor (lexikalische Negation)<sup>224</sup> „ohne daß” (... ohne daß sie jemand sah ...; ... ohne daß sie die Notwendigkeit hatten,...)

Nga analiza tekstore e gramatikore e tekstit „Të çelen arkapijat” mund të përfundohet se paskajorja e shqipes si shenjë e rëndësishme për realizimin e tërësisë kuptimore të tekstit, në shumicën e rasteve në tekstin në gjuhën gjermane është përkthyer nga Lamberci me tipin e paskajores të ndërtuar me parafjalën „zu” (Infinitiv mit „zu”) dhe funksionet e saj në të dyja gjuhët rezultojnë si funksione kryesisht qëllimore.

Lidhur me përcjelloren në tekstin shqip, shihet se funksionet mënyrore të saj shfaqen dhe në tekstin e përkthyer, ku në një rast është dhënë me Gerundiv – Partizip I dhe në dy raste me preteritin e dëftores.

---

<sup>223</sup> DUDEN, B.4, f.436

<sup>224</sup> DUDEN, B.4, f.921-922

Dhe së fundi, pjesorja mohore e shqipes me tipare foljore e shfaqur dy herë në tekst, në tekstin në gjuhën gjermane del me shenja tekstore verbale në preteritin e dëftores të prirë nga pjesëza mohore leksikore „ohne daß” në të dyja rastet.

## **6. HULUMTIMI I KONEKTORËVE NË TEKSTET SHQIPE DHE NË TEKSTET E PËRKTHYERA**

Studiues të njohur të gjuhësisë së tekstit, si de Beaugrande / Dressler e të tjerë duke diskutuar rëndësinë e konektorëve dhe marrëdhëniet bazë që krijojnë konektorët për lidhjen e fjalëve dhe fjalive të tekstit, edhe pse jo gjithherë pajtohen me klasifikimin e konektorëve, megjithatë janë të mendimit se marrëdhëniet bazë, që realizohen përmes konektorëve janë: marrëdhënia shtesore, marrëdhënia kundërshtore dhe marrëdhënia shkakore (de Beaugrande / Dressler 1981:77-79).



Gjurmimi i konektorëve në tekstet shqipe, të cilat Lamberci i ka përkthyer në gjermanisht do të bëhet sipas kësaj ndarjeje, pra në tekste do të shqyrtohen këto marrëdhënie bazë, si pjesë të rëndësishme sipërfaqësore të tekstit, gjegjësisht të kohezionit të tekstit. Edhe pse, siç është e ditur, konektorët si shenja tekstore më vete nuk kanë ndonjë kuptim, megjithatë ata kanë funksione të rëndësishme, sepse bëjnë lidhjen kuptimore të tekstit.

### ***6.1. Tekstet e analizuar me lidhëza që krijojnë marrëdhënie shtesore***

20. Në tekstin që do të analizohet në vijim, do të bëhen përpjekje që të hetohet marrëdhënia shtesore. Teksti i përrallës „I biri i padišahit, tsi e müt difin e kulšedren” mund të thuhet se është shembull tipik i përdorimit të lidhëzave me marrëdhënie shtesore. Në këtë tekst gegërisht nga Dibra, lidhëzat sinonimike shtuese „e”, „dhe”, „edhe” shfaqen në variantet e tyre dialektore „e”, „en”, „ene”, ku më së denduri në tekst është përdorur lidhëza „ene”(në kuptimin e lidhëzës edhe). Me anë të këtyre lidhëzave këpujore radhiten ngjarjet dhe faktet e ndryshme në tekst. Edhe pse këto lidhëza tipike bashkërenditëse, të cilat krijojnë marrëdhënie shtesore mes dy gjymtyrëve brenda fjalisë apo dy a më shumë fjalive nuk janë gjithherë sinonime, gjatë analizës së tyre në tekst vërehet se ato mund të përdoren lirisht në vend të njëra tjetrës:

„Ajo mǎla na böte ka ni kok n mát. **En** at koken e hate ðifi”.

„En ai djali hiken **e** škon n štpoi e i 9ot böábs:”

Në përgjithësi lidhëzat këpujore në shembullin në fjalë bëjnë njësoj lidhjen si mes fjalive, ashtu dhe mes gjymtyrëve brenda fjalisë dhe shfaqin raporte barazie mes tyre:

„**En** ai difi tjasen en ai i meñ tröi tsotsat **ene** škon kah ajo špela **e** i 9ot asai t maðes **e** e liðen me litar **ene** hipen atje n din'a teper **ene** e liðen tsotsen e nderm'ešme **en** ai e hipen tsotsen e nderm'ešme n din'a teper **en** ai i 9ot asai tsots vokl.”

Në tekstin në fjalë lidhëzat bashkërenditëse këpujore, të cilat shprehin marrëdhënie shtesore, në pikëpamje semantike krijojnë marrëdhënie kohore dhe marrëdhënie shkak-pasojë. Marrëdhënia kuptimore shkak-pasojë që krijojnë lidhëzat këpujore në tekst shfaqet në këto fjali:

„**E** nai tsotsa k'ään **en** i päikin ði paika l'ot atij djalit n fätše”..

„**Und** da weint das Mädchen **und** zwei von ihren Trännentropfen träufeln dem Knaben ins Gesicht..”

„**E** na vjen ni džärpen e hipen per lisit, t haje zödzt e karakošit **en** ai djali ngrähet **ene** e pret at džärpnin “..

„**Und** sieh! da kommt eine Schlange **und** sie kriecht auf die Eiche, um die Junge des Adlers zu fressen; **und** unser Knabe springt auf **und** er schlachtet jene Schlange ab”...

Po të krahasohet fjalia e parë në shqip me atë të tekstit gjermanisht mund të konstatohet se konektorët që krijojnë marrëdhënie shtesore, në të dyja këto fjali në pikëpamje semantike shprehin marrëdhënie shkakore, meqë në këtë rast lidhëza „en” mund të zëvendësohet me lokucionin lidhëzor „për këtë shkak”. Ndërkaq, nëse

krahasohet fjalia e dytë e shqipes me fjalinë e tekstit të përkthyer , do të vërehet se edhe në këtë rast konektori, që shpreh marrëdhënie shtuese „ene”, fjalisë së dytë i jep kuptim shkakor, kurse sa i përket konektorit „und” të gjermanishtes, gjegjësisht marrëdhënies semantike që ai shpreh, në këtë rast del si konektor kundërshtor sepse lidhëza „und” ka kuptimin e lidhëzës „aber”.

Duke pasur parasysh marrëdhëniet semantike që shprehin lidhëzat bashkërenditëse këpujore mund të thuhet se në këtë tekst ato paraqesin dhe marrëdhënie kohore:

„**E** na i vret t di vlaznit e vet **ene** bön ştat dit mört **en** ai bön ştat dit dārsn .....

„**Und** jener tötet seine zwei Brüder **und** veranstaltet sieben Tage hindurch ein Leichenfest, **und** dann feiert er sieben Tage hindurch sieben Tage Hochzeit,...

Nga gjithë kjo që u tha më lart, del se marrëdhëniet shtesore të realizuara përmes lidhëzave bashkërenditëse këpujore në këtë tekst, në pikëpamje të strukturës morfologjike janë fjalë të thjeshta dhe përdoren në tri forma „e”, „en”, „ene”, të cilat në tekstin në gjuhën gjermane janë dhënë vetëm me lidhëzën „und”. Në pikëpamje sintaksore ato në të dy gjuhët lidhin fjali apo gjymtyrë brenda fjalive. Ndërkaq, duke u mbështetur në kuptimet e fjalive që ato bashkojnë, këta konektorë krijojnë dhe marrëdhënie shkakore, kohore e kundërshtore në tekst.

**21.** Shembull tjetër i përkthyer në gjermanisht nga Lamberci, në të cilin hulumtohen lidhëzat që krijojnë marrëdhënie shtesore, është tregimi i Jakov Xoxës „Kurorat e Masar Beut”. Lidhëzat bashkërenditëse këpujore të shtrira në tërësinë e këtij teksti janë lidhëzat e, dhe, edhe. Këto forma të lidhëzave janë të dialektit toskë të shqipes, të cilat dallohen për nga ndërtimi prej formave e, en, ene të përdorura në tekstin e

përrallës së shqyrtuar mësipër. Mirëpo, edhe pse kanë ndërtim paksa më ndryshe, për nga kuptimi janë të njëjta. Duke shqyrtuar kuptimet e lidhëzave këpujore, shihet se ato në tekstin e diskutuar në shumicën e rasteve përdoren duke krijuar marrëdhënie shtesore. Struktura dhe kuptimi i marrëdhënies shtesore, që realizohet përmes këtyre lidhëzave në tekst rendit veprimet, ngjarjet dhe faktet e paraqitura në të. Marrëdhënia shtesore, e cila ndërton renditje të tillë të zhvillimit të ngjarjes kryesore apo syzheut të këtij tregimi spikatet në këto fjali të tekstit:

„Kur u rrit Masar Beu **dhe** mbushi dhjete vjetet, dadoja, duke e krehur nje dite, i tha se kishte dy kurora ne maje te kokes.”

„Als Masar Beg heranwuchs **und** volle zehn Jahre alt geworden war, da sagte die Kinderfrau, als sie ihn eines Tages kämmtte, zu ihm daß er zwei Kränze oben auf seinem Kopfe hatte.”

„Aq i kenaqur mbeti nga pritja e Masar Beut, sa kur vuri kemben ne yzengji per te shkuar i tha te hapte gojen **dhe** t’i kerkoje ç’ti doje e bardha zemer”.

„So befriedigt war dieser von der Aufnahme bei Masar Beg, daß er, als er seinen Fuß in den Steinbügel setzte, um fortzureiten, dem Masar sagte, er möge nur seinen Mund öffnen **und** möge von ihm verlangen, was sein Herz begehre.”

Krahas marrëdhënies së mirëfilltë shtesore, e cila ndërtohet me anë të lidhëzave bashkërenditëse këpujore e, dhe, edhe, në tekst, këto lidhëza realizojnë edhe marrëdhënie shtesore-kundërshtore mes fjalive që i bashkojnë. Kështu, në kuptim shtesor – kundërshtor janë fjalitë:

„Pive ne te Turqise dhe s’u ngope; pive ne te Shqiperise dhe s’te zuri, pive ne te Italise sa desh plase”.

„Du hast getrunken an den Brüsten der Türkei **und** bist nicht satt geworden; du hast getrunken an den Brüsten Albaniens **und** auch das war dir noch nicht genug, du hast getrunken an den Brüsten Italiens, soviel du wolltest, bist satt geworden bis zum Zerplatzen”

Sikurse tri fjalitë e para, në të cilat marrëdhënia shtesore është e barasvlershme si në tekstin shqip edhe në tekstin gjermanisht, poashtu edhe në dy fjalitë vijuese që shprehin marrëdhënie shtesore-kundërshtore në gjuhën shqipe dhe në gjuhën gjermane, mund të thuhet se kjo marrëdhënie është e njëjtë. Pra, në të dy rastet ka mundësi që fjalitë, përveçse me lidhëzat këpujore edhe, dhe të shprehen dhe me lidhëzën kundërshtore „por” ose „aber”.

Dhe së fundi, lidhëzat këpujore e, dhe, edhe, të përdorura në tekst krijojnë dhe marrëdhënie shtesore me vlera shkakore. Marrëdhënie të tilla në tekst krijohen në këto fjali:

„Asnje nuk u ngrit ta pershendese **dhe** ketu beut nuk i erdhi mire.”

„Keiner erhob sich um ihn zu begrüßen, **und** hier wurde es dem Beg etwas übel zumute”

„Kur te pish ne dy sisa bashke do te behesh vali, o bej ! **dhe** qeshi me te dy bulçite duke ngritur dhe ulur koken nga gazi i math.”

„Wenn du an zwei Brüsten zugleich trinken wirst, dann wirst du Vali werden, Beg! **Und** er lachte mit seinen beiden Backen, indem er den Kopf hob und senkte von Freude.”

Nga analiza e lidhëzave këpujore si konektë të marrëdhënies shtesore në tekstin „Kurorat e Masar Beut”, në të dy gjuhët shihet se përdorimi i këtyre konektëve krijon marrëdhënie shtesore me vlerë shkakore. Këta konektë të tekstit shqip kanë mundësi të zëvendësohen dhe me lokucione lidhëzore me kuptim shkakor në gjuhën shqipe dhe me lidhëza shkakore në gjuhën gjermane.

## ***6.2. Tekstet e analizuara me lidhëza që krijojnë marrëdhënie kundërshtore***

Autorë të gramatikave shqipe si J.Rrota, K.Cipo, S.Floqi etj., duke trajtuar lidhëzat bashkërenditëse kundërshtore përmendin llojet dhe funksionet e tyre. Kështu, Rrota (1942:28) konsideron se marrëdhënie kundërshtore shprehin lidhëzat por, po, porse, veç, veçse, a por (a po), vetëm përkundrazi, megjithkëta, por, ase, ja se, ndo-ndo, përndryshe etj. Duke përkufizuar karakterin kundërshtor të tyre, ai mendon se këto lidhëza, përveç marrëdhënieve kundërshtore, bëjnë dhe ngushtim apo kufizim kuptimi. Kurse, S.Floqi në grupin e lidhëzave bashkërenditëse kundërshtore rendit lidhëzat po, por, porse, ndërsa, kurse. Por, marrëdhëniet kundërshtore sipas tij shprehen edhe me anë të pjesëzave-lidhëza, siç janë veç, vetëm se, veç se. Nisur nga ky fakt, ai dallon katër marrëdhënie kundërshtimi: marrëdhënie përjasjeje dhe kundërvënieje, marrëdhënie kundërshtore të

mirëfillta, marrëdhënie lejore dhe marrëdhënie kundërshtore kufizuese (1966:4). Edhe në Gramatikën e gjuhës shqipe (2002:406) në grupin e lidhëzave kundërshtore hyjnë lidhëzat kurse, megjithatë, megjithkëtë, mirëpo, ndërsa, teksa, po(r), porse, veç, veçqë, veçse, vetëm, vetëm se etj. Duke trajtuar marrëdhëniet, që këto lidhëza krijojnë mes fjalive apo gjymtyrëve të tekstit, ato shprehin marrëdhënie kundërshtore, përqsore-kundërshtore ose kundërshtore-kufizuese.

Në dy tekste të përzgjedhura për analizë të lidhëzave që shprehin marrëdhënie kundërshtore i kemi gjetur llojet e disa prej tyre duke u fokusuar në marrëdhëniet kundërshtore që ato shprehin në këto tekste.

**22.** Në tekstin „Në Parkun e Lirisë” të Shefqet Musarajt, të përkthyer nga Lamberci në gjermanisht, lidhëzat e përdorura nga autori, si shenja të rëndësishme tekstformuese kohezive apo të sipërfaqes së tekstit, krijojnë katër lloje marrëdhëniesh kundërshtore mes fjalive. Marrëdhëniet që shprehin ato në këtë tekst janë: marrëdhënia përqsore-kundërshtore, marrëdhënia kundërshtore e mirëfilltë, marrëdhënia kundërshtore-kufizuese dhe marrëdhënia lejore. Në bazë të zërthimit të tekstit, shihet se marrëdhënia përqsore-kundërshtore është përdorur më shpesh, gjithsej 3 herë, kurse në gjermanisht 2 herë:

„Pese frenga ! – mendonte Micoli i vogel, duke e veshtruar ne sy kryeplakun. – Pese frenga ! Domethene afro njezet koqe ve, *kurse* pula te shkreten, s’ka as pese dite qe ka nisur te pjelle.”

„Fünf Franken! dachte der kleine Micoli, indem er dem Dorfältesten in die Augen schaute. Fünf Franken! das heißt fast 20 Stück Eier, *obwohl* doch unser Huhn, das arme, seit fast fünf Tagen nicht mehr angefangen hat, Eier zu legen.”

„Micoli i shikonte me vrejtte, *po* kryeplaku s’e kish çkeputur akoma davane.”

„Micoli betrachtete sie mit Aufmerksamkeit, **aber** der Dorfälteste hatte den Streit mit ihm noch nicht abgebrochen.“

„Një dimer i forte duket se do te vije, **po** prendvera e re nuk eshte lark.“

„Ein harter Winter scheint bevorzustehen, **aber** der neue Frühling ist nicht weit.“

Të tre shembujt e shkëputur nga teksti shqip „Në Parkun e Lirisë“ shprehin marrëdhënie përqsore – kundërshtore. Në tekstin e përkthyer dy shembujt e fundit, ku fjalitë lidhen mes tyre me lidhëzën „**aber**“, janë poashtu fjali përqsore-kundërshtuese. Ndryshe nga fjalia e parë e tekstit shqip, e cila shpreh marrëdhënie përqsore-kundërshtore, në tekstin gjermanisht jepet me lidhëzën lejore (konzesive Subjunktion) „**obwohl**“.

Me marrëdhënie të tjera, siç janë: marrëdhënia e mirëfilltë kundërshtore, marrëdhënia kundërshtore kufizuese dhe marrëdhënia kundërshtore lejore dalin këto fjali në tekstin shqip të këtij tregimi:

„Edhe une mbase e kam litarin ne gryke, **po** s’me pyet njeri“

„Auch ich habe vielleicht den Strick am Halse , **aber** es fragt mich niemand“.

„Jo se kish pasuri, se ai merr që me hake per te leruar arat me keq nga neve, **por** nuk ja mbante zemra te mirrte miser ose para nga ata qe s’kishin fare.“

„Nicht, daß es bei ihm etwa Reichtum gewesen wäre, denn er nimmt Rinder gegen Bezahlung, um seine Felder schlechter zu pflügen als wir, **aber** sein Herz konnte es nicht ertragen“

„Ajo një djalë të vetem ka, Micolin, per të ushqyer. **Po** megjithate, bie bretku ne pune.“



„Sie hat einen einzigen Sohn zu ernähren, den Micoli. **Aber** trotzdem, sie hat Glück bei der Arbeit.”

Në mbështetje të kuptimeve që junktorët, gjegjësisht konektorët apo lidhëzorët u japin fjalive në tekst, shihet se në dy rastet e para të përkthyer në gjermanisht ata shprehin marrëdhënie kundërshtore të mirëfilltë. Ndërkaq, në fjalinë e fundit si në tekstin shqip ashtu edhe në tekstin në gjuhën gjermane lidhëzat kundërshtore „por-aber” realizojnë kuptime kundërshtore lejore.

23. Teksti i radhës „Permi drangonin”, ku përqendrohemi në hulumtimin e lidhëzave kundërshtore është gojëdhënë demonologjike. Në të si dhe përgjithësisht në përrallat popullore, të cilat Lamerci i kishte mbledhë vetë nga populli dhe i përktheu në gjermanisht, lidhëzat që krijojnë marrëdhënie kundërshtore kanë më tepër karakter kundërshtor shtues dhe më pak kundërshtor të mirëfilltë. Në vazhdim paraqiten disa raste, të shkëputura nga ky tregim i shkurtër me lidhëza kundërshtore me karakter shtues:

„N’i bab nuk kishte fëmij. **Por** mas n’a disa ditë i fali Zoti një djal”

„Ein Vater hatte keine Kinder. **Aber** nach einiger Zeit schenkte der Herr ihm einen Sohn.”

„Djali u rit, u ba i maḡ, por kur ishte djam e vetim, kë u zdukte prej shpjet e shkote me at venn, ku ishte lufta ma e maḡe me kulshedren. **Por** kë djali sün urü’tš e ban luft me té.”

„Der Knabe wuchs heran, wurde groß, aber wenn es donnerte und blitzte, dann verschwand der Knabe aus dem Hause und dann pflegte er an jenen Ort zu gehn, wo der Kampf mit der Kulschedra am größten war. **Aber** unser Knabe greift schneidig an und kämpft mit ihr.”

Po t'i krahasojmë kuptimet e fjalive të shprehura me lidhëza kundërshtore mund të përfundohet se lidhëzat kundërshtore „por” në shqip dhe „aber” në gjermanisht janë të barasvlershme, sepse shprehin marrëdhënie kundërshtore – shtuese.

Nga tekstet e diskutuara të shqipes, të cilat Lamberci i përktheu në gjermanisht lidhëzat kundërshtore në tekstet e letërsisë së shkruar për nga llojet janë shumë më të pranishme se sa në përralla dhe në gojëdhëna. Ky konstatim del jo vetëm nga përçasja e këtyre dy tregimeve, por edhe nga hulumtimi i krijimeve të tjera letrare dhe folklorike që i kishte përkthyer Lamberci në gjermanisht.

### ***6.3. Tekstet e analizuarra me lidhëza që krijojnë marrëdhënie shkakore***

Lidhëzat që krijojnë marrëdhënie shkakore mes fjalive janë trajtuar në të gjitha gramatikat e gjuhës shqipe. Me këtë çështje janë marrë gjuhëtarë si K.Cipo, S.Floqi, M.Domi, I.Sheperi, J.Rrota, A.Xhuvani etj. Këta autorë dakordohen se fjalia shkakore tregon shkakun apo arsyen e një ngjarjeje a të një veprimi.<sup>225</sup> Sipas Ilo Dilo Sheperit, lidhëzat dhe lokucionet lidhëzore më të përdorura në gjuhën shqipe janë lidhëzat se, që, dhe lokucionet lidhëzore me qenë se, me që. Mirëpo, Sheperi shpreh dhe mendimin se shkakun në fjali mund të realizohet edhe me anë të lidhëzave kohore.<sup>226</sup> Ndërkaq, S.Floqi dallon disa tipa semantiko-strukturorë të fjalive, të cilat bashkohen me lidhëzat sepse, se, që, pse: fjalitë shkakore të drejtpërdrejta, fjalitë shkakore argumentuese të konkluzionit, fjalitë shkakore argumentuese të urdhërit, fjalitë shkakore të thënies së kushtëzuar, fjalitë shkakore-shtesore dhe ndërmjetëse, fjalitë shkakore të vlerësimit dhe fjalitë shkakore të

<sup>225</sup> Floqi,S., Periudha me fjali të varur shkakore, Studime filologjike, nr.2, 1966, f.4; Cipo,K., Sintaksa, Tiranë, 1952; Rrota,J..., Sintaksa e gjuhës shqipe, Shkodër, 1943.f.84

<sup>226</sup> Sheperi,D., I., Gramatika dhe sindaksa e gjuhës shqipe, Vlorë, 1927, f.193

ndjenjës.<sup>227</sup> Ndërsa, Gramatika e gjuhës shqipe (2002:408), siç është parë, zgjeron spektrin e lidhëzave që ndërtojnë marrëdhënie shkakore. Lidhëza të mirëfillta shkakore, me të cilat shprehet shkak në gjuhën shqipe janë lidhëzat: sepse, ngaqë, meqenëse, meqë, nga shkak se, nga shkak që, nga frika se, për shkak se, për arsye se, përderisa, duke qenë se, duke qenë që, duke marrë parasysh se, duke marrë parasysh që etj. Mirëpo, si konektorë të shkakut mund të merren dhe lidhëzat e lokucionet kohore si: kur, tek, mbasi, pasi, posa, sapo, gjersa, derisa, sakohë që, qëkur, qëkur se etj. Si konektorë që bëjnë lidhjen e fjalive shkakore dhe që krijojnë marrëdhënie shkakore janë edhe ndajfoljet e shkakut. Në këtë grup të konektorëve të shqipes hyjnë: për këtë shkak, për këtë arsye, për këtë qëllim. Dhe së fundi, në grupin e konektorëve me marrëdhënie shkakore mund të konsiderohen edhe lidhëzat rrjedhimore përmbyllëse si: prandaj, andaj, ndaj, pra, kështuqë, në mënyrë që, sa, aq sa, që etj.

Në tekstet e analizuara më poshtë do të hulumtohen fjalitë shkakore, në të cilat marrëdhënia shkakore ndërtohet me anë të lidhëzave e lokucioneve shkakore, lidhëzave e lokucioneve kohore që tregojnë shkak, ndajfoljeve shkakore, lidhëzave rrjedhimore e përmbyllëse, të cilat poashtu shprehin shkak.

**24.** Në tregimin „Pajtim në gjak” të Zihni Sakos, të përkthyer nga Lamerci në gjermanisht, janë përdorur dendur konektorët shkakorë: se, se mbase, prandaj, si shenja tekstore që bëjnë lidhjen e fjalisë kryesore me fjalinë e varur shkakore. Gjatë analizës së bërë në tekst, duke u mbështetur në kuptimin semantik dhe ndërtimin strukturor të fjalive, ato në këtë rast dalin si:

1. Fjali shkakore argumentuese të pyetjes:

---

<sup>227</sup> Sheperi, D., I., vepra e cit., f.9

„Kush e di ku e ka zene gjumi ... dhe doli lemenjeve ta kerkonte, *se* kush e di ç'ngjante”

„Wer weiß, wo ihn der Schlaf gepackt hat ... und sie ging von den Tennen weg, um ihn zu suchen, *denn* wer weiß was ihm zugestoßen sein konnte”.

„Kush e di tha *se* mos ka vatur te partizanet.”

„Wer weiß, sagte sie, *ob* er nicht zu den Partisanen gegangen ist.”

Këto fjali të varura shkakore të ndërtuara me lidhëzën „se” në tekstin shqip, që realizojnë marrëdhënie shkakore, përligjin dhe motivojnë këto pyetje dhe tregojnë arsyen përse bëhet pyetja. Ndërkaq, në tekstin e përkthyer fjalia e parë është dhënë me lidhëzën „denn” e cila tregon shkakun e veprimit, kurse në rastin e dytë është përkthyer me lidhëzën e fjalive të varura pyetëse (Interrogativnebensätze) „ob”,

## 2. Si fjali shkakore të vlerësimit:

„Por qe kur qe rritur Çunia, u kishte hypur dridhma *se* thoshin qe ishte gjarper ...”

„Aber seitdem Çunia erwachsen war, war die Frucht gestiegen, *denn* man sagte, er sei eine Schlange ...”

Fjalitë e mësipërme të tekstit shqip janë fjali shkakore të vlerësimit, që krijojnë marrëdhënie shkakore mes fjalisë kryesore dhe fjalisë së varur. Fjalitë e varura shkakore të ndërtuara me lidhëzën „se” tregojnë shkakun e veprimit të fjalisë kryesore duke e

vlerësuar atë. Në tekstin e përkthyer në fjalinë e parë, marrëdhënia shkakore është realizuar me lidhëzën e mirëfilltë shkakore „denn”.

3. Si fjali shkakore e drejtpërdrejtë:

„Llazo Mertiri kishte pasur nje hasmeri te vjeter, nga capkenllek i tij. Po nje here e nje kohe nuk e hanin dot *se* ishte djal që të mir gjak n vetull”.

„Llazo Mertiri hatte eine Feindschaft gehabt infolge seiner schelmischen Natur. Aber gar so schnell ging es nicht, sie konnten ihn nicht umbringen, *denn* er war ein Bursche, mit dem es nicht gut anzubinder war.”

Fjalia e varur shkakore e drejtpërdrejtë e shqipes e ndërtuar me lidhëzën „se” në këtë tekst tregon shkakun e fjalisë kryesore në mënyrë të drejtpërdrejtë duke krijuar marrëdhënie shkakore mes fjalisë kryesore dhe fjalisë së varur. Në tekstin gjermanisht kjo fjali është përkthyer me lidhëzën shkakore të mirëfilltë „denn”,

4. Si fjali shkakore përmbyllëse:

„Edhe ate nate s’kishte besuar Llazo Mertiri, *prandaj* flinte atje pas qipis, me kashte, i qete e s’u kthye as nje here ne krahun tjetet.”

„Auch jene Nacht hatte Llazo Mertiri kein rechtes Vertrauen gehabt, *darum* schließt er dort hinter einem Strohhaufen ganz ruhig und drehte sich auch nicht einmal auf die andere Seite.”

„S’ka gje! kemi hasmeri te vjeter une dhe ay, *prandaj* s’foli”

„Das hat nichts zu sagen! Wir haben alte Feindschaft miteinander, ich und jener *darum* hat er nichts gesagt.”

Fjalitë shkakore të realizuara me anë të lidhëzës rrjedhimore përmbyllëse „prandaj” shfaqin në të dy rastet e tekstit shqip rrjedhën dhe përmbylljen e veprimit të fjalisë kryesore duke paraqitur shkakun e veprimit. Në tekstin në gjuhën gjermane këto fjali janë dhënë me ndajfoljen prepozicionale (Präpositionaladverb) „darum”.

## **7. VËSHTIM I PËRGJITHSHËM I PËRDORIMIT TË SHENJAVE NOMINALE, DETERMINANTËVE DHE REFERENTËVE TË TYRE**

Në këtë pjesë të punimit jemi përqendruar në përdorimin e shenjave nominale në tekstet shqipe dhe në tekstet e përkthyer nga Lamberci në gjermanisht. Në kuadër të këtyre shenjave janë bërë përpjekje që në disa tekste të përzgjedhura të gjurmohen determinantët e shenjave nominale dhe përdorimi i shenjave referenciale të emrit.

Derisa shenjat verbale dhe konektorët janë bërë përpjekje të hulumtohen më gjerësisht në tekstet shqipe dhe ato të përkthyer, hulumtimi i shenjave emërore, determinantëve dhe shenjave referenciale të emrit në tekste janë trajtuar më shkurtimisht.

### ***7.1. Shenjat nominale, determinantët dhe referencat e tyre në tekste***

Emri si shenjë gjuhësore është ndër klasat më të rëndësishme të shenjave të gjuhës dhe njëherit bartës i informacioneve (Informationsträger) në tekst. Dy nënklasat kuptimore të emrave janë emrat e përveçëm (Eigennamen), me të cilët identifikohet emri i një personi a sendi dhe emrat e përgjithshëm (Gattungsnamen), kuptimi i të cilëve përfshin një masë (Umfang) dhe përmbajtje më të gjerë (Inhalt). Emrat për nga forma lidhen me kategorinë gramatikore të gjinisë (Genus des Nomens), numrit (Numerus des Nomens) dhe rasës (Kasus des Nomens). Gjuha gjermane dhe gjuha shqipe kanë tri gjini të emrit: gjinisë mashkullore (Maskulin), femërore (Feminin) dhe asnjansë (Neutrum). Përkundër kategorisë së gjinisë së emrit, koncepti numër (Numerus) i emrit përmbledh një opozicion binar: njëjës (Singular) dhe shumës (Plural). Dhe së fundi, rasa shprehet me lakimin e nyjave si konstituent apo formativ flektiv („efektiv”) i lakimit rasor. Kurse, vetë emri është konstituent fragmentar („defektiv”) i lakimit rasor. Një çështje tjetër shumë e rëndësishme që lidhet me emrin është dhe përcaktimi i tij nga determinantët e ndryshëm në grupin nominal siç janë: emrat e tjerë, përemrat, nyjat, nga të cilat shenja gjuhësore, emri ka varësi referenciale (Referenzzusammenhang).

Emri përcaktohet nga determinantë të ndryshëm, të cilët në tekst shfaqen si atributë. Këta atributë dalin të paravendosur (präterminierende Attribute) dhe të prapavendosur në raport me emrin (postterminierende Attribute). Emri së bashku me atributët e tij, të para ose të pasvendosur në tekst formon grupin nominal (Nominalgruppe). Si atribut të paravendosur mund të vëhen adjunktët prepozicionalë (Präpositional-Adjunkte), adjunktët në gjinore (Genitiv-Adjunkte) dhe adjunktët relativë (Relativ-Adjunkte). Ndërkaq, si atributë të pasvendosur mund të jenë: adjunktët në gjinore (Genitiv-Adjunkte), adjunktët prepozicional (Präpositional – Adjunkte), adjunktët lidhëzorë (Konjunktional – Adjunkte), adjunktët në paskajore (Infinitiv-Adjunkte),

adjunktët relativë (Relativ-Adjunkte) dhe ndajfoljet atributive (attributive Adverben). Aributi i pasvendosur njihet si apozicion (Apposition).<sup>228</sup>

Gjatë aktit të komunikimit roli i dhënësit dhe i marrësit determinohet si negativ, ngaqë situata nuk u referohet këtyre dy faktorëve kontekstualë. Që të sqarohet kjo dukuri është shumë i rëndësishëm roli referencial, i cili në tekst jep referencën me referentë të ndryshëm. Si referencë e precizimeve semantike paraqitet roli referencial të gjithë emrat dhe përemrat që dalin në tekst. Referentët e tekstit hetohen me anë të përsëritjeve tekstuale (textuelle Rekurrenz). Forma më e thjeshtë e rekurrencës është përsëritja e emrave të njëjtë. Ndërkaq, format më komplekse të rekurrencës janë konstituivët e tematikës tekstuale (konstituive für die textuelle Thematik) dhe kuazi-përsëritja (Quasi-Rekurrenz). Si përbërës të tematikës tekstuale janë përsëritja e emrave në tekst përmes emrave të tjerë me kuptime të ngjashme. Kurse, kuazi-përsëritja është përdorimi i një vargu emrash të ndryshëm me kuptime të njëjta a të ngjashme. Këto mjete të ndërtimit të tekstit janë mjete stilistike.<sup>229</sup>

**25.** Në tekstin e këngës „Martesa e Halilit”, i përkthyer nga Lamberci në gjermanisht, krahas shenjave të tjera tekstore, rëndësi të madhe kanë dhe shenjat tekstore nominale. Teksti në fjalë, përderisa në gjuhën shqipe është tekst në vargje, në gjuhën gjermane është dhënë në prozë. Në këtë tekst, përbërës të kohezionit krahas shenjave të tjera tekstore janë emrat, determinantët e emrit, referencat e emrit, elementet konstituive të tematikës tekstuale (format komplekse të përsëritjes së emrit në tekst) dhe kuazi-përsëritjet. Emrat në këtë tekst dhe përgjithësisht në tekstet e tjera shqipe, në të shumtën e rasteve janë të paravendosur, krahasuar me determinantët e tyre. Në disa raste në tekst emrat kanë dhe pozicion nistor në varg. Pozicionin nistor të tyre në fjali, gjegjësisht në varg, në këtë tekst e përcakton natyra e tekstit si krijimtari poetike. Paravendosja e emrit në raport me

<sup>228</sup> Weinrich, H., vepra e cit., f.317-367

<sup>229</sup> Weinrich, H., vepra e cit., f.368-371



determinantët e tij, gjegjësisht me mbiemrin dhe emrin në gjinore paraqitet në këto vargje:

„ Se gjith grát e krahinës, ku janë,

„ Se gjith vashat e Jutbinës, ku janë,

„ Bash si motra qi po m’duken.”

„ Alle Frauen unseres Landes, alle Mädchen von Jutbina sind mir wie Schwestern”

„Po s’e mora Tanushën e krajlit”

„ Sterben will ich, wenn ich nicht Tanusha, die Tochter des Königs, zur Frau gewinne”

„Shteku i ballit, si shteku i malit,

„ ..., die Mittellinie ihrer Stirn ist wie der Pfad über einen Berg ...”

„Hunda ndrejt, si kalëmi i Tushës !”

..., ihre Nase gerade wie der Gewehrlauf aus der Werkstatt des Waffenschmiedes Tusha, ...”

„E ka qërpikun, si krahi i dallendyshës ;”      ..., ihre Augenlider wie  
Schwalbenflügel, ...”

„ Dhâmët e bardhë, si gurzit e lumit,”      , ihre Zähne weiß, wie die Kieselsteine des  
Flusses nach dem Regen, ...”

„ Syni i saj, si kokrra e qershís ;”      ..., ihr Auge wie die Kirsche , ...”

„Qafa e saj, si qafa e pllumbit:”      „ ..., ihr Hals wie der Hals der Taube , ...”

„ Goja e vogël, si lulja qi shpërthen ;”      „..., ihr Mund klein wie die Blüte , ...”

„Misht e dorës, porsì rrêmi i shemshirit” „... das Fleisch ihrer Hand wie die Blüte der Myrte!”

Në shembujt e analizuar shihet se detereminantët e emrit në tekstin shqip të shoqëruar me emër në gjinore ose dhe me mbiemër, në tekstin e përkthyer në gjermanisht barten me emër në gjinore, me mbiemër, por ka raste kur emri nuk shoqërohet fare nga determinantët e tij

„Syni i saj, si kokrra e qershís ;” „... ihr Auge wie **die Kirsche** ,...”

Në disa raste në këtë tekst emrin në gjinore Lamberci e përkthen me kompozitë:

„E ka qërpikun, si krahi i dallendyshës ;” „... ihre Augenlider wie Schwalbenflügel, ...”

Shenjat emërore si shenja tekstndërtuese në këngën „Martesa e Halilit” shoqërohen dhe me shenja referenciale, me anë të të cilave realizohet dhe ndërtohet tërësia kuptimore integrale e tekstit. Shenjat referenciale të emrit në tekstin në fjalë dalin në këto vargje:

„Vetulla e saj ndrejt si fiskaja;” Ihre Augenbrauen sind wie ein junger Eichenwald,..”

„Syni i saj, si kokrra e qershís ;” „... ihr Auge wie die Kirsche ,...”

„Qafa e saj, si qafa e pllumbit;” „... ihr Hals wie der Hals der Taube ,...”

„Shtati i saj, si ‘ i shtat çetinet;” „ ..., ihr Körper wie der Fichtenstamm ,...”

Shenjat refernciale të emrit si në tekstin shqip ashtu edhe në tekstin e përkthyer dalin me përemra pronorë, të cilët përshtaten me shenjat nominale në gjini dhe në numër. Mund të thuhet, se pozicioni i shenjave refernciale të përemrit në tekstin e analizuar të shqipes dallon nga pozicioni që zënë shenjat refernciale në tekstin e përkthyer. Këto shenja në tekstin shqip janë të vendosura pas emrit në të gjitha rastet, kurse në tekstin në gjuhën gjermane gjithherë janë të vendosura para emrit.

Kuazi-përsëritjet e shenjave nominale kanë rëndësi të madhe në tekst, sidomos në strukturën e teksteve me vlerë letrare poetike, sepse realizojnë efekte artistike me karakter krahasues dhe metaforik dhe janë përbërës të stilit të këngës. Në këtë tekst kuazi-përsëritjet të shenjave nominale janë shprehur këto vargje :

„Vetulla e saj ndrejt si fiskaja;” -Ihre Augenbrauen sind wie ein junger Eichenwald,..”

„ Syni i saj, si kokrra e qershís ;” „ ..., ihr Auge wie die Kirsche ,...”

„ Ftyra e saj, si kuqet molla n’degë ;” „ ..., ihr Gesicht wie der Apfel ,...”

„Hunda ndrejt, si kalëmi i Tushës !”

„ ..., ihre Nase gerade wie der Gewehrlauf aus der Werkstatt des Waffenschmiedes Tusha,...”

„ Goja e vogël, si lulja qi shpërthen ;” „ ..., ihr Mund klein wie die Blüte ,...”

Nga gjithë ky vlerësim që u bë më lart mund të shtojmë se kohezioni i tekstit „Martesa e Halilit” realizohet në mbështetje të shumësisë së shenjave kohezive tekstore,

të cilat krijojnë lidhje të fortë midis fjalëve, fjalive dhe të tërë tekstit. Në këtë mënyrë gjithë koneksioni i shenjave tekstore ndërton koherencën e kësaj kënge. Duke u mbështetur në ndërtimit të kohezionit të këtij teksti poetik narrativ shihet se emrat, determinantët dhe shenjat referenciale të emrit e përshkojnë atë nga fillimi deri në fund:

- si determinantë të emrit në tekstin në fjalë dalin këta shembuj -gratë e krahinës (Frauen unseres Landes), vashat e Jutbinës (Mädchen von Jutbina), Tanushën e Krajlit (Tochter des Königs), krahi i dallëndyshes (Schwalbenflügel), kokrra e qershis (die Kirsche), qafa e pllumbit (Hals der Taube), goja e vogël (ihr Mund klein), dhâmt e bardhë (ihre Zähne weiss), gurzit e lumit (die Kieselsteine des Flusses),

- si shenja kohezive referenciale të emrit në tekst dalin këta shembuj – vetulla e saj ( ihre Augenbrauen), syni i saj ( ihr Auge), qafa e saj (ihr Hals), shtati i saj (ihr Körper),

- si kuazi-përsëritje shembujt :

„Hunda ndrejt, si kalëmi i Tushës !”

..., ihre Nase gerade wie der Gewehrlauf aus der Werkstatt des Waffenschmiedes Tusha,...

„ Dhâmët e bardhë, si gurzit e lumit,”

, , ihre Zähne weiß, wie die Kieselsteine des Flusses nach dem Regen,...

„E ka qërpikun, si krahi i dallendyshës ;”

..., ihre Augenlider wie Schwalbenflügel, ...”

Ndërkaq, duke u mbështetur në përbërësit informativë të tekstit, gjegjësisht temës dhe remës, mund të theksohet se tema e rema si përbërës primarë të koherencës tekstore

shtrihen edhe në tekstin e këngës „Martesa e Halilit”. I tërë ky tekst përshkohet nga tipi i progresionit me temë prodhuese (Die Progression mit abgeleiteten Themen), ku nga fjalitë e veçanta konceptohet një hipertemë:

Shteku i ballit, si shteku i malit,

„Die Mittellinie ihrer Stirn ist wie der Pfad über einen Berg ...”

„Hunda ndrejt, si kalëmi i Tushës !”

„Ihre Nase gerade wie der Gewehrlauf aus der Werkstatt des Waffenschmiedes  
Tusha, ...”

„ Dhâmët e bardhë, si gurzit e lumit,”

„Ihre Zähne weiß, wie die Kieselsteine des Flusses nach dem Regen, ...”

„ Syni i saj, si kokrra e qershís ;”                    „Ihr Auge wie die Kirsche , ...”

„Qafa e saj, si qafa e pllumbit:”                    „Ihr Hals wie der Hals der Taube , ...”

„ Goja e vogël, si lulja qi shpërthen ;”                    „Ihr Mund klein wie die Blüte , ...”


„Misht e dorës, porsì rrëmi i shemshirit”

„Das Fleisch ihrer Hand wie die Blüte der Myrte!”


Të gjitha këto fjali realizojnë koherencën e tekstit duke u bërë progresion prodhues i disa temave, prej të cilave prodhohet një hipertemë. Hipertema bëhet e njohur nga temat e dhëna që në rastin tonë shfaq „bukuria e Tanushës – die Schönheit von Tanusha”. I gjithë ky progresion temash prodhuese mund të jepet edhe në mënyrë skematike dhe përfshinë

edhe informacionet e panjohura të temave, gjegjësisht remat (Rhemen) për secilën fjali veç e veç:

Hipertema (bukuria e Tanushës)



Hyperthema (die Schönheit von Tanusha)



26. Teksti tjetër në vijim, në të cilin do të shqyrtohen kuazi-përsëritjet dhe determinantët e shenjës nominale si shenja të rëndësishme tekstndërtuese është teksti i këngës „Koha e ré” nga vepra e Gjergj Fishtës „Lahuta e Malcis”. Analiza e kuazi-përsëritjeve si përbërës të rëndësishëm të stilit është shtrirë në tërësinë e tekstit në fjalë, në të cilin shihet se autori ka realizuar stilin e këngës duke përdorur një numër shenjash nominale. Këto shenja në tekst krijojnë kuazi-përsëritje dhe i referohen shenjës kryesore nominale për të cilën bëhet fjalë në të. Vargjet e këngës, gjegjësisht fjalitë e tekstit, ku spikaten kuazi-përsëritjet janë:

„ Arðun shtatit si << breshana >>”	„ Bist fo fchlank wie die Brefhána,”
„Rreze ðiellit ðora e llana,”	„Sonnenftrahlen deine Hände,”
„ Kama matë per gjeth të lilit,”	„ Abgemeffen an der Lilie Blatt dein Fuß ift”
„ Mori sumlla sumollore,”	„Holde, runde Blütenknofpe,”
„ Mori ðarðha ðimënore,”	„Süße Birne, Winterbirne,”
„A ðin shka moj gerxhelí,”	„Weißt du was, mein holdes Schelmchen?”
„Mori rrezja nper frangi:”	„Heller Sonnftrahl, der durchs Schießloch Eindringt in die finftre Kulla,”
„Se, perzét, kshtû, moj petritë,”	„Denn -- bei Gott ! –ich fürcht’ , mein Habicht,”

Në tekstin e analizuar të shqipes, përmes përsëritjes të shenjave nominale, realizohet një stil i veçantë me përmes të cilit përshkruhen ngjarjet dhe veprimet e tekstit.

Stili bëhet edhe më i veçantë duke u rimuar vargjet me njëra tjetrën. Ndërkaq, në tekstin e përkthyer, stili nuk është dhe aq i fuqishëm si në tekstin origjinal dhe Lamberci vargjet nuk i ka dhënë si të rimuara.

Në këngën „Koha e ré”, shenjat tekstore nominale në disa vargje dalin me determinantë, përdorimi i të cilëve shihet në këto raste:

„Ftyra shtrua n'fletë t'ðrandofillit,”	„ Dein Geficht wie Rofenblätter,”
„Kama matë per gjeth të lilit,”	„ Abgemeffen an der Lilie Blatt dein Fuß ift”
„Mori sumlla sumollora,”	„Holde, runde Blütenknofpe,”
„Mori ðarðha ðimënora,”	„Süße Birne, Winterbirne,”

Lidhur me determinantët e lartpërmendur të shenjave nominale, shihet se në tekstin shqip të këngës së analizuar në dy raste këto shenja dalin me emër në gjinore dhe në tri raste me mbiemër. Kurse, në tekstin e përkthyer, Lamberci determinantët e shenjës nominale i ka dhënë në tri fjali me kompozitë dhe në dy fjali me mbiemër.



## 8. STILI I TEKSTEVE TË ANALIZUARA

Në këtë kapitull është bërë përpjekje të trajtohet stili i teksteve, të cilat i kemi analizuar, qofshin ato krijime poetike apo edhe krijime letrare në prozë. Ndër krijimet poetike, në të cilat do të diskutohen çështje të stilit janë shembuj poemash të „Lahutës së Malcis”, një numër këngësh kreshnike, kurse nga krijimet në prozë janë marrë për t’u shqyrtuar në këtë drejtim përralla, gojëdhëna popullore dhe tregime nga letërsia e shkruar, të cilat Maksimilian Lamerci i ka përkthyer në gjuhën gjermane.

Stili poetik i këtyre krijimeve varet kryekëput nga vetitë dhe nga mënyra e përdorimit të gjuhës si në krijimet e shkruara prej autorëve të njohur, ashtu dhe në krijimet gojore. Gjatë trajtimit të kësaj problematike në radhë të parë është shqyrtuar rëndësia stilistike e shenjave verbale, konektorëve, rëndësia e shenjave nominale si dhe determinantëve dhe referencave të shenjave nominale.

Në punën e mëparshme hulumtuese që kemi bërë gjatë procesit të analizave tekstore, meqë tekstet e analizuara kanë karakter fiktiv, gjegjësisht letrar, është hetuar se

sidomos shenjat verbale kanë funksion të theksuar figurativ, që do të thotë se kanë rëndësi të posaçme në realizimin e stilit. Mirëpo, edhe shenjat e tjera tekstore, siç janë konektorët, të cilët bëjnë lidhjen sintaksore dhe semantike të mendimeve në tekst, poashtu kanë vlera gjuhësore – stilistike të ligjëritimit.

Meqenëse, tekstet e analizuara i takojnë gjinisë së krijimtarisë letrare epike në vargje dhe në prozë, rrëfimi dhe stili rrëfimtar, i shprehur sidomos me mënyrat e foljeve, por edhe me kohët e tyre, janë përcaktues të stilit të këtyre krijimeve.

### ***8.1. Folja – shenjë stilistike e teksteve të analizuara***

Folja, duke qenë qendër organizative e tekstit, ka forcë dhe potencial të veçantë stilistik në krijimtarinë imagjinative, gjegjësisht në krijimtarinë letrare. Ky konstatim i njohur i funksionit të foljes si shenjë verbale e tekstit vlen për krijimtarinë e gjithmbarëshme të Fishtës e sidomos kur është fjala për veprën madhore të tij „Lahuta e Malcis” si dhe për të gjitha tekstet e tjera që i kemi bërë objekt të analizave tona. Në vijim do të shqyrtojmë rëndësinë kuptimore themelore, gjegjësisht gramatikore dhe kuptimet e bartura figurative – stilistike në tekstet e analizuara. Së pari, do të përqendrohemi në shembujt e analizuar të poemave të Lahutës, ku mënyra dhe koha e foljeve kanë rëndësi të dorës së parë. Derisa mënyrat e foljes paraqesin raport subjektiv ndaj mendimit që shprehet, kohët e foljes tregojnë kohën e kryerjes së veprimit duke vendosur raportet me mënyrën. Kështuqë, përmes raporteve mënyrë-kohë krijohen vlera të fuqishme stilistike. Ndër mënyrat e foljes me ngarkesë të theksuar emocionale dhe stilistike në këngët e Lahutës dallohen sidomos mënyrat më të shenjëzuara apo më të markuara të verbit epik fishtian. Këtu hyn në radhë të parë dëshirorja, pastaj edhe urdhërorja dhe habitorja. Mirëpo, kjo nuk do të thotë se folja në mënyrën dëftore, lidhore

e kushtore nuk shpreh efekte ideoemocionale, gjegjësisht stilistike në poemat që i janë nënshtruar analizave tona.

**8.1.1.** Funkzioni stilistik i dëshirores në poemat e Lahutës shpreh ndjenja të fuqishme emocionale në formë urimi, mallkimi dhe betimi. Në këtë drejtim është e njohur shprehja e modalitetit të dëshirës me vlera kuptimore të urimit të Gjergj Fishtës. Këto vlera kuptimore të dëshirores në formë urimi janë krijime perla jo vetëm të poezisë së Fishtës, por në gjithë poezinë tonë të traditës, të krijuara me mjeshtri përmes verbit në optativ. Foljen në optativ, përmes së cilës Fishta realizon stilistikisht emocione të fuqishme, dhënësi e shpreh me anë të së tashmes së dëshirores, që ka kuptimin e së ardhmes. Ky funksion stilistik i foljes në optativ mund të shihet në këto vargje:

„ Letë u kjoftë mbí vorr leđina,	-,, Leicht fei auf dem Grab der Rafen
	Für die helden, die drin ruhen,
Butë u kjošhin moti e stina,	Lind fei ihnen Wetter, Jahr’szeit,
Akli, bora e serotina:	Eis und Sdnee und Sturmgewitter,
E ðer t’knðoje n’mal nðo’ i zânë,	Und folang noch einer Zâna <sup>230</sup>
	holdes Lied tönt in den Bergen,

<sup>230</sup> Zana është qenie mitike e besimeve popullore si dhe figurë e folklorit letrar shqiptar. Ajo përfytyrohet si vashë e bukur e pyjeve. Në veprën e Fishtës „Lahuta e Malcis”, në përrallat dhe në gojëdhënat popullore njihet si trimëshë dhe luftëtare e paepur. Ajo në këto krijime i ndihmon trimat epikë në aksionet e tyre luftarake. Por, krahas këtyre tipareve karakterologjike të saj në folklorin letrar dhe në besimet popullore është edhe hakmarrëse, kur trazohet nëse është duke pushuar pranë krojeve, gurave, nën mrize, maja malesh etj. Në „Lahutën e Malcis”, ajo e frymëzon Fishtën sikurse muza Homerin.

Në „Lahutën e Malcis”, në eposin e kreshnikëve dhe në përrallat popullore, zana është e njohur edhe me emrat shtojzovalle, të lumet e malit, nuset e malit, të mirat e malit etj., emra këta që kanë karakter eufemistik.

Lamberci në përkthimin e Lahutës, këngëve kreshnike, përrallave popullore, gojëdhënave etj., ku zanat janë personazhe të këtyre krijimeve, nuk i ka përkthyer fare në gjermanisht. Ai, poashtu nuk i ka përkthyer në gjuhën gjermane as emrat e figurave të tjera të besimeve popullore, siç janë kulshedra, dragoi, orët. Mendojmë se Lamberci nuk i ka përkthyer emrat e këtyre figurave të besimeve popullore, sepse në bazë të përmbajtjes së tyre që shprehet në këto krijime ia lë lexuesit gjerman që të gjykojë vetë për tiparet mitike të tyre, të cilat mund të mos jenë të njëjta me tiparet figurave gjegjëse mitike në mitologjinë gjermane.

E ðer t'ketë n'ðét ujë e rânë	Und folang' raufcht in dem Meere
	Waffers Woge, Sandes Fülle,
Dér sá t'shnðrisin ðiell e hânë	Salang' leuchten Sonn=und Mondlicht,
Ata kurr mos mos u harrojshin,	Soll'n fie unvergeffen bleiben,
N'kângë e n'valle por u knðojshin.”	Mögen fie befunen werden”

(L.M.,f.43-58)

(L.L., f.24)

Krahas vlerave të dhëna apo të shprehura në formë urimi, siç u pa nga vargjet e mësipërme të këtij teksti të Fishtës, përmes optativit në Lahutë shprehen stilistikisht edhe emocione që kanë vlerën e nëmave, mallkimeve apo anatemave. Me strukturë shprehëse stilistike në formë mallkimi, dëshirorja del në këto vargje të Lahutës:

„Hani ðjelm! e ju vraftë buka!

Eh ju vrafté buka e Dauletit;

Eh ju ðança ujët e ðetit,

Po s'u muer soð gjaku i Avðís,

Po s'i u kthye nðera Shqypnis”. (L.M. f.22-23)

„Mög'das Brot in Hals euch würgen!

Mög das Sultan Brot euch würgen!

Werd' in Hinkunst eueren Durst euch

Stillen mit dem Meeres Wasser,

Mit des Meeres salz'gem Wasser,

Wenn wir nicht noch heute Bleutrach'

Nehmen für den Tod des Avdi!" (L.M., f.24)

Në pjesën e parë të këtij punimi që shtrihet në katër kapituj janë dhënë konsiderata teorike për gjuhësinë tekstore dhe gjuhësinë kontrastive, çështje të tipologjisë së tekstit dhe konsiderata teorike për foljet dhe konektorët. Në fillim është folur për zhvillimin historik të gjuhësisë krahasimtare dhe kontrastive, për dallimet esenciale mes gjuhësisë historike krahasimtare apo komparativizmit dhe gjuhësisë kontrastive, me ç’rast është nënvizuar se e para, gjegjësisht gjuhësia komparative studion zhvillimin historik të gjuhëve të lidhura gjenetikisht mes tyre, pra ajo studion paralelizmat mes gjuhëve. Ndërkaq, e dyta, gjegjësisht gjuhësia kontrastive spikat në radhë të parë kontrastet apo dallimet mes gjuhëve, por duke mos lënë anash edhe ngjashmëritë që kanë dhe duke i studiuar ato gjithëherë në sinkroni. Në vazhdim të punimit trajtohen çështje problemore që lidhen me kuptimin e konceptit „tekst”, përkufizime mbi kohezionin dhe koherencën e tekstit dhe kriteret e tjera të tekstualitetit, ku jepen mendime të studiuesve të njohur të gjuhësisë së tekstit, të cilët kanë bërë përkufizime për tekstin si koncept themelor i gjuhësisë tekstore. Nga diskutimet e këtyre studiuesve rreth përkufizimit të tekstit del qartë se teksti është shenja më e madhe organizative e gjuhës, që definohet si njësi komunikative gjuhësore, me strukturë komplekse, e cila ka ndërvarësi tematike dhe konceptuale. Më tutje, në punim janë dhënë mendime të studiuesve të ndryshëm (Jakobson, O.Jeperson, D.Crystal, Halliday/Hasan, Beaugrande/Dressler, Weinrich, van Dijk, N.Janich, K.Brinker etj) për dy kriteret kryesore të tekstualitetit: kohezionin dhe koherencën si dhe për kriteret e tjera të tekstualitetit: synueshmërinë, pranueshmërinë, njoftueshmërinë, situacionalitetin dhe ndërtekstualitetin.

Në mbështetje të pikëpamjeve të këtyre studiuesve del se koherenca dhe kohezioni në studimet e gjuhësisë tekstore janë dy kriteret apo standardet kryesore të tekstualitetit. Kohezioni përbën strukturën sipërfaqësore të tekstit dhe është gramatikor dhe leksikor. Nga ana tjetër, koherenca tekstore paraqet strukturën e thellë, komplekse dhe shumëdimensionale të tekstit, e cila bën lidhjen tematike të tij në mënyrë të natyrshme. Gjithë kjo, vërteton se teksti si shenja më e madhe organizative e gjuhës, mund të konsiderohet si i tillë kur këto dy kriteret të tekstualitetit nuk mungojnë dhe kanë ndërvarësi mes veti.

Krahas paraqitjeve të mendimeve të studiuesve të gjuhësisë tekstore mbi konceptin „tekst” dhe kriterëve kryesore të tekstualitetit, kohezionit dhe koherencës, në punim janë dhënë konsiderata të studiuesve dhe për tipologjinë e tekstit (E.Werlich, N.Janich etj.), të cilët në këtë drejtim dallojnë grupet e tekstit, tipat e tekstit dhe format e tekstit.

Në kuadër të konsideratave teorike për tekstin, në mënyrë të veçantë jemi përqendruar në dijen teorike për rëndësinë që kanë foljet dhe konektorët për strukturën e tekstit dhe diskursit. Në këtë mes jemi fokusuar në funksionin e kohës (Tempus) në tekst, kuptimet e mënyrës së foljes (Modus), përkufizime të aspektit (Aspekt) dhe mënyrës së veprimit (Aktionsart), funksionin e vetës (Person) dhe të numrit (Numerus) në situatën e ligjëritimit, diatezën (Diathese), format e pashtjelluara të foljeve (infinite Verbformen), dhe funksionin e tyre si dhe në mendimet e studiuesve për konektorët e tekstit, gjegjësisht junktorët (Junktoren) në gjuhën shqipe dhe në gjuhën gjermane.

Njohuritë teorike shkencore nga fusha e gjuhësisë tekstore të paraqitura në pjesën e parë të studimit kanë qenë të nevojshme, sepse më kanë shërbyer për interpretim dhe analiza konkrete të teksteve shqipe që Maksimilian Lamerci i ka përkthyer në gjuhën gjermane.

Derisa në pjesën e parë të studimit është paraqitur dija teorike e domosdoshme për tekstin, konstituentët e tekstit, tipologjinë e tekstit, për foljet dhe konektorët si shenja të rëndësishme të strukturës sipërfaqësore dhe të strukturës së thellë të tekstit, në pjesën

qendrore të këtij studimi janë bërë analiza tekstore e kontrastive të teksteve, të cilat janë vendosur në fund të punimit. Gjatë analizave të teksteve të përzgjedhura në shqip dhe në gjermanisht janë bërë përpjekje të analizohen në radhë të parë rëndësia dhe funksionet që kanë foljet dhe konektorët në kuadër të strukturës së tekstit, pa lënë anash dhe shenjat nominale, determinantët si dhe referentët e tyre.

Duke trajtuar shenjat verbale në tekste jemi fokusuar sidomos në përdorimin e mënyrave dhe kohëve të tyre në këto tekste. Hulumtimi i përdorimit të dëftores dhe kohëve të saj në tekstet e analizuara dëshmon se përdorim të shpeshtë në të dy gjuhët kanë kohët e regjistrit narrativ, sepse këto tekste janë tekste narrative. Në mbështetje të analizave të bëra del se format kohore të së pakryerës dhe të më se të kryerës së dëftores së shqipes që i takojnë regjistrit narrativ, Lamberci i ka përkthyer në gjermanisht poashtu me forma kohore të regjistrit narrativ, gjegjësisht me Präteritum dhe Plusquamperfekt të mënyrës dëftore. Ndërkaq, format kohore të së kryerës së thjeshtë të dëftores së teksteve shqipe, në tekstet e analizuara në gjermanisht janë paraqitur të shumtën në Präteritum. Mirëpo, krahas kohëve të regjistrit narrativ në tekstet origjinale dhe ato të përkthyer më rrallë janë të pranishme dhe format kohore të së tashmes (Präsens) dhe të së kryerës (Perfekt) së dëftores, që i takojnë regjistrit komentues. Dhe kjo është krejtësisht e arsyeshme, meqë siç është e ditur nuk ka tekste të pastra narrative.

Në tekstet e përrallave popullore është vërejtur se marrëdhëniet kohore të foljeve si shenja kohezive të tekstit shprehin varësi të njejtë temporale mes dy gjuhëve. Varësia temporale mes fjalisë kryesore dhe fjalisë së varur, e cila paraqet zhvendosjen e kohëve në tekst shpreh njëkohëshmëri (Gleichzeitigkeit), parakohëshmëri (Vorzeitigkeit) dhe paskohëshmëri (Nachzeitigkeit).

Gjatë analizave të teksteve në vazhdim është hulumtuar funksioni tekstndërtues i lidhores (Konjunktiv) dhe kohëve të saj në të dy gjuhët. Në bazë të shqyrtimeve të përdorimit të lidhores në tekstet në gjuhën shqipe shihet se dhënësi i dërgon marrësit veprime të mundëshme dhe të detyrueshme, të cilat shprehin urdhër, qëllim, shkak dhe



kusht. Mesazhi i teksteve shqipe i shprehur përmes lidhore me këto nuanca modale kryesisht bartet edhe në tekstet e përkthyer. Mirëpo, përderisa në tekstet e analizuara shqipe shenjat kohezive verbale që realizojnë këto mesazhe shprehen kryesisht përmes lidhore, ato në gjuhën gjermane paraqiten me forma verbale të përziera si me të tashmen, të kryerën dhe të ardhmen e dëftores; të tashmen dhe të pakryerën e foljeve modale të dëftores; me lidhore; me urdhërore dhe me forma infinite të foljeve me ose pa parafjalën „zu”.

Në mbështetje të hulumtimit të funksioneve kuptimore dhe të përdorimit të mënyrës urdhërore në tekstet e analizuara në vargje dhe në prozë në të dy gjuhët rezulton se në realizimin e kohezionit dhe koherencës së këtyre teksteve edhe mënyra urdhërore krahas shenjave të tjera tekstndërtuese ka rëndësinë e vet. Nga analizat e bëra në këto tekste në plan kontrastiv del se mënyra urdhërore e shqipes në shumicën e rasteve shfaqet njësoj në tekstet e përkthyer, që do të thotë së Lamberci urdhëroren e shqipes e ka përkthyer me urdhërore në gjermanisht. Lamberci përpiket të jetë konsekuent, meqë modaliteti i dëshirës përmes urdhërores shfaqet në të dy gjuhët si urdhër i prerë, por edhe si urdhër me nuanca kuptimore të dëshirës (këshillë, kërkesë, grishje, lutje, lejim etj.). Urdhërorja duke qenë formë foljore që shpreh modalitet me nuanca dëshire ka fuqi shprehëse dhe funksion të theksuar emocional. Prandaj, në këto tekste letrare të analizuara, vlera emocionale e urdhërores që shpreh qëndrimin e folësit e shton peshën stilistike të këtyre teksteve.

Gjatë zbërthimit të optativit në shembujt e teksteve në të dy gjuhët vërehet se optativi si në përralla ashtu dhe në këngët e Lahutës del me dy vlerat e veta kuptimore – atë të urimit dhe të mallkimit. Dëshirorja e shqipes, e cila në shumicën e rasteve shfaqet me kohën e tashme që ka kuptimin e së ardhmes bartet kryesisht me elemente të lidhore (Konjunktiv I) të gjermanishtes, qoftë kur ka funksion anatemes, qoftë kur ka funksion urimi. Në tekstet e përkthyer shihet se fjalitë që shprehin urim në gjermanisht të gjitha dalin me foljen modale „mögen” në lidhore (Konjunktiv I), kurse fjalitë që shprehin mallkim përkthehen kryesisht pa folje modale, apo me ndonjë folje tjetër që gjithashtu del

në Konjunktiv I dhe shumë rrallë dëshirorja e shqipes në gjermanisht paraqitet me dëftore (Indikativ) apo mënjanohet fare dukë varfëruar fuqinë emocionale të tekstit shqip. Përfundimisht, optativi i shqipes në tekstet e analizuara, stilistikisht shfaq ndjenja shumë më fuqishëm se sa mundësia e shfaqjes së këtyre ndjenjave përmes fjalisë dëshirore në gjermanisht.

Krahas dëshirores edhe habitorja e teksteve të analizuara të shqipes shihet se nuk bartet me ekzaktësi të plotë në gjermanisht për shkak të mungesës së formave të mvetësishme të tyre në këtë gjuhë. Po t'i referohemi versioneve të teksteve të përkthyer, mungesën e formave të posaçme të habitores, Lamberci është përpjekur ta bëjë me forma të ndryshme kohore të shenjave verbale në mënyrën dëftore. Përcaktimi i Lambercit që habitoren e shqipes ta përkthejë me dëftore duket se zvogëlon emocionalitetin e habitores së shqipes. Format kohore të habitores të përdorura në tekstet shqipe, siç janë koha e tashme dhe koha e kryer në tekstet e përkthyer, Lamberci i ka dhënë me preteritin e dëftores. Edhe pse modaliteti i vërtetësisë në tekstet e përkthyer shprehet në mënyrën dëftore, ndjenja e habitës dhe ngjyrimet emocionale të saj duket se nuk realizohen në mënyrë të plotë.

Në mbështetje të hulumtimeve të bëra në tekstet shqipe të përkthyer nga Lamberci, krahasuar me përdorimin e mënyrave të tjera, kushtorja si mënyrë e foljeve, megjithë përpjekjet, nuk është gjetur në asnjë rast. Për këtë arsye, në tekste janë hulumtuar fjalitë me kuptim kushtor. Kështu, sipas përdorimit në tekste, mund të konstatohet se këto fjali janë më të pranishme në përralla dhe më rrallë në tekstet në vargje si në këngë kreshnike dhe në poemat e „Lahutës së Malcis”. Duke shqyrtuar përdorimin e fjalive kushtore në tekste shihet se fjalitë kushtore të shqipes të ndërtuara me pjesëzën mohore „pa”, në tekstet e përkthyer dalin me ndajfoljen „sonst”; fjalitë kushtore të shqipes të ndërtuara me lidhëzën „n”, në gjermanishte shfaqen poashtu me lidhëzën kushtore „wenn” (nëse). Edhe fjalitë e varura shkakore me lidhëzën „se” në raste kur mund të zëvendësohen me ndajfoljen „ndryshe” në tekstin shqip dhe me ndajfoljen „sonst” në gjermanisht, kanë vlerë kuptimore kushtore. Dhe së fundi, fjalitë e

varura kushtore, të realizuara me lidhëzën „por” në rastet e trajtuara kanë gjithashtu vlerë kuptimore kushtore në të dy gjuhët.

Veç rëndësisë së formave finite për strukturën e teksteve në të dy gjuhët, vëmëndje e posaçme në studim i është kushtuar edhe përdorimit të formave infinite të foljes, siç janë përcjellorja (Gerundium – Partizip I), paskajorja (Infinitiv) dhe pjesorja (Partizip), të cilat kanë shtrirje të gjerë në këto tekste.

Përdorimi i përcjellores në tekstet e analizuara në të dy gjuhët pothuajse shfaqet me funksione të njejta. Edhepse funksionet e përcjellores së shqipes dalin të përafërta me ato të gjermanishtes në tekste, mënyra e ndërtimit të tyre dallon në tekstet e përkthyer. Format me të cilat shprehet përcjellorja e shqipes në tekstet në gjuhën gjermane janë dëftorja (Indikativ), përcjellorja (Partizip I), infinitivi i ndërtuar me „zu” (Infinitiv mit „zu”) si dhe format e ndërtuara nga ndajfolja dhe emri.

Përkritazi me përdorimin e paskajores (Infinitiv) në tekstet shqipe të përkthyer nga Lamerci, do thënë se kjo formë infinite ka shtrirje të gjerë në to, meqë këto tekste kanë strukturë tregimtare, gjegjësisht rrëfimtare. Ky konstatim mund të bëhet qoftë kur është fjala për tekstet narrative në vargje (poemat e Lahutës, këngët kreshnike, këngët historike) apo edhe për llojet e tregimeve popullore (përrallat, gojëdhënat dhe tregimet që i përkasin letërsisë së shkruar). Në tekstet, në të cilat është gjurmuar përdorimi i paskajores së tipit „me + pjesore” i dialektit gegë të shqipes, kur në tekstet shqipe është me funksion përcaktor, në tekstet në gjuhën gjermane bartet me folje modale, infinitiv dhe me mënyrën dëftore të foljeve. Kurse, kur ka funksion qëllimor, në tekstet e përkthyer bartet në shumicën e rasteve me infinitiv me „zu”, me infinitiv pa parafjalën „zu” dhe me folje modale.

Dhe së fundi, pjesorja si formë infinite e foljeve, e cila ka tipare kuptimore e gramatikore të foljes dhe të mbiemrit të nyjshëm, në tekstet e shqyrtuara del më rrallë e përdorur krahasuar me paskajoren dhe përcjelloren. Pjesorja e shqipes në këto tekste kur ka tipare të foljes, në tekstet e përkthyer del me folje në mënyrën dëftore (Indikativ),

kurse me tipare të mbiemrit, në bazë të gjetjeve në tekstet e përkthyer, ajo ndërtohet me folje në mënyrën dëftore (Indikativ) dhe me pjesore (Partizip II).

Në kuadër të gjurmimit të konektorëve, si mekanizma të rëndësishëm kohezivë dhe tekstformues, në studim jemi përqendruar sidomos në lidhëzat si konektë që krijojnë marrëdhënie shtesore, shkakore dhe kundërshtore në tekste.

Duke hulumtuar përdorimin e lidhëzave që krijojnë marrëdhënie shtesore në tekstet e analizuara rezulton se krahas marrëdhënies së mirëfilltë shtesore, që ndërtohet me anë të lidhëzave bashkërenditëse këpujore e, dhe, edhe, ato realizojnë edhe marrëdhënie shtesore – kundërshtore apo dhe marrëdhënie shtesore me vlera shkakore mes fjalive që i bashkojnë. Struktura dhe kuptimi i marrëdhënies shtesore, që realizohet përmes këtyre lidhëzave në tekst rendit veprime, ngjarje dhe fakte e paraqitura në të. Marrëdhënia shtesore – kundërshtore në shembujt e shqyrtuar të teksteve është e barasvlerëshme në të dy gjuhët, meqë në këta shembuj konekti këpujor mund të zëvendësohet me konektin „por” të shqipes dhe „aber” të gjermanishtes. Kurse, marrëdhënia shtesore me vlera shkakore, që realizohet me konektë këpujorë në të dy gjuhët mund të zëvendësohet pa humbur kuptimin dhe me lokucione lidhëzore me kuptim shkakor në shembujt e shqipes, ndërkaq në gjermanishte edhe me lidhëza shkakore.

Në tekstet e diskutuara të shqipes, që Lamerci i ka përkthyer në gjermanisht, lidhëzat kundërshtore në tekstet e letërsisë së shkruar për nga llojet janë shumë më të pranishme se sa në përralla dhe në gojëdhëna. Ky konstatim mbështetet jo vetëm në qasjen e tregimeve të analizuara, por edhe në hulumtimin e krijimeve të tjera letrare dhe folklorike, që i kishte përkthyer Lamerci në gjermanisht. Edhe konektët kundërshtorë, të shprehur me lidhëza kundërshtore, gjatë gjurmimeve që janë bërë hetohet se në tekstet origjinale dhe të përkthyer nga Lamerci ndërtojnë marrëdhënie kundërshtore të mirëfilltë, marrëdhënie përqsore – kundërshtore, marrëdhënie kundërshtore – kufizuese dhe marrëdhënie lejore. Kështu, marrëdhënia përqsore – kundërshtore e shembujve të shqipes, në të shumtën e rasteve në tekstet e përkthyer shfaqet me marrëdhënie

përqasore – kundërshtore dhe më rrallë jepen me lidhëz lejore (konzesive Subjunktion). Ndërkaq, marrëdhëniet e tjera të teksteve shqipe, si marrëdhina kundërshtore – kufizuese dhe kundërshtore – lejore në gjuhën gjermane, jepen më së shpeshti me marrëdhënie kundërshtore të mirëfilltë dhe me rrallë me lidhëzën kundërshtore „aber” (por), e cila në rastet e shqyrtuara realizon kuptime kundërshtore lejore.

Në mbështetje të kuptimit semantik dhe të ndërtimit strukturor të fjalive, fjalitë shkakore të bashkuara me anë të konektëve shkakorë, në tekstet e analizuar paraqiten si fjali shkakore argumentuese të pyetjes, fjali shkakore të vlerësimit, fjali shkakore të drejtëpërdrejta dhe fjali shkakore përmbyllëse.

Fjalitë shkakore argumentuese të pyetjes të ndërtuara me konektin „se”, në tekstet shqipe përlligjin dhe motivojnë pyetje dhe tregojnë arsyen përse bëhet pyetja. Ndërkaq, në tekstet e përkthyer ato janë dhënë ose me lidhëzën shkakore „denn” që tregon shkakun e veprimit ose me lidhëzën e fjalive të varura pyetëse (Interrogativnebensätze) „ob”.

Fjalitë shkakore të vlerësimit, të ndërtuara me lidhëzën „se”, në tekstet shqipe tregojnë shkakun e veprimit të fjalisë kryesore duke e vlerësuar atë. Këto fjali shkakore me vlera të tilla në tekstet e përkthyer barten me lidhëzën „denn” si lidhëz e mirëfilltë shkakore apo edhe me lidhëzën krahasuese (Vergleichskonjunktion) „als ob”.

Në tekstet e analizuar hulumtimi i fjalive të varura shkakore të drejtëpërdrejta, të ndërtuara me lidhëzën shkakore „se” paraqet shkakun e fjalisë kryesore në mënyrë të drejtëpërdrejtë. Në tekstet e përkthyer fjalitë e varura shkakore të drejtëpërdrejta janë dhënë me lidhëzën e mirëfilltë „denn”.

Dhe në fund konektorët shkakorë që krijojnë marrëdhënie shkakore përmbyllëse, të shfaqura me anë të konektit shkakor „prandaj” në tekste shqipe tregojnë rrjedhën dhe përmbylljen e veprimit të fjalisë kryesore duke paraqitur shkakun e veprimit. Kurse, në tekstet në gjuhën gjermane, këto raporte mes fjalisë kryesore dhe fjalisë së varur paraqiten me ndajfoljen propozionale (Präpositionaladverb) „darum”.

Derisa në studim janë bërë përpjekje që shenjat verbale dhe konektorët të hulumtohen më gjerësisht në tekstet shqipe dhe ato të përkthyer, hulumtimi i shenjave emërore, determinantëve të tyre, referencave nominale dhe kuazi-përsëritjeve në tekste janë trajtuar më shkurtimisht.

Nga shembujt e analizuar shihet se determinantët e emrit, siç janë emrat në gjinore ose mbiemrat në tekstet e shqipes, në tekstet e përkthyer në gjermanisht barten me emra në gjinore, mbiemra ose me kompozita. Kurse, shenjat refernciale të emrit, si në tekstet e shqyrta shqipe ashtu dhe në tekstet e përkthyer, dalin me përemra pronorë, të cilët me shenjat nominale përshtaten në numër dhe gjini. Mirëpo, do theksuar se pozicioni i shenjave refernciale të përemrit në tekstet shqipe dallon nga pozicioni që zënë shenjat refernciale në tekstet e përkthyer. Këto shenja në tekstet e shqipes janë të vendosura pas emrit në të gjitha rastet, ndërkaq në tekstet në gjuhën gjermane janë të vendosura para tij.

Për sa u përket kuazi-përsëritjeve të shenjave nominale, mund të thuhet se edhe kuazi-përsëritjet kanë rëndësi të madhe në strukturën e teksteve me vlerë letrare poetike, sepse ato realizojnë efekte artistike me karakter krahasues dhe metaforik dhe janë përbërës të stilit të këngëve. Në tekstet e analizuara përmes përsëritjeve të shenjave nominale realizohet stil i veçantë. Stili bëhet dhe më i veçantë duke u rimuar vargjet njëra me tjetrën. Ndërkaq, në tekstin e përkthyer stili nuk është dhe aq i fuqishëm si në tekstin origjinal dhe vargjet nuk janë të rimuara.

Meqenëse tekstet shqipe të përkthyer nga Lamerci në gjermanisht janë krijime fiktive gjegjësisht letrare, është hetuar se sidomos shenjat verbale kanë funksion të theksuar shprehës figurativ që do të thotë se kanë rëndësi të posaçme në realizimin e stilit. Mirëpo, edhe shenjat e tjera, siç janë konektorët, të cilët bëjnë lidhjen sintaksore dhe semantike të mendimeve në tekste, poashtu kanë vlera gjuhësore-stilistike të ligjërit.

Ndër mënyrat e foljes me ngarkesë të theksuar emocionale dhe stilistike në tekstet në vargje të përkthyer nga Lamerci e sidomos në „Lahutën e Malcis”, por edhe në përralla dallohen mënyrat më të shenjëzuara apo më të markuara të verbit, siç janë dëshirorja, urdhërorja dhe habitorja. Mirëpo, kjo nuk do të thotë se folja në mënyrën dëftore, lidhore e kushtore nuk shpreh efekte ideoemocionale e stilistike në këto tekste.

Funksioni stilistik i dëshirores në tekstet e shqyrtuara në vargje dhe në prozë shpreh ndjenja të fuqishme emocionale në formë urimi, mallkimi e betimi. Krijimet narrative të Lahutës dhe të përrallave popullore me forcë shprehëse stilistike në tekstet shqipe, duket se nuk janë realizuar me forcë të njëjtë stilistike në versionet e përkthyer nga Lamerci, meqë gjuhës gjermane i mungojnë format e mvetësishme gramatikore të optativit. Megjithatë, Lamerci ka arritur të përcjellë te marrësi kuptimin stilistik të dëshirores, por me shenja verbale në Konjunktiv I dhe me shenja verbale modale, që gjithashtu përdoren në Konjunktiv I.

Vlerat stilistike të mënyrës urdhërore të teksteve të analizuar në vargje dhe në prozë arrihen me anë të zhvendosjes kuptimore të urdhërit. Duke u bërë zhvendosje kuptimore dhe kohore e urdhërores, begatohet kuptimësia e saj me nuanca të reja kuptimore si urdhër i prerë, urdhër i butë, grishje, lutje, lejim, këshillë etj. Këto nuanca kuptimore të urdhërores në tekstet e analizuar kthehen në veçori shprehëse stilistike. Shumica e nuancave kuptimore të urdhërores barten dhe krijojnë vlera kuptimore stilistike edhe në tekstet e përkthyer.

Sikurse dëshirorja ashtu edhe habitorja është mënyrë me ngarkesë shprehëse ndjenjore dhe ka potencial të fuqishëm stilistik në tekstet e analizuar. Sa u përket teksteve të përkthyer në gjuhën gjermane, shihet se në habitoren e gjermanishtes ngarkesa emocionale dhe stilistike e habitores së shqipes nuk del aq fuqishëm e realizuar. Mendojmë që kjo ndodhë për shkak se habitorja në gjuhën gjermane nuk ka forma gramatikore më vete.

Krahas formave finite të markuara të foljes, të cilat janë përbërës të veçantë të stilit, në tekstet e analizuara edhe format infinite kanë rëndësi në ndërtimin e tij. Kështu, paskajorja duke shprehur veprim në proces, përmes funksioneve të veta në tekste, paraqet imazhe poetike në strukturën e teksteve narrative, si në këngët kreshnike, poemat e Lahutës dhe në përralla popullore. Poashtu edhe përcjellorja që ka përdorim të gjerë në këto tekste, duke shoqëruar veprimin e foljes kryesore, gjuhën e teksteve e bën emocionalisht shprehëse. Kurse, pjesorja me tiparet e veta të foljes dhe të mbiemrit të nyjshëm, sidomos në këngët e Lahutës, kthehet shpesh në mjet të vlefshëm artistik.

Derisa format finite të foljes në tekstet shqipe që kanë ngarkesë stilistike dallohen nga ato të gjermanishtes, shprehësia stilistike e formave infinite të shqipes në shumicën e rasteve përafrohen me ato të gjermanishtes.

## **ZUSAMMENFASSUNG**

Die Dissertationsthese „Die Übersetzungen der albanischen Texte von Maximilian Lambertz ins Deutsche – Textanalyse“ hat das Objekt der Untersuchung den Korpus, der von Lambertz aus dem Albanischen ins Deutsche übersetzt ist. Diese Texte, die von Lambertz ins Deutsche übersetzt sind, gehören zur zeitgenössischen sowie zur traditionellen albanischen Literatur. Allerdings werden im Korpus seiner Übersetzungen, auch literarische Folkloretexte



untersucht, wie: Märchen, Sagen und epische Lieder. Hier muss erwähnt werden, daß bislang keine Studien in Bezug auf die Textanalyse dieser Übersetzungen gemacht worden sind. Daher ist das Ziel unseres Studiums, diese Übersetzungen ins rechte Licht zu rücken, nicht auf eine traditionelle Art und Weise, sie nähert sich aber dem Text und behandelt ihn als eine größere kohärente und kohäsive Einheit. Während der Untersuchungen wurde eine Auswahl der Texte getroffen. Dabei sind Texte der geschriebenen Literatur sowie mündliche Literaturtexte ausgewählt worden.

Bevor mit den textuellen und kontrastiven Analysen der von Lambertz, vom albanischen ins Deutsche übersetzten Texte begonnen wird, die die grundlegende Definition dieses Studiums stellen, finden in besonderen Kapiteln die notwendige Darstellungen, der theoretischen Überlegungen über den Text, Textstruktur, Textkonstituenten, Texttypologie, insbesondere die Überlegungen von Linguisten über die Verben und Konnektoren statt. Diese theoretischen Erkenntnisse der Textlinguistik waren sehr notwendig, weil sie uns für die Interpretationen und die konkreten Analysen der Texte in den beiden Sprachen dienen.

Wie wir oben gesagt haben, in dem Studium wir sind im Verben und Konnektoren, als wichtige Zeichen des Oberflächen- und Tiefstruktur des Textes konzentriert, insbesondere in der Funktion des Tempus, Modus, Aspekt, Aktionsart und Person der Verben. Hier haben wir festgestellt:

Indikative Tempora werden oft in den analysierten Texten von beiden Sprachen verwendet, insbesondere die Tempora von narrativen Register, weil die behandelte Texte narrative Texte sind. M. Lambertz hat „Kohën e pakryer“ und „kohën më se të kryer“ von Indikativ der albanischen Texte durch Präteritum und Plusquamperfekt übersetzt. Auf der anderen Seite sind die Zeitformen „të së kryerës së thjeshë“ des Indikativs der albanischen Texte, in den analysierten deutschen Texten am meisten durch Präteritum gegeben. Aber, außer den narrativen Zeitformen werden in den analysierten Texten auch Formen von Präsens und Perfekt verwendet, weil es keine rein narrativen Texte gibt.

Der Konjunktiv der albanischen Texte ist durch Präsens, Präteritum und Zukunft des Indikativs; Präsens und Präteritum der Modalverben im Indikativ; Imperativ und infinite Formen von Verben mit oder ohne Präposition „zu“ gegeben.

In den analysierten albanischen und übersetzten deutschen Texten, spielt auch Imperativ eine große Rolle um die Kohäsion und Kohärenz des Textes zu realisieren. In dieser Bedeutung bemerkt man, daß der Imperativ ähnlich in beiden Sprachen realisiert wird. Der Imperativ als Modalität färbige Verbform hat in beiden Sprachen starke emotionelle Funktion.

Optativ, sowie in den albanischen Märchen als auch in Liedern von der „Die Laute des Hochlandes“ stellt durch zwei Funktionen Glückwunsch und anatemische Funktion dar. In den übersetzten Texten sind die Sätze, die glückwünschliche Funktion darstellen durch Modalverb „mögen“ im Konjunktiv I gegeben, und die Sätze, die anatemische Funktion haben, werden in den ins Deutsche übersetzten Texten am meisten ohne Modalverben, oder mit einem anderen Verb im Konjunktiv I dargestellt. Albanischer Optativ stellt in den analysierten Texten stilistisch die Emotionen stärker dar als die Möglichkeit der Darstellung dieser Emotionen durch Wunschsatz ins Deutsche. Das Admirativ in den analysierten, ins Deutsche übersetzten Texte wird durch verschiedene Zeitformen des Indikativs von verbalen Zeichen gebildet. Im Albanischen wird das Admirativ durch seine syntetische Formen gebildet. In den analysierten Texten in beiden Sprachen bemerkt man, daß die Emotionen durch Admirativ in Albanischen Texten stärker als im Deutschen realisiert werden.

Während der Untersuchungen, die wir in den Texten gemacht haben, haben wir in den übersetzten Texten den Konditional nicht gefunden. Deswegen sind wir, in den analysierten Texten, in den Sätzen mit konditionale Bedeutung basiert. Daher haben wir festgestellt, daß die konditionalen Sätze mit der Negationspartikel „pa“ in den übersetzten Texten durch Adverb „sonst“ gegeben sind; konditionale Sätze des Albanischen, die durch Konjunktion „n“ gebildet werden, werden auch ins Deutschen auf konditionale Konjunktion „wenn“ ausgedrückt.

Nach der Bedeutung der finiten Verbformen in den Texten, in beiden Sprachen, haben auch infinite Verbformen eine wichtige Bedeutung, wie; Gerundium (Partizip I) , Infinitiv und Partizip, die oft in den Texten verwendet werden.

Das Gerundium der albanischen Texte wird durch Indikativ, Partizip I und Infinitiv mit „zu“ in den übersetzten Texten dargestellt.

Der Infinitiv in den originalen Texten wird sehr oft verwendet, weil diese Texte narrative Struktur haben. In den Texten, in denen die Verwendung von Infinitivtyp „ me + pjesore“

untersucht ist, mit der attributiven Funktion, tritt in den übersetzten Texten mit Modalverben, Infinitiv und Indikativ auf. Wenn es mit modalen Funktion ist, dann ist in den meisten übersetzten Fällen Infinitiv mit „zu“, Infinitiv ohne „zu“ und Modalverb gegeben.

Und das Partizip, als infinite Verbform in albanischen Texten hat zwei Bedeutungsfunktionen: Partizip mit der Funktion des Verbs und Partizip mit der Funktion des Adjektivs. Das Partizip der albanischen Texte mit der Funktion des Verbs wird in den übersetzten Texten durch Indikativ dargestellt, und mit der Funktion des Adjektivs wird durch Indikativ und Partizip II in den übersetzten Texten realisiert.

Unsere Untersuchung ist auch auf die Konnektoren, als wichtige kohäsive und textkonstituente Mechanismen, fokussiert. In dem Studium sind wir insbesondere in den Konjunktionen basiert, die als Konnekte des Textes dienen und die einfache additive Relationen, objektive kausale Relationen und adversative Relationen in den Texten bilden. Während der Untersuchung von Konjunktionen, die die additive Relationen in den albanischen Texten bilden, mit denen die Sätze durch einfache additive Konjunktionen verbunden werden, die additive Konjunktionen realisieren auch additive-adversative Relationen und additive Relationen mit kausaler Bedeutung.

Die adversativen Relationen von Sätzen in den analysierten albanischen Texten werden durch adversative Konnektoren, vergleichs-adversative Konnektoren und konzessive Konnektoren vertreten. Die vergleichs-adversative Relation der albanischen Texte wird in den übersetzten Texten von Lambertz auch durch konzessive Subjunktion realisiert. Die adversativ-konzessive Relation von albanischen Texten bildet am meisten adversative Relation in den übersetzten Texten und selten wird diese Relation durch adversative Konjunktion „aber“ gegeben, aber in behandelten Fällen realisiert adversativ-konzessive Bedeutungen.

Die kausalen Relationen in den originalen Texten werden in den kausalen-argumentativen Sätzen der Frage, kausalen Sätzen der Auswertung, direkten-kausalen Sätzen und finalen-kausalen Sätzen ausgedrückt.

Die kausalen-argumentativen Sätze der albanischen Texte werden in den deutschen Texten durch kausale Subjunktion „denn“ oder durch Konjunktion „ob“ der Interrogativs Nebensätze realisiert; die kausalen Sätze der Auswertung werden durch „denn“ oder durch

Vergleichskonjunktion „als ob“ ausgedrückt; die direkten kausalen Sätze werden durch „denn“ realisiert; und die finalen-kausalen Sätze der albanischen Texte werden in den deutschen Texten durch Präpositionaladverb „darum“ realisiert.

Neben den verbalen Zeichen in den Originaltexten und in den von Lambertz ins Deutsche übersetzten Texten, haben auch nominale Zeichen und ihre Determinanten eine besondere Bedeutung, wie: Determinanten des Genetivs, referenzielle Zeichen des Substantivs, Rekurrenz und Quasi-Rekurrenz, die die syntaktischen und semantischen Bedeutung der nominalen Zeichen erfüllen.

Die Determinanten des Substantivs, wie Substantive im Genetiv oder Adjektive, in den ins Deutsche übersetzten Texten, werden durch Adjektive oder Komposita realisiert; Referenzzeichen des Substantivs sowie in den albanischen Texten als auch in den übersetzten Texten werden durch Possesivpronomen ausgedrückt. Diese Possesivpronomen werden mit den Nominalzeichen in Numerus und Genus übereingestimmt. Und die Quasi-Rekurrenzen realisieren artistische Effekte mit vergleichs- und metaphorischem Charakter in den Texten.

## **BURIMET**

### **Korpusi i përdorur**

- Fishta, Gj. (1937): O.F.M.. Lahuta e Malcis Shtypshkronja françeskane. Shkodër.
- Jakova, K.(1960): Toka jonë, Tiranë.
- Lambertz, M. (1956): Albanien erzählt, Berlin.
- Lambertz, M. (1955): Lehrgang des albanischen, Teil II - Albanische Chrestomathie, Web deutscher Verlag der Wissenschaften, Berlin.
- Lambertz, M. (1922): Albanische Märchen (und andere Texte zur albanischen Volkskunde), Alfred Hölder, Wien.
- Lambertz, M. (1958): Die Laute des Hochlandes, Verlag R.Oldenbourg, München.
- Lambertz, M. (1958): Die Volksepik der Albaner, Halle (Salle).
- Lambertz, M. (1917): Die Volkspoesie der Albaner, Sarajevo.
- Lambertz, M. (1961): Unser Boden, Halle, (Salle).
- Lambertz, M. (1922): Zwischen Drin und Vojussa, Leipsig und Wien.
- Palaj, B. / KURTI, Donat (1937): Visaret e Kombit II – Kângë kreshnikësh dhe Legenda, Tiranë.
- Prenushi, V. (1911): Kângë popullore gegnishte, Sarajevo.

## **BIBLIOGRAFIA:**

- Abrashi, T. (2009): Frazat nominale në gjuhën gjermane dhe në gjuhën shqipe (Disertacioni i doktoratës në dorëshkrim). UP / Fakulteti i Filologjisë. Prishtinë.
- Adamzik, K. (2004): Textlinguistik. Eine einführende Darstellung. Tübingen.

- Adamzik, K. Hrsg. (2002): *Texte-Diskurse Interaktionsrollen. Analysen zur Kommunikation im öffentlichen Raum.* Tübingen.
- Admoni, W.(1990): *Historische Syntax des Deutschen.* Tübingen.
- Admoni, W.(1960): *Der Deutsche Sprachbau.* Leningrad.
- Agalliu, F. et al. (1995): *Gramatika e Gjuhës Shqipe I – Morfologjia.* Tiranë.
- Agalliu, F. (1988): *Çështje të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe.* Tiranë.
- Alerton, D.J. et al. (1979): *Function and context in linguistic analysis.* Cambridge University Press. London.
- Aliçkaj, Xh. (2000): *Lahuta e Malcis e Gjergj Fishtës.* Faik Konica. Prishtinë.
- Bausch, K.-H. (1979): *Modalität und Konjunktivgebrauch in der gesprochenen deutschen Standardsprache. (Heutiges Deutsch I, 9.1).* München.
- Beaugrande, R.-A.de / Dressler, W.U.(1981): *Einführung in die Textlinguistik. (Konzepte der Sprach-und Literaturwissenschaft, 28).* Tübingen: Max Niemeyer Verlag.
- Beci, B. (2010): *Gramatika e gjuhës shqipe për të gjithë.* Tiranë.
- Bisle – Müller, H. (1991): *Artikelwörter im Deutschen. Semantische und Pragmatische Aspekte ihrer Verwendung. (Linguistische Arbeiten, 267).* Tübingen.
- Blumenthal, P. (1977): *Sprachvergleich Deutsch – Französisch. Retromanische Arbeitshefte.* Niemeyer.
- Bokshi, B. (1984): *Prapavendosja e nyjes në gjuhët ballkanike.* Rilindja. Prishtinë.
- Bones, I. (2010): *Formale Semantik und mögliche Welten – erste Schritte in Richtung einer Modalsemantik.* Norderstedt.
- Brinker, K. (1996): *Zur Analyse der narrativen Themenentfaltung am Beispiel einer Alltagserzählung.* In: J.Hennig/J.Meier (Hrsg.), *Varietäten der deutschen Sprache. Festschrift für D.Möhn.* Frankfurt, Berlin.
- Brinker, K. (1997): *Linguistische Textanalyse. Eine Einführung in Grundbegriffe und Methoden.* Berlin.

Brinker, K. (1998): Aspekte der Textkohärenz am Beispiel einer Rundfunkpredigt. In: K.Donhauser/L.M. Eichinger (Hrsg.), Deutsche Grammatik-Thema in variationen. Festschrift f. H.-W. Eroms. Heidelberg.

Brinker, K. (2000): Textstrukturanalyse. In: Brinker/Antos/Heinemann/Sager.

Brinker, K. (2006): Ursprung und Entwicklung der Textlinguistik. In: S.Auroux/E.F.K. Koerner/H.-J. Niederehe/K. Wersteegh (Hrsg.), Geschichte der Sprachwissenschaften. Bd.3. Art.261. Berlin, New York.

Buchholz, O. / Fiedler, W. / Uhlisch, G. (1977): Wörterbuch Albanisch – Deutsch. Langenscheidt Verlag Enzyklopädie. Leipzig, Berlin, München.

Buchholz, O. / Fiedler, W. (1987): Albanische Grammatik. Verlag Enzyklopädie. Leipzig.

Bußmann, H. (1983): Lexikon der Sprachwissenschaft. Stuttgart: Körner.

Buscha, J. / Zoch, I. (1988): Der Infinitiv (Zur Theorie und Praxis des Deutschunterrichts für Ausländer. Leipzig).

Buscha, J. / Zoch, I. (1988): Der Konjunktiv (Zur Theorie und Praxis des Deutschunterrichts für Ausländer). 2.Aufl. Leipzig.

Calbert, J.P. / Vater, H. (1975): Aspekte der Modalität. (Studien zur deutschen Grammatik 1). Tübingen.

Cipo, K. (1949): Gramatika Shqipe. Instituti i Shkencavet. Tiranë.

Cipo, K. (1952): Sintaksa. Tiranë.

Crystal, D. (1977): A dictionary of Linguistics and Phonetics. Oxford. Blackwell.

Conte, M.-E. et al. (1989): Text and Discourse Connectedness: Proceedings of the Conference on Conexity and Coherence. (Studies in Language Companion Series, 16). Amsterdam.

Coseriu, E. (1980): Textlinguistik. Eine Einführung.4. Tübingen.

Coseriu, E. (1988): Sprachkompetenz. Gründzyge der Theorie des Sprechens. Tübingen.

Çabej, E. (1975): Studime gjuhësore V. Prishtinë.

Çabej, E. (1990): Epika e Gjergj Fishtës. Jeta e Re, nr.11-12. Prishtinë.

Çeliku, A. (2007): Herstellung von Textkohärenz im Deutschen und im Albanischen, Mannheim.

Çeliku, M. (2013): Format e pashtjelluara të foljes në gjuhën shqipe. Tiranë.

- Çeliku, M. et al. (2004): Gramatika dhe praktika e gjuhës shqipe. Tiranë: Botimet Toena.
- Çeliku, M. et al. (1997): Gramatika e gjuhës shqipe II – Sintaksa. Tiranë.
- Chomsky, N. (1965): Aspects of Theory of Syntax. Massachusetts.
- Chomsky, N. (1978): Studien zu Fragen der Semantik. Frankfurt – Main – Berlin: Ullstein.
- Çubelić, T. (1972): Književni lexikon. Zabreg.
- Daneš, F. (1970): Zur linguistischen Analyse der Textstruktur. In: Folia Linguistica 4.
- Danon, G. (1988): Two syntactic positions for determiners in Hebrew. In Proceedings of ITAL 13, ed.
- Demiraj, Sh. (1971): Gramatika e gjuhës shqipe – fonetika dhe morfologjia. Prishtinë: Enti i teksteve...
- Demiraj, Sh. (1970): Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe I. Tiranë.
- Dibra, K. / Vorfi, N. (2005): Gjuhësi teksti. Shkodër.
- Dijk, T. A. van (1980): Textwissenschaft. Eine interdisziplinäre Einführung. Tübingen.
- Dijk, T. A. van (1972): Some Aspects of Text Grammars. A Study in Theoretical Linguistics and Poetics. The Hague, Paris.
- Dijk, T. A. van (1977): Text and Context. Explorations in the Semantics and Pragmatics of Discourse. London, New York.
- Dijk, T. A. van (1980): Macrostructures. An interdisciplinary Study of Global Structures in Discourse, Interaction, and Cognition. Hillsdale, New Jersey.
- Domi, M. (1971): Gramatika e gjuhës shqipe – Sintaksa. Prishtinë: Enti i teksteve...
- Donhauser, K. (1986): Der Imperativ im Deutschen. Studien zur Syntax und Semantik des deutschen Modusystems (Bayreuther Beiträge zur Sprachwissenschaft, 6). Hamburg.
- Dressler, W. (1978): Hrsg. Textlinguistik. Darmstadt.
- Dressler, W. (1978): Textlinguistik (Wege der Forschung, 427). Darmstadt.
- Dressler, W. (2002): Einführung in die Textlinguistik (Konzepte der Sprach - und Literaturwissenschaft, 13). Tübingen.
- DUDEN (2006): Die Grammatik. Bd.4. Mannheim.
- DUDEN (2009): Die Grammatik. Bd.4. Mannheim.



Dykro, O. / Todorov. C. (1984): Fjalor enciklopedik i shkencave të ligjërimit. Prishtinë: Rilindja.

Dhima, Th. (2005): Gjuha shqipe – Sintaksa. Tiranë.

Eichler, W. / Bünting, K.-D. (1989): Deutsche Grammatik. Form, Leistung und Gebrauch der deutschen Gegenwartssprache. 4. Aufl. Frankfurt / Main.

Engel, U. (1988): Deutsche Grammatik. Heidelberg.

Engel, U. (1982): Syntax der deutschen Gegenwartssprache. (Grundlagen der Germanistik, 22). 2.überarb. Aufl. Berlin.

Erben, J. (1980): Deutsche Grammatik . Ein Abriß. 12.Aufl. München.

Erben, J. (1984): Deutsche Syntax. Eine Einführung. (Germanische Arbeitshefte, 31). Tübingen.

Erons, H.-W. (2000): Syntax der deutschen Sprache. Berlin / New York: Walter de Gruyter.

Floqi, S. et al (1991): Gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe – Sintaksa e periudhës.. Prishtinë. Enti i teksteve ....

Floqi, S. (1956): Fjalja e përbërë e bashkërenditur në gjuhën shqipe. „Buletin për shkencat shoqërore”. Tiranë.

Floqi, S. (1966): Periudha me fjali të varur shkakore I. Studime filologjike, nr.2. Tiranë.

Friedman, V.A. (2003): Studies on Albanian and other Balkan languages. Prishtinë.

Fries, N. (1983): Syntaktische und semantische Studien zum frei verwendeten Infinitiv und zu verwandten Erscheinungen im Deutschen (Studien zur deutschen Grammatik, 21). Tübingen.

Fries, U. (1987): The Structure of Texts. (Swiss Papers in English Language und Literature, 3). Tübingen.

Gansel, Ch. / Jürgens, F.(2009): Textlinguistik und Textgrammatik. Göttingen.

Gelhaus, H. / Latzel, S. (1974): Studien zum Tempusgebrauch im Deutschen (Institut für deutsche Sprache, Forschungsberichte, 15). Tübingen.

Halliday, M.A.K. / Hasan, R. (1977): Cohesion in English. (English Language Series, 9). 2.Aufl. London.

Halliday, M (1985): An Introduction to Functional Linguistics. London.

Harweg, R (1979): Pronomina und Textkonstitution. München.

Heinemann, W. / Viehweger, D. (1991): Textlinguistik. Eine Einführung (Reihe Germanistische Linguistik I 15, Tübingen.

Heinemann, M. / Heinemann, W. (2002): Grundlagen der Textlinguistik. Interaktion – text – Diskurs. Tübingen : Niemeyer.

Helbig, G. / Bucha, J. (1993): Deutsche Grammatik. Ein Handbuch für den Ausländerunterricht. Leipzig.

Heringer, H.-J. (1989): Grammatik und Stil. Praktische Grammatik des Deutschen. Frankfurt / Main.

Heringer, H.-J. (1988): Lesen, lehren, lernen: Eine rezeptive Grammatik des Deutschen. Tübingen.

Heringer, H.-J. (2011): Texte analysieren und verstehen. Eine linguistische Einführung. Paderborn: Wilhelm Fink.

Heim, I. & Kratzer, A. (1998): Semantics in Generative Grammar. Massachusetts / Oxford: Blackwell.

<http://www.hispanoteca.eu/Lexikon%20der%20Linguistik/t/TEXTLINGUISTIK%20nach%20Klaus%20Brinker.htm>

[http://de.wikipedia.org/wiki/Kontext\\_\(Sprachwissenschaft\)](http://de.wikipedia.org/wiki/Kontext_(Sprachwissenschaft))

[https://www.univie.ac.at/linguistics/publications/diplomarbeit/schepelmann/Daten/der\\_begriff\\_kontext.htm](https://www.univie.ac.at/linguistics/publications/diplomarbeit/schepelmann/Daten/der_begriff_kontext.htm)

Islamaj, Sh. (2004): Gjuha e Jakov Xoxës. Instituti Albanologjik i Prishtinës. Prishtinë.

Islamaj, Sh. (2012): Gjergj Fishta – Gjuha dhe stili. Prishtinë.

Ismaili, R. (1974): Shenjë e ide. Prishtinë.

Ismaili, R. (1980): Shumësia e tekstit. Prishtinë.

Iviq, M. (1977): Drejtimet në linguistikë. Rilindja Prishtinë.

Jacobs, J. (1982): Syntax und Semantik der Negation im Deutschen. (Studien zur Theoretischen Linguistik, 1). München.

Janich, N. (2008): Textlinguistik. 15 Einführungen. Tübingen: Narr.

Jokli, N. (1990): Gjykime mbi At Gjergj Fishtën dhe veprën e tij. Jeta e Re, nr.11-12. Prishtinë.

Jeperson, O. (1934): The philosophy of Grammar. London.

- Jung, W. (1982): Grammatik der deutschen Sprache. Leipzig.
- Kanzog, K. (1976): Erzählstrategie. Heidelberg.
- Kelmendi, T. (2006): Kështjellat e sintaksës. Prishtinë.
- Klisch, A.M. (2013): Textkohärenz. Heidelberg.
- Koliqi, E. (1996): Marash Uci. Jeta e Re, nr.3. Prishtinë.
- Krzyszowski, T.P. (1972): Kontrastive generative Grammatik, in: G.Nickel: Reader zur kontrastiven Linguistik. Frankfurt am Main.
- Kvam, S. (2009): Grundlagen einer textlinguistischen Übersetzungswissenschaft, Waxmann Verlag. Münster.
- Lambertz, M. (1990): Disa mendime për Fishtën dhe veprën e tij. Jeta e Re, nr.11-12. Prishtinë.
- Lang, E. (1977): Semantik der koordinative Verknüpfung. Studia grammatica, XIV. Berlin.
- Lämmert, E. (1972): Bauformen des Erzählens. Stuttgart.
- Lefèvre, M. (2000): Subordination in Syntax, Semantik und Textlinguistik. Tübingen.
- Linke, A. et al. (2001): Studienbuch Linguistik. Tübingen.
- Lohnstein, H. (1976): Formale Semantik und natürliche Sprachen. Opladen: Westdeutscher Verlag.
- Löbner, S. (2002): Semantik – Eine Einführung. Berlin: Walter de Gruyter.
- Lötscher, A. (1987): Text und Thema. Studien zur thematischen Konstituenz von Texten. (Reihe Germanistische Linguistik, 81). Tübingen.
- Lyons, J. (1980): Semantik. Bd.I. München.
- Lyons, J. (1980): Semantik. Bd.II. München.
- Lyons, J. (1968): Introduction to Theoretical Linguistics. Cambridge University Press.
- Lyons, J. (2001): Hyrje në gjuhësinë teorike. Tiranë.
- Lloshi, Xh. (1999): Stilistika dhe pragmatika. Tiranë.
- Mathews, P.H. (1997): The Concise Oxford Dictionary of Linguistics, OUP. Oxford and New York: Oxford University Press.
- Mehmeti, E. (1990): Lahuta e Malcis dhe eposi popullor. Jeta e Re, nr.11-12. Prishtinë.

Mehmeti, F. (2007): Studim përqasës i mënyrës lidhore në gjuhën gjermane dhe shqipe. (Punim i magjistraturës në dorëshkrim). UP / Fakulteti i Filologjisë. Prishtinë.

Memushaj, R. (2011): Shqipja standarde. Tiranë.

Memushaj, R. (2003): Gjuhësia gjenerative. Tiranë: Botimet Toena.

Meibauer, J. et al. (2002): Einführung in die germanistische Linguistik. Stuttgart / Weimar.

Mëniku, L. (2013): Konektorët e tekstit në gjuhën shqipe (punim për mbrojtjen e gradës „Doktor”), Tiranë.

Mujaj, H. (2004): Gjuhësia e tekstit. Prishtinë.

Neis, E. (1964): Struktur und Thematik der Traditionellen und modernen Erzählkunst.....

Newmark, L. (1982): Standard Albanian – A reference Grammar for Students. Stanford, California.

Oomen, U. (1979): Texts and sentences. Petöfi (editor). Bd.1

Palloshi, N. (1988): Kontributi i Maksimilian Lambercit në gjuhësinë shqiptare (Punim magjistrature). Prishtinë.

Pasch et al. (2003): Handbuch der deutschen Konnektoren. Berlin.

Polenz, P. von (1988): Deutsche Satzsemantik. Berlin.

Prifti, S. (1971): Sintaksa e gjuhës shqipe. Prishtinë: Enti i teksteve...

Qosja, R. (1983): Kultura e gjuhës dhe kultura e shkencës. Prishtinë.

Rafuna, S. (2012): Analizë tekstore e përqasëse e përdorimit të kohëve të shkuara në gjuhët gjermane dhe shqipe. (Disertacioni i doktoratës në dorëshkrim). UP / Fakulteti i Filologjisë. Prishtinë.

Raiable, W. (1972): Satz und Text. Untersuchungen zu vier romanischen Sprachen. (Beiehefte zur Zeit schrift für romanische Philologie, 132). Tübingen.

Ramers, K.H. (2000): Einführung in die Syntax. München: Fink.

Rath, R. (1979): Kommunikationspraxis. Analyse zur Textbildung und Textgliederung im gesprochenen Deutsch. Göttingen.

Rečnik književni termina(1985): Nolit. Beograd.

- Redder, A (1984): Modalverben im Unterrichtsdiskurs. Pragmatik der Modalverben am Beispiel eines institutionellen Diskurses. (Reihe Germanistische Linguistik, 54). Tübingen.
- Rein, K. (1983): Einführung in die Kontrastive Linguistik, Wissenschaftliche Buchgesellschaft. Darmstadt.
- Reis, M. / Rosengren, I. (1990): Fragesätze und Fragen. Referate anlässlich der 12. Jahrestagung der Deutschen Gesellschaft für Sprachwissenschaft. (Linguistische Arbeiten, 239). Tübingen.
- Riza, S. (1997): Vepra 2. Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës. Prishtinë.
